



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27 DHE 28 TETOR 2016**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 27. I 28. OKTOBRA 2016. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar për vlerat e UÇK-së në raport me situatën e krijuar

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava o vrednostima OVK-a u odnosu na nastalu situaciju

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës me kërkesë të 45 deputetëve të Kuvendit.

Fillojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat për vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në raport me situatën e krijuar

Të nderuar deputetë,
Grupi prej 45 deputetëve të Kuvendit, mbështetur në nenin 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka parashtruar kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në raport me situatën e krijuar dhe në fund të debatit të miratohet një rezolutë, teksti i së cilës do të harmonizohet nga grupet parlamentare.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që në emër të parashtruesit të kërkesës për debat ta marrë fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në emër të një pjese të deputetëve nënshkrues të një kërkesë për seancë të jashtëzakonshme, duke i falënderuar të gjithë ata, edhe të tjerët që kanë shprehur gatishmërinë të nënshkruajnë.

Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe me Kushtetutën e Republikës, ne e kemi kërkuar një debat për vlerat e UÇK-së në raport me situatën e krijuar.

Duke u bazuar në situatën e këtyre ditëve, pas shpalljes së aktgjykimit kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së, e cila ka shkaktuar shqetësime në opinionin e gjerë të qytetarët e Republikës së Kosovës, ne si deputetë të Republikës së Kosovës kemi kërkuar seancë të jashtëzakonshme dhe sot jemi këtu, duke iu falënderuar një përgjigjeje të shpejtë të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Më lejoni, zoti kryetar, që tani, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, të shpreh qëndrimin lidhur me këtë situatë dhe me kërkesën për këtë seancë të jashtëzakonshme.

Sot, pra, jemi mbledhur këtu për të shprehur shqetësimin tonë permanent dhe njëherësh për të debatuar dhe për të nxjerrë përfundime lidhur me secilin rast dhe veçanërisht me rastin e fundit dënimeve drakonike të ushtarëve dhe drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe për të shpërfaqur tendencat e hapura të qarqeve të ndryshme ndërkombëtare e vendore për ta dëmtuar imazhin e luftës sonë çlirimtare, duke e mohuar pastërtinë dhe vlerat sublime të saj në kundërshtim të rreptë me çdo normë morale, me standardet e drejtësisë bashkëkohore dhe me ligjet e shtetit të Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të gjithë jemi dëshmitarë se lufta çlirimtare ishte e drejtë dhe ishte luftë për liri, për mbijetesë përballë gjenocidit të shtetit serb, të cilit i ishim ekspozuar si shqiptarë në luftën për demokraci, të drejta njerëzore kombëtare dhe shtetbërje.

Luftën nuk e dëshiruar, por ishim të shtrënguar të luftojmë, pasi kishim dështuar në të gjitha mënyrat e tjera të provuara paqësore. Luftën çlirimtare e bëri populli, të gjithë pa dallim. Kush i rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e kush duke e përkrahur dhe ndihmuar në forma tjera të mundshme. Si e tillë, lufta jonë gëzoi dhe vazhdon të gëzojë respekt, jo vetëm te qytetarët tanë, por edhe më gjerë tek bota perëndimore demokratike dhe liridashëse.

Duke qenë luftë e pastër dhe e drejtë, lufta jonë u mbështet edhe nga faktori politik e ushtarak ndërkombëtar. Prandaj, ne meritueshëm i konsiderojmë si partner të çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës ata, posaçërisht Aleancën Veriatlantike të NATO-s dhe partnerin tonë strategjik - Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke mos e anashkaluar për asnjë çast mbështetjen e gjithanshme shembullore dhe të pashoqe të shtetit shqiptar, Shqipërisë.

Partnerët dhe miqtë ndërkombëtarë na ndihmuar edhe për luftë, edhe pas lufte, por na ndihmuan edhe tani në forcimin e shtetit, të rendit publik e të ligjit. Për këtë ne do t'u jemi mirënjohës përgjithmonë.

Të nderuar deputetë,

Ndërtimi dhe forcimi i shtetit ngërthen në vete edhe sfida të shumta. Në kontestin e zhvillimeve të fundit me fokus të përqendruar në fatin e ish-ushtarëve dhe komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndërlidhur me vendimin e gjyqësorit me rastin "Drenica", e konsiderojmë si kërkesë imediate qytetare që të trajtohet fenomeni i gjahut ndaj vlerave të UÇK-së, mbi kontestin e rrethanave politike, jo vetëm vendore, por edhe të relacioneve rajonale dhe ndërkombëtare.

Kosova është shpallur shtet sovran dhe i pavarur me ndihmën e partnerëve dhe miqve tanë, SHBA-së dhe BE-së, e këtë partneritet do ta ruajmë dhe do ta kultivojmë duke u ballafaquar edhe me argumente rreth rrugëtimit tonë të drejtë, drejt së ardhmes evropiane.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne kemi luftuar shekuj brez pas brezi që ta kemi një shtet, natyrisht shtet të së drejtës, një shtet ligjor, i cili do t'u shërbejë gjithë qytetarëve pa dallime politike, etnike, race apo gjinie. Prandaj, ne të zgjedhurit e popullit duhet të jemi të kujdesshëm që asnjë pushtet të mos degjenerojë me vendimet e tij në emër të sovranitetit politik apo ligjor. Kjo është detyra jonë karshi qytetarëve të vendit.

Në këtë kontekst, çdo herë duhet të ketë mekanizma për korrigjimin e padrejtësive, sa herë që ndodhin ato dhe nga kushdo që ndodhin ato.

Ne jemi për drejtësi, e cila do t'i gjykojë të gjitha krimet e argumentuara nga kushdo qoftë, që i ka bërë duke rënë ndesh me ligjet vendore e ndërkombëtare, duke synuar të ndërtojmë shtetin e së drejtës, të ndërtuar mbi parimet e të drejtës për të gjithë. Andaj e konsideroj se drejtësia, përveç se duhet të jetë e drejtë, ajo duhet të jetë bindëse në vendimet që i merr.

Të nderuar deputetë,

Nuk ka gjë më të padrejtë dhe me më shumë pasoja se sa kur dyshimi apo mosbesimi në drejtësi vjen si pasojë e vendimeve të saj.

Ne jemi të vetëdijshëm që askush s'duhet të jetë mbi ligjin dhe për këtë pajtohemi të gjithë. Askush nëse dëshmohet se ka bërë krime nuk duhet të mos përgjigjet për veprat e kryera. Por, fjala "dëshmi" nënkupton dëshmi që të bindet jo vetëm avokati mbrojtës, jo vetëm pala akuzues, por të binden gjithë aktorët, të binden edhe qytetarët, madje edhe i akuzuari të bindet dhe t'i pranojë shkeljet ligjore dhe të kërkojë falje për veprën e kryer. Por, fatkeqësisht po ndodh e kundërta. Po ndodhë e kundërta në procese gjyqësore ndaj ish-ushtarëve, ish-pjesëtarëve të UÇK-së, ku është duke u cenuar edhe vetë sistemi i drejtësisë dhe nocioni drejtësi për qytetarin tonë.

Ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës nuk mund të qëndrojmë si spektatorë, apo të heshtim ndonëse mund të paragjykojemi rreth vendimeve të gjykatave, të cilat nuk kanë ofruar fakte bindëse për vendimet e rënda lidhur me ish-ushtarët e UÇK-së, në rastin konkret, rastin e Drenicës.

Ne nuk guxojmë të lejojmë që për agenda politike të kujtqo qofshin të kemi vendime gjyqësore pa fakte. As si qytetarë të lirë dhe as si deputetë të Kuvendit, ne nuk guxojmë t'i mbyllim sytë kur gjyqet dhe shtetet krijojnë rend juridik mbi fakte të fabrikuara ndaj qytetarëve tanë.

Të nderuar kolegë deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Vlera subline e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lufta e pastër dhe e drejtë është vlerë e cila nuk do të lejohet nga askush dhe për asgjë të nëpërkëmbët.

E dimë se ka vullnetarë për ta luftuar këtë vlerë të dëshmuar botërisht, madje edhe vendorë, por kjo është një rrugë e gabuar, është betejë e humbur dhe do të jetë betejë gjithmonë e humbur prej tyre.

Ne të gjithë betohemi se do të punojmë për shtet të së drejtës, por në vend të përfundimit të kësaj fjalie pashmangshëm shtrohet edhe një pyetje, e cila u drejtohet të gjithë mekanizmave ndërkombëtarë brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve, sidomos të atyre të drejtësisë.

Si të binden qytetarët në drejtësinë e pretenduar nëse dikush dënohet me dëshminë e vetëm një dëshmitari të paemër për faktin se gjykata kur s'ka mundur t'ia gjejë një të tillë.

Në një rast të tillë, bindja dhe bërja për vete e besimit të qytetarëve është e pamundur. Njëkohësisht është e tejdukshme tendenca e mohimit të vlerave tona subline dhe dënimit të ushtarëve dhe komandantëve të lartë të UÇK-së në kundërshtim edhe me të gjitha standardet e drejtësisë të njohura në botë dhe me ligjet e Kosovës.

Prandaj, ne si deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës vazhdojmë të besojmë në pafajësinë e bashkëluftëtarëve në luftën e drejtë dhe të pastër të UÇK-së, si dhe kërkojmë veprime konkrete në mbrojtje të imazhit të drejtësisë. Do të vazhdojmë të mos pajtohemi për asnjë çast në aktgjykimet që kanë bërë në bazë motiveve tjera jashtë drejtësisë. Bëjmë ftesë dhe kërkojmë mbështetje edhe nga kolegët tjerë deputetë.

Të nderuar kolegë deputetë,
Po besoj që në fund të këtij debati të ulemi dhe bashkërisht ta bëjmë një dokument një rezolutë, në mënyrë që mesazhi ynë sot për t'i mbrojtur vlerat më të mira të këtij vendi, vlerat e Luftës Çlirimtare të Kosovës, të dalë i përbashkët dhe të dëshmojmë edhe një herë se në momente të tilla kur kemi të bëjë me vlerat kombëtare të gjithë duhet dhe mund të jemi bashkë.

Faleminderit për mbështetje dhe për mirëkuptim!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Ky do të jetë qëndrimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Anton Quni e ka fjalën.

Unë e kam këtë listë, atëherë kërkoj falje, por është mirë edhe kryetarët e grupeve. Urdhëro zoti Ismet Beqiri, megjithëse u bë shumë dhe këtu nuk po duket se e ke shtypur, kërkoj falje. Atëherë do të shkoj vetëm kryetarët e grupeve parlamentare, pastaj shkoj në bazë të listës. Kërkoj falje.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës nuk ka asnjë dyshim që liria që sot ne e gëzojmë, shteti i pavarur i Kosovës është rezultat i një rezistence të shumë e shumë gjeneratave nëpër vite, veçmas si rezistencës sonë aktive të udhëhequr nga presidenti Rugova, e kulmuar me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të djemve dhe të vajzave më të mira të vendit tonë dhe pa dyshim ndihmës vendimtare dhe shpëtimtare, nëse mund të thuhet ashtu, të miqve dhe përkrahësve tanë, NATO-s të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet e Bashkimit Evropian.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, qytetarët e Kosovës, nuk ka asnjë dyshim që kanë bërë luftë të drejtë, luftë çlirimtare, luftë për liri, luftë kundër gjenocidit dhe këtë fakt askush nuk mund ta mohojë në asnjë rrethanë, sepse ky është realiteti, kjo është ajo që dihet, kjo është ajo që është përkrahur nga ata që thashë dhe sot jemi këtu ku jemi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po ashtu, ne jemi të vetëdijshëm që si shtet po ndërtojmë dhe duhet të ndërtojmë institucione të pavarura, sado që është e dhimbshme, e ndjeshme dhe situatat e tilla çfarë jemi duke i parë veçmas këto ditë, pa dyshim që edhe këto situata duhet t'i tejkalojmë me qetësinë, largpamësinë dhe përkushtimin tonë për të bërit dhe të ekzistuarit e shtetit ligjor.

Këto organe shtetërore në çdo rrethanë duhet të jenë të pavarura, profesionale dhe të përgjegjshme karshi detyrave që i kryejnë.

Ne të gjithë duhet të bëjmë dhe ta japim kontributin tonë që kjo punë, do të thotë e institucioneve tona të jetë e pavarur për të gjithë dhe kjo pavarësi të reflektojë në vendime të drejta.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është shumë e qartë që asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk mund dhe nuk do të ketë dhe s'mund të ketë barazim, tentim barazimi të fajësisë, sepse është shumë e qartë se kush për vite të tëra ka bërë krime në Kosovë, policia, paramilitarët, ushtria, e pse jo mekanizmi shtetëror serb.

Dhe ne, si Lidhje Demokratike e Kosovës, siç e tha edhe kolegu më herët, në fund do ta japim kontributin tonë në mënyrë që të harmonizohen rekomandimet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rexhep Selimi e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosja”, zoti Pal Lekaj bëhet gati në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

REXHEP SELIMI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Me vëmendje e pashë listën e deputetëve nënshkrues të këtij debati dhe nuk mund të mos i dalloj ata të cilët e kanë votuar ose jo dikur Gjykatën Speciale po në këtë parlament.

Dhe, atyre që dje e kanë votuar themelimin e Gjykatës Speciale do t’u thosha çfarë kërkojnë në këtë debat, pse ata janë në këtë sallë sot, kur të njëjtit e kanë mbjellë farën për t’i dënuar luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pra, për cilat vlera flasin ata deputetë, votues të asaj gjykate, dhe cilat vlera të luftës duhet t’i mbrojnë ata deputetë, të cilët edhe në veprime të tilla i shkelin këto vlera dhe i dënojnë paraprakisht ato vlera. Pra, a nuk jeni ju këta që e keni votuar gjykatën speciale?!

A nuk jeni ju deputetët e njëjtë, jo të gjithë, le të na ndiejnë ata që nuk e ndiejnë veten aty, që keni votuar edhe për amnistinë e kriminelëve serbë dhe sot vini këtu derdhni lot krokodili për luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! A nuk jeni ju ata deputetë, të cilët keni kërkuar vazhdimin e mandatit të EULEX-it, e tash dilni kundër vendimeve të Gjykatave të EULEX-it!

Thirrja e këtij debati pas gjithë kësaj çfarë i keni bërë në fakt Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është thjesht një hipokrizi. Nuk kam si ta quaj ndryshe, përveçse se një hipokrizi. Lot krokodili për ata të cilët ju paraprakisht i keni dënuar!

Mos harroni, nuk është rasti i parë, dikur po i njëjti grup parlamentar ka bërë thirrje për të debatuar edhe për një rast tjetër, për rastin “Kiçina”. Madje atëherë na patën ardhur me një draft-rezolutë, të cilën ne parimisht e mbështetëm para debatit dhe kur erdhi koha që ta votojmë atë projektrezolutë, ta bëjmë rezolutë, të njëjtit, pra thirrësit, kërkuan prej nesh që të heqim dorë nga ajo rezolutë.

Ne dhe të gjithë ata deputetë që kemi reaguar në raste të tilla kundër këtyre veprimeve kundër UÇK-së kemi të drejtë të flasim sot. Por, ju që i keni bërë këto veprime me votën tuaj kundër UÇK-së, sot nuk keni të drejtë të flisni as në emër të luftëtarëve të UÇK-së, e as në emër të mbrojtjes së vlerave të UÇK-së. Ju nuk keni të drejtë të flisni në emër të atyre që i keni çuar në burg, sepse edhe nëse jua lejojmë ne, ata nuk ua kanë dhënë këtë mandat.

Ju nuk keni të drejtë të flisni në emër të atyre që i latë edhe pa pensione. Ju nuk keni të drejtë të flisni në emër të atyre luftëtarëve, të cilët luftuan për Kosovën, e ju sot shitni territor të asaj

Kosove, për të cilën ata ishin në gjendje të vdisnin. Ju nuk keni të drejtë të flisni në emër të atyre që ua sollët gjykatat mbi kokë.

Prandaj, sot, unë dhe të gjithë ata kolegë të mi, të cilët i kundërshtuan këto veprime tuajat, flasim ballëhapur këtu. Por, përveçse jemi ballëhapur, neve na vjen shumë keq që sot kemi ardhur në këtë situatë ku Parlamenti i Kosovës bën thjesht një lojë sa për t'ua zbutur zemrën familjarëve të tyre.

Tek e fundit, ju si pushtet nuk mund të flisni për mbrojtjen e atyre që sot po gjykohen, sepse vetë ua keni ndërtuar burgun, vetë ua keni themeluar gjykatat, e besa shpeshherë vetë ua keni ndërsyer edhe prokurorët.

Kam një pyetje për ju që e keni votuar Gjykatën Speciale: A do ta bëni të njëjtin gjë sot sikur këta të arrestuar të ishin të arrestuar te Gjykata Speciale? A do të thërrisnit debat? Ma merr mendja që ndoshta do të thërrisnit, ndoshta do ta kishit kurajën që ta thërrisni një gjykatës pas një vendimi të Gjykatës Speciale.

Që nga themelimi i Gjykatës Speciale, por edhe më herët, e deri te problemet me listat e veteranëve, të gjitha këto probleme i keni krijuar ju.

Prandaj, sot, po e pyes thirrësin e këtij debati pse s'na e keni sjellë një projektrezolutë? Sot, pra, do të duhej të ndaheshit: o me EULEX-in, o me UÇK-në! Sot nuk mund të jeni me të dyja. Prandaj, zgjidheni njërën rrugë sot me kë doni të jeni.

Dhe, në fund, nëse ky debat po mbahet sot, një debat që gjithsesi po mbahet - debat pas një vendimi, e do të duhej të mbahej një debat para një vendimi, pra sot po mbajmë debat pas vendimit të gjykatës, e do të duhej të ishte para një mendimi të Parlamentit, veç një të vërtetë e keni të sinqertë - atëherë nxirreni një rezolutë ose propozojeni një rezolutë, me të cilën ku nuk i njihni vendimet e gjykatave të EULEX-it, ku i shpallin inekzistuese këto vendimet, pastaj kërkojeni kontributin tonë. Sa për të bërë lojë, mos llogaritni në ne.

KRYETARI: Pal Lekaj e ka fjalën, ndërkohë Haxhi Shala, pastaj Zafir Berisha në emër të Grupit Parlamentar "Nisma" dhe nga "6+", Myfera Serbica-Shinik.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Ministra të PDK-së,

Ajo që më ra në sy është sot: Ku është kryeministri i Kosovës, ku janë ministrat e LDK-së, se për Stojanoviqin e di që është kah lobon në Beograd kundër Kosovës.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë,

Kosova është çliruar nga UÇK-ja me ndihmën e vendeve mike dhe me NATO-n. Këtë nuk do të mund të na mohojë askush, sado që mund të ketë tendenca për një gjë të tillë.

E fituam një betejë pra bashkë me miqtë tanë, por sot po përndiqen ata të cilët janë më meritoret për çlirimin e vendit.

Janë bërë gati dy dekada prej se e fituam Kosovën tonë të lirë, e pa administratën e pushtuesit. Thamë që u çliruam, por kjo lufta e dytë kundër djemve më të zotë të luftës çlirimtare me burgosje e aktakuza të paqena, por të cilat janë të ndërtuara të gjitha në Beograd, po del të jetë edhe më e ashpër dhe me humbje edhe më të mëdha morale, më së shumti për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Një herë e një kohë na kishte rënë Milosheviqi në shpinë, duke na thënë “terroristë e irredentistë” vetëm pse e kërkonim lirinë tonë, shtetin tonë, e kur iu përgjigjëm ushtarët me ushtarë, ai filloi të hakmerrej në popullatë civile, duke vrarë, masakruar e përdhunuar dhe dhjetëra mijëra deri në atë masë që edhe fëmijët e gratë shtatzëna nuk i kursyen.

Të gjitha këto përjetime i ndiem ne si popull, por drejtësia UNMIK, EULEX, tribunalet ndërkombëtare dhe drejtësia vendore a u morën me këtë çështje seriozisht ndonjëherë? Përgjigjja është jo.

Le të m’i thotë dikush pesë emra eminentë të udhëheqjes së policisë e ushtrisë paramilitare serbe, të cilët i kanë udhëhequr me dhjetëra masakra ndaj popullit të Kosovës, vetëm pse kanë qenë të një etnie tjetër e vetëm pse e kanë dashur lirinë, që janë arrestuar e dënuar për këto krime.

Edhe ashtu nuk do të mjaftonte, sepse Serbia ka qenë agresore në kuptimin e plotë të fjalës. Ka qenë më e motorizuar, më sofistikuar dhe në të njëjtën kohë ka qenë e pranishme në të gjitha vendet ku kanë ndodhur edhe masakrat, bile nganjëherë janë përsëritur në të njëjtin vend nga dy a tri herë vrasjet makabre ndaj civilëve shqiptarë.

Sot Serbia nuk e merr mundin të tregojë edhe për fatin e atyre që i zhdukuri e pretendon të integrohet në Bashkimin Evropian.

Sot, jam këtu para jush, kolegë deputetë, para qytetarëve nëpërmjet medieve që i falënderoj për praninë e tyre, jo për të folur kundër drejtësisë, sepse secila viktimë e cilitdo nacionalitet qoftë, është për keqardhje që ka ndodhur, por jam për të shprehur brengën time e të Grupit Parlamentar të Aleancës për mënyrën se si po bëhet kjo drejtësi.

Ne kemi treguar se jemi të hapur për organet e drejtësisë, si për ato vendore, ashtu për ato ndërkombëtare, që nga viti 2001 me UNMIK-un, pastaj me gjykatën ndërkombëtare dhe pastaj edhe me EULEX-in, i cili për çdo muaj jep dënime deri në një shekull për grupe, siç i quan ato, herë të Dukagjinit, herë të Drenicës, herë të Llapit, herë të Shalës, e tani së fundit edhe Gjykata Speciale, e cila do të jetë jashtë juridiksionit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, edhe Serbia po bën drejtësi në kurriz të Kosovës sipas saj, duke arrestuar qytetarë të Kosovës e duke i nxjerrë para gjykatave, por kriminelët e vërtetë të saj ku janë? Përkundrazi, u kanë dhënë edhe medalje për angazhimin e tyre kundër shqiptarëve. Sot janë edhe gjeneralë e komandantë të përgjithshëm të ushtrisë serbe ata të cilët do të duhej të ishin në burg. Nganjëherë të jepet të kuptosh sikur të kishim qenë ne okupatorë, e jo Serbia.

Prandaj, ta ndajmë çka është drejtësi e çka është politikë, në emër të drejtësisë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Zafir Berisha e ka fjalën. Ndërkohë të bëhet gati zonja Myfer Shinik-Serbica, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

ZAFIR BERISHA: Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar,

Kryetar i Kuvendit,

Ne sot e kemi thirrur një seancë kot, përjashtuar që kjo seancë nuk ka logjikë për të diskutuar një temë që bëhet me drejtësi. Unë e kam nënshkruar thirrjen e kësaj seance veç për të mos thënë matrapazët, injorantët dhe idiotët se Zafa nuk është për të folur për djemtë që janë në burg.

E para, kjo seancë është e thirrur për t’u hedhë hi syve qytetarëve edhe që të palarat që i ka bërë ky Kuvend për t’u munduar disi për t’u arsyetuar para qytetarëve, e në të njëjtën kohë që ju i shihni veç si votues.

Përgjegjësia ligjore e këtij Kuvendi karshi qytetarëve, veçanërisht karshi luftës është krejt tjetër, por ky Kuvend, veçanërisht kjo legjislaturë, nuk ka moral të flasë për UÇK-në, bile nuk ka të drejtë as mendja t’i shkojë.

Është kjo legjislaturë e cila ka nxjerrë ligje, vendime edhe marrëveshje ndërkombëtare për ta luftuar UÇK-në, ekskluzivisht për ta luftuar luftën e drejtë të UÇK-së dhe të shqiptarëve dhe tash ne të dalim këtu e të shesim mend para nënës së vëllezërve Demaku është më shumë se një turp që është duke e bërë kjo legjislaturë.

Komplotet e shantazhet ndaj UÇK-së nuk janë risi, nuk janë këto të fundit. Kjo është vazhdimësi. Mijëra djem e vajza të UÇK-së janë trajtuar nga organet e drejtësisë nëpër burgjet që nga viti

1999. Ju kujtohet rasti i Grupit i Dukagjinit, të Llapit, të Pashtrikut, dy grupe. Rasti më eklatant, e që dikush edhe në sallë ka përgjegjësi, është rasti i vëllezërve Kiçina e Ramadani. Por, shantazhuesit edhe të këtij grupi, që sot jemi mbledhur, kanë bërë një likuidim të një familje të fëmijëve të pafajshëm për t'i futur djemtë në burg dhe sot të vijnë të derdhin lot krokodili para qytetarëve se ne jemi për t'i mbrojtur vlerat e luftës. Kush i mbrojti vëllezërit Kiçina dhe Ramadani? Paraprakisht djali i 'shkinës', i Radomillës, që sot ka të drejtë dhe merr guximin të shkruaj edhe ndaj bashkëshorteve të luftëtarëve e t'i fyejë nëpër medie.

Ne nuk mund që me seanca kot të lahem dhe t'i lajmë gjynahet që i kemi bërë ndaj djemve dhe vajzave të UÇK-së.

Barazimi i luftës çlirimtare dhe luftës okupuese, siç thashë, është vazhdimësi. E keqja është se pjesë e këtij barazimi janë edhe njerëzit të cilët thirren në emër të luftës, janë edhe shqiptarët të cilët për interesa të ngushta meskine janë në gjendje që çdo gjë ta devalvojnë është në këtë vend, vetëm e vetëm që t'i ruajnë pozicionet momentale.

Unë mendoj se barazimi i kësaj lufte që ka filluar më herët është duhur të ndalet me vendime dhe ligje, e jo me rezoluta kot, të propozuara dhe që do të propozohen, megjithëse unë e kam edhe një propozim në atë rezolutë të famshme.

Njerëzit, duke e harruar gjakun e derdhur për këtë vend, duke i harruar djemtë dhe vajzat më të mirë të këtij vendi ia kanë shtrirë dorën regjimit të Milosheviqit.

Ia kanë shtrirë dorën Daçiçit, që është pasardhës i Milosheviqit. Ia shtrin dorën Vuçiqit, që është pasardhës i Sheshelit. Me një fjalë, e kanë legalizuar dhe legjitimuar politikën gjenocidiale të Serbisë ndaj Kosovës. Pse? Vetëm e vetëm për ta ruajtur pozicionin momental në politikë.

Nuk mund ky Kuvend të bëjë hapa të drejtë për ta mbrojtur vlerën, që quhet UÇK.

Përgjegjësi për devalvimin e kësaj lufte kanë shumë njerëz, por njëri është kryesori dhe ai e ka emrin Hashim Thaçi. Përderisa ai njeri nuk del publikisht e ta pranojë se cili është misioni i tij për Kosovën, ne mund të flasim fjalë të kota në këtë Kuvend.

Ai njeri, përpos që me rezolutë duhet të shpallet tradhtar i këtij vendi dhe i gjithë lakenjtë e tij që kanë mbajtur dhjetëra e dhjetëra takime të fshehta dhe kanë bërë dosje komplete deri tash për djemtë e UÇK-së dhe për dënimet dhe gjykimet që priten të bëhen.

Nuk pastrohet njeriu duke dhënë dorëheqje nga ministri i Drejtësisë. Një fjalë popullore thotë: "Në rast se pitja është hëngër tepsia ka mbetur". Për gjithë atë punë që e keni bërë kundër Kosovës dhe kundër vlerës së vetme, që është UÇK-ja, herët a vonë do të jepni përgjegjësi.

Unë po besoj se për ju, të nderuar kolegë deputetë, dhe për qytetarët është më se e qartë se letrat e fundit të kryetradhtarit Hashim Thaçi janë vazhdimësi e komplotit që i bëhet së kaluarës të lavdishme dhe perspektivës evropiane të këtij vendi.

Ato letra kanë adresa të qarta. Nuk e ka në adresë Serbinë, sepse ai veç është mësuar me Serbinë. I ka adresë djemtë dhe vajzat dhe unë dyshoj me të drejtë se prapa atyre letrave ai edhe emrat i ka dërguar se kë duhet çua në burg. Pse? Sepse, duke barazuar luftën çlirimtare dhe luftën okupuese të Serbisë, ai mendon në afat më të gjatë të jetë në politikë dhe t'i realizojë projektet djallëzore të vendeve jomike dhe të shërbimeve të huaja.

Kështu që propozimi im konkret është: Në rast se shkohet me një rezolutë të kotë, pika e parë të jetë që Hashim Thaçi të shpallet tradhtar i vendit dhe organet të merret me atë injorant, i cili shokët, miqtë e vet, djemtë dhe vajzat është duke i përdhosur skajshmërisht. Faleminderit!

KRYETARI: Kolegë deputetë,

Të kisha lutur mos i jep shumë zor në gjykime, Ju si individë, fillojeni peticionin, shikoni sa keni përkrahje, por nuk është mirë të shfrytëzohet foltorja e Kuvendit, se ne e kemi një rast konkret, diskutojmë rreth kësaj çështjeje e jo ta shfrytëzojmë foltoren për sulme të brendshme. Nuk është mirë. Kjo nuk është korrekte.

Vazhdojmë me zonjën Myfera Serbica-Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

MÛFERRA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryetar!

Herkesi saygıyla selamlıyorum,

Bilindiği üzere Kosova'nın bağımsız bir devlet, demokratik bir yapı ve tüm toplumların özgürce bir yaşayabilmesi için en büyük rolü Kosova Kurtuluş Ordusu üstlenmiştir. Elbette ki bugünkü konuma ulaşmamızda verdiğimiz şehitlerin katkısı çok büyüktür. Bu arada şehitlerimizi rahmetle anıyoruz. Son yıllarda özellikle son günlerde Kosova Kurtuluş Ordusuna karşı yapılan suçlamalar, karalamalar bizler tarafından kabul edilebilir bir durum değildir. Kosova'yi destekleyen uluslararası güçlerle ortak hareket eden KKO mensuplarının bazı çevreler tarafından suçlanmasına anlam veremeyiz. Hukuk üstünlüğüne inandığımızı belirterek müdahil olmak istemeyiz, ancak önyargılı suçlamaların da kararların alınmasına da karşı olduğumuzu bildirmekteyiz. KKO'nun Kosova'nın bağımsızlığına katkısının bilincinde olan Kosova Türk, Boşnak, Rom ve Aşkalı toplumlarının önemli bir değere sahip olduğunu ve her zaman da bu değerlerin savunucusu olacaklarını, “6+” PG grubu olarak belirtmek isteriz.

Teşekkür ederim...

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë kryetarët - përfaqësuesit e grupeve parlamentare i kanë dhënë qëndrimet e tyre.

Jemi te përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës së Kosovës, zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hajredin Kuçi e ka fjalën.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Unë besoj që në fillim ka nevojë që të jepet një arsyeshmëri për debatin e sotëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ne të gjithë që jemi në këtë sallë, besoj në veçanti ne që jemi juristë e kemi të qartë se ndarja e pushteteve është postulat i sistemit tonë juridik, natyrisht i njohur edhe prej nesh, edhe me Kushtetutë, edhe vendeve tjera.

Debati i sotëm besoj i ka dy qëllime. Qëllimi i parë e ka që ta kemi të qartë të drejtën prej drejtësisë. Shpeshherë ajo çka është e drejtë duket që nuk është drejtësi, ose e kundërta. Dhe e dyta, për disa vlera që ne po supozojmë që po cenohen.

Dhe, më lejoni të them që në këto dy drejtime ne duhet të jemi të fokusuar, pa e cenuar sistemin e pavarur të drejtësisë edhe vetë lufta e njerëzve tanë, e angazhimit tonë, e UÇK-së, ka qenë që ta kemi një sistem demokratik të bazuar në rend dhe ligj.

Sa i përket çështjes që ka të bëjë me drejtësinë, besoj se ne duhet të kemi të qartë se duhet të jemi të bindur, jo vetëm gjyqtari, po parimi i publicitetit nënkupton edhe të tjerët, përfshin edhe qytetarët e Republikës së Kosovës, që në rastin konkret duket se qytetarët nuk janë të bindur që vendimi i tillë është edhe i drejtë.

Ne shpeshherë flasim për vlerat e ndryshme dhe nganjëherë tentojmë t'i monopolizojmë këto vlera, apo edhe t'i kundërshtojmë.

Më lejoni të them se nuk mund të flasim për UÇK-në pa folur për vlerat e saj. Vlerat e saj janë vlerat sublime të një kombi, vlerat më sublime mund të them prej luftës së Skënderbeut e deri më sot.

Më lejoni të them po ashtu që UÇK-ja i ka themeluesit e vet, i ka njerëzit e vet, komandantët e vet, ushtarët e vet dhe UÇK-në duhet ta shohim ajo që ka qenë dje, që është sot dhe ajo që duhet të jetë nesër.

Ajo që ka qenë dje është më shumë se një emër, është më shumë se krejt ushtarët e UÇK-së, më shumë se krejt komandantët, është një mision i një populli për liri për pavarësi.

Çka është sot? Nganjëherë është garë politike. Ne që jemi në parti të ndryshme politike e shohim si garë, që nuk duhet të jetë. Nganjëherë jemi konkurrentë, nganjëherë jemi të gabueshëm dhe në momente të caktuara jemi edhe konfrontues për disa vlera që unë do t'i quaja ADN-ja e shtetit.

Për UÇK-në unë jam i bindur që do të jetë më e mirë në sytë e qytetarëve. Pse po e them më e mirë? Se nuk do të jemi gjallë ne konkurrentët sot, nuk do të jemi ata të cilët fitojmë nëse e lavdërojmë ose shajmë UÇK-në, dhe unë e marr pozitive, po e zëmë, kur vlerat e UÇK-së shpërmdahen dhe unë mendoj që nuk i takojmë një partie, një individ, një subjekti, apo edhe më shumë se një familje. Mua më gëzon fakti kur e shoh zotin Quni deputet në LDK. Dhe kjo nuk ka diçka të keqe.

Hajde të provojmë që këto vlera t'i bëjmë vlera të përbashkëta kombëtare. Hajde të provojmë t'i bëjmë me ligj. Dhe, unë mendoj që në këtë drejtim duhet të punojmë më shumë në kuptimin juridik.

Sa i përket sistemit të drejtësisë, drejtësia tranzicionale, në veçanti kjo ndërkombëtare e ka parasysh paqen dhe drejtësinë dhe shpeshherë nuk ka qenë e drejtë. Shikoni, shpeshherë s'ka qenë e drejtë, se në emër të paqes tenton nganjëherë të bëjë drejtësi e unë mendoj se drejtësia vendoset vetëm në bazë të fakteve, e jo me çështje të tjera.

Ne nuk mund ta përmendim UÇK-në sot dhe ta mbrojmë UÇK-në duke i kundërshtuar themeluesit e saj.

Nuk mund askush ta përmendë UÇK-në pa Adem Jasharin, pa Luanin e Shkëlzenin, pa Zahir Pajazitin, nuk mund pa Agim Ramadanin e plot të tjerë, po hajde dalim një fazë më tutje, po edhe Adem Jasharin s'mund ta përmendësh pa e përmendur Sylën e Samiun, as s'mundesh Luanin pa e përmendur Ramushin, as s'mundesh Zahirin pa e përmendur Remin, as s'mundesh Agimin pa e përmendur Antonin. Pra, të mos e bëjmë një shkëputje me thikë se ky është kështu, ky është kështu dhe vetëm të vrarët janë të mirë e këta të gjallët janë të koritshim. Unë nuk mendoj ashtu.

Unë mendoj që atëherë kur është bërë UÇK-ja e deri më 12 qershor 1999, ajo është e paprekshme dhe këtu duhet pasur edhe ligj, edhe vlerë, edhe të gjitha tjerat, e jo për ndonjë konkurrencë politike.

Por, për hir të asaj që kanë lindur ata njerëz pas 1999, për hir të atyre që do të lindin pasi të vdesin krejt këta që kanë qenë UÇK, për hir të atyre që kanë për t'i fituar votat pa e përmendur UÇK-në dhe ne këtu duhet ta kemi parasysh dhe në këtë drejtim nganjëherë po ngutemi.

Të mos e harrojmë një: lufta e UÇK-së ka qenë për ta ndërtuar një shtet ligjor, shtet demokratik, një liri, një shkollim të mirë, një edukim dhe në këtë drejtim ne duhet të jemi të kujdesshëm. Në raport me faktorin ndërkombëtar duhet t'i themi: "Bëjeni atë që e bëni në shtetit tuaj", hiç kurrëgjë tjetër mos kërkon.

Unë i ftoj gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it dhe të tjerët ta bëjnë atë që e bëjnë në shtetin e tyre. Unë e pranoj një drejtësi të tillë, por nuk pranoj drejtësi që nuk do ta bëni në asnjë shtet anëtar të BE-së dhe këtu duhet të jemi të qartë. Domethënë, ne po flasim për vlera të drejtësisë si vlera sublime, a po flasim prej rastit në rast. U përmend edhe rasti, që të mos i mbetem borxh Zafirit, si indirekt të mos e shohë veten në monopolin e UÇK-së. Dhe unë po e them me bindje të plotë, krejt çka ka prej 2 janar 1971, e deri sot këqyrni lirisht. Premtoj që në fund do të dalë CV-ja ime më e mirë se jotja dhe s'kam kurrëgjë në jetë të fsheh.

Në anën tjetër, më lejoni të them që ne duhet të jemi të kujdesshëm në veprimet tona. Pse po e them duhet të jemi të kujdesshëm? Ky rasti, "Drenica 2", ky rast është që na ka vënë në vëmendje dhe nuk mund ta diskutojmë një çështje të tillë pa i përmendur emrat konkretë. Unë e kam thënë më herët në këtë Kuvend, e kam thënë jashtë këtij Kuvendi, asnjë fjali nuk e heq prej asaj që kam thënë. Por, po e them shumë hapur, ata që mendojnë të rrisin pajtueshmërinë mes popujve përmes dënimeve të tilla, e kanë gabim.

Këta njerëz kanë qenë dje hero, "fatkeqësisht" po them, këto aktgjykime po i bëni edhe sot hero, a nesër sigurisht do të mbesin hero. Dhe, unë po them që kanë qenë njëherë hero mjaft, s'ka pasur nevojë që të bëhen heronj me këto aktgjykime. Ka pasur nevojë të bëhen sikur ne, konkurrent, kryetar, kritikues, debatues dhe këto raste nganjëherë po na e krijojnë ambientin që ne nuk jemi shumë të lirë që të flasim.

Unë e di që ka kritika që u bëhet njerëzve të tillë edhe për hir të asaj që identifikohen në partitë e ndryshme, PDK-në, AAK-në, "Nismën", deri diku. UÇK-ja identifikohet me vlerat e popullit. Njerëzit e saj mund të jenë sot futbollistë të mirë, mund të jenë lojtarë të mirë, mund të jenë politikanë të mirë ose më të dobët. Por, nëse dikush ka qenë në UÇK dhe sot e jep një gol, e ka vlerën e tij, nëse dikush ka qenë në UÇK e sot është kryetar komune ose kryeministër, ose diçka tjetër, kryetar vendi, unë po ua përmend vetëm një shembull. Tre presidentë të SHBA-së kanë qenë komandantë, pastaj kanë qenë presidentë, por kanë fituar me vota. Krejt këta që nga pak i shohim me xheloz, edhe në këtë vend, pozitë- opozitë, janë njerëzit që kanë fituar me vota.

Dhe, çka do të thotë, e ka përmendur dikush UÇK-në, në punën e tij, por normale është, dikush e përdor dijen që të fitojë vota, dikush e përdor autoritetin, dikush bukurinë, dikush atë, dikush këtë dhe në krejt botën ndodh kjo. Por, nëse është legjitim para qytetarëve, duhet ta ketë. Dhe, e fundit, unë mendoj se UÇK-ja është vlerë që na bashkon. Nuk mund ta mbrojmë askush UÇK-në duke i sulmuar themeluesit e UÇK-së. Nuk ka luftë të madhe të UÇK-së me komandantë të

vegjël, mbajeni në mend këtë. Edhe Napoleon Bonaparta nuk ka qenë qysh mendojnë ata, por e ka verifikuar populli francez, ne i kemi luftëtarët tonë, njerëzit tonë.

Tash jemi konkurrentë, konkurrencën nga 12 qershor e këndeje e bëjmë sa të jemi gjallë. Para 12 qershorit s'jemi konkurrentë në ato vlera. Dhe, unë ju ftoj sot që të jemi unik dhe në rezolutën, edhe le të shtojë pika cilido grup parlamentar, edhe të bëjmë një rezolutë të përbashkët dhe në fund të dalim që UÇK-ja nuk është objekt që e ndan këtë Kuvend, që e ndan këtë popull, e kundërta. Partitë politike bëjnë gara dhe unë mendoj që këto gara janë krejt normale dhe do të shtyhem sa të jemi gjallë, bile sa herë të munden do t'i mund edhe Zafirin, edhe tjerët. Faleminderit!

KRYESUESI: E ka të drejtën e replikës deputeti Zafir Berisha. Urdhëro, Zafir!

ZAFIR BERISHA: Zoti Kuçi, për biografinë dhe CV-në, unë është shumë e vërtetë, tregoj diçka që di ta përsëris. Biografia ime kur unë me katër vëllezër në vitet e '80-ta kam qenë nëpër burgjet e regjimit fashist të Serbisë, ti ke qenë milic në Vushtrri, kjo është.

Sa u përket komandantëve të mëdhenj dhe të vegjël, besojmë se e di, se historia njih mirë, veçanërisht e shqiptarëve, shumë patriotë që kanë filluar angazhimin për çështje kombëtare kanë përfunduar bashkëpunëtorë të mbretit për dy qypa lira. Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëro, një minutë, zoti Kuçi!

HAJREDIN KUÇI: Unë jam i lindur më 2 janar 1971, në vitet e '80-ta i kam pasur 9 vjet, më '89-'90 i kam pasur 18 vjet, pa i bërë 19 ende, është e vërtetë dhe kam qenë nxënës i shkëlqyer, bile, por kurrë në jetë s'i kam bërë veprim antikombëtar vendit tim dhe po të them shikoje CV-në.

Sa u përket komandantëve, unë fola deri më 12 qershor '99, edhe për ty, Zafir, pas 12 qershorit '99, Zoti të ndihmoftë ty dhe të gjithë të tjerëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYETARI KADRI VESELI: Mirdita, të gjithëve, ju përshëndes!

Në fakt, jam përgatitur për sot me një fjalim, të cilën dëshiroj ta lexoj, por realisht situata në të cilën jemi në ambientin e Kuvendit, Zafir, shumë pak po na lë të përçojmë mesazh së pari te qytetarët, të njerëzillëkut. Për këtë arsye nuk po flas më shumë. I ke kontributet tua, i ke kontributet e jashtëzakonshme, edhe si familje, është e vërtetë s'mund t'i heqë askush, por nuk bën asnjëherë në emër të kontributeve ta goditni tjetrin.

Shumë rëndë e godite dhe pa nevojë, ty të vjen rëndë se ta them, unë s'kam dalë të polemizoj me ty e me asnjë tjetër, kam dalë vetëm të flas,ta them mendimin tim, qëndrimin tim politik edhe si kryetar i Kuvendit, edhe si kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, edhe si ish-luftëtar i lirisë edhe si qytetar i këtij vendi.

Por, shumë lehtë është veç të mundohesh të godasësh. Për shembull, ish-zëvendëskryeministri aktualisht, një djalë i ri,i ka shërbyer Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka qenë bashkarish me ne. Po, ka qenë edhe ish-polic. Po e a di ti, Zafir, se edhe emblema e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë polic, njëjtë sikurse ky.

Zahir Pajaziti, Zafir, nuk duhet ndarë popullin se të gjithë, pa u bërë të gjithë bashkë s'kishim arritur lirinë. Derisa e ndajmë njëri-tjetrin,s'do t'i kemi mirë punët. Kanë për të na dënuar çdo kush, mund ta përdorë, e kemi ditur paraprakisht kur kemi ardhur këtu, këtë seancë mund ta përdorë dikush tash të godasë njëri-tjetrin, por nuk kemi për t'u dhënë mesazh të mirë njerëzve, por as këtij vendi. Mundohuni nga pak sa të mundeni të respektoni, të gjithë kemi familje, të gjithë kemi fëmijë, ruajeni njëri-tjetrin, ju kisha lutur sa të mundeni. Ruajeni! Për Zot, për atë gjak që është derdhur, thjesht. Pastaj, neve çka kemi mbetur gjallë pas '99-ës gjykimit asnjëri s'do t'i shpëtojmë.

Do të kthehem te pjesa e fjalimit tim për vlerat e UÇK-së, për bashkëluftëtarët e mi. Do të nisem me një rrëfim,i cili është shumë personal, i cili nuk është veç personal, se s'jam unë personalisht, por fatmirësisht në këtë rrëfim, të cilin e them këtu, ka qenë edhe një koleg imi, i cili është këtu, i opozitës, bashkëluftëtar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

7 prill 1999, Zona Operative e Drenicës. Kur mijëra trupa të ushtrisë serbe kishin mësyre territorin e Kosovës, njësi militare, paramilitare, policë serbë, dëbonin, vrisnin dhe dhunonin shqiptarët e Kosovës. Në një pjesë të saj, përkatësisht në Drenicë,Brigada elite e UÇK-së 111 zhvillonte luftime për jetë a vdekje në grykat e maleve, aty ku qëndronte popullata civile dhe qindra të plagosur, ushtarë dhe civilë. Vuajtjet ishin të mëdha, dhimbja ishte e rëndë, por edhe vendosmëria për qëndresë ishte e pathyeshme. Drenica nuk po dorëzohej, ashtu si e tërë Kosova.

Në mbrëmje të asaj dite, të gjendur në një perimetër rrethimi të hekurt, nga pjesa e malit Kosmaq, ku ishim të vendosur,u bashkuam me bashkëluftëtarët e tjerë në fshatin Baicë. Aty morëm bilancin tragjik të asaj dite të rëndë luftimesh: tre luftëtarë të rënë nga Brigada 111: Ymer Shala, Bedri Demaku dhe Xhevat Demaku. E falënderoj doktor Fadilin,i cili te plagosja e Bedriut u mundua të bëjë të pamundurën, nuk arriti.

Atë kohë çdo ditë, deri në përfundimin e luftës ne përballeshim me lajme të tilla të rënda, e gjithë Kosova po paguante një çmim të madh për lirinë e saj. E veçanta e këtij rrëfimi dhe asaj dite është më domethënëse për sot, jo vetëm për ndërlidhjen e kësaj ngjarje me rastin e fundit, por me

një përshkrim që do të mundohem ta sjell ashtu si unë e pashë dhe e përjetova atë mesnatë, para mëngjesit të ri, që do të ishte po aq i rëndë në vazhdimin e deri në përfundimin e luftës tonë, më 12 qershor.

U nisëm drejt Obri për t'i varrosur tre bashkëluftëtarët e rënë, atë natë të 7 prillit, nuk mundëm të përdornim as drita, as makina, varrimi zakonisht bëhej në terr. Largësia nga forcat e armikut nuk ishte më shumë se perimetri i goditjes së revoles, mund të binim në pritë nga çasti në çast. Arritëm në Obri pas mesnate dhe u futëm të heshtur dhe zemërthyer në një dhomë të mbetur në një shtëpi gjysmë të rrënuar.

Brenda dhomës qëndronin tre trupa të shtrirë të pajetë. Tre djem të rinj me uniforma të tyre dhe plagë e trup të gjakosur, më shumë se dhjetë ushtarë të njësisë speciale të Brigadës 111, qëndronin rreth trupave të tyre, të mërzhitur dhe pa fjalë!

Në dhomë ishin dhe prindërit e njërit prej këtyre heronjve të rënë. Duke u munduar të gjenim ca fjalë për t'i ngushëlluar, nëna e heroit, duke parë mërzhinë tonë, na pa në sy dhe na tha: "Djemtë e mi, bëni gajret, bëhuni të fortë, kur hasmi, të tjerët vijnë dhe vdesin në tokën e huaj, pse djemtë e mi të mos vdesin për Kosovën. Hallall i qofshin krejt djemtë e mi kësaj toke!".

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo ishte nëna e Xhevat Demakut, hero i rënë në luftë për liri atë ditë, nëna e Zeqirit, Jahirit, Fadilit dhe Nexhat Demakut. Të pestë djemtë e saj, të gjithë ishin vënë në mbrojtje të atdheut. Këta prindër e kishin edhe një vajzë të vetme, edhe ajo po atë ditë të rënies së Xhevatit, së bashku me djalin e vetë, Mirgetin, në fshatin Çabiq, tre vjeç, u vranë nga ushtria serbe, ndërsa vajzën tjetër, dy vajzat e tjera, në fakt, por njëra nga ato që mbijetoi, mezi arritëm ta tërhiqnim nga zonat e luftës, janë këtu shumë bashkëluftëtarë, të cilët e dinë. E shpëtuam nga fati i nënës dhe motrës së vogël, por u vonuam t'ia shpëtonim dorën.

Sot ajo jeton në Francë, me kujtimin për nënën, motrën dhe shumë dajallarë të rënë. Familja Demaku i ka gjashtë pjesëtarë të familjes të rënë për liri. Jeton pa dorën e saj, të amputuar në kohë lufte si pasojë e shkaktuar nga plagët e plumbave të armikut.

Sot, kjo nënë e madhe e vëllezërve Demaku padrejtësisht duhet të durojë një dhimbje tjetër: edhe katër djemtë e tjerë të saj, vëllezërit e Xhevatit dëshmor, katër luftëtarë të lirisë, bashkë me komandantin trim të sa e sa betejave, komandantin e përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Sylejman Selimin, bashkëluftëtarin Hysni Thaçin dhe Bashkim Demiğin me tre vëllezër të tjerë, keni parasysh, është për ironi, njëri nga vëllezërit Demiqi kurrë s'ka qenë në Kosovë gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe është i dënuar tani në procesin të cilin janë dënuar para sa ditësh me disa vjet burgim.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftoi për t'i dhënë fund regjimit aparteid serb, ku shqiptarët trajtoheshin si qytetarë të dorës së dytë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës luftoi për të ndërtuar një shoqëri të lirë, ku sundon drejtësia, ku të gjithë janë të barabartë para ligjit. Për të krijuar një shtet, ku një qytetar mund të dënohet vetëm pas një procesi të ndershëm gjyqësor, ku fajësia provohet nëpërmjet provave të qarta, të besueshme dhe bindëse.

Për një sistem evropian të drejtësisë, ku pasi fajësia të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, edhe dënimi të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë. E kemi sakrifikuar që të ndërtojmë një shtet të pavarur, të mbështetur në parimet e demokracisë, në parim politika nuk duhet të ketë involvim në çështjet gjyqësore, kjo është ajo çfarë më së shumti i duhet Kosovës, i duhet të ardhmes së saj euro-atlantike.

Partia Demokratike e Kosovës ka besuar dhe beson fuqishëm te ky parim themelor kushtetues dhe demokratik. Kjo ka qenë arsyeja edhe pse kemi heshtur, pse nuk kemi reaguar asnjëherë edhe kur kemi pas shumë dilema në veprime të caktuara të gjyqësorit. Për t'i hapur rrugën drejtësisë, Latif Gashi dhe Rustem Mustafa janë larguar nga pozita e deputetit në këtë mandat. Më herët Ramush Haradinaj e ka lëshuar pozitën e kryeministrit, po ashtu edhe Fatmir Limaj pozitën e deputetit.

Po ashtu, edhe kur u arrestua Azem Syla, unë e kam mbështetur largimin e tij nga të gjitha përgjegjësitë institucionale, edhe tash me vetiniciativë Fadili dhe Nexhati kanë lëshuar pozitat e tyre politike. Ne po zbatojmë parimin e drejtësisë, mirëpo me kalimin e kohës po shohim se shqetësimet e qytetarëve dhe tonat me këto procese po bëhen edhe më të mëdha.

Nuk ka asgjë më shqetësuese në një vend se sa kur në emër të drejtësisë shkaktohet pasiguria. Nuk ka padrejtësi më të madhe se sa ajo që mund të bëhet në emër të drejtësisë.

Kolegë të nderuar,

Parimi i shtetit ligjor dhe i mosndërhyrjes janë parime bazë mbi të cilat angazhohemi, dhe jemi të vendosur në këtë shtet: asnjë ndërhyrje në çështjet e gjyqësorit! Këtë parim, si dje për liri, kemi qenë të gatshëm dhe kemi pranuar edhe çmimin e kërkuar nga ne, që edhe jashtë vendit tonë të ndahet drejtësi mbi dilemat e padrejta të vëna mbi luftën tonë. Dhe, ne mund të pranojmë çdo çmim dhe sakrificë individuale, e them edhe sot me këtë qëllim, pa asnjë dyshim dhe nuk kemi asnjë dilemë në këtë drejtim. Disa as nuk mund ta imagjinojnë këtë gatishmëri të luftëtarëve të lirisë për t'u ballafaquar me çdo pasojë në emër të sakrifikimit për shtetin tonë të ri, disa edhe mund të abuzojnë këtë gatishmëri tonë në kuadër të lojërave së luftës, të cilat i kemi për pushtet politik.

Sido që të jetë, kam qëndruar dhe qëndroj mbi parimin se liria e personit dhe fati i tij është më pak e vlefshme se liria e popullit tonë dhe sovraniteti i shtetit tonë. Ky është kriteri mbi të cilin qëndroj sot edhe këtu, por pranimi i standardeve jobalancuese të drejtësisë nga ne si shqiptarë në Kosovë, do të thotë ky pranim, se kemi pranuar edhe Gjykatën Speciale, nuk nënkupton edhe legjitimin e cenimit të moralit njerëzor dhe kauzës sonë për liri, as UÇK-së dhe as më pak cenimin e shtetit tonë të pavarur dhe sovran.

Shqetësimi qytetar dhe yni është se në këto procese ka mangësi, ka mangësi të dukshme të zbatueshmërisë së ligjeve në fuqi dhe ballafaqimit apolitik të fakteve dhe provave. E thashë edhe më herët, njëri nga njerëzit e dënuar s'ka qenë fare në Kosovë dhe ka një tendencë të ndëshkimit me çdo kusht të luftëtarëve të lirisë. Kjo po shkakton mosbesim dhe frikë te qytetarët, se diçka nuk është në rregull me standardet e kërkuara nga drejtësia. Ish-luftëtarët e UÇK-së janë të gatshëm t'i nënshtrohen individualisht parimit të barazisë para drejtësisë. Asnjëherë s'i kanë ikur, as nuk do t'i ikin as në të ardhmen.

Për t'i hequr dilemat rënduese dhe akuzuese mbi ta dhe luftën e tyre për liri, por asnjëherë nuk do të pranojnë etiketimet linçuese as ndaj tyre, as ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kosova dhe shumica e qytetarëve të saj ka vuajtur gjatë në të kaluarën nga padrejtësi dhe standarde të dyfishta të trajtimit të tyre dhe kemi nevojë për një epokë të re, të instalimit të besimit në drejtësi dhe shtet ligjor. Ne nuk duam të interferohemi në sistemin gjyqësor dhe asnjëherë nuk do ta bëjmë këtë, aq më pak në vendimet gjyqësore, por nga ana e përgjegjësisë sonë politike ne nuk mund të mos kërkojmë që të trajtohen seriozisht dhe të adresohen shqetësimet tona mbi këto procese. Barazi para ligjit, askush mbi ligjin, por nuk është mirë edhe askush të diskriminohet prej ligjit.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Drejtësia dhe e vërteta nuk mund të ndahen asnjëherë. Ka një të vërtetë të vetme për Kosovën dhe luftën e saj. Lufta e Kosovës për liri ishte një luftë e drejtë, çlirimtare, për mbijetesën e një populli të robëruar në fundin e shekullit XX, kur të gjithë popujt e tjerë të Evropës ishin të lirë. Ishte luftë për çlirim, asgjë më shumë, asgjë më pak.

Dihet kush ishte viktimë dhe kush ishte agresori. Mund të bëhen akuza, mund të bëhen gjyqe, të shkruhen raporte, të bëhen lloj-lloj fushatash kundër UÇK-së dhe drejtuesve të saj, por kurrë nuk do të mund të barazohen agresori dhe viktimë. Kurrë nuk do të mund të barazohet luftëtari çlirimtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me agresorin serb, ushtarin serb.

Sa u përket disa sulmeve të vrazhda mbi drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, tendencën ndarëse të saj, veçanërisht për njerëzit që janë mbetur gjallë. Më duhet të theksoj se nuk mund ta

duash UÇK-në abstrakte, s'ka ekzistuar pa njerëzit e saj, pa gabimet e saj dhe të tentosh ta kriminalizosh Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Mund ta duash ose të mos e duash Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ushtri Çlirimtare e Kosovës ishin të gjithë qytetarët e këtij vendi që luftuan për liri dhe pavarësi. Nuk duron askush veten as familjen e vet me akuzat që ua bënë çdo luftëtar apo individ në veçanti. Kush ka akuza duhet t'u drejtohet gjykatave. UÇK-ja ishte vetë fati i popullit tonë, historia jonë e hidhur, historia e saj është vetë realiteti ynë i hidhur dhe i vrazhdë, i jetuar dhe i përjetuar si komb i robëruar, por njëkohësisht edhe produkti më i lartë që e njeh historia e popullit shqiptar në këto troje, në këtë tokë.

Pa UÇK-në as NATO-ja, as Bashkimi Evropian, as Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk do të ishin për dhe në shtetin e Kosovës, mund të ishin në Kosovën e sotshme, jam shumë i sigurt, por jo në shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës.

Të nderuar kolegë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Është në nderin tonë sot të debatojmë racionalisht për interesin e vendit tonë dhe mbrojtjen e vlerave tona si Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Nuk duhet të nxitemi nga egot dhe interesat parciais, më së pakti në këtë moment. Nxjerrja i një rezolute të përbashkët nga Kuvendi i Republikës sonë do të konfirmonte edhe njëherë dinjitetin, pastërtinë dhe ndershmërinë e luftës sonë çlirimtare për liri dhe pavarësi. Një rezolutë që të theksojë sërish se lufta heroike e bërë nga luftëtarët tanë ka qenë një luftë e drejtë dhe se është obligim moral i çdo institucioni në Kosovë që ta mbrojë dhe ta respektojë këtë të kaluar të lavdishme të historisë së popullit tonë.

Më lejoni në fund t'ju drejtohem me disa fjalë bashkëluftëtarëve të mi, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Po kalojmë momente shumë të rënda për vendin tonë, urtësia, mençuria dhe qëndrueshmëria na duhen si në ditët më të rënda të luftës sonë për liri. Lirinë dhe shtetin që kemi dashur, e kemi arritur ta bëjmë të gjithë bashkë, por kemi edhe shumë për të bërë bashkë, çdo ditë që këtë shtet ta bëjmë edhe më të konsoliduar politikisht, më të zhvilluar ekonomikisht, me perspektivë të sigurt për të tashmen dhe të ardhmen e fëmijëve tanë.

Mund të rrëmbehem nga emocionet dhe shkatërrojmë çdo gjë çfarë kemi arritur deri këtu. Kemi shumë arsye edhe të jemi të pakënaqur, edhe të konsiderojmë se po na bëhet padrejtësi, por duhet të mendojmë prapë se partneriteti ynë dhe i vetëm është orientimi ynë përëndimor dhe partneriteti i përjetshëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian. Ky është, tek e fundit, edhe vetë përcaktim i popullit tonë.

Ju luftëtarët e lirisë qëndroni krenarë dhe ballëhapur për luftën tuaj, që edhe sot të qëndroni të përgjegjshëm ndaj shtetit dhe ligjit me obligimet që keni. Sulmet e padrejta kurrë nuk do të mund

të errësojnë faktin se ju keni qenë dhe mbeteni përjetësisht çlirimtarët e Kosovës, jo vetëm familjet, por e gjithë Kosova krenohet me ju.

Sylejman Selimi, komandant i përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fadil, Jahir, Zeqir, Nexhat Demaku, Hysni Thaçi, e Bashkim Demiçi, tash bashkë edhe me atë vëllain që është dënuar edhe pse s'ka qenë në luftë, ne i kemi konsideruar veç luftëtarë të lirisë, mbrojtës të popullit të tyre, tokës së tyre edhe gjithmonë do të mbesin të tillë. Ne do të jemi gjithmonë me ta, e gjithë Kosova, qytetarët e Kosovës janë me ta. Kam një mesazh të veçantë edhe për fëmijët e këtyre bashkëluftëtarëve të lirisë: shkoni në shkollë, mësoni sa më shumë dhe ndjehuni krenarë me atë çfarë kanë bërë baballarët tuaj për vendin tonë! Ajo është krenari e këtij kombi. Ju duhet ta dini se jeni fëmijë heronjsh dhe heronjtë e kanë një fat gjithmonë: kthehen të fundit nga beteja dhe të fundit e përjetojnë lirinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Anton Quni.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Është fakt se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk e ka marrë trajtimin e duhur politik, historik, juridik, shkencor, profesional e tjera. Varësisht nga interesat ditore, partiake, ashtu edhe është trajtuar lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjërat janë stërmadhuar, irracionalizuar, përvetësuar, monopolizuar, përjashtuar, mohuar, hesht, e tjera.

Kur ngjarjet hiperbolizohen, filluar nga etiketimet deri te glorifikimi, atëherë edhe aktorët apo protagonistët e ngjarjes marrin vlerësime të ngjashme. Shpesh dëgjojmë vlerësime se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e shenjtë, pajtohem edhe unë. Por, nëse shumicës së stafit komandues, drejtuesit të luftës kalojnë nëpër procese gjyqësore, atëherë çka mbetet e shenjtë, mbrapa kujt paskan shkuar luftëtarët e shenjtë nëse komandantët e tyre akuzohen për krime lufte? Ky është një paradoks, por ne për këtë situatë nuk mund të fajësojmë sot askënd përpos vetvetes, sepse ne vetë i kemi krijuar parakushtet që sot të abuzohet me luftën, veteranët, familjet e dëshmorëve, invalidët, e tjerë.

E nëse ne abuzojmë, atëherë pse duhet të presim se të tjerët, në këtë rast të huajt, do të na trajtojnë me respekt. Nëse ne si dëshmitarë të ngjarjeve të luftës nuk kemi pajtim racional dhe një ngjarje, veprim apo operacion e shpjegojmë apo vlerësojmë ndryshe nga njëri-tjetri dhe nuk japim gjykim të drejtë, atëherë si mund të presim se një trup gjykues nga jashtë do t'i trajtojë ngjarjet me një objektivizëm.

Tani nuk mund t'i kthejmë ngjarjet mbrapa, jemi para aktit të kryer në relacion me të dënuarit. Sot mund të japim vetëm mbështetje morale, nëse edhe kjo mbështetje është e sinqertë. Shumicën e të dënuarve i njoh personalisht, Fadilin me vëllezër, më së miri e njoh Sylejman Selimin, isha për gjashtë muaj këshilltar ushtarak i tij derisa ai ishte komandant i Forcave të Sigurisë së Kosovës. Kam vetëm vlerësime të mira për kulturën, qëndrimin, sinqeritetin e tyre.

Po të mundja, do të kisha zëvendësuar për një kohë gjatë vuajtjes së dënimit. Kjo është gatishmëri individuale. Por, si deputet me të drejta dhe autorizimet që i kam unë dhe vetëm e shpreh një mbështetje morale, gjithnjë me kujdesin që të mos e vështirësojmë situatën e tyre në ndërhyrjet në pavarësinë e institucioneve të drejtësisë. Por, ne ende kemi mundësinë që me komunikim të sinqertë mes vete, në kërkim të zgjedhjeve më të mira për të ardhmen tonë, e kaluara jonë, qoftë rezistenca paqësore, qoftë ajo luftarake, të trajtohen drejt në kontekstin e kohës, mundësive dhe zhvillimeve.

Uroj që deklarimi përfundimtar të shpreh vullnetin dhe gatishmërinë tonë për unifikim të qëndrimeve kur janë në pyetje mbrojtja e vlerave tona, si shoqëri dhe si komb. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Qytetarë të nderuar,

Mendoj që sa i përket krimeve në Kosovë, krimeve që kategorizohen si të luftës, si quhen prej faktorëve ndërkombëtarë, mendoj që kanë ekzistuar dy standarde të kundërta ose së paku plotësisht të ndryshme sa i përket qasjes së faktorëve që janë vendimmarrës e që janë ndërkombëtar në Kosovë sa i përket trajtimit të krimeve të luftës dhe kjo është shumë e qartë.

Kur është puna për krimet që i paska kryer UÇK-ja dhe shqiptarët, bashkësia ndërkombëtare është udhëhequr nga parimi: "Duhet të gjendet gjilpëra në kashtë". "Duhet ta gjejmë gjilpërën në kashtë", është a s'është ajo, duhet ta lypim dhe ta gjejmë diku, kurse sa i përket krimeve të Serbisë në Kosovë, ata udhëhiqen prej principit: "Ujkun po e shoh, por nuk po i shoh gjurmët kurrkund". Pra, një mosveprim edhe aty ku faktet kanë qenë tejet të qarta, edhe ku dëshmitë janë me bollëk kush ka kryer krime këtu në Kosovë dhe kush është agresori i vërtetë.

Në Kosovë prej qershorit të vitit 1999 ka sunduar doktrina e UNMIK-ut, sipas të cilës krimet e Serbisë në Kosovë nuk duhet të hapen dhe përgjithësisht nuk duhet të gjykohen, sepse kjo e rrezikon një diçka që ata e quajnë multietnicitetin në Kosovë. Kjo mendoj që ka qenë qasje shumë e gabuar dhe na ka dëmtuar shumë. Pra, multietniciteti e paska si parakusht sakrifikimin e drejtësisë. Por, përgjegjësia e LDK-së edhe e PDK-së fatkeqësisht është që janë pajtuar me këtë

doktrinë të UNMIK-ut. Kanë kritikuar kështu në mënyrë deklarative, mirëpo në heshtje ka ecur kjo doktrinë e UNMIK-ut dhe çka është më skandalozja këtu në Kosovë për shembull e kemi pasur të etabluar parimin që kurrkush prej kriminelëve serbë nuk guxon të gjykohet dhe të dënohet në mungesë.

Ne e dimë që shumica prej kriminelëve që i kanë kryer krimet nga policia e ushtria dhe paramilitarët serbë në Kosovë, ata shumica kanë ikur në Serbi, e disa prej tjerëve kanë vazhduar edhe të fshihen në veri të Kosovës, me siguri qindra prej tyre. Dhe këtu ka ekzistuar doktrina, edhe me pajtimin e subjekteve politike këtu që e kanë udhëhequr Kosovën, që kurrkush, asnjë proces nuk duhet të ekzistojë i gjykitimit edhe i ndëshkimit në mungesë.

Qysh ia ka bërë, për shembull, Kroacia. Kroacia krejt serbët që kanë bërë krime i ka dënuar dhe i ka gjykuar në mungesë. E, ata le të guxojnë të kapërcejnë pastaj nëpër territorin e Kroacisë. Ne nuk e kemi bërë, shumë gabim. Edhe merreni edhe ju vetë një pjesë të përgjegjësive. Pra, këtu drejtësia ndërkombëtare fatkeqësisht është dhunuar në dy principe që konstituojnë drejtësinë. Nëse ia heq ato dy parimet drejtësisë, nuk ka drejtësi. Çka ka ndodhur me ne? Këtu është dhunuar principi i joselektivitetit edhe principi i paanshmërisë. Pra, ka pasur shumë përzgjedhje në raste, dhe ka pasur shumë anim.

Menjëherë pas luftës, ju e dini që UNMIK-u ia pati rezervuar vetvetes të merrej me krime të luftës. Veç ai e ka pasur këtë kompetencë, por në të njëjtën kohë, domethënë nae ka pamundësuar neve që të merremi me ata të cilët nuk janë këtu, dhe që janë kriminelë të luftës. Ekzistojnë lista e lista të tëra, me qindra e qindra emra e mbiemra, të mobilizuarve në polici, ushtri dhe në grupet paramilitare të Serbisë, të cilët kanë kryer krime mbi popullatën shqiptare të Kosovës dhe nuk ekziston aktualisht asnjë proces gjyqësor kundër tyre.

Në anën tjetër, në gjykatat e Serbisë nuk janë trajtuar as 0,5% e krimeve të ushtarëve dhe të policëve të saj dhe të grupeve paramilitare që kanë kryer krime në Kosovë. As 0,5%, domethënë as te 1% nuk ka arritur sa i ka trajtuar Serbia krimet e saj të luftës që janë kryer në Kosovë. E çka është e çuditshme për mua dhe, me të vërtetë, e papranueshme. Ka nja 4-5 vjet më së paku që asnjë deklaratë nuk e kam dëgjuar nga BE-ja, nga Brukseli, që thotë se Serbia duhet t'i trajtojë krimet e saj të luftës që i ka bërë në Bosnjë apo në Kosovë. Asnjë deklaratë nuk ka shans ta dëgjosh.

Kosovës ia përmendin çdo javë deklaratat, për Serbinë nuk kam dëgjuar asnjë deklaratë pesë vjetët e fundit nga BE-ja që problem është kjo përqindje e ulët e trajtuar e krimeve të luftës që janë bërë prej vetë kriminelëve serbë, që kanë marrë pjesë në ushtri, polici dhe që kanë qenë të kyçur në këto fushatat e spastrimeve etnike, të masakrave në Bosnjë dhe Kosovë e kështu me radhë. Kjo është me të vërtetë e çuditshme.

Serbia në kohë të luftës, zonja dhe zotërinj, i ka pasur 70 mijë ushtarë, i ka pasur më shumë se 30 mijë policë, ka pasur mijëra vetë të organizuar nëpër grupe paramilitare, krejt këto po t'i mbledhësh bëjnë 100 mijë vetë të kyçur drejtpërdrejt apo në mënyra të tërthorta në fushata të spastrimeve etnike të masakrave, e kështu me radhë. 100 mijë vetë, sa janë dënuar në Serbi? Dhjetëra! Një grusht i njerëzve është dënuar në Serbi prej krejt këtyre dhe bashkësia ndërkombëtare thotë; "Serbia e kreu punën e vet, hajde integritet evropian". E Kosova nuk është kurrkund, duhet t'i dënojnë komandantët e UÇK-së.

Pra, konsiderohet që Serbia diqysh e ka kryer obligimin e vet ndaj drejtësisë në raport me krimet e luftës. Dhe, unë këtu ua shoh për të madhe sërish LDK-së edhe PDK-së, edhe juve që jeni përpara. Kurrë nuk e keni ngritur këtë çështje në Bruksel, gjithmonë pajtoheni diqysh me këto çështje dhe kur të na vijë neve dënimi pastaj, krejt çka dini të bëni janë këso seancash, ku ne vajtojmë. Mirë, po vajtojmë, mirëpo kjo nuk është përgjegjësi shtetërore, të vajtosh nuk është përgjegjësi shtetërore. Ta ngresh zërin dhe me t'i mbrosh vlerat është përgjegjësi shtetërore, jo të vajtosh kur proceset ndodhin dhe kur UÇK-ja shkelet. Pastaj krejt çka bëjmë është vetëm qajmë edhe ankohemi.

Edhe po ta shikojmë strukturën e rasteve gjyqësore kundër krimeve të luftës kundër shqiptarëve, atëherë ju mund ta vëreni se cili është procesi më i rëndësishëm gjyqësor që po ndodh tash. Procesi më i rëndësishëm gjyqësor është veç një, veç një proces gjyqësor është duke ndodhur në Kosovë kundër krimeve të Serbisë, ky është procesi i Oliver Ivanoviqit me grupin e tij. Ai e ka aktakuzën edhe për krime gjatë luftës, ky Oliver Ivanoviqi është edhe kriminel i pasluftës, dorën në zemër, se me ato spastrimin e veriut të Kosovës në vitin 2000, shkurt me rojat e urës dhe me krejt, po e ka aktakuzën edhe për krime lufte të Lagjja e Kovaçëve në Mitrovicë.

Ky është rasti i vetëm, ama jo i profilit të lartë, i profilit të mesëm, që po zhvillohet ndaj krimeve të luftës të Serbisë në Kosovë. Dhe tash shtrohet pyetja: sistemi i drejtësisë e dënoi Sylejman Selimin, sistemi i drejtësisë, sistemi ynë vendor e dënoi komandantin e UÇK-së, duhet ta kemi parasysh, është dënuar komandanti ynë i UÇK-së, Sylejman Selimi, në një periudhë të caktuar kohore. Natyrisht UÇK-ja ka pasur komandantë supremë, të cilët janë ndërruar përgjatë muajve, mirëpo edhe komandant Sylejman Selimi ka qenë figura më e lartë e UÇK-së, edhe u dënuar.

A po e dënon Serbia Dikoviqin? Nuk vjen në shprehje! E tash, kjo është sa i përket përgjegjësi dhe në raport me drejtësinë ndërkombëtare, por të dalim tash te përgjegjësia vendore, se unë mendoj që kjo është edhe më e rëndësishme.

Zonja dhe zotërinj, protagonistët politikë të pasluftës UÇK-në nuk e kanë konsideruar për asnjë moment vlerë dhe themel të lirisë dhe të shtetësisë së Kosovës. Po më vjen keq, por duhet ta them këtë. Ata UÇK-në e kanë trajtuar si kredi personale dhe elektorale, kjo është për të cilën duhet të vajtojmë. Se fenomenet politike dhe sociale kurrë nuk pikin prej qiellit. Fenomenet politike

shoqërore nuk janë të rastësishme, ato janë produkt i një zinxhiri të pashkëputshëm të rrethanave dhe të proceseve brenda një rrjedhje të përcaktuar kauzale, e që tash po e konstatojmë ne problemin e dhimbshëm, po themi kështu: UÇK-ja është shkelur, UÇK-ja është përdhosur!

A është ky konstatimi? Këtë po e dëgjoj, edhe që disa vjet jemi duke e dëgjuar këtë. UÇK-ja është shkelur, UÇK-ja është përdhosur! Po e konstatojmë një dukuri, një fenomen, ama fenomeni, bre, nuk vjen prej qiellit. Fenomeni nuk vjen pahiri, fenomeni nuk vjen në mënyrë të rastësishme. Kush e shkeli dhe kush e përdhosi UÇK-në? A e shkeli UÇK-në edhe a e përdhosi UÇK-në OKB-ja? A na e shkatërruan UÇK-në BE-ja e Brukseli, a? Jo, zonja dhe zotërinj, kjo nuk është e vërtetë, ky, me sa e kam lexuar unë, nuk është mandati i këtyre organizatave ndërkombëtare.

Përgjegjësinë pse erdhëm në këtë gjendje duhet ta gjeni te ata të cilët gjatë zgjedhjeve në Kosovë bëhen Mic Sokola të UÇK-së, e kur vjen puna të japin intervista në Euro News bëhen analistë larg fronteve të luftës. Prandaj, për ta kuptuar pse erdhëm deri këtu dhe pse po na ndodhin gjithë këto dukuri duhet t'i kuptojmë disa fenomene të tjera përpara këtyre, pse erdhëm deri këtu. Çka duhet të kuptojmë? UÇK-ja u çarmatos dhe u shkapërderdh, UÇK-ja nuk u mbrojt pasluftës, se UÇK-ja nuk ka pasur nevojë, zonja dhe zotërinj, të mbrohej gjatë luftës, se gjatë luftës ajo vetë lufta ka qenë, UÇK-ja ka qenë vetë lufta. UÇK-ja është dashur të mbrohet në liri, është dashur të mbrohet në paqe, se ajo e ka mbrojtur vetveten gjatë luftës, ajo ka qenë lufta vetë.

Pra, nuk e kemi mbrojtur UÇK-në, ia kemi kthyer shpinën UÇK-së pasluftës. UÇK-ja u keqpërdor, domethënë problemi është një klan i caktuar brenda Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e ka parë pasluftës UÇK-në si pushtet, si kontroll, si pasuri dhe kjo nuk duhet të na vijë marre ta themi se ky është problemi. UÇK-ja nuk u fut në Kushtetutë, UÇK-ja nuk u fut në Deklaratën e pavarësisë dhe, qe zonja dhe zotërinj, krejt këto katër arsye që i thashë, pastaj ku na çojnë dhe ku përfundojnë: përfundojnë në gjykata ndërkombëtare që themelohen veç për UÇK-në, jo për kriminelët serbë.

Përfundojmë në listat të veteranëve, ku 20 mijë statuse të veteranëve shiten dhe blihen. Përfundojmë në përmendore të UÇK-së, ku vidhet nëpër tenderë, dhe përfundojmë në procese të ndyta, ku shokët e luftës bëjnë pazare kush të qëndrojë në kolltuk politik, e kush të shkojë në qeli, për ta paguar burgun. Në këtë gjendje, zonja dhe zotërinj, kemi ardhur! Qe ku e keni sjellë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, përgjegjësinë le ta marrë ai që e ka, e jo ai që s'e ka. Por, unë mendoj që ata që e kanë përgjegjësinë dhe që e kanë sjellë UÇK-në në këtë gjendje pa kurrfarë dyshimi mendoj që janë të mallkuar kombëtarisht.

KRYETARI: Ismet Beqiri e ka kërkuar fjalën, kërkoj mirëkuptim, pastaj Time përgatitësh dhe ndërkohë...

ISMET BEQIRI: Kërkoj falje, Time! Zoti kryetar, faleminderit!

Edhe në fillim e thamë edhe tash mendoj që ne vërtet duhet të koncentrohemi dhe të bëjmë përpjekje të mos gjuajmë ‘shkeptas’, siç thuhet, edhe të mos flasim të pavërteta, shpifje, sepse kur flitet për LDK-në, si subjekt politik, në këtë rast, po besoj edhe për PDK-në si subjekt, edhe për AAK-në si shtetformuese, edhe për UÇK-në si paraprijëse, edhe për ndërkombëtarët është përgjegjësi e madhe që të flasim gjëra të pavërteta.

Sepse, ne e konsiderojmë pasuri tonën, të gjithë deputetët që i kemi të LDK-së këtu, bashkë që jemi, edhe ata që kanë qenë në UÇK janë në grupin tonë parlamentar, edhe ata që s’kanë qenë, por kanë ndihmuar në mënyra të tjera, forma të ndryshme dhe nuk duhet etiketuar, sepse po flasim për njerëz që e kanë votën dhe kur e ofendon një subjekt politik, i ofendon ata qytetarë që ta kanë dhënë votën, të mirë të këqij, jemi këta që jemi, por jemi me votë të qytetarëve sikurse që jeni edhe ju dhe është e vërtetë që ne dallojmë në vlerësimin e vlerave shtetërore, vlerave, pse jo, edhe kombëtare në vlerësimin e luftës e të gjitha këto, sepse kjo nuk është ad hoc, nuk është ditore, nuk është për marketing. Kjo e ka një qëndrueshmëri dhe duhet të jetë pak më gjatë. Mirë është të flasim me pasion e të tjera, mundësisht të përmbahemi, ta themi mendimin, por të mos ofendojmë, sepse u thanë shumë gjëra që nuk qëndrojnë, që janë të pavërteta.

Edhe njëherë po e them, janë këto subjekte, janë qytetarët e Kosovës, është lufta, është rezistenca, të gjitha këto që e kanë bërë të mundshme që ne jemi shtet, e mbi të gjitha është edhe përkrahja vendimtare, e miqve tanë ndërkombëtarë në krye me SHBA-në. Këtë e kemi thënë edhe kështu gjithmonë do ta themi, sepse është e vërtetë dhe një gjë po e them, mund të ketë individë, por asnjëherë edhe për vrasjet që janë bërë të veprimtarëve të LDK-së, ushtarëve të UÇK-së, veprimtarë të shquar e kryetarë komunash, kurrë ne as nuk dëshirojmë t’i adresojmë dhe t’ua zgjasim gishtin individëve. Ne këtë punë ua lëmë organeve shtetërore dhe juve disave kur ju kemi dëgjuar me kaq zell të kërkonin edhe diçka të tillë, të zbardhen këto nga organet e drejtësisë, çfarëdo vrasje, çfarëdo motivi që ka qenë, duhet zbuluar, por organet e bëjnë këtë. Nuk e bën LDK-ja, po as VV-ja nuk e bën.

Andaj, leni këtë retorikë, sepse ne jemi si subjekt 27 vjet, shumëçka kemi përjetuar, por mbi të gjitha besimin e kemi në atë që punojmë për t’u forcuar në shtet, në organet shtetërore dhe jo në ata që bëjnë marketing ditor për përfitime politike dhe pikërisht kur qajnë për UÇK-në, pikërisht qajnë me lot krokodili ata të cilët duhet të qajnë edhe për të tjerët që kanë pasur vrasje, viktime, sepse edhe ata kanë qenë luftëtarë, e ata kanë qenë njerëz që kanë punuar për këtë vend. Po, këtë ua kemi lënë organeve të drejtësisë, mos na moralizoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e keni fjalën, ndërkohë bëhet gati zoti Haxhi Shala.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

KRYETARI: Më fal Time, kërkoj falje, por ka reagime, se replikë, kërkoj falje, të lutem edhe një herë. Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së e ka kërkuar fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Si përfaqësues i atyre që kanë kërkuar debatin, po kërkoj edhe njëherë që debati të jetë në fokus të asaj që kemi kërkuar.

Ne kemi qenë të vetëdijshëm kur e kemi kërkuar këtë debat që do të ketë një retorikë, siç ishte këtu, ne e dimë, edhe të tjera keni për të thënë ju, ndoshta veç nuk do të thoni sot që Latif Gashi e ka vendin në burg, ashtu siç e keni thënë më herët.

Por, ju kisha kërkuar që të jeni të kujdesshëm, edhe ju kisha kërkuar që sot edhe njëherë po them, të dalim të vëmendshëm, të jemi të fokusuar në çështjet për çka jemi mbledhur, pra në mbrojtje të vlerave të luftës. Nuk keni nevojë të paragjykoni qysh flasin në Bruksel. Nëse doni që të flisni edhe për Brukselin ndonjë ditë flasim krejt qysh kemi folur atje, edhe qysh flasim nëpër seanca, edhe qysh flasim me ndërkombëtarë, edhe qysh bëhen raportet me ndërkombëtarë, edhe qysh flitet këtu ndryshe e atje ndryshe. Nëse doni, flasim edhe për këto, por nuk është sot e moralshme para familjarëve, para mijëra njerëzve që i kanë mbështetur ata që sot pretendojnë të futen në burg, e që janë përfaqësues legjitimë të qytetarëve atje, për aktivitetin e tyre, të tashëm, pasluftës, le më për ato që i kanë bërë atëherë.

Edhe njëherë, pra, kërkoj që sot të jemi, edhe zoti kryetar, unë e di në këtë sallë, në këtë podium kemi pasur momente të vështira, skena të dhunshme dhe ju keni toleruar për shkak të mos bëhet situata më e rëndë dhe unë besoj që ju do të kërkonit që të ketë rrugë të mira, të tilla edhe sot. Por, të fyhensit tradhtarë drejtuesit e institucioneve të shtetit, këtu kurrkush nuk e ka të drejtën në këtë vend të jetë kujdestar, inspektor i atdhetarisë për ta dedikuar kush është tradhtari, kush është patrioti. Mendoj që ka mundësi me Rregulloren të Kuvendit, zoti kryetar, që të marrë masa ky Kuvend njëherë e mirë të kthehet në normalitet, qoftë në përdorimin e gjuhës dhe qoftë me çështje të tjera që kanë të bëjnë me funksionimin e Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Më shumë sesa gjykimi që do t'ju vijë nga njerëzit që na dëgjojnë, kot unë e qes dikë jashtë. Kot është.

Zonja Time Kadrijaj, fjala për ju, përgatitet zoti Haxhi Shala, dhe pastaj zoti Arsim Bajrami e ka kërkuar fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Gjykimet e padrejta dhe pa fakte që po bëhen ndaj ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk janë asgjë tjetër veçse një tendencë për ta degraduar dhe njollosur luftën e shenjtë të UÇK-së.

Lufta jonë çlirimtare ishte dhe mbetet e drejtë, ishte përpjekja më serioze dhe më e pastër për t'i thënë jo një regjimi, i cili na mbajti nën okupim me dekada të tëra, duke na mohuar çdo të drejtë në vendin tonë, duke vrarë, masakruar, dëbuar e dhunuar popullatën e pafajshme, duke mos kursyer as gratë dhe fëmijët. Edhe sot i kemi mbi 1600 të pagjetur, në mesin e tyre 100 fëmijë. Kush u dënua deri sot për këto krime? A mund të quhet drejtësi kjo?

Kur ushtarët e lirisë dënohen e gjykohen vetëm e vetëm pse i dolën zot atdheut të tyre e në anën tjetër, ata që bënë gjenocid mbi popullatën e pafajshme lëvizin lirshëm, hyjnë e dalin në Kosovë sa herë që ata të duan, pa pasur frikë nga askush edhe pse ata ishin okupuesit dhe armiqtë e Kosovës, kjo nuk do koment!

Këtë po ua mundëson Qeveria e paaftë e jona për të mbrojtur qytetarët, për të mbrojtur shtetin dhe dhembjen e nënave, që duhet të durojnë vrasësit të vijnë e të shëtisin lirshëm në çdo pjesë të Kosovës. Këto gjykime nuk janë, as drejtësi, as sinqeritet. Këto procese gjyqësore janë të çuditshme dhe të padrejta, janë ofendime dhe nënçmime, janë njollosje për një popull të tërë, sepse UÇK-ja ishte vetë populli.

Rastet e gjykimeve të komandantëve dhe ushtarëve të UÇK-së në Hagë, besa edhe rigjykimet për të shpikur “fakte e argumente” dhe tash gjykimi i “Grupit të Drenicës”, pa pasur ndonjë provë të besueshme dhe dëshmitarë normalë, kjo mund të ndodhë vetëm në gjykatat e Kosovës.

Politika duhet të jetë jashtë çështjeve juridike dhe ndoshta janë ndikuar nga ndërkombëtarët, por politika vendëse nuk ka bërë asgjë për të kërkuar drejtësi, duke parë padrejtësitë që qëllimshëm u janë bërë Sylejman Selimit, Sami Lushtakut, Jahir Demakut, Fadil Demakut dhe të tjerëve. Kjo po dëshmon, se ne kemi një qeveri servile, të cilët për të shpëtuar veten janë në gjendje të shesin atdheun, të shesin shokët dhe të falin territore. Ata po harrojnë, se janë qytetarë të Kosovës dhe duhet t'i përgjigjen këtij populli dhe, se për çdo dështim e lëshim në raport me dinjitetin dhe sovranitetin e vendit do të dënohen nga populli.

Pse si shtet nuk po kërkojmë nga ndërkombëtarët apo të përgatisim fakte relevante për të gjitha ato krime, që kanë ndodhur në Kosovë. Të kërkojmë drejtësi për të gjitha ato viktima të vrara në masakrat anekënd Kosovës, për njëzetmijë gra të dhunuara, për fëmijët e vrarë, gra e pleq, sepse me kodet e luftës kjo kategori nuk cenohet.

Për fund, nuk do ta lë pa e thënë shkurt e qartë, për të gjithë ata të cilët kur Kosova digjej në flakë nga regjimi i Milosheviqit, kontributi i tyre për Kosovën shtrihet në bregdetin e Ulqinit dhe

të Durrësit. Sot, po të njëjtit, kanë kurajën që t'i luftojnë vlerat e UÇK-së duke deponuar materiale fund e krye të rrejshme, vetëm që t'i mundësohet Serbisë që të ndërtojnë aktakuza kundër shqiptarëve, që nuk kanë bërë asgjë tjetër veçse kanë mbrojtur pragun e shtëpisë. Këta shqipfolës, që veprojnë kështu kundër UÇK-së nuk janë asgjë tjetër veç bashkëpunëtorë të Serbisë, si dje ashtu edhe sot.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Haxhi Shala e ka fjalën, ndërkohë bëhet gati ministri Arsim Bajrami.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra, që jeni këtu sot,

Sot, përkulem para heronjve e dëshmorëve të kombit. Sot, përkulem me përulësi me keqardhjen më të madhe para komandantit legjendar, para gjithë familjes Jashari. Sot, përkulem me të madhe dhe u kërkoj falje të gjithë të dëbuarve nga forcat serbe. Sot, u kërkoj falje të gjitha familjeve të të zhdukurve, të burgosurve politikë. Sot, me përkuljen më të madhe u kërkoj falje gjyshërve dhe stërgjyshërve të mi. Sot, i kërkoj falje gjithë popullit të Kosovës, për një të vetme arsye, sepse populli ynë krijoi vlerën më të madhe të kombit shqiptar të shekullit 20-të, ata krijuan UÇK-në, ndërsa ne si të zgjedhurit e tyre votuam që të barazojmë këtë vlerë shekullore me forcat gjenocide serbe.

Ky Parlament votoi që të gjykojë një popull liridashës, votoi që të barazojë një popull që dha gjithçka për lirinë me një okupator gjenocidal, me forcat e kasapit të Ballkanit.

Ne, ish-ushtarët e UÇK-së, jemi sfiduar në vazhdimësi para gjykatave ndërkombëtare të pasluftës. Rasti Limaj, Haradinaj në Hagë, Grupi i Dukagjinit, Grupi i Llapit, Rasti "Kleçka" e shumë, e shumë rastesh tjera, janë përballur me gjykata ndërkombëtare dhe në shumicën absolute kemi dalë fitimtarë prej tyre, sepse është e vetmja një e vërtetë - lufta e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe e pastër.

Por, ne si Parlament apo edhe institucionet e Kosovës, asnjëherë nuk kemi reaguuar në mënyrë institucionale. Më vjen mirë, që më në fund po mbahet një seancë, ku të gjithë mund të flasim. Flasin, pasi që koha për vepra tashmë ka përfunduar. Ne është dashur të veprojmë shumë më herët. Kemi qenë të zënë... Ata, të cilët janë paraqitur në mediet tona, kinse janë themelues të UÇK-së, ndërsa në Euro-News deklaroheshin se nuk kanë marrë pjesë në frontet e luftës, ata kanë qenë të zënë duke lobuar për veten e tyre, në vend se të llobojnë për liri, për sakrificën e popullit të tyre, në vend se të tregojnë dhe dëshmojnë të vërtetën e UÇK-së.

Të nderuar qytetarë,

Siç e dini, e vërteta e UÇK-së është një dhe e vetme e që nuk mund të ndryshohet, as me vendimin e gjykatave të apelit, as të ndonjë gjykate tjetër, sepse ajo e vërtetë është e pandryshueshme - UÇK-ja ka bërë luftë të drejtë dhe të pastër.

Po thuhet, se po gjykohen apo dënohen individë dhe jo UÇK-ja! Kush tjetër mund të përfaqësojë UÇK-në, përveç komandantit të përgjithshëm të saj? Kush tjetër mund të përfaqësojë UÇK-në, përveç komandantëve të zonave apo anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm? Kush mund të përfaqësojë UÇK-në, përveç familjeve të dëshmorëve e në këtë rast, përveç familjes Demaku?

Se sa ishte e pastër lufta e UÇK-së tregoi edhe rasti “Drenica”. As edhe një element të veprës penale nuk ka pasur në atë rast. Kjo që ka ndodhur me ta, me bashkëluftëtarët tanë, ka qenë një padrejtësi absolute, sepse, më lejoni të ju pyes para gjykatësve, që thuhet se “kanë vendosur në emër të popullit”. A mund ta di se në emër të cilit popull kanë vendosur ata, të nderuar ministra?

Unë si qytetar i Kosovës, pjesë e këtij populli, nuk mund as të imagjinoj, që komandanti i Ushtrisë Çlirimtare, i cili ka luftuar për çlirimin e vendit dhe të popullit tim, të dënohet. Pra, në emër të cilit popull kanë vendosur ata, sepse në emrin tim jo. Kurse, gjykatësit të cilët dënojnë bashkëluftëtarët tanë thirren çdoherë në emër të popullit dhe ajo mbetet në arkivat e shtetit.

Kështu, kërkoj nga ju, zonja gjykatëse dhe ju zëvendëskryeministër, që këtë term ta heq nga... kur e dini edhe ju vetë, që ka padrejtësi, të mos thirren në emër të popullit dhe të dënohen bashkëqytetarët tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri Arsim Bajrami e ka fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,
Të respektuar deputetë,

Padyshim, që në një shoqëri demokratike, ku ekziston parimi i ndarjes së pushteteve dhe ku funksionon demokracia kushtetuese është i tepërt një debat edhe për proceset gjyqësore. Por, një debat për UÇK-në është plotësisht legjitim, sepse këtu nuk po flasim për raste individuale, por po flasim për institucion kombëtar, për institucionin i cili duhet të mbrohet nga institucionet shtetërore dhe institucion, nga i cili edhe varet e ardhmja jonë.

Tani, themelimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë një moment i ndritur dhe më i rëndësishmi në historinë tonë. E themeluar si guerilë ky institucion në një periudhë shumë të shkurtë u transformua në një ushtri të mbrojtur edhe falë programit të mirë politik, falë udhëheqjes politike dhe falë vendosmërisë së popullit për ta mbrojtur këtë institucion.

Ishin tri shtylla të këtij programi politik, që bëri që kjo guerilë të jetë e para në historinë e guerilëve që njihet ndërkombëtarisht. E para, karakteri mbrojtës i luftës sonë çlirimtare, e dyta karakteri çlirimtar dhe e treta, lufta për pavarësi si një e drejtë legjitime. Pikërisht, udhëheqja pragmatike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sidomos udhëheqja politike bëri që kjo ushtri të njihet si partner i respektuar ndërkombëtar i Aleancës Veri-Atlantike, në Konferencën e Rambujesë dhe pastaj, në një koalicion të pashpallur formalisht, të realizojnë misionin e parë, çlirimin e Kosovës.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës bazohet në vlerat fundamentale patriotike të vendit tonë, të njerëzve atdhedashës, të cilët morën mbi supe misionin final të realizimit të idealit, për të cilin luftuan gjenerata të tëra. Sot këtu nuk po flasim për raste individuale, nuk po flasim për krimet e pasluftës, po flasim për rastet të cilat po janë rezultat i një drejtësie transicionale, i një drejtësie, të cilat kanë edhe qëllime. Kanë edhe qëllime politike dhe mendoj, se jo vetëm rasti i fundit ku gjykohet padrejtësisht një familje patriotike, një familje prej patriotësh, por edhe shumë raste tjera kanë disa mesazhe politike fundamentale për të ardhmen tonë. Unë do të doja, që tri gjëra t'i diskutojmë këtu bashkë me ju, tri shqetësime që i kemi thënë jo rrallëherë dhe që janë shqetësime, për të cilat duhet të bashkohemi. Duhet të bashkohemi dhe nuk ndahemi në parti politike, sepse nga ajo se si ne diskutojmë sot dhe si ne bashkohemi sot varet shumë edhe e ardhmja jonë. Jo rrallë ne po shohim një tendencë të hapur të krijimit të një baraspeshe midis luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare për liri dhe agresionit serb. Dhe, kjo baraspeshë shihet haptas në secilin segment, sepse sikur ekziston një përshtypje që agresioni është dënuar me bombardime dhe me krijimin e shtetit të Kosovës dhe se tani duhet të krijohet edhe baraspesha tjetër.

Duhet të gjithëve t'u themi, që pavarësia e Kosovës nuk është diçka që i është dhënë këtij populli, ajo është një gjë që i është mohuar këtij populli dhe është rikthimi i drejtësisë, e cila historikisht është mohuar dhe absolutisht nuk duhet të pajtohem asnjëherë me faktin, se ne jemi sot shtet i pavarur dhe duhet të amnistohet krimi i cili ka qenë shtetëror, i cili ka qenë i orkestruar dhe i cili, fatkeqësisht, akoma nuk është ndëshkuar në nivelin e duhur.

Momenti i dytë, që ne duhet ta marrim shumë seriozisht, është se dikush po dëshiron të na e rishkruajë historinë. Dikush po dëshiron që ne pas 20 vjetësh, nxënësve në librat e historisë të mos ua tregojmë të vërtetën se kush këtu ka bërë krime në shkallë gjenocidi dhe kush ka bërë luftë çlirimtare. Dhe, kjo pasqyrë sikur krijohet me këto raste gjyqësore, sepse e thanë edhe deputetët e mëhershëm, kemi vetëm një rast në zhvillim e sipër gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë. Janë dënuar disa udhëheqës të Serbisë, por krimet janë bërë në Kosovë. Numri më i madh i krimeve do të duhej të gjykohej në Kosovë. Edhe nga autoritetet ndërkombëtare kemi një rast të hapur, të pambyllur dhe kemi dhjetëra raste ndaj udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kjo do të ndikojë që nesër historia të shkruhet mbrapshtë.

Dhe momenti i tretë, unë mendoj se kjo ka një porosi, që në të ardhmen të krijohet një pajtim ndëretnik, duke falsifikuar faktet historike, duke bërë një tranzicion gjeneratash dhe kjo është krejtësisht e padrejtë, kjo është e papranueshme sepse ne duhet historinë ta ndërtojmë mbi bazën e fakteve dhe mbi bazën e një sakrifice, sublimimin që ne e kemi bërë.

Kështu që, unë mendoj se nuk po flasim për rastet individuale, sepse respektin më të mirë këtyre njerëzve ua ka bërë populli edhe do t'ua bëjë populli, por duhet vërtet të bashkohemi sot në një debat, duke kërkuar një drejtësi për të gjithë, jo një drejtësi selektive, duke kërkuar që drejtësia transicionale të jetë e drejtë, të jetë e baraspeshuar dhe të trajtojë realitetin dhe historinë drejtë, ashtu siç ka qenë.

Do të donim, që vërtet ne këtë debat ta shndërrojmë në një unitet politik dhe asnjëherë të mos punojmë që përmes debateve të tilla, që duhet të na bashkojnë, të krijojmë përplasje politike, sepse këto nuk na duhen për shkak se po flasim për një periudhë historike, për një periudhë ku ka ndërruar historia e Kosovës dhe po flasim për personalitete, që kanë marrë mbi supe pikërisht një mision historik -çlirimin e Kosovës dhe krijimin e mundësisë që pastaj të realizohet dhe procesi i shtetndërtimit.

Natyrisht, se shtetndërtimi i Kosovës ka qenë një proces jashtëzakonisht specifik dhe të gjithë ata që janë pjesëmarrës në këtë shtetndërtimi, unë po shoh shumë persona këtu, kolegë me të cilët kemi punuar në procesin e shtetndërtimit, e dimë që s'ka qenë aspak i lehtë. S'ka qenë aspak i lehtë, sepse ky shtetndërtimi ka qenë specifik, në kushte të një partneriteti ndërkombëtar dhe krijimit të një shteti në rrethana ndërkombëtare, ku nuk kemi mundur t'i bartim as në Kushtetutë, as në Deklaratë të Pavarësisë, të gjitha dëshirat e popullit.

Të nderuar kolegë,

E kemi bërë këtë më 2 korrik të Deklaratës Kushtetuese dhe në Kushtetutën e Kaçanikut, por atë e kemi bërë në një kontest tjetër politik. E kemi ditur, se nuk po bëjmë realitet, por kemi qenë të sigurt se po fillojmë një proces të shtetndërtimit. Ne kemi qenë shumë krenarë atëherë kur e kemi nisur procesin, tani duhet të jemi politikanë seriozë, politikanë racionalë, ta dimë që rruga jonë e shtetndërtimit është një rrugë specifike, është një projekt ndërkombëtar, është një projekt i partneritetit ndërkombëtar, është rezultat i luftës çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Asnjëherë nuk do të kishte, as intervenim ndërkombëtar, as përfundim të shtetndërtimit, pa luftën e shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por tani ne duhet ta mbrojmë këtë luftë nga cilido proces i denigrimit të saj apo i falsifikimit të fakteve historike, sepse ia kemi borxh këtij populli. Nëse e realizojmë këtë borxh ndaj këtij populli, jo për të mbrojtur individët, sepse ata do të mbrohen vetë, atëherë ne do të jemi një popull krenar.

Kosova është shembulli më i mirë i bashkëpunimit me drejtësinë ndërkombëtare, është shembulli më i mirë i mundshëm, jo vetëm në rajon, por ndoshta edhe në tërë globin, sepse ju e dini se asnjëherë njerëzit e UÇK-së nuk i kanë ikur drejtësisë ndërkombëtare. Edhe zoti Haradinaj, edhe zoti Limaj, kanë shkuar atje, jo për të mbrojtur vetveten nga akuzat e pabaza, por për ta mbrojtur luftën e drejtë të UÇK-së edhe rastet që tani po zhvillohen, edhe pse quhen raste individuale, kanë disa prapavija të tjera, kanë për qëllim që vërtet duke inkriminuar figurat kryesore të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të krijojnë pasqyrë të rreme të asaj çfarë ka ndodhur në periudhën e luftës dhe që japin porosi të paqëndrueshme për të ardhmen e vendit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Daut Haradinaj. Fjalën s'e ke kërkuar, këtu nuk të ka dalë që ke kërkuar. Vetëm e shtypni...

DAUT HARADINAJ: Nuk e kam në plan edhe të flas për këtë temë, se po e shoh që po buron bajraktarizëm, por meqenëse parëz e tërhoqe një paralele, mendoj se nuk ka paralele që mund të krahasohet Hajredin Kuçi dhe Zahir Pajaziti. Mendoj se ishte një lapsus juaji, kryetar.

Ndërsa, pyetjen unë e kam për ekzekutivin këtu që janë prezentë, a munden këtë të na tregojnë neve ndonjë veprim konkret që e kanë bërë në përkrahje, qoftë të çfarëdo natyre të mundshme, në procesin "Drenica", prej ditës që ka filluar deri më sot. A keni ju ndonjë gjë të na e thoni neve, jo vetëm fjalë miradije, por çfarë veprimesh keni bërë ju deri sot? A e keni pyetur EULEX-in ndonjëherë? A keni kërkuar transparencë? A çfarë keni bërë diçka? Konkretisht na tregoni, se ai vendim është fakt i kryer, ne tash veç flasim këtu badihava.

KRYETARI: Faleminderit! Në qoftë se, më lejohet! Krahasimet gjithmonë, po nuk janë të mira asnjëherë, po e mira është se të gjithë... është qenie në vete edhe me e respektua secilën. Vetëm për këtë e thash, si ti paragjykojmë veç kemi me e ulë vlerën tonë. Atëherë, zonja Donikë Kadaç-Bujupi, e dëshironi fjalën? Kush e dëshiron fjalën, le të lajmërohet tani, në mënyrë që ta bëjë edhe një radhitje.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Para më shumë se një viti, në këtë Kuvend, në mesin e 82 deputetëve që votuan pro themelimit të një Gjykate me karakter mono-etnik dhe që do të gjykojë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte edhe iniciuesi i kësaj seance sot. Pra, njeriu i cili me vetëdije votoi që të themelohet një trup që gjykon UÇK-në dhe po ashtu, grupi parlamentar i tij.

Sot tenton që para qytetarëve të Kosovës të dalë në pozicionin e atij që shqetësohet për dënimin e disa krerëve të UÇK-së nga një trupë tjetër, po ashtu ndërkombëtare, në këtë rast EULEX-i. Këtë veprim edhe po të donim ta quanim ndryshe, nuk kemi se si. Kjo është një hipokrizi!

Po në këtë Kuvend, po të njëjtën ditë, pak më shumë se një vit më parë, asokohe lideri i PDK-së, Hashim Thaçi, duke kërkuar votën e deputetëve për Gjykatën Speciale, në mes tjerash pati thënë: “Tash disa vite kemi punuar për të dokumentuar krime dhe viktime të luftës në Kosovë dhe shumë shpejt kosovarët, institucionet kosovare do të kërkojnë drejtësi nga Gjykata Ndërkombëtare, për...”, siç thoshte ai, “...tentativën e gjenocidit të shtetit serb në Kosovë. Do të kërkojmë edhe reparacionet e luftës.” Po ashtu, shumë herë ka deklaruar në emër të Qeverisë së Kosovës, se do të ngritët padi ndaj Serbisë për krimet e shkaktuara në Kosovë.

Edhe pas gjithë këtyre viteve, paditë e vetme që po ngritën janë ato ndaj shqiptarëve. Ndërkohë, që në Prishtinë po dënohet UÇK-ja, Serbia vazhdon me arrestimin e zyrtarëve të lartë të Kosovës për, siç thuhet në aktakuzat e tyre, dëbimin e një familjeje gjatë luftës në Kosovë, ndërkohë që Kosova nuk ngriti padi për 1 milionë njerëz të dëbuar gjatë luftës së fundit.

Sa vetë u dënuan për 11 mijë shqiptarë të vrarë nga shteti serb? Sa vetë u dënuan për 20 mijë dhunime të bëra nga ushtria serbe ndaj grave shqiptare? Sa vetë u dënuan për gjithë ato masakra, që ushtria serbe i bëri ndaj popullit shqiptar? A duhet të dënohet dhe të japë llogari dikush, që edhe sot pas gjithë këtyre viteve, mijëra qytetarë konsiderohen të zhdukur dhe nuk dihet për fatin e tyre? Kosova në vitin '99 ka qenë tokë e djegur. Kush u dënua për këto krime?

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës dhe ju të nderuar familjarë të pjesëtarëve të UÇK-së,

Shumë nga këta deputetë, të cilët sot shtiren kinse janë të shqetësuar me atë se çfarë po u ngjanë ushtarëve të UÇK-së dhe se çfarë kahe po i jepet luftës së UÇK-së, janë të njëjtit që kanë votuar një gjykatë që do të gjykojë e dënojë vetëm UÇK-në. Këta prej kohësh i kanë tradhtuar idealet e ushtarëve të UÇK-së. Këta prej kohësh janë distancuar nga lufta e UÇK-së, ashtu siç bënte edhe Hashimi sa herë përmendej Gjykata Speciale.

Në kohën kur po gjykohen ushtarët e UÇK-së, i ashtuquajti president i vendit po përkulet para pllakave, ku shkruan “këto janë viktime të terrorit shqiptar”. A nuk është kjo hapje e derës për dënimet dhe aktakuzat nga vetë Thaçi?!

Natyrisht, se dorasit duhet dënuar dhe secili krim i kryer duhet ndëshkuar. Por, përkulja e Thaçit para pllakës së Serbisë është legjitimim i pretendimeve ndaj Ushtrisë Çlirimtare e në anën tjetër, thërrisni seancë sa për t’u “hedhur hi syve” qytetarëve dhe familjeve të ushtarëve të UÇK-së. Kjo është PDK-ja dhe kjo është LDK-ja, këta janë deputetë që e kanë shitur UÇK-në, këta janë ata të cilët kanë tradhtuar dhe shkelur mbi vlerat e UÇK-së, kanë shkelur mbi gjakun e dëshmorëve. Dhe sot, ne të gjithë duhet të ngremë zërin dhe t’i kundërshtojmë këto akuza të padrejta, të gjithë. Të gjithë, përveç atyre të cilët vitin e kaluar, me votën e tyre dhanë verdiktin final kundër UÇK-së, kundër familjeve të tyre, vendosën që fëmijët e tyre mos ta gëzojnë lirinë me prindër. Dhe po, këtë e bënë pikërisht krerët, ata të cilët e kthyen në Kuvend dy herë Ligjin për Gjykatën Speciale.

A ju kujtohet? Deputetë votuan kundër kësaj padrejtësie dhe ishin krerët, kryetari i Kuvendit dhe ju të tjerët, të cilët e rikthyet, përtej të gjitha parimeve dhe insistuat, i shantazhuar, i bletë e i shitët deputetët, në mënyrë që Gjykata Speciale të votohet. Kurse sot, po vini këtu e po qani! Për çka?

Të gjykohet dikush që ka braktisur familjen dhe jetën e vet për të luftuar për çlirimin e vendit, përveçse është kundërligjore, sepse nuk ka ligj në Botë që ia mohon një populli të drejtën për tu mbrojtur, është edhe abstrakte dhe është kundërnjerëzore. Lexoni, të gjithë ju që po reagoni sot këtu, shkrimin e gruas, që sot e keni në të gjitha mediet, burri i së cilës ra kurban i pazareve të ndyta dhe ndoshta, atëherë do ta kuptoni se sa e thellë është dhembja, kur ti jep gjithçka për vendin tënd dhe në fund burgosesh.

Ndoshta, vetëm atëherë do ta kuptoni turpin që e keni bërë duke thirrur këtë seancë për arrestimet, që derivojnë pikërisht nga pazaret tuaja.

KRYETARI: Xhevahire Izmaku, fjala për ju. Ka dhjetëra të lajmëruar, mbi 90% janë nga Partia Demokratike e Kosovës, deputetët që kanë kërkuar fjalën. Keni parasysh, mund të ketë nga dy herë a tri herë të PDK-së, për arsye se 90% duhet të jenë diku rreth 30 vetë, nga ata 90% janë të Partisë Demokratike të Kosovës që kanë kërkuar fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Para se ta kem fjalën, vetëm më lejoni që të kem një replikë, i nderuar kryetar, sepse në përgjithësi ne deputetët e Kuvendit dhe Partia Demokratike u ndje e ofenduar nga fjalët e koleges sonë, deputetes Donika Kadaj, për të cilën tash kam një pyetje. Nuk e di në emër të kujt tash po flet, të cilit subjekt, të “Vetëvendosjes” apo si ish-deputete e Aleancës? Sepse, si “Vetëvendosje” ti ke abstenuar, si Aleancë... pra, ta dimë në emër të kujt po flet. E dyta, ende opinioni publik nuk e diti, Donika Kadaj, për çka u largove ti nga Aleanca. A ke pak moral dhe atikë dhe na trego, për çka u largove apo të larguan.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të vendit,

KRYETARI: Më fal, zonja Izmaku! Zonja Donika aq është entuziaste, sa do t’u përgjigjet menjëherë. Përgjigjuni njëra-tjetrës, a dëshironi të mos ndaleni.

XHEVAHIRE IZMAKU: Pas fjalës sime...

KRYETARI: Dëgjo, është shumë entuziaste. Ajo mund të dalë menjëherë jashtë ulëses. Për ata, qetë! Të gjithëve do t’ua jap fjalën nga 20 herë.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Unë do të hyj në temë.

Të nderuar kolegë të mi deputetë,

Të nderuar qytetarë të vendit, që po përcillni këtë seancë të jashtëzakonshme,

E nderuar familje e kolegut tim, Fadil Demaku dhe të gjithë familjarët tjerë Demaku,

Të çmuara familje e Sylejman Selimit dhe ju familjarë të gjeneralit Sami Lushtaku,

Të nderuar kolegë të mi deputetë, bashkëluftëtarë të këtyre njerëzve që sot janë në burg,

Në këto momente kur ju keni shqetësimet tuaja dhe tronditjen nga kjo që ndodhi dhe edhe ne deputetët e Kuvendit, dënimi i familjarëve tuaj na bëri bashkë sot, sepse ngjarja që ndodhi dhe na preku rënd të gjithëve barabartë.

Të nderuar qytetarë,

Fadil Demaku me vëllain Nexhatin dhe vëllezërit tjerë ishin ndër ushtarët e parë të luftës së lavdishme të UÇK-së. Ata në këtë luftë mbetën pa motrën e re, pa mbesën, e cila u vra e u masakrua nga forcat paramilitare serbe dhe po ashtu, mbesa e tyre e vogël, sot 20-vjeçare, e humbi njërën dorë, ku nëna e saj vdiq në vend nga plagët e plumbave të policisë e ushtrisë serbe.

Kjo familje dha edhe dëshmorin e lirisë dhe sot si kulm mbi kokë po i bie kaq rëndë kjo barrë e re, duke iu burgosur të gjithë djemtë e mbetur gjallë me dëshmi edhe të pavërteta.

Në asnjë moment, që flas për Fadilin, nuk i kam jashtë mendjes dhe zemrës sime familjarët e Sylejmanit e gjeneral Lushtakut, që u bënë vite që jetojnë në ankth, në pritjen e dënimit për gjëra të akuzuara dhe kurrë të vërtetuara. Nuk do t'i harroj asnjë nga këta luftëtarë të çmuar, që sot po rrinë të mbyllur në burg për akuza të fabrikuara, por më mirëkuptoni, të kem një dedikim të veçantë për bashkë-kolegun tim, Fadilin, sepse e kam koleg që nga dita e parë e fakultetit e bashkë dëgjuam edhe ligjëratat në studime të tjera dhe u takuam përsëri në këtë sallë, ku ai sot po mungon.

Duke folur në personale, po dua të tregoj se ne jemi njerëz në radhë të parë e pastaj gjykojmë si politikanë, e gjykojemi si politikanë. Pra, u bënë 20 vjet që e njoh këtë njeri dhe kurrë, asnjëherë në këto vite, jo që s'e kam parë duke bërë një veprim që lëndon dikë, por asnjë mendim negativ s'ia dëgjova për askënd e s'ia kanë dëgjuar as kolegët e mi të tjerë deputetë. Dhe sot, po dalka që ky njeri, me këtë edukatë, qenka bërë kriminel brenda natës! S'ka asnjë mundësi, sepse askush në këtë vend s'e ka njohur kurrë për të tillë.

Nga viti 2013 kemi folur bashkë për këtë aktakuzë qesharake dhe, se kurrë s'e kam besuar që deri në këtë nivel degradohet drejtësia, sepse ne idealin për liri e shtet ligjor e morëm nga ju, miq tanë të çmuar ndërkombëtarë, mbi këto vlera të larta evropiane, që keni vënë në shtetet tuaja. Besojmë dhe besuam edhe në rastet kur na u kërkua të dalim mbi veten tonë, për tu hapur rrugë hetimeve, të cilat u kërkuan, pra në mënyrë selektive, po ashtu në këtë drejtim.

Secili nga ne deputetët shqiptarë, në çdo datë e në çdo ditë, kemi folur në këtë Kuvend mbi krimet e kryera nën organizim dhe planifikim nga ushtria e policia serbe. Edhe unë vij nga një komunë, që nga kjo luftë doli e lënduar shpirtërisht e materialisht, duke humbur me qindra civilë e qindra ushtarë lirë. Por, që krejt në fund, sot e shtatëmbëdhjetë vjet pas, asnjë dosje nuk u hetua, asnjë kriminel s'u dënua e ata ishin shumë dhe kanë emra.

Po e përsëris, vi nga një komunë që ka qindra të vrarë civilë e ushtarë, por edhe në shtëpinë time, po ashtu, më mbetën jetimë mbesa e nipa dhe shumica që e dinë këtë ndjenjë edhe do të flasin pak më ndryshe edhe përjetojnë pak më ndryshe. Në vitin '99, vetëm pak ditë pasi përfundoi lufta, bashkë me Këshillin për Lirinë dhe të Drejtat e Njeriut filluam t'i mbledhim dëshmitë e krimeve. Dhe dhjetë vjet pas, duke i ruajtur me fanatizëm i dorëzuam, si komunë, në zyrat e EULEX-it, jo dëshmi të kota, por ngjarje të vërteta, krime të kryera, vajza të dhunuara, djem të rinj të prerë në fyt, emra e mbiemra me dëshmitarë të gjallë për kriminelët, por kriminelët që popullin në Vushtrri e kishin shkatërruar dhe masakruar, ishin pra të njohur. Disa nga ta kanë ikur në Beograd, kanë zënë edhe pozita në polici e ushtri, bile edhe janë shpërblyer.

Domethënë, sot ajo qeveri që po pretendon t'i bashkohet Bashkimit Evropian i mbanë këta kriminelë dhe i gradon. Kush s'e ka njohur kryekriminelin Vuçina në komunën time? Çdo i dyti shqiptar u rrah dhe maltretuar nga ai për dhjetë vjet e ndoshta edhe më shumë. Ja, e keni në Beograd, është gjallë dhe punon. E sa të tjerë të tillë, që i njohën bashkëqytetarët e mi, që ua sakatuan familjet e tyre, por që fatkeqësisht, nuk u bë asgjë kurrë.

Jam rritur e jam pjekur me ëndrrën për të pasur një shtet ligjor, që i ngjanë Evropës. Kam ëndërruar e kam punuar që ta kem një shtet, që merr model shtetet evropiane për zbatim të ligjshmërisë e për jetë të lirë. Kur liria erdhi, të nderuar miq ndërkombëtarë, ne e patëm nevojën tuaj dhe e kemi shumë nevojën tuaj, sepse jemi shtet i ri.

Ne pranuar e pranojmë këshillat tuaja për të funksionalizuar çdo segment të shtetësisë, por në sferën e drejtësisë sikur diçka nuk po ecën mbarë. Ne shohim, që në rastet kur gjykohen njerëzit tanë një normë e re e standard tjetër përdoret edhe një dinamikë tjetër e vendimeve. Fjalën e kam vetëm për luftëtarët e lirisë dhe dënimet për ta. Kërkojmë që fjalët tona mbi këtë të mos devijohen, me qëllimin që ne ndërhyjmë në drejtësi, por ne kemi nevojë të besojmë, që ju po krijoni një sistem të drejtë këtu, ne kemi nevojë të kuptojmë që drejtësi po bëhet, sepse duhet ligjshmëri. Por, jo sepse duhet një raport për ta dërguar diku, që ju keni mbyllur misionin tuaj me sukses, duke gjymtuar familjet e luftëtarëve tanë, këtyre njerëzve që kur ne humbëm shpresat për çlirim, lanë rehatinë e tyre familjare e nisën një luftë të pabarabartë me një ushtri e polici, pa e ditur kurrë nëse nata i zë të gjallë apo mëngjesi i çel duke marrë frymë.

Në, po sikur ju, të nderuar miq ndërkombëtarë, duam dhe do t'i nderojmë luftëtarët tanë, sepse këtë e keni bërë edhe ju në luftërat që bënë shtetet tuaja për çlirim në periudha të ndryshme të historisë.

Vëllezërit Demaku, shoku im Fadil, gjeneralët Lushtaku e Selimi, janë heronjtë tanë të gjallë. Dënimi i tyre nuk na bind që pat drejtësi të pastër. Ju, të çmuar miq ndërkombëtarë, na mësuat që transparencën duhet ta bëjmë si parim në këtë shoqëri, por parimin e drejtësisë po e bëni selektiv për popullin tim, pas lirisë.

EULEX-i gjithë këto vite nuk është se bëri një mrekulli. Nuk e di një shembull tjetër të punës së tij, përveçse me aq nguti arrestoi e gjykoi, me dëshmi e pa dëshmi, ish luftëtarët tanë, pa të cilët s'ka kuptim as kjo liri.

Kërkoj që të kuptoni drejtë fjalën time, sepse jam deputete, përfaqësoj besimin e qytetarit tim. Ai mendon kështu si unë dhe fjalën e tij po ua bart drejtë, të pandryshuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë ka... urdhëroni zonja Kadaj-Bujupi!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Siç dihet botërisht, nuk ka qenë abstenim. Përkundrazi, kam pasur edhe fjalim në këtë foltore, ashtu siç kanë vepruar e gjithë opozita me 26 qershor, kur edhe deputetja ka votuar drejtë herën e parë. Dhe, ne e kemi mbështetur, madje e kemi përgëzuar për atë votë të drejtë më 26 qershor.

Po, çka ndodhi më 3 gusht dhe çka u desh që ta ndërrojë mendjen dhe të votojë pikërisht pro Gjykatës Speciale dhe dënimit të UÇK-së, kur pikërisht njerëzit që sot janë në burg dhe po mbahen atje padrejtësisht e për të cilët po derdhin lot krokodili PDK-ja e LDK-ja, kanë qenë edhe asokohe në burg. Le të na tregojë pse e ka ndërruar qëndrimin dhe votën prej 26 qershorit deri më 3 gusht dhe a e ka votuar Gjykatën Speciale?

KRYETARI: Urdhëro, zonja Izmaku, kundër-replikë.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Unë prita që do të përgjigjet, sepse nuk e harrova pyetjen që ia bëra. Nëse, përgjigjet Donika për çka e ndërroi partinë, pse iku nga Aleanca, atëherë unë do t'ia jap përgjigjen për çka e ndërrova.

KRYETARI: Fisnik Ismaili, e dëshiron fjalën, se e ke zërin e madh. Urdhëro, në qoftë se e dëshiron fjalën. Fisnik Ismaili. Veç mos bëni debat ndërmjet vete, për arsye se po krijoni pasqyrë negative.

FISNIK ISMAILI: Çka ka lidhje një zgjidhje individuale e zonjës Donika Kadaj me të mirën madhore, për të cilën po flitet këtu. Është shumë absurde kjo pyetje juaj të krahasohet me pyetjen që ju bëri Donika Kadaj. Kështu që, shumë e natyrshme është që të përgjigjeni në pyetjen që ua bëri Donika edhe të mos kapeni në zgjedhjet individuale personale të dikujt.

KRYETARI: Atëherë, vazhdojmë me debatin. Tash, kundërpërgjigje, po. Edhe një kundër-replikë në kuadër të replikave e kundër-replikave. Zonja Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Me veprimin e juaj në këtë ditë, kur familjarët e të të dënuarve, për shkak të votës suaj dhe veprimeve tuaja po na shikojnë, unë nuk do të replikoj në temat të cilat po provon t'i ngresh. Ndoshta do ta kuptosh qëndrimin tim në seancën në të cilën je dëshmitare e ftuar, ku unë e kam mbrojtur Kosovën nga "Zajednica" dhe Demarkacioni, e ti edhe atëherë ke votuar. E tash je dëshmitare.

Ndërkohë që, po më vjen keq, jo që i keni zhgënjyer të gjithë qytetarët dhe familjarët, por i keni zhgënjyer edhe fëmijët e juaj. Edhe vajza jote, edhe pse punon në RTK, një herë ka pasur të drejtë dhe këtë më 26 qershor.

KRYETARI: Ju lutem, a ka mundësi familjarët mos me i përmend në debat. Lërimi familjarët jashtë, merruni me debatin për të cilin jemi.

Tash po kërkojnë... zonja Shqipe Pantina, menjëherë ta jap fjalën, vetëm zonja Izmaku e ka. Kush e do fjalën, vetëm mos ta humbim rregullin.

XHEVAHIRE IZMAKU: Donika Kadaj,

Po harron që sot këta nuk janë dënuar prej Gjykatës Speciale. Unë kam besuar dhe besoj në drejtësi, sepse ish-lideri yt, Haradinaj, u përball me këtë dhe doli fitimtar, po ashtu edhe kolegu im dhe kolegu ynë, Fatmir Limaj, doli fitimtar.

Unë besoj në këtë drejtësi që do të dalë, mirëpo le t'i mbetet opinionit ta shohë, pra kush pati të drejtë dhe kush me kë ndjehet krenare. Vajza ime ndihet krenare me mua, sepse unë veproj si deputete dhe nuk veproj si një rrugaçe brenda Kuvendit, t'u hedh në sy dhe gaz lotsjellës kolegëve...

KRYETARI: Asnjë fjalë më! Asnjë fjalë të rëndë dhe të njëjtën kohë, as kur të përmenden familjarët... kam me ua ndalë fjalën, ta dini! Ndoshta, do të dal në pozicion të rëndë, por nuk e kam ndërmend, familjet le të mbeten jashtë. Bekim Haxhiu, fjala për ju. Pal Lekaj le të përgatitet. Kush e dëshiron fjalën, vetëm merreni fjalën, adresohuni publikisht, familjarët lërimi jashtë, ju lutem! Dhurata Sadiku pastaj nga Qeveria.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet kam pritur një debat në frymën e kërkesës për këtë debat, por po shihet që ka dëshirë t'i jepet dhe konotacione të tjera këtij debati. Prandaj, detyrimisht më duhet të them që në fillim të fjalës sime apo të sqarojmë një fakt. Kush po bën lojë sot këtu? Kush po shet demagogji në Kuvend sot?

Ne që kërkuam debat për një çështje të drejtë, sepse deputetë dhe ju deputetë të "Vetëvendosjes" sponsorizuan dhe ndihmuan hartimin e raporteve kundër UÇK-së. Kush po bën lojë sot? Kush po bën demagogji? Kush!? Ata që takuan Dick Martin, David Philipsin, sponsorizuan udhëtimet dhe raportet e tyre? Kush!? Apo, ne që po kërkojmë të mbrohet lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse ata, ata e njollosën me raporte të fshehta kundër UÇK-së. Kush sponsorizoi David Philipsin në Kosovë? Kush sponsorizoi Dick Martin? Çka është demagogjia?

Është demagogjia nëse prapa kësaj salle, në takime të fshehta shkruan raporte kundër UÇK-së dhe vjen këtu, del e mbron atë. Kjo është demagogjia! Pse jeni kundër Gjykatës Speciale? Thojani popullit pse keni qenë kundër! Sepse, dëshiruat që raportet tuaja t'i valorizojnë prokurorët rusë dhe pro-rusë në OKB. Kjo është pse ju ishit kundër UÇK-së, kundër Gjykatës Speciale, se raportet tuaja dëshiruat ata t'i valorizojnë. Ju nuk deshët dhe nuk dëshironi, që Gjykata Speciale të jetë e përbërë nga gjykatës amerikanë dhe evropianë. Por, kërkuat me çdo kusht, me çdo mjet, që ta rrënoni kërkesën e cila ndodhë si produkt i atyre raporteve të fshehta të juaja.

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kam menduar gjatë, si çdo qytetar i Kosovës edhe si përfaqësues i popullit, se vërtet ndër shekuj kemi qenë një popull i robëruar dhe përjetësisht Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të jetë vlera më sublime e saj derisa nuk do të kishte të atillë që e njollosin atë. Nuk jam jurist me profesion, të gjithë e dini, por sigurisht nga ato njohuritë e mia dhe nga diskutimet me ekspertë, shpjegimet e tyre juridike thonë se prova më e pasigurt në një gjykim janë deklaratat e dëshmitarëve, në veçanti, sipas praktikave të viteve të fundit të dëshmitarëve që kodi i procedurës penale i kualifikon si dëshmitarë bashkëpunues, të mbrojtur, që janë të joshur nga programe të mbrojtjes, të përfitimit material, sigurimin e jetës në vendet e perëndimit dhe mirëqenies së tyre. Dhe, këto dëshmi vërtetë janë të diskutueshme dhe janë dëshmitë më të vogla, që mund të ofrohen në raport me provat materiale, që ka për obligim çdo gjykatë t'i dëshmojë dhe paraqesë në gjykatore. Në mungesë të argumenteve aktgjykimi i apelit në rastin e emëruar si "Drenica 2" e konsideroj aktgjykim kundër drejtësisë, kundër së vërtetës dhe viktimizimit të ushtarëve dhe komandantëve të pafajshëm. Me fjalë të tjera, padrejtësia, shpifja, fabrikimi, falsifikimi,

gënjeshtat e kanë mbuluar të vërtetën në drejtësi dhe pafajësinë e komandantëve dhe ushtarëve të pastër si liria e Kosovës.

Jo vetëm vendimi, por i tërë procesi, që nga fillimi e deri në fund është i montuar, jo vetëm ky proces, por edhe procese të tjera kundër pjesëtarëve të UÇK-së, janë montuar e fabrikuar në Beograd dhe pastaj valorizuar në policinë e UNMIK-ut, nëpërmjet elementëve të caktuar pro-serbë, rusë e pro-rusë.

E kam thënë se EULEX ka huq në drejtësi në atë moment që ka marrë lëndët e UNMIK-ut, të cilat janë fabrikuar në Beograd. Procese të fabrikuara e të montuara, ku target kanë ndjekjen e individit, jo krimin, atëherë rezultati sigurisht është ky që është, i përndjekjes ndaj individëve.

Personalisht kam besuar në mekanizmin e drejtësisë, në veçanti në këtë të Bashkimit Evropian, por duke parë veprimet dhe vendimet e fundit shtrohet pyetja, se a do të mund të njëjtit gjykatës, me të njëjtat dëshmi, me të njëjtat prova, të marrin vendimin e njëjtë edhe nga shtetet nga vijnë.

Të nderuar kolegë, është shumë indikative se si krerë të UÇK-së, të cilët Serbia para luftës, disa nga ta i dënoi edhe në mungesë, vetëm pse po kërkonin lirinë për popullin e tyre, e drejtë që është e të gjithë popujve në krejt Botën, e drejtë universale, të njëjtit sot përballen me drejtësinë ndërkombëtare, me akuzat të cilat janë fabrikuar në Beograd e të ndihmuara edhe nga disa shqipfolës dhe po të njëjtit, që Serbia i akuzoi dhe disa nga ta i dënoi para luftës, po të njëjtit sot po përballen me drejtësinë. Është shumë indikative kjo. E bash ata që e paskan nisur luftën, a bash ata edhe paskan bërë krimet e supozuara? Po, kjo është vetëm një përndjekje ndaj krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Serbia e ka bërë për qëllime të ditura e disa sot e bëjnë për t'i eliminuar nga skena politike apo pak më herët, vite më herët, e kanë bërë për t'i eliminuar nga skena politike.

Një sentencë e urtë thotë, se më mirë është njëqind të pafajshëm të jenë në liri, se sa një i fajshëm në burg, kërkoj falje, do të thotë se 100 të pafajshëm të jenë... përmirësoj, se njëqind fajtorë të jenë në liri, se sa një i pafajshëm në burg. Kërkoj falje, e di që për shkak të asaj dhembjes që e ua thash të vërtetën ata edhe buzëqeshin, por familjet e Sylës, as të Samisë, as të Demakut, as të Demiëve, as të Kicinëve, nuk po u qeshet sot. Ama, janë për shkak të raporteve të juve, po, po. Po, po, sërish do ta votoj Gjykatën Speciale, për të mos e lënë të shkojë te rusët, ku keni qejf ju. Prapë, Donikë, e votoj Specialen, prë të mos e lënë të shkojë ku keni qejf ju të shkoj, në dorë të rusëve.

Po, se ti ke bërë raporte, je mësua se i ke ngjarë babës, e ke shkollë.

KRYETARI: E ndali fjalën me përdor për familje. Familja ka me qenë jashtë. Familja dhe të gjitha. Flitni çka keni veç për njëri tjetrin.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Pse është përndjekje ndaj krerëve të UÇK-së dhe është përndjekje ndaj individëve, shihet se nuk kemi asnjë rezultat ndaj ndjekjes së krimit. Nuk kemi asnjë rezultat për zbardhjen e krimeve të ndodhura në Kosovë, duke filluar prej ai që është i njohur dhe i shkruar në Burgun e Dubravës, ku dihen kush kanë qenë drejtorët e burgut, urdhërdhënësit dhe urdhërkryerësit e masakrës në Dubravë. Pastaj, masakrave të tjera, të gjitha ato vrasje, djegie dhe përdhunime që ndodhën në Kosovë dhe ne ende sot nuk kemi asnjë akuzë të ngritur, sepse jemi në përndjekje ndaj individit dhe jo në zbardhjen e së vërtetës dhe drejtësisë për krimet e kryera në Kosovë.

Të nderuar kolegë,

Ne e fituam luftën, do e fitojmë dhe paqen, sepse jemi kalitur në sfida dhe vështirësi, sado që urogatët që ka gjetur dhe surogatët, që ka gjetur Serbia për të goditur Kosovën, nuk do dorëzohemi asnjëherë, sepse do të ndërtojmë shtet, i cili do e trashëgojnë breza të tjerë të tërë. E vërteta dhe e drejta do të ngadhënjëjë dhe ajo është në anën e UÇK-së, djemve dhe vashave më të mirë të popullit të saj.

Ne e fituam luftën, do e fitojmë edhe paqen, sepse jemi kalitur në sfida dhe vështirësi, e vërteta dhe e drejta do ngadhënjëjë dhe ajo është në anën e UÇK-së dhe djemve dhe vashave më të mirë të popullit të saj. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar Pal, fjala për... Replikë a? Mos hyni në çështje familjare, hyni individuale. Urdhëro! Po, po, në qoftë se të ka përmend, urdhëro! Me më dëgjua mua... si të doni ju. Fisnik Ismajli e ka fjalën.

FISNIK ISMAJLI: Ju thatë, mos me hy në debate familjare. S'po hyjmë, veç individuale gjithqysh po duhet me hy edhe me qitë në pyetje dhe në dyshim gjendjen, shëndetin mendor të paraflësist. Një njeri me mend në krye nuk çohet me na akuzua për gjana që na akuzoi, posaçërisht duke e ditë vetë çfarë dallaveraxhiu e rrenacaku është. Ai nuk është absolutisht, nuk është hiç e rastësishme që FIF-a të ka qitë prej Kryesisë së Federatës së Futbollit, se je dallaveraxhi, a po kupton? E tash, po pret ne ty me të besua për krejt akuzat që na i bane? Amani të qoftë, merru me... a din, boll qave këtu rrejshëm. Merru me çështjen në fjalë e mos shko me akuzua pa lidhje, se krejt, krejt, po ty me të besua dikush, nëse pret... hajgare është kjo punë.

KRYETARI: Kundër-replikë, ju kisha lutur shkurt! Familjarë, regjia menjëherë ia ndalë fjalën. Kush flet për familje do ta bëjë atë që s'e kam bërë asnjëherë, do t'ia ndal dhe do të kërkojë ta lëshojë seancën dikush, se kjo është seancë vetëm për luftëtarët e lirisë. Të lutem, politikën do ta lëmë jashtë, bile këtë herë.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Deputet Ismajli,

Më ka besuar populli edhe jam këtu përfaqësues i popullit. Nja pesëmbëdhjetëmijë vota edhe nja njëqind herë, a njëqind e... herë më shumë se ti.

KRYETARI: Donikë, ta jap fjalën. Ta jap fjalën mos asi... Edhe ti Shqipe. Po, mësoni njeriun me fol, ju kisha lut, ju kisha lut

BEKIM HAXHIU: ...nëpër të njëjtin proces dhe në atë proces ka ndodhur bindshëm...

KRYETARI: Më fal, Bekim Haxhiu, më fal, ndale veç pak të lutem. Urdhëro, Shqipe Pantina, se je shumë e zëshme. Fol, fol e të dëgjojmë e mos fol pas sysh, qysh jeni mësuar. Fol edhe e kërkoj Prokurorinë, kryeprokurorin e Shtetit, që t'i marrë në vëmendje, për arsye se akuza ishte e drejtpërdrejtë. Tha i ka pesëmbëdhjetëmijë vota, the "i ka vjedhë". Fol!

SHQIPE PANTINA: E para, s'e thashë unë, jo s'e thashë unë. Kështu që t'u kanë ngatërruar sot edhe fytyrat, edhe emrat, si duket, se as s'fol. Po, meqë ma dhe fjalën, veç një porosi këtij zotit Haxhiu.

Po t'i thoshte këto fjalë para 3, 4 a 5 muajve, para se të dilte në pah afera "Pronto", ndoshta ndonjë militant i PDK-së edhe do t'i besonte, por pasi e kemi dëgjuar Zejdush Kastratin qysh i jepte këshilla Ademit: "Hajt gjuaje një fjalë, se populli e ha", valla nuk u beson më kurrkush, as militantët tuaj. Kështu që këto akuza qysh po i gjuani: "Hajt se s'ka rëndësi a ka argument a fakt, se populli kështu e kupton", nuk kanë më, nuk kanë...

KRYETARI: Regjia ia ndal fjalën, sepse është jashtë teme. Urdhëro, deputet i nderuar, futuni në temë, mos i ikni fjalës, mirë është të flisni publikisht e t'ju dëgjojë i tërë populli.

Kryeprokuror i përgjithshëm, t'u kisha lutur, në akuza çdoherë merrni masa, kryeprokuror, duhet sjellë prokurorët për t'i qartësuar qysh dhe çka kanë bërë akuza.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Po më vjen shumë mirë për këtë reagim në tërësi të kolegëve të "Vetëvendosjes", me të cilët kemi kaluar një proces të njëjtë zgjedhor dhe kur unë kam dalë fitues në raport me parafolësit dhe krejt këta çka folën bashkë, sa unë vota s'mund të bëjnë.

Edhe një herë! Më vjen mirë që reagoi zoti Ismajli, edhe pse s'ia përmenda emrin, por sigurisht që populli thotë: "Mizën nën kapuç". E di ai pse? Dhe, për atë reagoi zoti Ismajli, edhe pse s'ia përmenda emrin.

E sa i përket çështjes së FIFA-s dhe UEFA-s, zoti Ismajli, Bekim Haxhiu e ka përfunduar misionin në futbollin e Kosovës me pranimin e Kosovës në UEFA e në FIFA, kam dhënë shumë

për futbollin e Kosovës, kam ngritur “Trepçën”, Federatën dhe tani do të bëjmë edhe atë që është më e mira për vendin, do të bëjmë infrastrukturën sportive me dy stadione, në Prishtinë dhe në Mitrovicë, e do ta bëjmë edhe stadiumin nacional, për çka ti s’merr vesh, o bullafiq.

KRYETARI: Faleminderit! Pal Lekaj e ka fjalën dhe rrini në temë! Dëgjoni, jeni duke dalë nga tema dhe po tregoni se s’keni interes për temë. Jua jap unë prapë fjalën, e tash e ka fjalën Pal Lekaj. Po, nuk ia përmendi emrin askujt, sepse ua kisha dhënë fjalën! Pal Lekaj e keni fjalën dhe pastaj shkojmë tutje.

PAL LEKAJ: Të nderuar kolegë deputetë!

Mendoj se seanca e sotme është thirrur për luftëtarët e lirisë, për ata të cilët sot janë të burgosur padrejhtësisht dhe seanca e sotme nuk është thirrur që këtu të ngrihen ato çështje individuale apo interesat sa për të bërë politikë.

Qytetarët sot presin nga ne që vërtet të tregojmë seriozitetin në këtë temë të çmuar për ata që janë më meritoret për vendin, dhe nuk pret prej nesh që ne të lëshohemi në debate individuale personale dhe ju kisha lutur si deputetë të kthehemi në temë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Dhurata, kisha kërkuar mirëkuptim. Fjalën e ka kërkuar Fatmir Limaj, që është edhe një nga kryetarët e partive opozitare, e pastaj e keni ju fjalën. Pra, po vazhdojmë me fjalime, për arsye se po e humbim konceptin e debatit dhe s’kam tjetër hall. Urdhëro, zoti Limaj!

FATMIR LIMAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Sot jemi në një seancë të jashtëzakonshme për një çështje për të cilën këtu u fol dhe në fillim po them se jemi në një seancë tepër, tepër të vonuar, në një seancë e cila ka dashur të bëhet disa herë dhe shumë vjet më parë.

Mbajtja e një seance të tillë sot, më së paku ose hiq nuk u ndihmon atyre për të cilët është thirrur.

Të nderuar kolegë, sot këtë seancë e shikojnë edhe ata për të cilët është thirrur, që janë brenda në burgje, edhe familjarët dhe qindra-mijëra bashkëluftëtarë e qytetarë - liridashës të këtij vendi, me shpresë se po del diçka nga kjo seancë.

Ne sot, përveç shumë gabimeve që i kemi bërë në këtë drejtim dhe për këtë çështje, sot po e bëjmë një gabim tjetër, dhe me vetëdije jemi duke e bërë.

Të gjithë këtu në sallë e dimë se kjo seancë veç sa i dëmton dhe s'i ndihmon njerëzit për të cilët është thirrur. Të gjithë e dimë se kjo seancë është e vonuar. Dhe, mbi të gjitha, të gjithë e dimë se kjo seancë sot për këtë çështje është bash ndikim ose interferim në sistemin e drejtësisë. Është, dhe i dëmton...

Po a e dini sot për çka po flasim?! Ka këtu shumë juristë, ka shumë njerëz që e dinë se po flasim pas vendimit të Gjykatës së Apelit, vendimit të prerë të një gjykate.

Mosthirrja e menjëhershme e kësaj seance kështu, e pamundur është të mos jetë seancë emocionale. Dhe, ka prej deputetëve që s'i mban emocionin dhe dalin jashtë kësaj çështjeje, dhe më së paku ne na duhet një seancë për çështje të tillë emocionale.

Ne mund të flasim këtu, e të çojmë selam atje, se unë e di që natën dhe fatkeqësisht mund të them, një pjesë e madhe e deputetëve këtu dalin e flasin për vota atje që i kanë. E ka treguar për vite të tëra sjellja jonë për këtë çështje.

Një pjesë e deputetëve dalin atje dhe presin mesazhet: "A fola mirë?" Po ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për asnjë gjë nuk u ndihmohet atyre për të cilët e kemi thirrur këtë seancë.

Prandaj, ju kisha lutur që, të paktën, të paktën mos tentoni të përdorni vuajtjet, dhembjet, padrejtësitë dhe krejt çka janë bashkë, për poenë të lirë, politikë, kinse ne bëjmë diçka.

Kjo është seancë, e cila konteston dhe ndërhyr në sistemin e drejtësisë. Pikë! S'ka asnjë dilemë! Të ishte mbajtur kjo seancë para disa kohëve, do të ishte temë tjetër.

Unë dua t'u them familjarëve dhe të gjithë atyre t'u tregojmë se po mundohemi ta themi të vërtetën dhe vërtet kjo çka është duke u bërë sot, kurrgjë s'do t'u ndihmojë njerëzve tanë. Ishalla nuk i dëmton më shumë! Ishalla s'i dëmton më shumë!

Shteti dhe UÇK-ja. Ku është ai shtet dhe çka ka bërë për të mbrojtur interesin publik. Sot po flisni për emra të individëve. Jo! As Sami Lushtaku, as Sulejman Selimi, as Nexhat Demaku, as Fadili, as kurrkush s'ka hyrë për prona private të luftojë për Kosovë, as për shtëpi të vetë, as për megjë, as kurrkush s'i ka detyruar ata vullnetarisht t'ia japin jetën Kosovës. Po, jo megjave të tyre, arave të tyre.

Dhe, ne çka jemi duke bërë, çka jemi duke bërë sot me diskutime? E kemi kthyer këtë punën e mbrojtjes së UÇK-së në bazën individuale dhe familjare. Ai që akuzohet ia pagfëmë hairin me familje të vet, me atë rrethin e ngushtë të ballafaqohet, në mund të ballafaqohet, kujt s'i intereson, as shtetit.

Për sa vjet ky shtet nuk e ka nxjerrë të thotë: “Akuzat ndaj luftës çlirimtare janë akuza të interesit publik që shteti ka interes publik të përcjellë nga fillimi deri në fund për të mbrojtur interesin publik të luftës sonë çlirimtare”, duke prezymuar pafajësinë, që e thotë Kushtetuta dhe ligji ynë.

E tash shtrohet pyetja, çka po dua të them me këtë? Sa për pesë vjet gjykim që e kanë pasur këta njerëz, Qeveria e Kosovës a e ka dërguar ndonjë avokat në emër të Qeverisë së Kosovës të mbrojë interesin publik me gjykimin e njerëzve tanë, të ushtarëve të UÇK-së? Një avokat, jo ta mbrojë Sami Lushtakun, Sylejman Selimin, por të mbrojë interesin publik të shtetit, të luftës sonë çlirimtare. A e ka dërguar? Ta përcjellë se a po shkelen të drejtat, a po përlyhet pa të drejtë interesi publik, sepse lufta e UÇK-së është interes publik.

Nuk mjafton të thuhet me atë vjershën se UÇK-ja ka qenë një ushtri çlirimtare, e blla-blla, e pastër dhe e ndershme...! Mosni more kështu, këto sende në drejtësi nuk shkojnë. Këto janë pallavra që mund të fliten nëpër televizione në debate publike opinione.

A e ka dërguar atë Qeveria e Kosovës? A e ka ndihmuar mbrojtjen Qeveria e Kosovës? Këtu duhet kërkuar përgjegjësia, a e ka ndihmuar mbrojtjen. Sot kemi parë, vendimi i prerë dhe themi: “Po, u është bërë padrejtësi”, që në fakt krejt çka u përmendën nga disa deputetë emra se jo me dëshmitarë, e tjera, krejt janë fakte. Por, kujt po i themi, kur njerëzit kanë marrë dënime, kur tashmë është dënim i shkallës së prerë, është vetëm edhe një instancë, ligjshmëria.

Po ua them këtë, sepse shikoni vendet e tjera. Edhe në procesin e Hagës, edhe në proceset brenda Kroacisë, Bosnjës dhe Serbisë, nuk ka mundësi të zhvillohet një gjykim për krime lufte pa qenë shteti dhe pala e interesuar aty. Nuk ka mundësi!

Në Hagë, avokatët e shtetit kroat janë paguar me miliona, në emër të shtetit ata kanë dalë aty. Dhe, kurdo që është tentuar t’u bëhet padrejtësi dhe qëllim për të devijuar luftën çlirimtare kroate, është ngritur avokati i Qeverisë kroate dhe ka thënë: “Jo, s’po më intereson mua Gotovina, po më intereson shteti kroat. Këtë që po e thoni, nuk është e vërtetë, që ku janë argumentet”. Kjo bëhet që të mbrohet shteti, sepse ai s’ka luftuar për vete.

Këtë e kemi kërkuar ne disa vjet, por jo vullnetarisht kemi zgjedhur t’ia lëmë secilit fatin individual dhe le të merret me familjen e vet. Pra, në shpëtoftë, mirë, nëse s’shpëtoi, flaka i daltë! Ia lëshojmë një deklaratë aty dhe u krye puna!

Është turp! Është turp! Është turp sjellja dhe qasja e shtetit ndaj vlerës së vet, ndaj themelit të vet, ndaj themelit të lirisë.

Po sjellja dhe veprimi ynë nuk shkon në përputhje çka flasim ne. Është e kundërta, nga ajo që ne e bëjmë.

Ne praktikisht kemi ndihmuar për 15 vjet për t'i rrënuar themelet e shtetit tonë. Gaboni nëse mendoni se ata janë duke thënë: "Këqyrni për fatin tonë individual". Jo, nuk janë duke thënë atë. Gabim e keni. Ka të tillë që bile thonë - mos ligi! Shiko, këqyreni qysh e kthejnë këtë barbarizëm në punë primitive familjare. Shikoni, thonë - mos ligi! Thuaja se ai ka dalë atje, e ka bërë një krim individual, e kemi kthyer këtë punë primitive, ashtu qysh jemi ne, sepse ne s'kemi ide të shtetit, ne s'kemi logjikë shtetformuese. Ne bëjmë hajgare me shtetin. Ne veç erën ia kemi ndier shtetit.

Edhe të tjerët bëjnë hajgare me ne duke parë çfarë qasje kemi ndaj vlerave tona.

E kemi kthyer këtë punë në individuale. Dhe kështu do të shkojë, fatkeqësisht!

Bile, këtu ka aq pamoral sa që i kthejmë këto për luftë politike individuale flasim, kush çka bëri, e tek bëri. Edhe këtu tregon Parlamenti se qysh devijon, sa shpejt devijon prej teme këtu për çka jemi mbledhur. Shpejt devijon sepse lodhen, 5 minuta i kemi kryer dhe, hajt të kthehemi te ato temat tona të këndshme - ta shajmë njëri-tjetrin, se kjo për UÇK-në u mbyll, u krye.

Andaj, nuk shkojnë këto gjëra kështu. Prandaj do të keni shumë pasoja. Ju nuk mundeni, ju keni arritur që çdo qytetari të Republikës së Kosovës, kur t'i shihni këta njerëz, të mos i shihni si njerëz të kohës së luftës, por si njerëz të pasluftës, të politikës, pengesë janë, duhet larguar. Këtu është krijuar një opinion që s'mund ta ndani luftën dhe pasluftën. S'mund t'i ndani, i kanë bërë bashkë.

Sot ka njerëz të atillë që dikur, gjatë luftës në Kosovë, në Prishtinë pinin kafe, i fërkonin duart se dikush na e sjell lirinë, sikur që sot të njëjtit njerëz janë që i fërkojnë duart dhe thonë: "Ishalla shkojnë këta e vijnë ne në pushtet", se janë mësuar gjithmonë të gatshëm t'i kenë sendet.

Ndaleni këtë debat në këtë mënyrë. Sot kjo seancë jo që s'do t'i ndihmojë ata djem, por kjo seancë po e dëmton shtetin. Për mendimin tim, sot kjo seancë po e dëmton shtetin. Nuk ka parlament në botë që çohet pas vendimit të Gjykatës së Apelit të çohet e flet për atë çështje. Nuk ka. Dhe kjo po e dëmton sot shtetin. Domethënë jo që s'po i ndihmojmë ata, por edhe po i dëmtojmë. Për çka po e bëjmë këtë? Po e bëjmë për pazare politike ditore. Domethënë, jemi të gatshëm nganjëherë edhe shtetin ta rrënojmë kur na duhet për interesa.

Është bërë përrallë thirrja e famshme: "Askush mbi ligjin". 90% ju lidhje s'keni çka do të thonë "Askush mbi ligjin". Çka është kjo "Askush mbi ligjin"? A dini të thoni ndonjëherë, "Askush mbi ligjin", a dini të thoni ndonjëherë a di çka do të thotë që në emër të ligjit, në mënyrë të padrejtë, të abuzohet ligji? A e di çka do të thotë kjo? A di çka do të thotë të abuzohet me ligjin? Ne si kolektiv, si popull, si popull si tërësi, po jo individual, por si popull e kemi provuar në vitet e 80-ta në kohën e regjimit të Milosheviqit çka domethënë në emër të ligjit të abuzohet, si popull, si tërësi.

Po pak ka këtu në Parlament, në seancë këtu, pak ka njerëz a individ që e ka përjetuar individualisht çka domethënë, duke u thirrur në emër të ligjit, e të bëhet padrejtësi. Unë jam në mesin e atyre, një. Çka domethënë, në emër të ligjit, imagjinoni krejt Kosova thotë u bë ligji, a çka domethënë, duke u thirrur në emër të ligjit të abuzohet me ligj, me padrejtësi. Dhe, shkon ti, 15 vjet të jetës tënde i jep dhe në fund as kurrkush s'kërkon falje. Po drejtësia e kërkon kështu! Jo, jo, kjo s'ka lidhje me drejtësi.

Askush mbi ligjin, po askush nën ligjin, pra. Askush mbi ligjin, po askush s'guxon ta keqpërdorë ligjin, të abuzojë me ligjin. Provoni ju vetë një herë "Askush mbi ligjin" dhe kur ta provoni, unë e besoj këtë thënie. Pa e provuar ju vetë, unë s'besoj në këtë farë parulle "Askush mbi ligjin". Ju duhet ta provoni dhe provoni çka do të thotë. Provoni çka do të thotë në emër të ligjit të persekutohesh, duke abuzuar me ligjin, duke abuzuar me detyrën.

Ne folëm për ndikimin në drejtësi këtu, për seancën e tashme. Po ndikim është për drejtësi të bëhet thirrje për të dënuar njerëz. Është presion ndaj gjykatës, është presion ndaj prokurorisë dhe gjykatës të thuhet të dënojë njerëz. Është presion! Është t'i kërkojë prokurorisë, bën çka të duash, a ke prova a s'ke prova, dërgoi njerëzit në burg. Sot u krijua opinionimi publik në Kosovë se drejtësi ka vetëm kur të dënohet njeriu. S'ka drejtësi ndryshe në Kosovë. Drejtësi ka kur ta çosh në burg. A e patë, a u lirua ish-gjyqtari Nuhi Uka, po më duket, e patë. U lirua, ka thënë gjykata. Çka po themi...? Jo, drejtësi ka nëse çohet Nuhi Uka në burg, se kështu që u lirua nga gjykata, s'ka drejtësi!

Domethënë, standardet janë të dyfishta. Nëse s'e kemi përnjëmend për drejtësinë. Ne s'e kemi përnjëmend për drejtësinë, as ata opinionistët që na shesin pallavra përditë. Drejtësia pranohet ashtu si është, edhe kur të dhembë, edhe kur nuk është sipas dëshirës tënde, edhe kur ta prekë një interes politik. Shteti ligjor është ai.

E sot, prokurorët ngrenë aktakuza nga presioni, ose ngrenë hetime nga presioni. Kësaj po i thoni drejtësi, a?

Domethënë, mënyrat për të ndërhyrë në sistemin e drejtësisë janë të mëdha. E një nga këto është edhe kjo sot, po sidomos edhe ato të tjerat, për të cilat po flas, që flitet "Askush mbi ligjin", kërkesa për dënime, kërkesa për akuzime dhe kur të vijë puna e aktgjykimit, thonë jo, u lirua, por ku të dihet qysh është liruar! Shkon në gjyq, merr aktgjykimin, lirohet një herë, dhjetë herë, njëzet dhe prapë thotë: "Jo, u lirua, por diçka ka që është liruar". Pra, kënaqemi vetëm nëse e çojnë në burg.

Kjo që po ua imponojmë këtë mentalitet qytetarëve tanë do të na kushtojë, do të na kushtojë shumë.

Unë e di që në këtë Parlament kurrë s'do të kthjellet kjo klasë politike pa i ndodhur secilit veç e veç, sepse ju e keni humbur ndjenjën e solidaritetit. E kanë thënë të mëdhenjtë përpara: "Drejtësia mbrohet kur kolektivisht reagojmë ndaj padrejtësive që i janë bërë një individ", kështu mbrohet drejtësia, kur ne kolektivisht reagojmë kundër padrejtësisë që i është bërë një individ, çohemi të gjithë në këmbë dhe kështu e mbrojmë veten, e mbrojmë drejtësinë, por jo, sepse ne këtë punë e kemi kthyer në personale, në individuale.

Ky është vetëm fillimi për çfarë po flasim. Do të ishte mirë të kemi një seancë si duhet, seancë si duhet, shtetërore, për UÇK-në. Por fatkeqësisht ne do të ballafaqohemi goxha shumë ditë këtu me këto farë temash. Do ta shihni tash kur të vijin temat e tjera.

Kryetari i Parlamentit e tha një pjesë të një rrëfimi të vet. Saktë e tha, me rastin e familjes Demaku. Saktë! Bile ndoshta nuk e tha, se po të pikturohet del ende më shumë rreth ngjarjeve të '98-tës dhe vrasjeve të heroit të kombit, dëshmorit Xhevat Demaku.

Po ky rrëfim, zoti kryetar, është dashur t'u bëhet deputetëve të Parlamentit para se ta votoni Gjykatën Speciale. Këtë rrëfim është dashur t'ua bëni njerëzve para se të votoni Gjykatën Speciale, që është e padrejtë, që do të kemi prapë këso situata, sepse është e padrejtë. Është e padrejtë, është e padrejtë çka është duke i ndodhur këtij vendi. Po s'është mirë tani të thuhet edhe për Gjykatën Speciale pasi të kryhen të gjitha punët, e të thuhet: "Po, valla, e padrejtë", sikur që flasim edhe për rastin. Për të folur, tash është vonë.

Ajo që unë dua ta përmbyll fjalimin tim është se aq ky shtet është i painteresuar për çka ka ndodhur në vendin e vet. Shikoni ministrinë përkatëse. Këta lidhje s'kanë çka është duke ndodhur në vendin e tyre. Është bërë një përpjekje nga ish-ministri i Drejtësisë, një përpjekje serioze nga ish-ministri i Drejtësisë, me një Komision për krime të luftës. Po këta lidhje s'kanë, për shembull, a duhet Adriatik Kelmendi t'u tregojë, shtetit të Kosovës ose udhëheqësve, se sa gjykime janë mbajtur të UÇK-së dhe sa të kriminelëve serbë në Kosovë?

Pyetni, qe ku i keni, pyetni këta. Nëse e dinë sa gjykime janë mbajtur për UÇK-në dhe sa për krimet serbe në Kosovë? Nëse e dinë këtë, unë jap dorëheqje sot.

Nuk e dinë! Shikoni, në Obri dënohet njeriu, flas për katër vëllezërit për një shuplakë, ndërsa në Obri masakra e familjes Delijaj as nuk është hetuar e as nuk është gjykuar. Masakër! Fëmija 3-muajsh është vrarë...

Ne shpejt si Nisma do të vijmë me një iniciativë tjetër këtu, dhe po e përmbyll me këtë. Do të vijmë me një iniciativë, iniciativë që presim se do ta kemi mbështetjen e deputetëve.

Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët që kanë punuar pas vitit 1992 në pushtetin e Milosheviqit të mos jenë as gjyqtarë, as prokurorë dhe të mos kenë detyra publike në shtetin e ri të Kosovës! Dhe, jo të merren ata më me gjykime. Ata që kanë punuar pas 1992 në regjimin e Milosheviqit të mos kenë të drejtë të jenë gjyqtarë e as prokurorë.

A jemi të gatshëm ne për këtë iniciativë? A jemi të gatshëm? Hajde, t'ia nisim pak më seriozisht kësaj pune!

Ne e dimë, i kemi pasur do institucione tona paralele dhe në kohën kur institucionet tona paralele kanë thirrur për të mos punuar me Serbinë dhe nga ai moment jam duke folur. Ju e dini për çka po flas, ka rregull. Dhe, deri në ditët e fundit, të ditës së fundit të bombardimit të NATO-s. A ka të tillë? Nëse ka, jo të dënohen, por s'mund të jenë ata aty e të udhëheqin, sikur kur ka udhëhequr në kohën e "shokut Milosheviq", sikur kanë dëshirë ata të thonë.

Andaj ju kisha lutur, bile të paktën, të paktën ju kisha lutur juve deputetëve: kursehuni e mos luani me ndjenjat e njerëzve. Nisjani një herë e bëni diçka seriozisht. Mos i këqyrni këtu poenat politike që lirë t'i blini, kush po flet më shumë e çka them unë.

Hajde një herë si burrështetas të sillemi të gjithë. Hajde të bashkëndijmë seriozisht me këta njerëz e me këtë çështje!

Jo, dje e votoi Gjykatën Speciale, e sot të dalë e të vajtojë. E, në rregull, u krye, e hajde pra të merremi seriozisht, po jo t'i shfrytëzojmë emocionet dhe gjendjen e familjeve, se sikur që thashë, ne të gjithë e dimë që ata s'i kemi ndihmuar. Sot jo, e kur kemi mundur t'u ndihmojmë, kemi heshtur. Kemi heshtur dhe sot kjo është jo seancë për ta, por më tepër, e kisha quajtur, është seancë për turpin e këtij Parlamenti. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Është paraqitur për një reagim, në formë replike, kryetari i Parlamentit.

KRYETARI KADRI VESELI: Faleminderit!

Nuk është aspak replikë, duhet pasur parasysh. Është një qëndrim! Me Fatmir Limajn kemi qenë bashkëluftëtarë dhe kemi qenë gjithmonë ajo pjesa deri më 12 qershor 1999 në çdo vend, ku nevojitej.

Ajo çfarë dëshiroj të them është për atë që fole, Fatmir, për fjalimin tënd. Domethënë, seanca është thirrur me 45 nënshkrime dhe ka qenë obligim kushtetues, ta kemi parasysh, është pjesë e kësaj, për t'u qartësuar proceduralisht.

Pjesa tjetër, është te çështja që e përmende, Gjykatën Speciale, të cilën e ngrite, e ngritën edhe shumë nga kolegët këtu. Duhet të kihet parasysh vetëm një fakt te Gjykata Speciale, si unë, si ti, Fatmir, e di këtë, se ajo nuk ka mundur të ndalet dhe nuk është dashur të ndalet në momentin kur e ka marrë një përmasë të tillë të ligësisë së vet kundër luftës.

Në momentin kur është shndërruar një raport i tillë me një pengesë të zhvillimit të këtij vendi, për çka unë e ti kemi sakrifikuar, ka edhe shumë të tjerë, të gjithë qytetarët e këtij vendi, s'po po e bëj këtë vetëm për konsum, por pa dashur i tërë populli, as unë e as ti s'kishim mundur të qëndrojmë në mal e të luftojmë. Në të gjitha anët kemi qenë të rrethuar nga popullata civile. Jemi munduar të luftojmë me aq sa kemi mundur, dhe s'kemi nevojë të skuqemi për asgjë.

S'kemi nevojë të fshehim kurrgjë. Publikisht i thërras, e kam votuar Gjykatën Speciale dhe, edhe sot e kisha votuar. E kam votuar se jam i bindur që do ta kisha dëmtuar shtetin, Republikën e Kosovës, u kisha lënë sherr fëmijëve të mi. Boll kam pësuar unë. Sa të jam gjallë, jam i gatshëm edhe të vdes. Le ta dijë çdokush. Ishalla nuk vjen ai pozicion dhe nuk besoj që s'do të dal të luftoj prapë, nëse cenohet nga Republika e Serbisë shteti im. Por, fëmijët e mi nuk kam qejf të shohin luftë. E di çfarë është lufta, asgjë më të vështirë s'ka. Mund të vdesësh, po edhe mund të mos vdesësh. Thjesht, prapë kur të kryhet lufta do ta futë dikush. Ka njerëz të ligë. Dhe, dëgjo, thonë: "Qysh u çliruam, more. Qysh u çliruam? Është dashur të çlirohet më shumë, pak kanë bërë, kanë tradhtuar. Ka mbetur Mitrovica e ndarë, thjesht. Kush u vra, qysh u vra ai?!" Në luftë vrahesh e të vrasin. Lufta është kjo. Nuk është e bukur, është e vështirë. Kurrë mos dhëntë zoti gjeneratat e ardhshme të ballafaqohen me të.

Ajo çfarë po dua të them publikisht. E kam votuar Gjykatën Speciale për të mos e dëmtuar vendin dhe mirë keni bërë kush e ka votuar. Le ta dinë miqtë e armiqtë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka luftuar për lirinë e vendit dhe çfarë ka gabime, ku të jenë, në Alaskë, në Arktik, kudo që janë, ejani dëshmoni. Dëshmoni për Kadri Veselin, çka po i jepni zor. Njëri nga emrat e parë që u përmend, tërë po i thonë: "Raporti i Dick Marty është. Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli janë në raportin e Dick Marty, të parët". Ju tjerët jeni prapa. Thjesht!

Marre është të mendojë dikush se e ka marrë ndonjë garanci, marre i qoftë dhe mallkuar i qoftë nëse mendon dikush për shpirtin e vet. Mallkuar i qoftë! Thjesht, le të ballafaqohet, le të dalë publikisht kush ka të dëshmojë. Shkoni atje, por mos fyeri. Ndaleni fyerjet!

Shpeshherë në këtë Kuvend, njerëz të poshtër, që s'bëjnë kurrgjë për vendin e vet, veç mundohen të ta fusin dhe shajnë. Ndaleni, more këto. Bëni burrërisht! Dy sende janë: tradita e shqiptarit. Kur s'ki traditë shqiptari, shko në bazë të ligjit! S'kisha thirrur kurrë vetëm gjyqësinë. Po ndalini sendet... Thjesht!

Deri më 12 qershor e kemi obligim ta mbrojmë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pas 12 qershorit secili e mbron veten. E bart me shëndet! Kush është inkriminuar, le ta mbajë me shëndet! Veç edhe në bazë të traditës së shqiptarit goxha shumë, boll ata që bëjnë keq janë të këqij, por më të këqij janë ata që gjithmonë shtinë dhe s'kanë burri kurrë të ballafaqohen drejtpërdrejt.

Është mirë të orientohe mi në obligimet që i kemi ndaj fëmijëve tanë, të mos u lëmë sherr. E kemi votuar Gjykatën Speciale për arsye se nuk duam t'i lëmë sherr vendit tonë, fëmijëve tanë. Kjo është arsyeja.

Dikush, nëse mendon, dhe edhe e ardhmja do të tregojë e sa ka mundur të ndalet, apo ka qenë pozicioni politik kur dikush ka qenë për pushtet e dikush ka qenë në atë farë bllokun e famshëm, janë kryer këto sende, por tash dëgjo, si po dalim në pushtet, edhe për çështjen e demarkacionit, më thanë, ata përpara kishin pas dalë në protesta. Kur ka qenë Aleanca në pushtet kishin dalë përpara. Lidhja Demokratike e Kosovës, kështu më thanë, për demarkacion kur është bërë.

(Ndërrhyrje)

Kundër! Daut, ti e di më mirë se unë, e çka të them. E tash jeni ju opozitë, mirë është kjo. Lufta politike i ka ngapak këto, thjesht.

(Ndërrhyrje)

Mirë, jam duke folur te ndarja pak a shumë e proceseve. Dhe, Daut, menjëherë kryesuesi ta japë fjalën, por sido qo të jetë, të koncentrohem te kjo pjesa dhe të ndihmojmë diçka atyre çka mund t'u ndihmojmë. Është e vërtetë se kjo seancë nuk do t'u ndihmojë dhe më së paku atyre që janë në burg. Ka pasur shumë reagime pse s'e kam përmendur një nga njerëzit që nga viti 1991 isha së bashku me të në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, Sami Lushtakun. S'e kam përmendur për arsye se s'dua të prejudikoj e të paragjykoj dhe besoj që duhet të lëshohet njeriu, sepse është absurd pse mbahet në burg, e s'po dihet as çka ka bërë. Thjesht!

Sido që të jetë, nuk dua të ndërhyj në çështje të gjyqësorit. E thashë edhe në fjalimin tim dhe qëndrimet tona politike janë këto të cilat i kemi, e marrim përgjegjësinë secili. Mirë është të ketë korrektësi, mirë është në fund të dilet nga ky debat me një rezolutë të përbashkët dhe, të paktën, të ruhem të mos i cenojmë çështjet gjyqësore. Pra, të ruhem dhe të mbajmë atë përgjegjësinë që e kemi politike dhe të dalim rreth kësaj.

Kjo ishte, Fatmir, pjesa ime e reagimit, për ta qartësuar qëndrimin politik pse e kemi votuar dhe nuk pati asgjë të bëjë me një replikë lidhur me fjalimin tënd, përkundrazi, e konsideroj shumë përmbajtësor fjalimin tënd. Ka vërejtje të cilat janë shumë reale, veçanërisht si po bjen dikush,

poshtë menjëherë po e lëmë vetë, kjo është e vërtetë. Institucionet e Republikës së Kosovës financiarisht duhet t'i ndihmojnë në mbrojtjen e tyre. Duhet ndihmuar familjet e tyre dhe kjo ishte dashur të bëhet edhe më herët, mirë është të bëhet edhe tash, nuk është kurrë vonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Limaj e ka fjalën, për replikë.

FATMIR LIMAJ: Këtë marrje të fjalës s'duhet trajtuar replikë, se në fund edhe s'kam kurrfarë replike, por qëndrimet tona ndaj Gjykatës Speciale janë të qarta, ndryshimet, dallimet. I di këto opinionin publik. Dhe, natyrisht, secili grup politik kur të vijë tema do ta thotë atë qëndrimin e vet politik. Ju i keni arsyet tuaja që ju kanë shtyrë, ne i kemi arsyet tona e besojmë që s'bëhet.

Për shembull, unë jam i bindur në dy gjëra se ka mundur të mos bëhet Gjykata Speciale qysh është bërë, dhe në atë Gjykatë Speciale nuk është dashur në mënyrë etnike të gjykohet vetëm një grup njerëzish. Këtu është dallimi ynë. Pra duhet të gjykohen të gjitha krimet që janë bërë në Kosovë.

Dhe, ajo që unë s'pajtohem kurrë, logjika për të fshehur këtë veprim, të votimit të Gjykatës Speciale gjoja se ne s'kemi çka të fshehim, kjo është e papranueshme.

Pse duhet ne ta themi këtë, çka kemi fshehur ne, s'kemi çka të fshehim, a gjithmonë ne duhet të provohemi a, për çka duhet thënë këtë. Pse s'e thotë Serbia?

Arsyetimi se ne s'kemi çka të fshehim, kjo është për mendimin tim arsyetim i paqëlluar, i padrejtë, sepse ne kemi qenë në Hagë. Këtu kanë qenë me mijëra trupa të huaja, kanë hetuar, kanë gjykuar. Ja kanë hetuar në Kosovë prej 1999-ës, ja kurrkund në botë.

Dëgjoni mirë çka po ju them, nuk ka luftë në botë që është hetuar më shumë se lufta çlirimtare e Kosovës. Dhe, edhe ti mundohu sa të duash të fshehësh, se po të kishin pasur, ata s'të kishin lënë të fshehësh.

Kështu që, po kthehem në temë përmbajtjesore, e tema përmbajtjesore është: pse në Kosovë të krijohet një trup, një gjykatë që do të merret me hetim ose gjykim vetëm të një grupi etnik? As nuk ndihmohet paqja, as nuk ndihmohet shteti, as pajtimi që mund të vijë nesër në këtë mënyrë, sepse ka elemente raciste të kësaj gjykate. Këtu është dallimi ynë politik. Të tjerat, besoj s'kemi diçka, dhe unë besoj se kjo temë do të jetë goxha e këndshme në të ardhmen, se do të jetë temë e shpeshtë.

Apeli im është për kolegët deputetë, mos i shfrytëzoni mikrofonat në dhembjen dhe vuajtjen e njerëzve e të përfiton poena individualisht. Pra, nëse s'mund e s'dini të ndihmoni, uleni kokën. E ata që e kanë obligim ta kryejnë punën e vet, le ta kryejnë punën e vet ashtu siç duhet.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Në ndërkohë, e kërkoi fjalën Dauti, po edhe Rexhep Selimi. Daut, a e do fjalën? Atëherë le të bëhet gati edhe Rexhep Selimi.

DAUT HARADINAJ: Kryetar, edhe një herë të mos i përsëris. Unë edhe në fillim e bëra pyetjen, do të thotë, çka ka kontribuar Qeveria e Kosovës, a ka mundur t'u qaset problemeve? E tash ju po thoni sa keni qenë në bllok, i keni thënë po. Me sa e kuptova unë, kemi qenë pjesë e bllokut...

KRYETARI: S'thashë po, thashë sa kanë qenë ata të tjerët në opozitë, kanë dalë në protestë, është fjala për demarkacionin.

DAUT HARADINAJ: Jo, një është për Gjykatën Speciale dhe një për demarkacionin. Për demarkacionin, keni qenë këtu në sallë, kryeministri e ka sjellë, nuk i ka pasur numrat, është tërhequr. Dhe, u pa se deputetët nuk janë të interesuar ta miratojnë atë që e kanë bërë ish-shefat tu.

Në anën e kundërt, kryetar, po harron se je lider i Partisë Demokratike dhe që je pjesë e Qeverisë dhe që i ke ministrat këtu prezent. Nuk e di a u ke thënë ndonjëherë këtyre për të marrë ndonjë veprim apo për t'u interesuar për ish-kolegët tuaj partiakë, të cilët janë dënuar, e që janë bashkëluftëtarë tuaj dhe të shumicës prej nesh.

Po edhe ajo që u fol pak më herët, për shembull, njerëzit ku kanë punuar e qysh kanë punuar. Natyrisht se s'ka qytetar të Kosovës në ish-Jugosllavi që i ka pasur mbi 18 vjet e që s'e ka kryer shërbimin ushtarak. Domethënë janë gjetur në shumë forma të ndryshme, kanë kryer edhe shkolla të ndryshme dhe kurrë nuk i kemi anatemuar, kundërshtuar ose sulmuar, por unë mendoj se nuk është marre hapur ta themi se njerëzit të cilët i kanë shërbyer regjimit të Milosheviqit të jenë të sanksionuar për të shërbyer në institucionet e Kosovës, duke filluar edhe në ndërprerjen e vedingut për udhëheqësit e institucioneve më të larta të sigurisë. Kush e ka ndaluar vedingun, kontrollin, ose është një komision që i kontrollon ata për shërbimet ose a e kanë kaluar testin e besueshmërisë ata njerëz, të cilët e udhëheqin sigurinë, e për të cilët, neve edhe kemi informata, jam i sigurt se edhe ju i keni, po edhe kryeministri e presidenti prej inteligjencës, të cilët permanent bashkëpunojnë me strukturat e sigurisë në Serbi dhe me Zyrën e prokurorit në Nish. Shkojnë u çojnë informata të rregullta, janë struktura të larta të Policisë së Kosovës.

Dhe ju, nuk është marre, meqenëse keni ministër të Punëve të Brendshme, të kërkohet nga ministri i Punëve të Brendshme, prej ministres të Drejtësisë, e cila tash sa ka ardhur në detyrë, prej ish-ministrit të Punëve të Brendshme, të zëvendëskryeministrit që urgjentisht Inteligjenca e Kosovës të shtijë në fuqi ligjin e vedingut për zyrtarët e lartë të institucioneve të Drejtësisë, të

Sigurisë, qofshin ata në prokurori, inteligjencë policore, inteligjenca e AKI-së apo edhe në gjykata, sepse mjaft më pas 17 vjetëve të udhëheqin drejtësinë njerëzit e Milosheviqit, të cilët fatkeqësisht janë të privilegjuar në Kosovë.

Ne sot mund të flasim edhe një herë sa të doni, ne kemi respekt dhe po ju them se nuk ka qytetar në Kosovë që nuk i janë dhimbsur djemtë e Drenicës, por a mund ne të ndihmojmë sot diçka me këtë debat? Sinqerisht them, përpos një përkrahjeje morale, jam i bindur se asnjë produktivitet nuk do ta japim, për të mos thënë se ndoshta u bëhet edhe ndonjë dëm.

Pra, nuk jemi duke ndërhyrë në drejtësi, nuk jemi kah i themi drejtësisë asnjë fjalë, s'përmendi kush asnjë dëshmitar dhe nuk e konsideroj ndërhyrje në drejtësi për derisa diskutojmë hapur dhe drejtpërdrejt. Nuk jemi duke e përmendur dëshmitarin, jemi duke folur për një vendim, i cili potencialisht po konsiderohet se s'ka qenë transparent. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Daut! Rexhep Selimi e ka fjalën! Ndërkohë, që ka pajtueshmëri, kishim shkuar në pauzë, sepse po kërkojnë deputetë, po shihet reagimi.

REXHEP SELIMI: Do të mundohem të jem pak i shkurtër dhe kam dalë këtu për një saktësi për ata të cilët po mburren që e kanë votuar Gjykatën Speciale, duke thënë se kanë bërë diçka të mirë, sepse unë pashë edhe njerëz që thonë me krenari se e kanë votuar Gjykatën Speciale për të parandaluar diçka më të keqe.

Duhet t'ju rikujtoj se votimi i Gjykatës Speciale, këtu në këtë Parlament, ka ardhur si pasojë e raporteve zinxhirore deri te raporti i kryeprokurorit të task-forcës speciale, zotit Wiliamson. Besoj se këtu dakordohemi.

Dhe, duhet të rikujtoj se çfarë shkruan në këtë raport. Te kapitulli Të gjeturat, është kapitulli II, më duket, nëse gaboj e marr përgjegjësinë, thuhet: "Të gjeturat rezultojnë që në Kosovë është kryer spastrim etnik në anën jugore të lumit Ibër". Po mundohem kështu ta them, që i bie se ky Parlament, i vetmi Parlament i të gjitha njësive federale të ish-Jugosllavisë ka marrë përsipër diçka të tillë. Pra, nuk duhet të mburremi me këtë.

Dhe, e dyta, paragrafi pasues te ky raport thotë: "Këto nuk janë veprime individuale të bataçinjeve, por janë të organizuara dhe udhëhequr nga krerët e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës". Që pra çka kemi votuar.

Dhe duhet ta dimë se çfarë kemi vepruar para se të mburremi se gjoja e paskemi shpëtuar Kosovën nga kataklizmi.

KRYETARI: Jo, s'do të ketë reagim. Urdhëro, deputet, po e shoh që po reagoni. Salih Salihu. Jo s'ke për çka të reagosh! Atëherë, po e bëj unë një reagim.

Shqetësimi më i madh është të shqetësohemi jo çfarë raporti ka dalë, por kush e ka bërë raportin. Më së shumti këtu le të frikësohet kush e ka bërë raportin dhe kush padrejtësisht na i ka bërë emrat atje. Sepse këtu ka që flasin edhe deputetë, por s'po di, sot janë të qetë, se i kanë si kryefjalë emrat tanë aty sipër edhe sot, por sido që të jetë, kjo duhet të jetë shqetësuese, por nuk do të skuqet asnjë luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por vetëm do të forcohet. Çka nuk të mbytet, të forcon më shumë.

A të bëjmë pauzë? Atëherë, kemi pauzë deri në orën 15:15, kur edhe do të fillojë seanca. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Kolegë deputetë,

Ndërkohë derisa ta fillojmë seancën, na ka ardhur një lajm, të cilin duhet t'jua kumtoj të gjithë deputetëve. Është pozitiv, i gëzueshëm është.

Më 27 tetor 2016, në orën 16:10, deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ramiz Kelmendi, ka dhënë dorëheqje nga mandati i deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Unë e përmenda veç si deputet.

(Reagime nga salla)

Prit se ka histori ende. Është pjesa e dytë e historisë. Avash!

Më 27 tetor 2016, para se të japë dorëheqje, Ramiz Kelmendi emërohet zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Urime! I urojmë fat deputetit, tani zëvendëskryeministër!

Atëherë në qoftë se e kisha pasur vëmendjen tuaj, futemi në vazhdim të seancës.

Shaip Muja, pa grup parlamentar edhe ky. Kisha kërkuar vëmendje, se tani jemi në vazhdim të seancës. Deputeti Shaip Muja, pa grup parlamentar, i adresohet seancës.

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Sot për këtë debat është shumë e vështirë të thuhet diçka e mençur, e saktë, e drejtë. E mençur është vështirë, sepse vetëm çmenduria nganjëherë ka mundësi të vlerësohet, sepse fjala publike e ka humbur peshën, shpifjet e fitojnë vendin në publik, vlera e ka humbur peshën specifike, bën fakt, e fakti bëhet temë, e tema aktakuzë.

Saktë e bëmë gabim që e votuam Specialen. I ka dy shpjegime.

Ne të përzgjedhurit e popullit në vazhdimësi goditëm drejtësinë, goditëm vlerat e shtetësisë, çirremi për shtet e shtetin s'e njohim, simbolin shtetëror s'e pranojmë. Kjo është hipokrizi kur thuhet e mohohet çdo hap. Prandaj, drejtësia e lënduar rëndë e paragjykuar fort, e kundërshtuar në Republikën e Kosovës është vështirë të quhet drejtësi dhe kjo si rrjedhojë e solli edhe Gjykatën Speciale.

Të flitet drejt sot do të ishte sikur ne do të ishim më unikë në forcimin e drejtësisë, unik në mbrojtjen e vlerës institucionale të Republikës së Kosovës, forcimin e vlerës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si sjellëse e kësaj pavarësisë që ne sot po e gëzojmë dhe si mund kështu ta mbrojmë.

Sot, nëse kthehemi në vitet '20 dhe parafrancojmë Faik Konicën në kohën e Princ Vedit, kur u drejtohet deputetëve shqiptarë në kohën kur Zogu pretendonte me fuqitë serbe dhe të tjerët të kthehej në front, ndërsa sundohej Shqipëria nga Princ Vidi, i lut deputetët e Republikës së Shqipërisë në atë kohë "hiqni dorë se u bëtë lodrat e botës, ta dini se në sytë e Evropës së qytetëruar sa na shajnë, sa na përqeshin, sa u vjen keq, por të gjithë na përbuzin dhe kanë për të na poshtëruar. Hiqni dorë se u bëmë palaçot e dheut, hiqni, shtrohuni, bashkohuni, punoni, bëhuni burra. Puna është më e lartë se trimëria, kazma më fisnike se palla, e kam zemrën aq të mbushur me lot sa nuk qaj dot dhe më në fund aq di, aq them, dhe jeni të lirë të veproni si të doni.

Shtrohet pyetja pse po goditet Ushtria Çlirimtare e Kosovës? Goditet dhe nevojitet për disa forca anti-Kosovë, disa forca anti-siguri, disa forca të cilat kanë interes t'i shtrojnë interesat e tyre në rajon dhe për ta barazuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si ushtri e barabartë me ushtrinë e Serbisë, gjë kjo që nuk është e saktë.

Mirëpo, qëllimi fundamental i tyre nuk është të goditet vetëm UÇK-ja. Është e interesuar të goditet NATO-ja, të goditen Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të goditen edhe Bashkimi Evropian.

Dhe, Serbia vazhdimisht këto do t'i godisë në vazhdimësi, po ashtu edhe në veçanti njerëzit e UÇK-së, vlerat e UÇK-së, për t'ia humbur historinë këtij vendi.

Prandaj, kur flitet vazhdimisht për kohën deri në vitin '99, ne duhet ta konservojmë si vlerë historike, por jo vlerë të përzier emocionale pas vitit '99, dhe këtu ne po bëjmë gabime, të cilat sot po na i keqpërdorin.

Në rastin “Drenica I” dhe “Drenica II” jorastësisht janë futur këta emra edhe në aktakuzë, sepse Drenica është edhe në rastin e Dick Martit dhe quhet “Grupi i Drenicës”, jo rastësisht, sepse Drenica ka qenë dhe do të mbetet pavarësisht sesi do të goditet, ajo çdo herë do të shkundet me fara më të forta për t’i rezistuar çdo kundërshtari, i cili e rrezikon vlerën e Republikës së Kosovës dhe prandaj Drenica nuk është e krijuar vetëm për Kosovën, ata mendojnë që do ta arrijnë atë punë, jo vetëm për Drenicën, po për tërë Kosovën.

Ne, sot, në këtë takim, është e vërtetë që nuk duhet të përziemi në drejtësinë e Bashkimit Evropian dhe të Kosovës, mirëpo ne ia kemi huq me disa çështje, duke e dëmtuar drejtësinë vendore, duke mos e vlerësuar asnjëherë, ne kemi çua mesazh që nuk kemi drejtësi vendore dhe kemi lejuar edhe një drejtësi ndërkombëtare.

Por, sot këtu kam dëgjuar disa çështje që janë shumë shqetësuese. Shqetësuese është, sepse në këtë procesin “Drenica” qenka dënuar një person, i cili s’paska qenë fare në Kosovë, dhe unë e shtroj pyetjen se çfarë ka vepruar ministria e Drejtësisë, e cila rri tërë ditën këtu, që nuk na tregon nëse e ka thirrur Këshillin Prokurorial, Këshillin e Lartë Gjyqësor, që ta ngrejë një komision të ekspertizës me profesionalistë...

Armend, nëse do të dëgjosh, nëse jo së paku bëhu më kolegial pak, ose po fillojmë me përqeshje.

KRYETARI: Zoti Muja, vazhdoje fjalën! Ju kisha lutur, në qoftë se bufeja është lart, nuk prish punë edhe të dilni, deputetë pushoni dhe menjëherë kthehuni.

SHAIP MUJA: Dikush nuk e ka me ndjenja këtë problem, prandaj edhe nuk e ka përgjegjësi.

KRYETARI: Zoti Muja, vazhdoje fjalën se të gjithë jemi me ndjenja, por konsultohen deputetët. Urdhëroni!

SHAIP MUJA: Unë nuk kam dalë këtu për të parë kush çka po thotë, unë po dua të kërkoj diçka çka mund të nxjerrim.

Bashkimi Evropian, sot edhe EULEX-si, në përgjithësi, unë personalisht kam menduar që Shtetet e Bashkimit Evropian do t’i çojnë ekspertët më të mirë të shteteve të tyre për ta drejtuar drejtësinë dhe për t’i ndihmuar segmentit të sigurisë në Republikën e Kosovës.

Mirëpo, së fundi jam shqetësuar shumë kur thuhet edhe në Gjykatën në Hagë e kanë hapur tenderin - konkursin dhe janë duke pritur kush po lajmërohet që t'i kompletojnë. Prandaj, për këtë komponent nuk kemi qenë në dijeni që do të ndodhë. Kam menduar personalisht që EULEX-i, edhe Bashkimi Evropian, që ia kemi deleguar edhe ne ligjin në Hagë, do t'i sjellë nga shtetet nga Amerika dhe nga Bashkimi Evropian ekspertët më të fortë, e jo të bëjnë gabime të tilla, siç e kanë dënuar në këtë rast.

Në një shtet normal nuk quhet përzierje të drejtësisë, por kjo është përdhosje e drejtësisë, e nëse përdhohet në këtë mënyrë drejtësia, atëherë nuk ka nevojë që ne të shtrëngohemi që të kërkojmë drejtësi.

Dëshmitari i njëjtë është me etiologji familjare të sëmundjeve psikike. Këtë nuk e thotë askush! Është e keqe mund t'ia dekonspiroj komplet, por është e drejtë që të lirohet konfidencialiteti, ai ka sëmundje psikike, ndërsa kryetari i grupit gjykues thotë "unë nuk u besoj unë dokumenteve të Republikës së Kosovës". Nëse nuk i beson Republikës së Kosovës që ai dëshmitar është proklamuar i sëmurë me terapi, nënën e ka të sëmurë, motrën e ka të sëmurë, e ka me traditë familjare, ata që janë mjekë e dinë fort mirë edhe problemin e skizofrenisë, edhe të sëmundjeve tjera psikike.

Prandaj, ne sot po i ndërtojmë disa standarde për shkak të kushteve të vështira ekonomike, për shkak të standardeve që do të sjellin konflikte të pabesueshme brenda kombit tonë dhe brenda popullit tonë.

Dhe, unë mendoj që nuk kemi nevojë të bëjmë rezolutë, por të bëjmë rekomandime.

Ministria e Drejtësisë t'i dërgojë letër për një ekspertizë profesionale tërë lëndës. Ta kërkojë tërë procedurën e ndjekjes të kësaj problematike. Dhe, ne nuk po themi mos e dënoni askënd, çdokush duhet të dënohet nëse ka vepra, e jo të dilet vetëm të paraqitet këtu sikur disa të tjerë.

Sot u munduam t'i gjejmë edhe fajtorët kush ishte ai dhe kush ishte ky. Disa po harrojnë për fjalën publike që po e thonë. E thonë fjalën shumë lirshëm këtu në foltore dhe harrojnë që këta ndërkombëtarë këtu që na shohin dhe mediet e bëjnë edhe lëndë faktike.

Ne nëpër fushata shumë lehtë i akuzojmë njerëzit kriminelë, i akuzojmë trafikantët e organeve në mënyra të ndryshme dhe të njëjtit harrojnë çka kanë folur, e kthehen thonë pse ti ke votua për Gjykatën Speciale.

Unë kam votuar jashtë vullnetit tim për Gjykatën Speciale, mirëpo kam votuar se kam besuar se do të bëhet drejtësi. Nëse bëhet drejtësi unë do t'i nënshtrohem çdo drejtësie, mirëpo nëse kjo praktika sot që ne jemi mbledhur këtu, ndodh që dënohet i dënuari pa qenë pjesëmarrës në

Kosovë dhe ai i njëjti dënohet, po ashtu kryetari i Komunës së Drenasit ka qenë pothuajse fëmijë, ai person i cili në atë aktakuzë sa kam lexuar unë, vetëm po të ishte pështyrë do të ishte sëmurë prej reumës, por jo po të ishte rrahur, çdo herë më kanë rrahur nga 20 - 30 veta, s'do ta kishte mbajtur as shpirti, por vetëm një i sëmurë psikik mund të aktrojë me nuancat të cilat i kanë të ndjenjës së skizofrenisë.

I kisha lutur kolegët tanë që të kenë vëmendje, sepse këtu ka pasur edhe disa konkludime shumë shqetësuese. Edhe zoti Kuçi, si ministër i Drejtësisë dhe si zëvendëskryeministër i luti prokurorët të bëjnë drejtësinë siç e bëjnë në vendin e tyre. Do të thotë, ka hapësirë që nuk e bëjnë siç e bëjnë në vendin e tyre.

Prandaj, unë jam i shqetësuar, që nëse nuk e bëjnë si në vendin e tyre, atëherë ne kemi probleme serioze dhe nuk është përzierje kjo në drejtësi, por drejtësia është duke u përzier në ne dhe ne kemi të drejtë të kërkojmë, edhe Bashkimit Evropian t'i tregojmë, e jo të barazohemi se ne po përzihemi në drejtësi dhe t'i tregojmë që komponenti juaj po përdor standarde të interesit politik për ta destabilizuar sigurinë e vendit, por jo për ta sjellë sigurinë e vendit dhe këto gjëra duhet të evidentohen.

Ndërsa disa kolegë të mi të “Vetëvendosjes” tërhoqën vëmendjen pse votuam. Unë votova, sepse në fushatë keni kërkuar që unë të jem dekan i transplantimit të organeve. Ju e dini kush keni thënë. Do të duhej të shkoni në Prokurori për të treguar, po jo këtu, jo në fushatë, ose Azem Syla të jetë dekan i Fakultetit të Mjekësisë në Komoran dhe shumë lehtë këto çështje, do të thotë diçka po dimë. Tek po dimë diçka, ti duhet edhe të deponosh. Dhe nëse ti vazhdimisht e godet një fakt dhe pret që dikush të mos ngrejë dyshime është hajgare, sepse jemi të papërgjegjshëm kur po flasim politikisht dhe nuk mund të bëjmë asgjë. Ose ky Fisniku ka bërë biznes në emrin tim dy vjet me vizatime, bile të ma kishte bërë një ndarje të biznesit, doktor Mengelja, doktor ky me vizatime, me Facebook me ato. Sot del shitet si një i virgjër i kompletuar, i cili krijon konfuzion dhe nuk ka qartësi. Por, ne kemi përgjegjësi dhe ne nesër duhet të ballafaqohemi edhe me ata të cilët dyshojnë edhe kur flasin. Prandaj, nuk duhet marrë me inat këtë punë, por duhesh pasur përgjegjësinë, sepse e kemi edhe para njerëzve tanë, edhe para popullit, sepse ne jemi në mes të popullit. Ne jemi të gjithë këtu populli i Kosovës. Nganjëherë po themi ‘ne deputetët’. Nuk jemi vetëm ne deputetët, por jemi populli i Kosovës këtu. Prandaj, si populli i Kosovës duhet të mendojmë.

Ju falënderoj shumë dhe shpresoj që rekomandimet të cilat do t'i nxjerrë ky debat do të jetë rekomandim i ekuilibruar i kërkesës së monitorimit, jo vetëm të lëndës “Drenica I” e “Drenica II”, sepse Drenica nuk mund të goditet edhe ata që i fërkojnë duart e kanë të kotë, mirëpo problemi është prapë Kosova.

Nëse përmes Kosovës mendojnë që ta ulin vlerën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si vlerë historike, shtetndërtuese e çliruese, e kanë të kotë sepse çdo ditë formohet nga një UÇK. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Muja! Ndërkohë fjalën e ka..., a ta përmendën emrin? Fisnik Ismajli e ka fjalën replikë, në qoftë se ta ka përmendur emrin, urdhëro! Merre fjalën!

FISNIK ISMAJLI: Po më habit kryetar që s’e dëgjove se goxha foli për mua, do të ishte dashur t’i dëgjosh dhe ti kolegët tu çka po flasin.

KRYETARI: Kërkoj falje se kam dëgjuar, se po ta kisha dëgjuar do ta kisha pranuar. Është e vërtetë.

FISNIK ISMAJLI: Ju zotëri këtu, posaçërisht ju të PDK-së, s’po di çka keni hëngër a çfarë keni pirë sot, veç s’jeni duke u dukur mirë diçka.

Zoti Shaip Muja, që të paskan penguar vizatimet e mia, prej të cilave nuk kam bërë biznes, kam bërë satirë politike e s’më kanë sjellë asnjë para, kisha pas qejf ndoshta edhe unë të përfitoj ndonjë send prej kësaj pune, por kam bërë hajgare me ty qysh po bëj edhe sot se je bërë për hajgare. Duhet marre të të vijë për çka i shpenzon minutat e Kuvendit këtu. Duhet shumë marre të të vijë.

E ju, ju kisha lutur... Diqysh s’jeni duke m’u dukur mirë sot. Çka keni hëngër e çka keni pirë nuk po e di, veç sinqerisht të dilni e të kapeni për kësë sendesh është më fëmijërore sesa çka do tjetër që do të kishim mundur të flasim sot këtu.

KRYETARI: Zoti Muja, fjala për ju dhe vazhdojmë pastaj.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë nuk dua të barazohem me standardin intelektual të tij, por as me peshën specifike të kilogramëve, vetëm një gjë po e them. Unë të kam thirrur ty në telefon dhe të kam thënë ta pimë një kafe pse shkruan ti keq - të sqarohemi, më njeh apo nuk më njeh? Nëse ti ke adresë që të punosh kundër autoritetit tim personal, unë nuk mund t’i ndërroj adresat tua, por identifikimin e adresave tua unë e kam të qartë. Adresa jote është antikombëtare, adresa jote është antishtetërore, adresa jote është antiintegruese dhe adresa jote është përfituese dhe spekuluese. T’i je rritur prej fondeve të Partisë Demokratike duke të dhënë fonde, duke të dhënë tenderë dhe ‘mendera’ e duke u sorollatur e duke e sharë në anën tjetër. Prandaj, t’i duhesh të japësh vetë llogari, por mos u mundo, nëse do të kruhesh mund të kruhemi deri në mëngjes.

KRYETARI: Po Fisnik, edhe ka qenë shumë specifik, a është e vërtetë kjo, se ne nuk e dimë?

FISNIK ISMAJLI: Të sqarohemi, veç një gjë po dua ta sqaroj, meqenëse më ke thirrur për kafe, zotëri!

Më kujtohet shumë mirë, nuk më ke thirrur në kafe që kam bërë hajger me ty, që të kam portretizuar si një doktor me një sharrë në dorë të përgjakur. Por, më ke thirrur në kafe për të m'u arsyetuar kur pate votuar, nëse nuk gaboj, atëherë kur u votua për t'i pranuar apo jo gratë e përdhunara gjatë luftës si viktimë të luftës. Atëherë, dhe e kam statusin në Facebook zotëri shumë mirë, atëherë ti ke qenë i pari në listë që ke votuar kundër dhe unë të pata kritikuar për atë dhe më pate thirrur në telefon, ke kërkuar të dalësh të pish kafe me mua dhe përgjigjja ime ka qenë shumë e qartë dhe shumë e prerë. Zotëri, se ma bëje 'ndoshta nuk të duan ty, "Vetëvendosja" nuk të lejon të dalësh me mua, dalim dikah privat'. Zotëri, unë nuk kam dëshirë të dal me njerëz si ti kërkah, as në kafe as këtu të të flas në bufe bile. Hiç kurrfarë dëshire as me ty, as me qiftin tënd, krejt ju që jeni ulur atje. Zotëri, me ty veç nëse duhet të ruhem prej diçkaje, duhet ta ruaj veshkën time se po më zë najkah në qysh e po ma merr.

KRYETARI: A shkojmë në pauzë dy minuta? Shkojmë në pauzë dy minuta, se kjo vetëm e tensionon situatën, me akuza... Asgjë nuk ka Dick Marti më shumë, as Gjykata Speciale. Shqip, një minutë e ke!

SHAIP MUJA: Ky është një gënjeshtar, i cili është turp të zërë vend në Kuvend dhe e sheh - bën akuzë këtu për veshkat, e ajo është dosja e Dick Martit. Aty Dick Marti e ka kapur, merr lexojë ti dosjen e Dick Martit. Spiunët sikur ti...

KRYETARI: Pauzë pesë minuta! Edhe ju kisha lutur ndalni këto sende!
Pauzë pesë minuta, mos e lëshoni sallën, rrimë bashkë, kamerat i kemi, mediet janë këtu.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Do t'i kishim zënë vendet, e vazhdojmë seancën.
Rrethanat të cilat janë krijuar, diskutimet ndoshta i kishim mbetur në hak dikujt, por unë do t'i pyes kryetarët e grupeve parlamentare, e ata e vendosin.

Në qoftë se do të kishim pasur mirëkuptim, ne do ta bënim projekt-rezolutën në harmonizim dhe kishim shkuar në votim drejtpërdrejt. Unë ju kisha lutur për mirëkuptimin tuaj, në qoftë se kryetarët e grupeve dëshirojnë, po e shoh se edhe atmosfera e debatit vetëm është duke u larguar

prej mesazhit për çka jemi thirrur këtu, nuk po e di nëse kontribuojmë më shumë me këtë debat, apo më mirë të shkojmë në votim.

Sido që të jetë, kryetarët e grupeve parlamentare, a ka mundësi...? Unë nuk e mbyll debatin, as nuk kam të drejtë ta mbyll. Unë veç kërkoj në qoftë se kemi konsensus të plotë nga të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare e mbyllim, në qoftë se nuk ka një grup parlamentar që konsideron që duhet vazhduar, e vazhdojmë. A mund të ju pyes?

Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës?

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse në këtë mënyrë debati i degraduar në këtë mënyrë të sjelljes, që më shumë e rëndon krejt procesin, edhe proceset tjera, meqenëse ju keni vlerësuar dhe po vlerësoni se mund të shtyhet ky debat, ne mund të shkojmë drejt në hartimin e një rezolute. Ne pajtohemi me këtë propozim.

KRYETARI: Vetëm pak! Unë po ju pyes të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare, në qoftë se një grup parlamentar nuk do, nuk do ta mbyll debatin. Ose në qoftë se pastaj ka reagime nga deputetët, e hedh në votim edhe në seancë, kështu që ju e vendosni vetë.

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës?

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Për ne është ok-ej, nëse bëhet një rezolutë dhe mund ta harmonizojmë tekstin e saj.

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja “Vetëvendosje”

GLAUK KONJUFCA: Ne mendojmë që debati është shumë i rëndësishëm dhe kërkojmë që ai të vazhdojë.

KRYETARI: Atëherë, nuk po shkoj më tutje, unë thashë, kështu ashtu po duan që debati të vazhdojë. Kemi thirrur seancë të jashtëzakonshme, nuk kam të drejt t’ia ndal fjalën askujt.

Hajdar Beqa e ka fjalën, Ali Berisha le të bëhet gati.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Unë kësaj here dua të reagoj pikërisht ndaj deputetit Fisnik Ismajli, i cili u drejtohet deputetëve të Partisë Demokratike, “sot po më dukeni ndryshe”. Mua personalisht Fisnik Ismajli m’u duk ndryshe prej se kam ardhur në këtë Parlament dhe prej se jam deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Unë e kam dëgjuar zotin Ismajlin duke iu drejtuar ish-kolegut të tij zotit Latif Gashi me termin “kriminel”, dhe po e njoftoj zotin Fisnik Ismajlin se sot u lirua sot Latif Gashi, e di që nuk gëzohet për këtë, por gëzohet familja, gëzohet Kosova dhe gëzohen shumë bashkëluftëtarë të tij, veteranë, familjarë të tij.

Nga kjo foltore, zoti Ismajli iu është drejtuar edhe sot zotit Muja, e fyen me raportin e Dik Martit, thotë “po ruhem nga ti për veshkë”, apo diçka tjetër.

Nga kjo foltore, zoti Ismajli i drejtohet edhe presidentit të Kosovës, “është njëri tradhtar”, apo me epitete të ndryshme.

Nuk e di kush e ka autorizuar këtë njeri, ku i merr ky kompetencat t’u drejtohet njerëzve që kanë dhënë shumë për këtë vend, për lirinë e Kosovës, me këto epitete?

Andaj, kërkoj nga ky njeri të sillet me norma të deputetit, konform edhe betimit që ka dhënë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është interesant kjo puna e fjalorit politik të disa deputetëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, ata kanë fjalë të mëdha, e bagazh patriotik shumë të vogël. Këta shiten sikur e kanë një ushtri të tërë patriotësh të dëshmuar dhe mundohen të marrin merita sikur kush e di sa shumë kanë kontribuar në luftën e fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në mesin e këtyre deputetëve mund të ketë kalimtarë apo dezertorë që kanë qenë pjesë e luftës ndonjë muaj, jo pse kanë qenë atdhetarë e patriotë, por sepse ka pasur nevojë t’i shpërlajnë mëkatet e tyre apo të afërmve të tyre në të kaluarën në sistemin e regjimit të Milosheviqit. Por, kjo punë është edhe më e thellë.

Përderisa disa deputetë të “Vetëvendosjes” me çdo kusht mundohen t’i bindin qytetarët dhe opinionin publik që janë patriotë. Pse e bëjnë këtë? Pse kanë nevojë t’i bindin se janë patriotë? Përgjigjja është e thjeshtë, sepse lidhje me patriotizëm as nuk kanë pasur në të kaluarën, as s’kanë në të tashmen dhe me këtë avaz politik nuk shihet që kanë as në të ardhmen.

U tha këtu me herët që ju e keni votuar Gjykatën Speciale, u tha që e keni votuar raportin e Dick Martit, por nga këtu raporti i Dick Martit nuk përmban diçka më shumë sesa thotë Fisnik Ismajli.

Edhe është shumë me rëndësi që ndoshta të shikohet kush i ka dhënë deklaratat për t'u hartuar një raport nga dëshmitarët e rrejshëm i Dick Martit. Kosova është e vogël, ne njihemi secili mes vete, i njohim edhe familjarët të njëri-tjetrit, e dimë secili çka kemi dhënë për këtë vend.

Qytetarët e këtij vendi kanë nevojë që ne ta kryejmë mandatin tonë, misionin tonë, me atë që na kanë dhënë qytetarët, ta bëjmë një vend me të vërtetë ku ka drejtësi jo selektive.

Ne këtu jemi mbledhur sot jo që ta dëmtojmë procesin e drejtësisë në Kosovë, por ne jemi mbledhur këtu që ta themi atë që nuk ka ndodhur askund në botë, e as në Kosovë, e të mos lejohet që pa prova, pa aprovimin e provave materiale të dënohen njerëzit, të mos vijmë në këso situatash, të kemi patriotizma folklorikë.

Patriotizmin këta e kanë veç sa për t'i manipuluar qytetarët dhe për të marrë vota. Nga të qenët shërbëtorë të mëdhenj të regjimit serb mundohen të shiten tash si shumë patriotë, duke shpresuar se kështu populli i harron më shpejt të bëmat e tyre dhe mund të bëhen më të pranueshëm të elektoratin.

Fjalorin patriotik apo edhe bashkimin kombëtar e kanë thjesht vetëm për të marrë vota apo për të përkthyer që ne me të vërtetë jemi ata patriotët që i duhen Kosovës.

Kosova ka nevojë për deputetë që japin kontribut, ka nevojë për institucione që e zhvillojnë këtë vend.

Ne jemi të gatshëm nga sot ta iniciojmë Ligjin për lustrim, me qëllim që të hapen dosjet e secilit dhe ta shikojmë që çdo zyrtar i lartë në këtë Kosovë çka ka bërë për këtë vend në regjimin e kaluar dhe çka është duke bërë sot.

Nuk është mirë që askush sot ta bëjë kauzë kombëtare deficitin patriotik të askujt, por unë do ta shtroj një pyetje: pse kjo ngarendje për ta njollosur luftën çlirimtare dhe prijësit e saj? Për këtë shpjegim dhe këtë kuptim dëshmon rasti i fundit i rikonfirmimit të dënimeve drakonike dhe të padrejta për grupin "Drenica II". A nuk është argument për këtë dënim për vrasje fiktive, në vend fiktiv dhe të personave fiktivë. Vrasje për të cilët nuk duhet personi i vrarë, nuk dihet vendi i vrasjes, por as koha kur është bërë vrasja.

Dhe, sa dënime të tilla janë bërë dhe bëhen? Krejt kjo me disa qëllime të errëta dhe nën ndikim e qarqeve vendore dhe ndërkombëtare, por, për fat të keq, të mjaftueshme sa për të bërë dëm të pariparueshëm. I tillë dhe tepër i rëndë, i padrejtë është edhe rasti i fundit, rasti i dënimit të çlirimtarëve, i njohur si "Drenica II". Pashmangshëm shtrohet pyetja dhe dilema: edhe sa raste të tilla do të ndodhin, apo mos kjo nuk do të pushojë kurrë përderisa qëllimi i synimeve të errëta

ndër të tjera është tendenca për komprometimin e udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me krahasimin e tyre me kriminelë që të fshihen nën emrin e UÇK-së.

Tendenca e një pjese të medieve për bërjen e gjyqeve publike ndaj komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me qëllim që t'i mbrojnë njerëzit e dyshimtë para dhe pas luftës.

Përgatitja e dëshmitarëve të mbrojtur e të rrejshëm, duke u ofruar benifite të ndryshme, me të vetmin qëllim - denigrimin e luftës çlirimtare.

Ne e dimë se sot në vendin tonë është një nivel jo i mirë i gjendjes ekonomike dhe njerëzit për hallet e veta kanë nevojë materiale dhe mund të bien pre e këtyre matrapazëve që dëshirojnë me të vërtetë t'i krijojnë një imazh të keq Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Tendenca që Gjykata e EULEX-it të grumbullojë dëshmi të rrejshme nga njerëzit të dyshimtë dhe në të kaluar të dyshimtë, meqë botërisht dihet se e vërteta është krejt ndryshe, e këtë nuk mund ta ndryshojë askush.

Prandaj, sa më shpejt që të evitohen këto tendenca, aq më shpejt do të vihet e drejtë në vend. Sa më shumë të funksionojë shteti ligjor dhe demokracia, aq më shpejt do të ketë paq dhe qetësi të mirëfilltë në vendin tonë.

Prandaj, vetëm me drejtësi të drejtë dhe jo selektive dhe të argumentuar do të vijë në vend amaneti i dëshmorëve për lirinë e Kosovës, por edhe synimi i luftëtarëve të lirisë, si dhe i komandantëve të ushtrisë çlirimtare. Faleminderit!

KRYETARI: Ali Berisha. Fisnik Ismajli e ka fjalën prapë. Më fal zoti Berisha, por ai e kërkon replikë. Unë kisha kërkuar, e mira do të ishte në interesin e qytetarëve, në interesin e këtij Kuvendi që ngadalë ta nxjerrim rezolutën, ta sjellim draft-rezolutën në Kuvendi, thjesht.

Në rrethana të tilla nuk po shoh atmosferë me një fjalë të tillë të komunikimit që do të kemi mundësi, po shoh se po ankohen individualisht, por unë nuk mund t'ia ndal fjalën asnjërit personalisht dhe s'do t'ia ndal. Kjo është më tepër për aspektin publik, mund të mbetet pastaj përgjegjësi pse kryetari kur e dinte nuk e ndalte. Po shihet se nuk ka atmosferë për debat, fyerjet janë më të rënda sesa mund t'i përballojë vetë Kuvendi. Si të doni ju, edhe një herë u kërkova dy kryetarëve të grupeve parlamentare, tash te Glauku, te Pali dhe te Valdetja do të vijnë këta kolegët e Administratës dhe te Myferaja, në qoftë se ka mirëkuptim do të kishim shkuar në draft-rezolutë dhe do ta e kishim harmonizuar dh votuar. Në qoftë se e kemi qëllim atë çështje.

Urdhëro Fisnik, fjala për ju!

FISNIK ISMAJLI: Sot jemi mbledhur për të folur për një temë të caktuar, por këtu po ka individë të cilët po duan të dalin prej temës së caktuar me qëllime të caktuara.

Unë nuk pranoj të vazhdojë debati në këtë mënyrë përderisa sulmohem në këtë mënyrë. Ajo që iu referova më herët një rasti ka qenë rast i pasluftës, s'ka të bëjë asgjë me Gjykatën Speciale dhe me krejt sulmet që i bënë këta...

KRYETARI: Ju kisha lutur, mos bëni reagim! Ju kisha lutur, lëre le të flasë deri në fund, reagim nuk ka! Ju lutem, se jemi para publikut.

FISNIK ISMAJLI: ...edhe do Zoti e ëndërroj secilin që ka bërë krime pas lufte, çfarëdo krimi qoftë, e ëndërroj një ditë ta shoh në burg secilin prej juve. Por, vjen ajo ditë dhe vjen koha për debat për atë punë. Tash për tash, ju kisha lutur të mos e qitni në rrafsh personal, se ia keni mësyrë andej, por ta vazhdojmë debatin ashtu siç kërkoi kryetari i grupit tonë parlamentar. Të vazhdojmë njerëzisht dhe prej juve kryetar pres të keni pak më shumë vigjilencë, se kur ia nis ai të flasë nuk kishe qenë as duke e dëgjuar dhe ta vazhdojmë këtë debat qysh i ka hije dhe ta përfundojmë qysh i ka hije. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi para opinionit publik. Dëgjojeni një situatë, njëra plan thotë flas çfarë të dua, ama ndale tjetrën palë. Kjo është pjesë publike, përgjegjësi publike, njerëzit reagojnë. Kur përmenden gjëra të tilla aq të rënda që nuk kanë të bëjnë me gjëra aq të lehta, të cilat pikërisht janë te Gjykata Speciale, normalisht njerëzit reagojnë.

Sido që të jetë, Shqipëria, të lutem, nuk dëshiroj të ta ndal fjalën, po e keqpërdori miqësinë familjare me ty, por puna është se nuk po e shoh si debat. Albin Kurti e ka fjalën, pastaj Ali Berisha, të lutem!

ALBIN KURTI: Së pari, unë po e shoh këtu një vullnet të madh që të diskutohet për Lëvizjen “Vetëvendosje”. Nuk ka kurrfarë problemi nëse dëshironi të diskutohet për Lëvizjen “Vetëvendosje” edhe ne i japim nënshkrimet për një seancë tjetër të jashtëzakonshme, në të cilën le ta diskutojnë edhe konceptin, edhe qëllimet, edhe mënyrat e Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Pra, nuk kemi aspak vërejtje që të ketë një seancë tjetër të jashtëzakonshme, në të cilën të diskutohet për ne. Mirëpo, jemi kundër keqpërdorimit të kësaj seance që ka të bëjë me dy gjykime e dënime të padrejta ndaj krueve që njihen si “Drenica I” dhe “Drenica II” për ta sulmuar “Vetëvendosjen”.

Pra, mund t'i mbledhim së bashku kur të doni nënshkrimet për një debat për Lëvizjen “Vetëvendosje”. Nuk kemi problem me këtë gjë. Mirëpo, ne jemi ftuar në një seancë tjetër sot dhe besoj që duhet t'i qëndrojmë besnik kësaj teme.

Unë dua t'i ngre disa çështje që u diskutuan sot këtu, e besoj që janë shumë të rëndësishme.

E para është që nuk mund të mbrohen vlerat e UÇK-së në Kuvendin e Kosovës, në një debat që vjen pas vendimeve gjyqësore, përderisa ky Kuvend, as në Deklaratën e Pavarësisë, as në Kushtetutën e Republikës nuk e përmend UÇK-në.

Pra, Republika e Kosovës, republika që unë po i them e dyta e Kosovës, e shpallur më 17 shkurt 2008 e ka një defekt fundamental në themelet e saj, e ka përjashtuar UÇK-në nga themeli, nga Deklarata e Pavarësisë, edhe nga Kushtetuta.

Tash mund të flasësh gjithë ditën e gjithë natën, mirëpo në themelet e kësaj republike të dytë është mohuar dhe është përjashtuar UÇK-ja. Ai që e ka shkruar Deklaratën e Pavarësisë, ai që e ka përpiluar Kushtetutën, nuk mund të thotë që e harrova UÇK-në. UÇK-ja nuk është një gjë që mund ta harrosh rastësisht. UÇK-në mund ta përjashtosh, UÇK-në mund ta mohosh, por nuk mund ta harrosh. Pra, ka ndodhur mohimi dhe përjashtimi me qëllim nga dokumentet themeltare.

Në Republikën e dytë të Kosovës kemi përjashtim nominal e juridik, edhe politik e ideologjik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në momentin kur ti e përjashton nga ngrehina jote shtetërore UÇK-në, natyrisht që u hap rrugën gjykimeve e dënimeve të mëpastajshme.

Dhe për të qenë edhe më keq se kaq, ai e dini me cilin dokument është themeluar EULEX-i? Është dokumenti i veprimit të përbashkët i datës 4 shkurt 2008. Ky dokument i veprimit të përbashkët i Bashkimit Evropian hyn në Gazetën Zyrtare dhe bëhet zyrtar më 16 shkurt 2008, pra një ditë para se të shpallej pavarësia. Juridikisht, EULEX-si është një ditë më i vjetër se pavarësia e Kosovës. A e dini çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë që në fakt shpallja e pavarësisë është shtyrë për një ditë. Ka pasur të shpallet të shtunën, është shpallur të dielën, në mënyrë që EULEX-i, për ata që besojnë që legjitimiteti vjen nga origjina të jetë për një ditë, për 24 orë, më i moshuar se Republika jonë.

Dhe “Vetëvendosja” edhe sot e kësaj dite persekutohet për ata 25 xhipa të EULEX-it që i patëm rrokullisur, atëherë kur e nënshkroi protokollin e bashkëpunimit EULEX-i me Policinë e Serbisë. Atë kohë na gjykonin, e na shanin, e na akuzonin. Mirëpo, po të ishim në atë kohë edhe shumë politikanë këtu me neve, nuk do të vinim në këtë pikë. Është tepër vonë ndërhyrja sot, në kohën kur është pranuar EULEX-i dhe gjykatat e tij.

Cili është problemi me qenien e EULEX-it dhe funksionimin e tij? Nuk na e pranon pavarësinë e Kosovës, nuk e pranon luftën çlirimtare të UÇK-së, nuk u jep llogari institucioneve të Kosovës,

nuk është përgjegjës ndaj popullit të Kosovës dhe ka imunitet ndaj çfarëdo ndjekje penale e kriminale për të gjithë zyrtarët e EULEX-it me familjet e tyre.

Pra, nga pikëpamja liberal-demokratike, ne kemi qenë kundër EULEX-it, jo vetëm nga aspekti politik, por edhe liberal-demokratik, mirëpo ai është pranuar dhe gjykatat e EULEX-it tash të sjellin në këtë rezultat.

Mos harroni, EULEX-in e pranon Serbia. Serbia nuk e pranon Kosovën, pavarësinë e Kosovës, Republikën e Kosovës, por EULEX-in e pranon. Edhe prokuroria në Serbi, edhe gjykata në Serbi e pranon EULEX-in. Dhe, në të gjitha gjykimet të cilat janë bërë ndaj pjesëtarëve të UÇK-së në vitet e pasluftës, ose në mënyrë direkte, ose në mënyrë indirekte, e gjeni gjithmonë Serbinë prapa. Në çdo luftë kundër UÇK-së e gjeni Serbinë, e këtu na kanë bërë dëm politikanët që kanë thënë në vitin 1999 “e kemi kryer punën me Serbinë, s’kemi pse merrmi më me Serbinë”.

Kur e panë që nuk u krye më ‘99, thanë më 2008 është kryer. Këta që kanë thënë e kemi kryer punën me Serbinë, këta e kanë demobilizuar popullin, e kanë demobilizuar shoqërinë, ndërkohë që Serbia e ka vazhduar luftën kundër neve. Ti mund ta pushosh luftën kundër Serbisë, por Serbia nuk e ka punuar luftën kundër teje. Ta arreston Nehat Thaçin dhe t’i kontrollon edhe veriun e Kosovës, edhe Preshevën, Medvegjën e Bujanocin, të lufton në çdo hap në arenën ndërkombëtare, financon struktura paralele që kanë për qëllim ta sabotojnë funksionimin e shtetit, e t’i thua “Bac’ u kry!”. Ky është problemi i kësaj parulle, e baci dihet kush është, është Adem Jashari, e nuk mundet t’i thuhet “Bac’ u kry!”, se dihet çfarë është betimi i UÇK-së.

“Vetëvendosja” nuk i mohon të arriturat, por “Vetëvendosja” e vë theksin te ajo që nuk është realizuar ende. Ne nuk vetëkënaqemi me çlirimin e Prishtinës, por ne e vëmë theksin te ndarja e Mitrovicës, sepse politika ka të bëjë me synime, nuk ka të bëjë me vetëkënaqësinë për të kaluarën.

Por, në këtë aspekt, unë jam i bindur që këto arrestime që po ndodhin, edhe këto dënime, e këto gjykime të padrejta të luftëtarëve të UÇK-së, nuk kanë të bëjnë thjeshtë për të kaluarën, siç mendoni ndoshta shumica prej jush. Kanë të bëjnë me të ardhmen. Këto nuk janë dënime, këto janë izolime.

Kush ka përvojë ushtarake në Kosovë? Po Sylejman Selimi ka, Sami Lushtaku ka, krejt këta që po mbahen në burgje.

Qe 17 vjet në Kosovë kemi breza e breza të rinisë sonë që janë të paaftë ushtarakisht, janë të paaftë ushtarakisht, pa asnjë dije ushtarake, pa asnjë përvojë ushtarake dhe kur stuhi të reja në Ballkan po na kërcënojnë, ne na lënë pa ushtri dhe ata të cilët kanë përvojën dhe dijen ushtarake

dhe nuk janë disiplinuar politikisht, sikur ta zëmë i ashtuquajti president, këta njerëz përfundojnë burgjeve.

Pra, burgu nuk ka të bëjë thjesht me të kaluarën, ka të bëjë me të ardhmen. Nuk është dënim për të kaluarën, është izolim për të ardhmen. Kështu duhet të kuptohet kjo. Burgu është mekanizim disiplinues dhe shumë prej jush e di që keni qenë në burg, por unë besoj që njeriu kur del prej burgut nuk mund të dalë bash qysh ka hyrë, ose del më i zbutur, ose del më radikal, njësoj qysh ka hyrë nuk del. Ose del më i mençur, ose më i paditur. Ose del më radikal e më i fuqishëm, ose del më i zbutur. Burgjet ekzistojnë për t'i zbutur njerëzit.

Edhe burgjet e pasluftës në Kosovë ekzistojnë për t'i zbutur luftëtarët. Atyre që konsiderohet që nuk janë zbutur ende, ua vazhdojnë burgun. Ata që konsiderojnë që tashmë i kanë bërë të pafuqishëm, i kanë zbutur, nuk ka radikalizëm më te këta, u thonë “mirë se vjen në shoqëri sërish”. Ata që konsiderohen që janë të pakontrollueshëm, ata i mbajnë të izoluar. Dikë e dispijlojnë e tenderë, dikë e dispijlojnë me burgje, dikë me të mirë, dikë me të keq, por synimi është e ardhmja, jo e kaluara. Këta njerëz nuk janë në burg për shkak të së kaluarës. Unë e pash që shumë prej jush e përmendni personin e vrarë që nuk dihet se kush është, nuk dihet as kufoma, po kjo është një dëshmi që ai nuk është në burg për të kaluarën. Është për të ardhmen.

Dikush ka konstatuar që ai është i pakontrollueshëm, ndërkaq këta të kontrollueshmit këta janë në rregull. Këta janë rresht për një. Protektoratin ndërkombëtar, ta votojnë Gjykatën Speciale, ta votojnë “Zajednicën”, ta votojnë demarkacionin, ta votojnë amnistinë e kriminelëve serbë... Pra, a je i disiplinuar apo jo? Ata që janë jashtë kontrollit, ata i pret burgu. Ata që janë të kontrolluar, ata i presin favore, postet, privilegjet, avancimet në karrierë e kështu me radhë.

Pra, kjo ka nisur shumë më herët. Çarmatosja e UÇK-së e para, shuarja e TMK-së e dyta, dhe dështimi i FSK-së që të bëhet ushtri, e treta. Kjo është për t'ia humbur vetëbesimin popullit tonë se, në fund të fundit, UÇK-ja është prodhim i popullit. Ky popull e ka nxjerrë UÇK-në. Mirëpo, qëllimi është që popullit t'i humbë vetëbesimi.

Kosova ka inflacion të diplomacisë, e diplomacia s'ka kurrfarë kuptimi pa ekonomi dhe ushtri, e te ne përdoret si zëvendësim për ato. Është botëkuptim krejt i mbrapshtë.

Shtetet që e kanë ekonominë edhe ushtrinë siç duhet, e kanë si vazhdimësi të tyre edhe diplomacinë.

Ne kemi aq shumë politikë të jashtme e diplomaci pikërisht si zëvendësim për ekonomi e për ushtri.

Unë besoj që ajo çka duhet të ndryshojë te ne është qëndrimi karshi Serbisë. Vlerat e UÇK-së nuk mund të mbrohen pa ndryshuar qëndrimi ndaj Serbisë i elitës politike në Kosovë dhe jo vetëm politike, por edhe shoqërore, kulturore, e kështu me radhë, sepse vlera e UÇK-së është konsiderimi i Serbisë si armik. Pa u kthyer te ky pozicion politik, nuk ka vlerë të UÇK-së. Nuk po them të kthehemi te qëndrimi ushtarak, por te qëndrimi politik i UÇK-së, se UÇK-ja ka lindur në kontrast me diçka, ka lindur në kontrast me okupimin e Serbisë.

Vetëm kur të kthehemi te qëndrimi politik i UÇK-së karshi Serbisë, ti mund t'i restaurosh vlerat e UÇK-së, e nëse bënë pazare me Serbinë e merresh vesh me të, e mandej thua po i mbroj vlerat e UÇK-së, kjo nuk është vetëm hipokrizi, kjo është e palogjikshme, është e pamundshme.

Tjetra? Këtu u tha që ne duhet ta paguajmë çmimin. Kemi paguar çmim. Edhe Veseli tha që duhet paguajmë çmim. Por, unë e kam një pyetje të thjeshtë, pse duhet të paguajmë ne çmim? Pse nuk duhet Serbia të paguajë çmim? Serbia e ka bërë edhe agresionin, edhe okupimin edhe aparteidin, edhe shtypjen, edhe shfrytëzimin, edhe diskriminimin, pse të mos i paguajë ajo dëmet e luftës? Pra, këtu ka njëfarë lloj përbrendësimi të fajit të paqenë. Kjo është tejet e gabueshme dhe unë këtu po e kuptoj sot pse Serbia nuk na i paguan dëmet e luftës, sepse në këtë Kuvend ne kemi njerëz që mendojnë që arrestimet që po na ndodhin prej EULEX-it qenka çmimi që ne duhet ta paguajmë. Po le të paguajë Serbia pak çmim, deri kur ne të paguajmë çmime? Pra, është komplet qasje e gabueshme. Ne duhet të jemi në ofensivë.

U tha edhe më herët, edhe në seancat tjera, duhet ta ndjekim shembullin e Kroacisë. Ka nevojë edhe për një aleancë të re ballkanike. Nuk mjafton vetëm aleanca me Shtetet e Bashkuara të Amerikës me Gjermaninë, Bashkimin Evropian, Britaninë e Madhe. Kemi nevojë për aleancë ballkanike. E aleanca ballkanike duhet të bëhet me Kroacinë, pra me Zagrebin, me Sarajevën, me Slloveninë, me Shqipërinë, mbi të gjitha, e para së gjithash, por edhe me Bullgarinë.

Kemi nevojë për aleanca ballkanike në këtë kohë kur stuhitë ballkanike të kërcënojnë.

Dhe, unë jam i bindur që një ndër arsytet pse nuk ndodh Ushtria e Kosovës është që ne të jemi sa më të dobët dhe kur ti je i dobët, ti bën marrëveshje të tilla. Marrëveshje të tilla që janë herë dorëzim, herë kapitullim, herë nënshtrim, e kështu me radhë.

U tha që edhe nuk duhet të ndërhyjmë në sistemin e drejtësisë. Unë besoj që kjo është gabim. Nëse ne themi që tash nuk duhet të ndërhyjmë në sistemin gjyqësor, në sistemin e drejtësisë, sepse ai duhet të jetë i pavarur, ne duhet ta kemi parasysh që mosndërhyrja jonë do të jetë mosndërhyrje në ndërhyrjen që tashmë është kryer. EULEX-i ty të ka ndërhyrë në sistemin e drejtësisë.

Nëse themi që Kosova është shtet i kapur, e është; nëse themi që Kosova nuk është demokratik, e nuk është; nëse themi që në Kosovë nuk ka drejtësi, e nuk ka; atëherë tashmë paska ndërhyrje. Ne mund të ndërhyjmë në ndërhyrje. Nuk je duke ndërhyrë në sistemin e pavarur e të paanshëm të drejtësisë. Ti mund ta krijosh drejtësinë pikërisht duke ndërhyrë në ndërhyrje dhe unë nuk jam fare kundër këtij debati. Unë mendoj që shumë mirë që po bëhet ky debat, por nuk duhet ta kemi një farë lloj vetëcensure që po ndërhyjmë në Gjyqësor, se Gjyqësorin s’e kemi as të pavarur, as të paanshëm. Pra, është gabim që mendohet që po ndryjmë në Gjyqësor. Nuk je duke ndërhyrë në Gjyqësor. Ti je duke ndërhyrë në ndërhyrje. EULEX-i ty të ka ndërhyrë.

Dhe u tha më herët që këto po bëhen në emër të ligjit. Gabim është. Tash, ju që keni qenë në gjyq, kam qenë edhe unë shumë herë e shpeshherë dhe s’kanë përfunduar ende ato, aty në fund kur të jepet dënimi në thuhet në emër të ligjit. Është më keq se kaq. Thuhet në emër të popullit. Shtrohet pyetja, në emër të cilit popull?

E këtu është tjetërsimi që edhe nocionit popull ia ka bërë kjo republika e dytë e Kosovës.

Merrni me mend, EULEX-i vjen edhe thotë “në emër të popullit”. Nuk mund të thotë ai në emër të popullit. Këtu duhet të ketë ndodhur diçka tmerrësisht gabimisht, tmerrësisht mbrapshtë që EULEX-i të mund të thotë në aktgjykim që është forma standarde në emër të popullit. Në emër të cilit popull flet EULEX-i?

Po këtu kemi disa politikanë që me nënshkrimet e pajtimit të tyre, herë të zëshme e herë të heshtura, herë të shkruara e herë të pashkruara, na kanë sjellë në këtë situatë ku EULEX-i mund të thotë “në emër të popullit”.

KRYETARI: Regjia, të lutem vazhdoja, më fal s’e kam vërejtur. Ua vazhdova dy herë, për fjalë nderit s’e kam vërejtur.

ALBIN KURTI: Edhe krejtësisht në fund. Kur ka qenë LDK-ja në opozitë, PDK-ja e ka akuzuar LDK-në që po çon dosje. Tash që jemi ne në opozitë, na thotë neve do çon dosje. A e kuptoni që kjo s’ka të bëjë me dosje? Kjo ka të bëjë me kush është në pozitë e kush është në pozitë. Nesër e pasnesër, kur të vijë “Vetëvendosja” në qeverisje, nuk do të thonë më që “Vetëvendosja” ka çuar dosje. Po, a dini edhe diçka?

Kur “Vetëvendosja” do të jetë në qeverisje nesër, “Vetëvendosja” është subjekti në Qeveri që juve nuk ju dorëzon në Gjykatë Speciale, se ne nuk e njohim Gjykatën Speciale. Edhe qeverisja e PDK-së do të ju dorëzojë në Gjykatë Speciale, ndërsa qeverisja jonë nuk ju dorëzon në Gjykatë Speciale. Veçse se për krimet e zhvatjes e të plaçkitjes të pasluftës, ne as nuk ju mbrojmë, as nuk ju ndihmojmë. Po sa për Gjykatën Speciale, që jeni nuk e njohim, pikërisht Qeveria jonë nuk do

të bënte dorëzime të tilla. Kështu që edhe ju keni interes që ne të vijmë në pushtet. E keni vështirë ta kuptoni e ta pranoni, por do të vijë edhe për këtë.

Edhe krejt në fund për çështjen e David Phillips, që u përmend këtu. Unë e kam me veti raportin e David Phillipsit, 1 maj 2010. Lart shkruan kështu, e shkarkova në pauzë prej internetit “National Committee on American foreign policy”... Devis Phillips është një profesor në Universitetin “Kolumbia”, me prejardhje është hebre, është mik i shqiptarëve, i cili ka shkruar një raport është e vërtetë për Kosovën, ku në faqen 8 shkruan kundër SHIK-ut, kundër PDK-së, kundër krimit të organizuar, e kështu me radhë, po nuk e përmend askund trafikim të organeve. Askund nuk e përmend UÇK-në, por PDK-n; e SHIK-un, pra është dallim shumë i madh.

David Phillipsi e ka organizuar konferencën “Albanian Neighborhood” në Tiranë. Ajo është për bashkimin e shqiptarëve dhe është për Kurdistanin. Të gjitha shkrimet që i ka sot, i ka për bashkimin e kurdëve. Është një ndër profesorët më së shumti kundër Rusisë. Është vështirë të gjendet ndonjë profesor më anti-rus se David Phillipsi dhe besoni është mik i shqiptarëve, po nuk është mik i krimit, dhe s’ka të bëjë kjo me Lëvizjen “Vetëvendosje”, me asnjë deputetë të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Pra, duhet ta kuptoni edhe një herë që mbrojtja e vlerave të UÇK-së kalon nëpërmjet cilësimit të Serbisë si armik. Pa u bërë bashkë ne shqiptarët edhe një herë, qofshim deputetë a s’jemi, qofshim politikanë a s’jemi, kundër Serbisë, as nuk do të kemi rahat në këtë Kuvend, e as jashtë këtij Kuvendi. Pyka që ka hyrë midis nesh është pykë e Serbisë. Nuk është pykë sekrete, është pykë publike, është pykë e qëndrimeve publike sa i përket Serbisë. Vendimtare sot është a e konsideron Serbinë armik, ose jo. Besoni me secilin prej juve që e konsideroni Serbinë armik, unë shumë kollaj mund të merrem vesh. Mirëpo, me të gjithë ju që bëni lakesa e nuk e konsideroni Serbinë armik, edhe votoni për “Zajednica” e demarkacione, e për amnisti ndaj kriminelëve serbë, kurrë nuk do të mund të merremi vesh. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar koleg deputetë Ali Berisha, të kërkoj falje publikisht! Fjala për ju.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryetar i Parlamentit!

Më lejoni që në fillim ta shpreh shqetësimin tim për formën e udhëheqjes së Kuvendit. Është e patolerueshme që të mos respektohen rregullat. Nuk kemi të bëjmë me demokraci. Tash më tepër tash u shndërrua në këtë anarki funksionimi i Kuvendit të Kosovës.

Të vonohet seanca për një orë e gjysmë dhe asgjë kurrkujt! Të paktën, deputetët të informohen. Në qoftë se është mangësi gjithmonë në këtë Kuvend të klithet ose të bërtitet për ta marrë fjalën, unë s’do ta marr kurrë.

Për Kosovën dhe shqiptarët, drejtësia është bërë një obsesion. Është bërë një dëshirë që populli i Kosovës nuk po mund ta përjetojë. Faktet janë të ditura se në Kosovë vazhdojnë të goditen vlerat kombëtare dhe të deformohet drejtësia.

Në Kosovën e pasluftës ndëshkohen ata që luftuan për çlirimin e saj. Edhe në Kosovën shtet ne për çdo ditë shohim sesi vuajnë ata që i shërbyen besnikërisht këtij populli dhe nuk kanë të ndalur, kurse luksi i madh i atyre që fituan me të padrejtë, pra të atyre që nuk i mbrojnë vlerat e luftës dhe sakrificën e këtij populli, e që thirren në emër të tyre, po merr dimensione shumë shqetësuese.

Në Kosovë ende nuk ka drejtësi. Në Kosovë, në emër të drejtësisë, reflektohen hapur shkeljet, abuzimet, ndërhyrjet, skenarët, kurthet, vendimet e veprimet absurde, të cilat i bëjnë të vuajnë njerëzit tanë.

Po të kishte drejtësi në Kosovë do të liroheshin ata që luftuan dhe do të burgoseshin kriminelët, që po sillen para hundëve.

Ish-luftëtarët e UÇK-së po e vuajnë padrejtësinë e dënimit, janë në akuzë të vazhdueshme.

Heshtja e institucioneve përgjegjëse përballë këtyre fakteve shpreh mjerimin e bartësve të tyre. Prandaj, jemi të obliguar që të mos heshtim, por të përpiqemi që të bëjmë diçka dhe në Kosovë të ndodhë ndryshimi, të vihet në vend drejtësia që është duke na munguar shumë të gjithëve.

Është e vërtetë e madhe se po heshtin ata që kanë përgjegjësi të flasin. Ata sot edhe mund të mos e dëgjojnë zërin që kërkon drejtësi, sepse mbi padrejtësi e shpërdorime janë ngritur dhe janë veshur me pushtet.

Nuk na habit fakti përse ata nuk po bëjnë diçka më mirë sot, sepse kanë bërë e po bëjnë kompromise të rënda, po e deformojnë shtetin e sapo krijuar të Kosovës.

UNMIK-u për shumë vjet solli shumë të këqija për Kosovën, ndërsa EULEX-i duket se ka vendosur t'i dërgojë në vend porositë e pakryera të tij.

A jeni duke parë edhe ju se gjykimet e djeshme të UNMIK-ut dhe gjykimet e EULEX-it e kanë një gjë të përbashkët? Janë fund e krye padrejtësi.

A nuk e shihni edhe ju se dhimbjet vazhdojnë të jenë pjesë e pandashme e jetës sonë? Plagët e marra nuk po shërohen, të pagjeturit e shumtë s'kanë ende shenja, as nuk kanë varre. Janë qindra familje që ende presin me shqetësim e ankth se kur do t'u kthehen njerëzit e tyre, të gjallë apo të vdekur. Çka po bëjmë ne për ta? Asgjë!

Në Kosovë ka struktura shtetërore të Serbisë, të veshura me petkun legal, të cilat veprojnë kundër Kosovës pa pengesa dhe askush nuk i ndëshkon ato. Harxhohen miliona euro për t'i paguar ata. Pse? Që të veprojnë kundër Kosovës.

Në buxhet e Kosovës mbahen liridashësit pa fakte, sepse drejtësia është zënë rob nga politika, kurse jashtë këtyre burgjeve kanë pozita të rëndësishme ata që i kanë bërë dhe i bëjnë dëm të madh politik, ekonomik e social Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Nuk duhet të durohet kjo gjendje. Duhet të mundohemi ta ndalim këtë të keqe dhe veprimet që e dhunojnë drejtësinë e vonojnë stabilitetin, paqen e sigurinë dhe prosperitetin e Kosovës.

Të ndalet gjuetia pa fakte ndaj ushtarëve të UÇK-së. Kushto që i gëzohet tragjedisë së tjetrit, herët a vonë do të bëhet pjesë e asaj tragjedie.

Kosovës i nevojitet më shumë se çdo gjë drejtësia, po drejtësia e faktuar. Kosova është e lodhur nga drejtësia e montuar, selektive dhe e ndikuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë i nderuar kolegë deputet do të vijë informacioni i saktë sa veta kanë qenë këtu. Kam qenë gjithë kohën në zyrë duke ju pritur. Sa veta kanë qenë në sallë në orën 15:15, kur ju kam thënë të vini, në 15:45, edhe në 16:00. Do të vijë informacioni i saktë, pastaj e bën gjykimin. Unë me zor nuk mund të ju fus në sallë, edhe kulturën e komunikimit nuk mund unë t'ju sjell. Urdhëro, zoti Berisha!

ALI BERISHA: Të paktën, të informohen ata që kanë qenë këtu në sallë se kur do të fillojë seanca, e jo të presim ashtu kot.

KRYETARI: Si kryetar i Kuvendit zakonisht mundohem të vijë në sallë kur janë deputetët që të mos krijoj përshtypje negative se nuk janë deputetët, e salla zbrazët. Për arsye se është përgjegjësia ime në qoftë se e kaloj seancën pa pasur deputetë.

Sido që të jetë, tash e sjell saktësisht, edhe xhirimet. Unë kam qenë në zyrën time. Xhirimet mund t'i verifikoni pastaj ju vetë, në katër rrethana kohore, për çdo 15 minuta jua sjell gjendjen.

Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Sinquerisht sot kam menduar që vërtet do të flasim për zhvillimet e fundit dhe do të flasim për vlerat e UÇK-së dhe dëmet që ka tendenca t'ia shkaktojnë kësaj strukture, por nuk mund të hyj në temë pa i thënë disa çështje me parafolësit e mi dhe të ndërlidhem me ta.

U tha shumë herë këtu sot nga kolegët e “Vetëvendosjes”, ndoshta edhe parafolësi i fundit nga Vetëvendosja”, zoti Albin Kurti, bëri disa çështje shtroi e që janë shumë të rëndësishme dhe tha “pse po dënohen shqiptarët, e nuk po dënohen serbët?”. Sinquerisht, unë asnjëherë nuk kam dëgjuar që në Parlamentin e Serbisë një deputet të çohet e t'i thotë një ushtari serb që ai ka nxjerrë organe, ose ka trafikuar organe. Nuk i kam dëgjuar që kanë përmendur ‘sharrë’.

E dyta, kurrë në jetën time nuk kam dëgjuar e të thuhet që “ju keni çelur bunarë”, siç e keni shpikur ju në mandatin e kaluar “bunarin e Likocit”. Unë asnjëherë nuk ju kam dëgjuar duke e përmendur për shembull bunarin e Qirezit ose të Kozhicsës, kur e dini shumë mirë që ato gra dhe vajzat e atij rajoni janë dhunuar dhe janë mbytur në ata bunarë, e më vjen keq që i përmend sot, sepse familjet e tyre ndoshta janë të prekura emocionalisht dhe janë traumatizuar, apo nuk mund pa i përmendur, sepse po provokohem nga këto ngjarje të këqija që po përmenden sot këtu.

Na ka hyrë tha pyka serbe në mes dhe thjesht na ka përçarë. Është e vërtetë dhe kjo nuk do shumë reflektim. Mjafton, kthehu prapa, majtas-djathtas dhe e sheh gjakun e atyre që gjyshërit dhe stërgjyshit gjithmonë kanë bërë zi për këtë vend. Prandaj, distancohu prej kolegëve tu, fillimisht... Jo, jo distancohu, e dini shumë mirë, nuk përmenda emra! Distancohuni prej kolegëve tuaj fillimisht dhe paraardhësve të tyre, dhe ejani e bashkëpunojmë. Ejani bashkëpunojmë për të mirën e këtij vendi, të bëjmë aleanca një herë ne këtu për vendin tonë, e pastaj flasim për aleanca ballkanike.

Pa dashur të përmend emrat, e tha shumë mirë që ata që e drejtuan ushtrinë sot janë në burg. E vërtetë është...

KRYETARI: Më fal deputete, vetëm pak të lutem. Glauk...! Urdhëro, aktivizoje mikrofonin se protokolli ka nevojë për... Dëgjo! Glauk, rri si burrat, se kjo është një zonjë deputete.

GANIMETE MUSLIU: Kryetar, unë vazhdoj, sepse kam përgjigje edhe për Glaukun, pa asnjë problem, hiq mos u ngut.

Po, faleminderit! Unë kam shumë pyetje, për shembull, folën për udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe thanë që drejtuesit e ushtrisë i kanë burgosur, sepse po e dënojnë të ardhmen, jo të kaluarën, shumë mirë. A keni harruar, zoti Kurti, kur keni bërë konferenca për shtyp dhe keni thënë që kriminelët po shëtitën nëpër spitale kur ata kishin nevojë për trajtime mjekësore. Kanë qenë pikërisht këto akuza, për të cilat ata edhe sot po rëndohen.

Nuk kanë qenë për krime të tjera ata në burg, në momentin kur ata kanë kërkuar trajtim mjekësor, në spital kanë qenë të njëjtit, kanë qenë pikërisht ata që ti i citove në fjalimin tënd dhe ju keni bërë konferenca për shtyp, keni thënë që kriminelët po shëtisin nëpër spital, mos i harroni këto gjëra. Prandaj, u tha shumë herë këtu prej parafolësve, është mirë kur të flasim të mbahet mend çka kemi folur, sepse tani po dalim kundër vetvetes në fjalimet e radhës.

U fol shumë për UÇK-në, u moralizua shumë, Albin, një pyetje e kam shumë konkrete për juve: Pse në vitin 1998, në Qirez, kur ta kanë ofruar kallashnikovin dhe uniformën, nuk keni pranuar të bëheni ushtar, keni thënë se do të vij një ditë tjetër. Kjo është pyetje shumë konkrete. Jeni shumë të saktë, edhe me data, edhe me histori, edhe me të dhëna, por ende kurrë nuk ike shpjeguar këtij Kuvendi ku ke qenë më 17 janar 2004? T'u ka përmendur edhe në Kuvend, edhe në media, ka dalë edhe në raporte të policisë që keni qenë në fshatin Bic të Klinës, në vizitë te vëllezërit Donçiq. Çka keni kërkuar, duhet ta sqaroni edhe këtë rast?

Këto pyetje i kam për juve dhe për “Vetëvendosjen”, por nuk dua ta kaloj kohën time pa i thënë dy-tri fjalë edhe për grupin “Drenica 2”, të cilët sot na kanë mbledhur në këtë seancë.

Të nderuar të pranishëm,

S’kam dashur të merrem sot me individë, s’kam dashur të merrem me parti politike, sepse tema, të cilën ne e trajtojmë është mbi përmasat politike dhe individuale, prandaj në këtë seancë të jashtëzakonshme sot do t’u drejtohem vetëm qytetarëve të vendit, të cilët janë dezinformuar në mënyrë kriminale në emër të drejtësisë në Kosovë. Është për keqardhje në çfarë pike ka arritur niveli propagandues i stilit të shpëlarjes së trurit deri në atë masë sa të pranohet çdo gjë e drejtë apo e padrejtë, qoftë ajo.

Të nderuar qytetarë,

Ne sot shprehim shqetësimin tonë për zhvillimet e fundit në proceset e grupit “Drenica”. Po bëhen katër vjet që ne jemi dëshmitarë, që gjyqësia jo gjithmonë ka të bëjë me drejtësinë. Përderisa ky grup u përball me të ashtuquajturën “drejtësi të misionit të EULEX-it”, duke mos anashkaluar faktin që të gjithë pruan të bashkëpunonin në këtë drejtim, në besimin se faktet ishin në anën e tyre. Ata u mbyllën në qeli të burgjeve, duke i lënë të presin me vite për t’ua komentuar pastaj dënimet, të cilat nuk njohin precedent në histori. Dënime këto të parapërgatitura dhe të ruajtura në zarfe nëpër sirtarë kancelarish.

Duke qenë që sot çdo fjali mund të merret si ndërhyrje në punët e gjykatave, jam e obliguar të shpreh thjesht mendimin tim, se në vendin tonë u mbyt shpirti i çfarëdo lloj proteste duke u implantuar një lloj letargjie kolektive. U mbyt besimi në drejtësi dhe u mbyt besimi se padrejtësitë mund të luftohen. Askush nga ne dhe asnjëri në gjithë Kosovën nuk është kundër zbardhjes së krimeve dhe shqiptimit të dënimit proporcional për to, por shqiptohen dënime me dhjetëra e dhjetëra vjet mbi bazën e asnjë dëshmie relevante. Kjo thjesht nuk është as zbulim

krimi dhe as nxjerrja e drejtësisë në vend, por është një krim në vete, i cili nuk e di se para çfarë gjykate do të duhej të trajtohej.

Shembull kapital për një krim të tillë është rasti “Kiqina” dhe tani rasti i grupit “Drenica 2”. Është edhe në rastin e parë, edhe në të dytin, po bëhen kurban djemtë më të mirë të Drenicës, të cilët nuk i dolën në mbrojtje vetëm Drenicës, por ata u bënë kurban për Kosovën dhe popullin e saj sa herë kishte nevojë. T’u merret njerëzve liria për të larë para botës mëkate të paqena, është krimi më i madh që mund të bëhet.

Të dashur qytetarë,

Ju që në, fund të fundit, jeni instanca më e lartë në këtë vend, më lejoni të pasqyroj shkurt bazën mbi të cilën EULEX-i shpalli dënime dhe kjo bazë është deklarata e një dëshmitari, për të cilin vetë familjarët e tij para trupit gjykues paraqitën fakte dhe dëshmi mjekësore se vuan nga skizofrenia. Për deklaratën e një skizofreni u shqiptuan 49 vjet burgim për më shumë se dhjetëra persona. Sot dua t’jua sjell para sysh situatën e familjes Demaku, edhe pse u përsërit nga parafolësit tanë.

Ku nga dy prindër u lindën e u rritën me atdhedashuri, u edukuan gjashtë fëmijë, prej tyre pesë djem dhe një vajzë. Prej tyre në luftën e Kosovës ra dëshmor Xhevat Demaku, u vra vajza e tyre e vetme, Fatimja, bashkë me të birin e saj trevjeçar, kurse vajzës së saj kjo liri përveç nënës dhe vëllait i kushtoi me një dorë që e humbi si pasojë e luftës sonë çlirimtare. Familjes Demaku lufta ua mori edhe axhën, Musliun, me dy djemtë, Bedriun dhe Dritonin, dhe iu plagosën edhe dy djemtë, Fadili dhe Nexhati.

Rezultat i atdhedashurisë dhe gatishmërisë vetëflijuese të tyre sot është dy prindër të vetmuar, të cilët fëmijët e tyre i brumosën me atdhedashuri dhe askush asnjëherë nuk pyeti: Këtij dëshmitari, i cili ofroi gjoja prova për gjykimin e këtyre njerëzve, a i mungon ndonjë gisht i vetëm? A i mungon ndonjë bri i thyer? A i mungon ndonjë sy, a i mungon ndonjë vesh? Nuk i mungon asgjë. Ai është shëndosh e mirë dhe për këtë u dënuan me 49 vjet burgim djemtë tanë.

Asnjëherë nuk e kam dëgjuar kolegun tim, Fadil Demaku, të flasë apo të kërkojë favore për gjithë sakrificën, ai thjesht e mbajti për vete si çmim që duhet paguar për liri.

Të dashur qytetarë,

Vendimi që seanca gjyqësore të mbahet në veri të Mitrovicës është edhe një diçka që duhet të përmendet. Kjo nuk është marrë pa një qëllim të caktuar, ky qëllim ishte që ai trup po mendohej të mbante larg syve dhe veshëve të opinionit turpin, të cilin ata po e përgatitnin. Nga mediat u morën vetëm ato që u lejuan t’iu servohen deri në gënjeshttrat për dhunë seksuale. Këto gjëra nuk ndodhin kot, këto gjëra ndodhin për të ndikuar në formimin e një opinionit të caktuar, por ju që

sot jeni duke përcjellë këtë seancë, sa herë merrni frymë në liri, mos harroni të mendoni se prindërve Demaku iu grabitën të gjithë fëmijët, duke mbetur të vetmuar, në pleqërinë e tyre.

Çdo fjalë jona sot nga disa pseudo-intelektualë që mendojnë të shfrytëzojnë rastin për të arritur një qëllim impakt të tyre, mund të merret si ndërhyrje në drejtësi. Ku ishin këto koka intelektualësh kur drejtësia u shkel nga vetë ata, të cilët duhej ta mbronin? Pse nuk reagues kur duhej të reagonin si ekspertë? Pse nuk folën atëherë, kur njeriu dënohet për një krim fantom? Ata duhet ta dinë se vetë gjykatësit e EULEX-it duhet të jenë në radhë të parë profesionistë dhe të pandikuar. Ne përballemi çdo ditë me akuza për korrupsion dhe krim të organizuar, por pikërisht këta gjyqtarë duhet t'i rezistojnë korrupsionit dhe duhet të dinë se nuk kanë të drejtë të shndërrohen në inkuizitorë të gjykatave politike, duke shkelur me këmbë etikën e punës së tyre më rëndë se në gjyqet e mesjetës.

Siç thotë një fjalë, gjyqësia është qorre, mirëpo gjyqësia e EULEX-it ka katër sy dhe vaj halli për ata sy, të cilët nuk pëlqejnë dikë. Unë besoj fort në parimin që asnjë padrejtësi nuk shpagueshet duke bërë një padrejtësi tjetër, më të madhe. Në qoftë se këta burra kanë bërë vepra të paligjshme, atëherë duhet të përballen me ligjin pikërisht për ato vepra, e jo t'u shpien drama për konsum politik, t'u shqiptohen dënime për krime fantome, pa as edhe të vetmen indicie. Kjo nuk i kontribuon drejtësisë në Kosovë dhe as drejtësisë në përgjithësi.

Një fjalë tjetër që është parim për punën e çdo gjyqtari, thotë: "Më mirë është 100 fajtorë në liri, se sa një i pafajshëm në burg". A mendojnë këta gjyqtarë në fjalë se rolin dhe detyrën që e kanë të marrin vendime të shkruara, të cilat pastaj i lexojnë në mënyrë ceremoniale në gjykatë. Ku u mbeti parimi tjetër në drejtësi, në dyshim për të akuzuarin? Këto parime jo që nuk u morën asnjëherë parasysh, por përkundrazi, ato u zbatuan në formën e kundërt. Nëse bëhet një pasqyrë reale e rrjedhjes së procesit në tërësi, do të kuptohet se avokatët mbrojtës janë nënçmuar deri në çnjerëzi përmes një demonstrimi të forcës juridike, politike dhe personale të trupit gjykues.

Gjykatësit në këtë proces kanë mbajtur anën e prokurorëve, duke shkelur çdo normë të detyrës së tyre. Prandaj, kanë humbur edhe kredibilitetin e tyre si gjyqtarë të pavarur. I tërë procesi ishte një tragjikomedi, me një epilog fatal për personat, falë sakrificës së të cilës jemi sot këtu ku jemi. A nuk e kanë merituar që për hir të korrektësisë historike të merremi pak më shumë me ecurinë e këtij procesi. A nuk është dashur që si shoqëri të analizojmë dhe të mendojmë se çfarë drame po i skenohet Kosovës. Nëse jo për të akuzuarit, atëherë për hir të objektivitetit raportues. Ku mbetën ekspertët medialë, politikë, juridikë e të tjerë që asnjëherë nuk u përpoqën të paktën të sqarojnë opinionin për ecurinë e këtyre proceseve.

Ata që janë të thirrur të monitorojnë proceset në shoqërinë tonë, është fjala për proceset në përgjithësi, kanë punuar me vite për të shpërndarë propaganda të qëllimshme për të instaluar një lloj averzioni në opinion lidhur me individë apo grupe individësh të caktuar, siç e pamë edhe së

fundmi, e që kishte një qëllim të vetëm të nxisteeemocionet dhe të tërhiqte vëmendjen e opinionit nga problemet bazike të kësaj shoqërie.

Bashkësia ndërkombëtare hiq më larg se dje raportoi lidhur me kërcënimet për një gazetar në Kosovë. Mirë që reagoi, sepse kërcënimet publike duhet të merren seriozisht. Dhe ne si shoqëri duhet të mësojmë të kundërshtojmë diçka me argumente, e jo me sharje dhe kërcënime. Por, do të ishte mirë që kjo bashkësi ndërkombëtare të ndërhynte edhe në këtë proces, i cili është komplet i politizuar dhe të thotë fjalën e saj, sepse heqja e lirisë është më e rëndë se sa një sharje publike.

Kredibiliteti i po kësaj bashkësie ndërkombëtare besoj që është më me rëndësi se sa mbrojtja e veprimeve raciste të disa gjyqtarëve, të cilët ndoshta për të shpëtuar lëkurën e tyre pranojnë të inskenojnë gjyqe të tilla. Kush janë këta gjyqtarë?

Të dashur qytetarë të vendit tim,

Ne jemi të pafuqishëm të zgjidhim të gjitha problemet tuaja në afate rekorde, por duhet të angazhohemi me seriozitet në këtë drejtim, sikurse edhe ju që duhet të jeni vigjilentë dhe të mos bini pre e shantazheve publike të thurura me mjeshtëri shekspiriane, sepse kjo çon vetëm në shtyrjen e gjetjes së zgjidhjes së problemeve tuaja, me të cilat ballafaqoheni çdo ditë.

Të dashur qytetarë,

Ju mund të bëni vetë krahasimin duke vendosur përballë gjyqin ndaj Ivanoviqit dhe grupit të “Drenicës” dhe mund të shihni tendencat e drejtësisë së EULEX-it.

Jemi për drejtësi, natyrisht se po, por a duhet t’i mbyllim sytë para drejtësive të tilla dhe shkeljeve të tilla të të drejtave të njeriut në vendin tonë. Unë them se jo. Lutja ime e vetme për ju, të dashur qytetarë, do të ishte: Mos bini pre e raportimeve të njëanshme, mos lejoni t’u hidhet hi syve dhe mos lejoni duke ju seruar sensacione mediatike t’u bëjnë t’i harroni nevojat tuaja! Ne asnjëherë nuk do të ndërhyjmë në drejtësi, por edhe asnjëherë nuk duhet të lejojmë që në emër të drejtësisë të na përdhoset dinjiteti. Unë sot kërkoj nga bashkësia ndërkombëtare që të kërkojë instanca të tjera për hetimin e gjyqtarëve, të cilët i gjykuan këto raste, të cilat edhe vetë Koreja Veriore do t’i marrë për shembull.

Kërkoj nga trupi gjykues të hetohet për shkelje të çdo norme ekzistuese juridike, ftoj kolegët e mi që të shqyrtojnë të gjitha mundësitë për të parandaluar shkeljet e mëtutjeshme të të drejtave të njeriut në këtë vend. Nuk kemi nevojë për gjyqe politike, ne duhet të lejojmë që vlerat tona sublime të bëhen kurban për dështimet politike ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi, Abdyl, pastaj ti, të kam të partisë sime, s’kam çka të bëj.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Në kohën kur erdhi kryetari i Kuvendit tha është një lajm i gëzueshëm, për një moment u ndala dhe thashë: Çfarë mrekullie ndodhi për momentin? I uroj LDK-së për kolegun Kelmendi dhe tani më lejoni t'i kthehem temës për të cilën vërtet duhet të kemi seriozitet.

Në vitin 2009, si nënkryetare e Komunës së Gjakovës, në një vizitë që i bëri presidenti i atëhershëm, zoti Sejdiu, familjes së nderuar Zeneli, në Shqiponjë të Gjakovës, edhe e nderoi me mirënjohje, gjatë asaj vizite kërkoi që të kthehemi te familja Querkezi, te zonja, te një nënë e nderuar, Ferdane Querkezi.

Gjatë vizitës që bëmë në atë familje, presidenti e pyeti zonjën Querkezi: Si po mbahesh? Ajo i tha, po e citoj: “Ka edhe më zi”. Ajo humbi katër djemtë dhe burrin në shtëpi, në familjen e vet, jo me uniformë, po krejt në shtëpinë e vet. Pra, që kishin qëndruar në familje dhe askujt asgjë nuk i kishin bërë. Pra, ata thjesht u masakruan. Ajo mbet pa asnjë fëmijë, pa asnjë djalë, pa asnjë fëmijë të vetëm dhe pa burrin. Për një moment thashë: Çka ka më zi? Tha: “Po, ka më zi, me m'u fshi mendja dhe mos me qenë në gjendje me e kujtu edhe me i tregu dikujt çfarë m'i ka ndodhë familjes sime”.

Sot, fatkeqësisht kemi ardhur në një moment kur vërtet po na fshihet, fatkeqësisht, nga mendja një e kaluar. Në qoftë se e harrojmë të kaluarën, asnjëherë nuk do ta ndërtojmë të ardhmen. Nëse vërtet do të duhej të bisedohej pikërisht për pasojat e luftës së fundit çlirimtare në Kosovë, natyrisht se është e udhës dhe krejt i natyrshëm do të ishte debati për pasojat e jashtëzakonshme që solli ajo: për djegiet, shkatërrimet, vrasjet, dhunimet në shkallë çmendurie, masakrat dhe gjenocidin ndaj shqiptarëve autoktonë në Kosovë.

Të shkatërruar nga Serbia dhe formacionet e saj paramilitare serbe, me 500 mijë forca serbe, ushtarake dhe paramilitare e 200 mijë të mobilizuar, pra civilë nga Serbia. Por, sot jemi të detyruar të bisedojmë për një temë që asnjëherë nuk do të duhej të ndodhte në Kosovën e pasluftës, sidomos ndaj asaj kategorie që më së shumti sakrifikoi për këtë vend. Kohë më parë kur gjuajtja e “shtrigave” kryesisht ishte fokusuar në Rrafshin e Dukagjinit ndaj luftëtarëve dhe bartësve të lirisë, për fat të keq, ajo tashmë është shtrirë pothuajse në tërë Kosovën.

Dhe, jemi në këtë gjendje të mjerë, së cilës jam shumë e sigurt që më së shumti i gëzohet Serbia, e kush gjatë rrugës iu bashkua e do t'i bashkohet kësaj valleje turpi, e bajt me shëndet” Sepse, të ndalet dhe të dënohet për krime lufte komandanti i UÇK-së, i ushtrisë që u pranua dhe u ndihmua nga bota demokratike si ushtri çlirimtare, ndërsa në anën tjetër, të thuhet se në këtë mënyrë nuk po dënohet dhe ndëshkohet Ushtria Çlirimtare e Kosovës, kjo në të vërtetë është e papranueshme dhe absurd i llojit të vet.

Është një përrallë, së cilës asnjëherë nuk do t'i besoj, nuk i besojnë edhe ata që e ndërtuan, e lëre më e nesërmja, ku gjithsesi do t'i bëhej një studim dhe gjykim i paanshëm kudo e nga kushdo qoftë. Pra, të nderuar deputetë, sot për fat të keq jemi para një akti të kryer, krejt të pamundur që realisht të bëjmë diçka në shërbim të këtyre njerëzve dhe në shërbim të sakrificës sonë sublime, e cila përkrahur nga Perëndimi determinoi edhe vetë lirinë e Kosovës.

Jemi të pamundur, sepse para se gjithash dështuam në çdo përpjekje si shoqëri dhe mbi të gjitha si shtet demokratik. Qeveritë e Republikës së Kosovës që nga shpallja e pavarësisë asnjëherë nuk u morën seriozisht me këta skenarë të kobshëm që po përgatiteshin para syve tanë për t'u verbuar pas pushtetit dhe pasurimit marramendës për veten dhe klanet e tyre. I harruan bashkëluftëtarët, shokët e idealit dhe krejt çka bashkarish arritëm për vite e dekada me radhë.

Dikush madje duhet të ndjehet i turpëruar përballë kësaj situate të rëndë, sepse në të vërtetë, e tillë është, kur para syve të dënohen ushtarët e lirisë, pjesëtarë të UÇK-së, bartës të lirisë. Dikush duhet të turpërohet që po ndodh një gjë e tillë, përderisa asnjëherë nuk ndodhi dënimi i shtetit të Serbisë, shtetit i cili gjatë vitit 1998 dhe '99 shkaktoi gjenocid ndaj shqiptarëve sipas programeve shoviniste serbe që prej vitit 1844 e këndeje, kur bazat e politikës serbomadhe i vuri ministri i Brendshëm i Serbisë, Ilia Garashanin, me programin sekret për krijimin e Serbisë së Madhe.

Veçanërisht në periudhën e luftës frontale, pra të periudhës '98-'99, dhuna, terrori dhe gjenocidi i Serbisë në Kosovë mori përpjesëtimet e tilla sa që e rrezikonte ekzistencën fizike të shqiptarëve që e përbënin popullsinë shumicë në Kosovë me mbi 90%.

Në fund të shkurtit dhe fillim marsin e vitit '98 Serbia, e cila trashëgoi gjithë infrastrukturën ushtarake të ish-Jugosllavisë, që e përbënte forcën e tretë në Evropë, filloi sulmet e armatosura frontale për ta pushtuar Kosovën me të gjitha trupat e rregullta policore, ushtarake e paraushtarake, të pajisura me mjetet më moderne, përfshirë edhe arsenalin luftarak të ndaluar edhe me konventa ndërkombëtare.

Duke synuar zhbërjen e një populli të tërë dhe spastrimin etnik të Kosovës. Duke kryer masakra të tmerrshme, fillimisht kundër popullsisë civile shqiptare në Qirez, Likoshan, Prekaz, Lybeniq, Çyshk, Reçak, masakrat në Mejë, Krushë të Madhe, Krushë të Vogël dhe në të gjitha viset pothuajse në Kosovë.

Nuk ishte fare me rëndësi përcaktimi i tyre politik, nuk ishte fare me rëndësi se a ishin mbështetës të UÇK-së, apo ishin përkrahës të vijës paqësore. Nuk ishte fare me rëndësi përkatësia e tyre fetare, i rëndësishëm ishte urdhri për zhdukjen dhe dëbimin e shqiptarëve nga Kosova dhe kjo duhej zbatuar. Ishte kjo një fazë e re e zbatimit të planeve operative për zhdukjen e shqiptarëve, të elaboruara me kujdes për një kohë të gjatë nga Akademia e Shkencave të Serbisë, Kisha ortodokse serbe dhe qarqet më të larta të Qeverisë së Serbisë.

Veprimtaria gjenocidiale, të cilën forcat okupuese policore, ushtarake e paramilitare të Serbisë e të ish-Jugosllavisë së mbetur, nën drejtimin e kasapit të Ballkanit Slobodan Milosheviq, e ushtruar kundër popullsisë shqiptare gjatë luftës '98-'99 është tërësisht identike në mbarë Kosovën. Përderisa gjatë vitit '98 forcat serbe, trupat e shqiptarëve pasi i vrisnin e i masakronin, i digjinin nëpër shtëpitë e oborrit të tyre, në furrat e termocentralit në Obiliq dhe në furrat e “Ferronikelit” e të shkritoreve të minierës së “Trepçës”, i hodhën në puse të ujit të pijshëm, në gropa të gëlqeres, i varrosën në varreza masive e i zhvarrosën për t'i zhdukur pa gjurmë apo për të shfajësuar UÇK-në kinse për vrasjen e tyre.

Gjatë vitit '99 kufomat e qindra civilëve shqiptarë, të qindra fëmijëve, gra dhe pleqve, të vrarë dhe të masakruar nga forcat okupuese serbe i transportuan për në Serbi, për të zhdukur dhe shkatërruar provat dhe të gjitha ato çka ata me veti i kishin marrë. E tërë kjo u bë në kuadër të operacionit sekret “Spastrimi”. Në këtë operacion për zhdukjen e gjurmëve të krimeve kanë marrë pjesë strukturat më të larta shtetërore të Serbisë dhe ish-mbetjes së Jugosllavisë.

Në këtë operacion të udhëhequr nga shefi i sigurisë publike të Serbisë, gjenerali Vlastimir Gjorgjeviq, ka marrë pjesë një zinxhir i tërë i oficerëve të shërbimeve sekrete serbe, të policisë, të njëjve speciale dhe të ushtrisë së Jugosllavisë. Këtë e dëshmon edhe zbulimi i varrezave masive me trupat e shqiptarëve në Batajnicë, Petrovo Sello, Danub, Peruqas, Rudnicë të Rashkës e të tjerë. “S’ka kufoma, s’ka krim”, do të konstatohej në takimet e nivelit më të lartë të Slobodan Milosheviqit dhe shtabit të tij strategjik që në muajin mars të vitit 1999.

Pas fillimit të bombardimeve të NATO-s ushtria jugosllave e ktheu Kosovën në fushëbetejë. “Masakrimi i shqiptarëve nuk ishte diçka që po kanosej, por diçka që po vazhdonte”, shprehej atë botë Joshka Fisher, ministër i Jashtëm gjerman. Operacioni famëkeq “Patkoi” për spastrimin etnik në Kosovë ishte planifikuar që në vitin 1998 nga Milosheviqi si një mjet brutal për t'i dhënë fund krizës sipas mënyrës së tij. Në vazhden e këtij operacioni sekret forcat ushtarake serbe, në bashkëpunim me MUP-in dhe vullnetarët lokalë serbë, i përsëritën krimet më të neveritshme të luftës nga vitet e '90-a.

Sipas kreut ushtarak serbë, me spastrimet etnike nëpërmjet operacionit “Patkoi” në Kosovë duhet të mbeteshin 400 mijë deri në 500 mijë shqiptarë dhe me kolonizimin e ri serb në Kosovë të krijohej një përqindje proporcionale e popullsisë 50-50 dhe të arsyetohej para botës. Edhe pse Serbia luftënxitëse, e cila në krye me kasapin e Ballkanit, Slobodan Milosheviqin, për gati një dekadë e lau me gjak gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë, madje çmenduria e kriminelëve serbë shkoi aq larg sa të bëjë llamba ndriçuese me kafkat e shqiptarëve.

Megjithatë, falë zvarritjes së procesit gjyqësor Slobodan Milosheviqi vdiq i padënuar në Tribunalin e Hagës, kreu i Serbisë, Milutinoviç, u shpall i pafajshëm, ndërkaq u dënuan vetëm disa ushtarë e kryepolicë të Serbisë për përgjegjësitë e tyre për krimet makabre në Kosovë dhe

atë vetëm për krime “kundër njerëzimit”, pa u përgjigjur dhe pa u dënuar për veprat e vërteta penale që i kanë kryer në Kosovë, të cilat në të drejtën ndërkombëtare kualifikohen si gjenocid apo vrasje e popullit, megacid, apo vrasje në masë, kulturocid, apo shkatërrim i kulturës e i monumenteve historike kulturore, ekonomikid, apo shkatërrim i ekonomisë, etnocid apo shkatërrim i etnisë dhe religiocid, ose shkatërrim i objekteve fetare.

Ajo që ka ndodhur me popullsinë shqiptare gjatë luftës në Kosovë në vitet ‘98-‘99, na kujton fatin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Përveç plaçkitjes, shkatërrimit të pasurisë së shqiptarëve, shkatërrimit të qyteteve, fshatrave shqiptare, plaçkitjes dhe shkatërrimit të trashëgimisë kulturore e dokumentacioneve administrative, u vranë e u masakruan mbi 12 mijë shqiptarë dhe ende konsiderohen të zhdukur edhe mbi 1 mijë e 600 persona.

Mbi 1 milion shqiptarë të ballafaquar me vdekjen u dëbuan gjatë jashtë Kosovës, gjatë operacionit për spastrimin etnik. U përdhunuan rreth 20 mijë femra shqiptare, qindra fëmijë, madje foshnja shqiptare në barkun e nënave u vranë me pretekstin se po ekzekutoheshin armiq të ardhshëm të Serbisë.

Eshtat e 374 të ekzekutuarve në masakrën e Mejës u gjetën në varrezat masive në Batajnicën 2, u identifikuan një numër i madh, por mbetën ende sot e kësaj dite 16 persona të pagjetur. U kthyen në Kosovë, por askush nuk u përgjigj për të ekzekutuarit pa gjyq në këtë masakër që shënon masakrën me numrin më të madh të vrarëve gjatë luftës në Kosovë. Për masakrën e Mejës, e të Korrenicës në shkurt të këtij viti Interpoli nxori një urdhër arrest ndërkombëtar për 17 ish-drejtuesit të forcave ushtarake e policore serbe, përgjegjës për masakrën, ndonëse lista e personave nuk është e plotë. Lista e të kërkuarve nga Interpoli kryesisht kryesohej pikërisht nga gjenerali Momir Stojanoviq.

Por, që nga ajo ditë, edhe pse me urdhër arrest aktiv ndërkombëtar të lëshuar nga Interpoli, Stojanoviqin nuk e ka shqetësuar askush, sepse shteti serb qëndron pas tij dhe të tjerëve. Edhe njëherë po e ritheksoj, Stojanoviqin nuk e ka shqetësuar askush, sepse prapa tij qëndron shteti serb dhe pas të tjerëve. Ose, thënë më mirë, ata janë vetë shteti, duke filluar që nga Presidenti i Serbisë, kryeministri dhe shefi i Shtatmadhorisë së ushtrisë që e përbëjnë listën e personave të dyshuar për pjesëmarrje në krimet e luftës në Kosovë. Stojanoviqi vepron i patrazuar nga organet e drejtësisë vetëm pse të ekzekutuarit e rastit në trajtim në Mejë të Korrenicës janë shqiptarë dhe atë të dy besimeve: katolikë dhe myslimanë dhe askujt nuk i bëhet vonë për t’i nxjerrë para drejtësisë këta kriminelë.

Të rënë në luftën e lirisë së Kosovës nuk janë thjesht statistika, nuk janë njerëz të vrarë dhe të masakruar, të djegur e të bërë shkrumb me varre e pa varre. Janë njerëz që u është marrë jeta padrejtësisht, janë njerëz që meritojnë dhe kërkojnë shpazim dhe jo hakmarrje. Në emër të këtyre viktimave të pafajshme shqiptare, në emër të kësaj çmendurie serbe, po bëhet kjo hakmarrje ndaj

shqiptarëve, ndaj mburojave të tyre, ndaj udhëheqësve të lirisë, e jo ndaj atyre që i shkaktuan këto shifra alarmante vdekjeprurëse, dëbime në shkallë gjenocidi. Pse? Për të barazuar çlirimtarin me kriminelin? Po kjo është e pamundur, zotërinj të nderuar deputetë, apo nëse vërtet një gjë e tillë ka ndodhur edhe gjetiu kudo në botë apo në Evropë bëjeni edhe njëherë në Kosovë, ju të nderuar ndërkombëtarë. Bëjeni edhe në token që 1 mijë vjet gjak pikon, siç thoshte bacaloku i ndjerë, Din Mehmeti.

Ndërsa, për fund, të gjithë atyre që i nxitën, urdhëruan, ndihmuan dhe sponsorizuan këto gjykime të padrejta sikur të rastit “Drenica 1 dhe 2”, të projektuara nga çlirimtarë të Kosovës dje dhe sot, fund e krye të padrejta, ju bëj thirrje apo së paku i lus që të kenë durimin dhe konsideratën për mijëra civilë shqiptarë të vrarë para dhe gjatë luftës së fundit në Kosovë, në mesin e të cilëve foshnjat e porsalindura e në bark të nënave, pleq me njërën këmbë në varr, të lexonin librin nga i cili sot për shkak të ndjeshmërisë së lartë shkëputa disa fragmente të argumentuara në mënyrë shkencore, pra nga libri “Terrori dhe gjenocidi i Serbisë në Kosovë” të autores Fitnete Ramosaj, ish-luftëtare e lirisë, ndërsa tani bashkëpunëtoresh profesionale në Institutin e Krimeve të Luftës në Prishtinë.

Për hir të atyre, të Zotit, lexojeni ju që nuk e keni lexuar, edhe pse në të vërtetë, druaj se tashmë është shumë vonë. Madje, aq vonë sa edhe treni i fundit ka ikur dhe nuk duket gjëkund. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, kini parasysh aktualisht është vetëm edhe zonja Shukrije Bytyqi nga Grupi Parlamentar “Nisma”, ndërkohë kemi... zoti Bali Muharremaj, për arsye se mendova që janë edhe 20 të tjerë deputetë vetëm të Grupit Parlamentar të PDK-së, në qoftë se pajtohem, kishim shkuar në votim.

Unë do t’ia jap fjalën kujtdo pas zonjës Shukrije, por në qoftë se pajtohem, shkojmë, pasi nuk ka tjetër. Si doni ju, unë prapë askujt s’do t’ia ndal fjalën. Por, në qoftë se pajtohem, për hir që ta nxjerrim rezolutën dhe për nga 2 deri në 3 orë ishim futur në seancën e radhës sot. Mirë, e lëmë për nesër, si doni ju. Zonja Shukrije Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Lufta speciale që po bëhet kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe protagonistëve kryesorë të saj, tash e disa vjet, ka hyrë në një rrugë të rrezikshme dhe aspak në përputhje me të vërtetën dhe vlerat që ka populli ynë. Tendenca për të barazuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës me forcat kriminale të ushtrisë serbe që vranë e masakruan, nuk kursyen as gra, as fëmijë, as pleq, as të rinj, nuk është asgjë tjetër pos tendencë për të vrarë lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Është e dhimbshme kur drejtësia është e dirigjuar nga politika e inkriminuar dhe eliminuese, e cila qëllim kryesor ka dënimin me faktet e falsifikuara, të montuara nga qarqet serbe, që tregon se tendenca për të barazuar agresorin dhe viktimën nuk ka lindur sot, por përgjatë gjithë historisë së re së Kosovës. Madje, kjo drejtësi, nëse mund të quhet e tillë, ka detyruar me vite, e ndoshta edhe dekada çlirimtarët tanë të sillen nëpër gjykata pa asnjë fakt të vetëm. Me të drejtë besuam e shpresuam që e krijuam shtetin e lirë për të vendosur drejtësinë dhe për t'i dhënë fund padrejtësisë që kishte sunduar për shekuj këto troje.

Drejtësi po, por jo drejtësi për të dënuar luftëtarë, por drejtësi për të luftuar korrupsionin e format e tjera të trafikimit, por jo dënimin e çlirimtarëve me dëshmi të rrejshme.

Të nderuar deputetë,

Dënuam gati çdo udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, lirinë, ata të cilët lirinë e kishin në zemër për popullin, shkatërruam çdo vlerë që na lidh me luftën çlirimtare, përbuzëm çdo ushtar që luftoi për liri dhe na kanë mbetur vetëm edhe vdekurit t'i dënojmë, me gjithë këto padrejtësi që janë duke u bërë ndaj ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe nëse kjo është drejtësi ndërkombëtare, ku kriminelit e viktima peshojnë po njësoj, atëherë nuk e di ku paska drejtësi, e kjo shprehje vërtet nuk e di a tingëllon e drejtë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Pas marrjes së lajmit për dënimin e luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe konkretisht “Rastit Drenica 1 dhe 2”, e cila është një goditje e rëndë për idenë e lirisë, të çlirimit dhe të drejtësisë, sikur na shkon mendja dhe pyesim a vërtet ne jemi fajtorë që luftuam për lirinë dhe pavarësinë e vendit? A jemi fajtorë që mbrojtëm pragun e shtëpisë dhe u rreshtuam përkrah qytetarëve, apo jemi vetëm numra matematikorë që për llogarinë e politikës mbetemi si plaçkë e hesapit mes tyre? Në dënimin e këtij rasti shpreh indinjatë të thellë dhe shpreh pakënaqësi me rastin e dënimit të Gjykatës së Apelit ndaj grupit “Drenica 2” dhe mendojmë që ky vendim i kësaj gjykate është i montuar dhe ka për qëllim të degradojë luftën e shenjtë dhe sublime të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne nuk pajtohemi asnjëherë me këto vendime të qëllimshme që kanë për objekt barazinë e luftës sonë çlirimtare me masakrat e ushtrisë serbe, të cilat vranë dhe masakruan qytetarët e pafajshëm. Këto vendime plotësojnë apetitet e Serbisë dhe armiqve të tjerë të shtetit të Republikës së Kosovës që ta errësojnë luftën e drejtë të Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Solidarizohem me çdo luftëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe është koha e fundit për t'i thënë stop çdo forme të ndjekjes kriminale ndaj çlirimtarëve. Ndjekje që nuk pushuan tash e 17 vjet në Kosovë dhe jashtë saj. Ju bëj thirrje institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që të dënohen kriminelët dhe të lirohen çlirimtarët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë janë edhe shumë deputetë, a dëshironi të shkojmë drejtpërdrejt në votimin e rezolutës? Po, për atë desha të kërkoj pauzë që grupet parlamentare të harmonizojnë draft-rezolutën. A dëshironi të shkojmë drejt? Unë do t'i lexoj çdo deputetë që ka kërkuar fjalën që të dihet edhe publikisht se kanë kërkuar fjalën... po me shkrim të gjithë dhe protokollohen në procesverbal.

Në qoftë se jemi të pajtimit, i thërras në rend të parë kryetarët e grupeve parlamentare, në qoftë se ka mundësi, të jenë në sallë, që të kem qëndrim. Nga Partia Demokratike e Kosovës, Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për të gjithë,

Kabinetin qeveritar dhe deputetët,

Ne thamë qëndrimin më herët realisht, dhe ne jemi të interesuar që të votohet rezoluta dhe pastaj konform asaj të ndërmarrim vendime të tjera.

Mirëpo i qëndroj asaj çfarë thatë ju në fillim, nëse ndonjë nga deputetët kërkon ta marrë fjalën, atëherë duhet t'i lejojmë, sepse ne e patëm një marrëveshje dhe një grup parlamentar nuk ishte pro asaj. Kështu që tash deputetët duhet të pyeten individualisht a duan ta marrin fjalën apo jo. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, unë mundësi individuale nuk po shoh, ja zoti Topalli tash u lajmërua. Jo, jo, zoti Topalli, je i 23-ti. Mund të propozosh, po jo fjalën ta marrësh se po dal në pozicion të vështirë, mos më keqkuptoni.

Thjesht, si të doni ju e vendosni, po më fal prapë, i nderuar Topalli, mendova se për fjalë. Po, unë ta pyes secilin deputet një nga një, kjo është e pamundur. Më vjen keq, por atëherë duhet të kalojmë gjithë deputetët.

Do t'i lexoj emrat, a ka mundësi t'i lexoj emrat vetëm le të dihen tash sa janë të lajmëruar. Abdyl Ymeri nga fillimi i seancës ka qenë i pari që ka kërkuar fjalën, Selvije Halimi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Adem Grabovci, Safete Hadërgjonaj, Mexhide Mjaku-Topalli, Besim Beqaj, Naim Fetahu, Sala Berisha-Shala, Agim Aliu, Shukri Buja, Nait Hasani, Blerta Deliu-Kodra, Nezir Çoçaj, Bislim Zogaj, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa, Nuredin Lushtaku, Bali Muharremaj, HajdarBeqa. Hajdar, e ke pasur fjalën një herë, ta kesh parasys.

Nuredin Ibishi, Faton Topalli, Fatmir Xhelili, Elmi Reçica. Do të thotë, është një numër, ku së paku edhe katër orë seancë nuk mund ta përfundojmë. U kisha kërkuar mirëkuptim, urdhëro zoti Reçica, menjëherë zoti Topalli e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Kryetar, atëherë në emër të Grupit Parlamentar po kërkoj që deputetët e Grupit Parlamentar të tërheqin fjalën dhe të shkojmë në harmonizim dhe votim të rezolutës.

KRYETARI: Urdhëro, të pyesim edhe nga “Vetëvendosja”, zoti Topalli e ka fjalën. Ok, unë ju kam në evidencë, nuk jam duke ia humbur askujt emrin, urdhëro, zoti Topalli!

FATON TOPALLI: Propozimi im ishte që deputetët, të cilët dëshirojnë ta tërheqin fjalën, le ta tërheqin fjalën dhe kaq, tani është një zgjidhje e çështjes.

KRYETARI: Zoti Topalli, je i vetmi nga Lëvizja “Vetëvendosje” që e ke fjalën, a flet në emër të Grupit Parlamentar apo tëndin.

FATON TOPALLI: Jo, ishte propozim individual.

KRYETARI: Cili është qëndrimi i Lëvizjes “Vetëvendosje”? Në qoftë se fillojmë me një, janë 20 e sa, duhet të gjithë. Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Po, pajtohem të flasim të gjithë, sepse është debat shumë me rëndësi ky dhe duhet ta përfundojnë. Nuk është e thënë që të kryhet sot, në kuptimin e kohës, seanca mund të vazhdojë, mund të nxirret rezoluta edhe nesër. Mirëpo, mendoj që u përket deputetëve individualisht, jo grupet parlamentare që t’ua cungojnë të drejtën deputetëve.

Me sa po e shoh ka mospajtueshmëri edhe prej deputetëve të koalicionit, sepse duan të flasim njerëzit dhe mendoj që t’ua cungosh përmes grupeve parlamentare qëndrimet është e padrejtë. Secili individualisht që do, mund ta dorëzojë fjalën e tij, mirëpo ai që do të flasë, mendoj se është e padrejtë t’ia ndalojmë.

KRYETARI: Ka një pajtueshmëri pozitive-opozitive, Abdyl Ymeri e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

Unë fillimisht paksa jam i shqetësuar me kahun që ka marrë ky debat, sepse ne kemi kërkuar që këtu të diskutohet për vlerat e luftës dhe nuk është mirë që ky debat të shfrytëzohet për t’i akuzuar pikërisht ata që ishin kreatorë dhe ideatorë të themelimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duke quajtur tradhtarë presidentin e vendit.

Nuk është mirë që ne ta godasim vetveten për qëllime krejt të ulëta, sepse kështu nuk ndihmohet në asnjë formë dhe mënyrë për të mbrojtur vlerat sublime të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. I madhi Nol në një vend thotë: “Këtu ambiciet janë pa fre e pa kufi, këtu i padituri i di të gjitha. Këtu tradhtari bëhet patriot dhe patrioti tradhtar”. Mos na tregoni këtu se kush është presidenti

Hashim Thaçi, ne jemi ata që e njohim më së miri, e njohim kontributin e tij për liri dhe çlirim, kurse kontributi juaj është zero ndaj tij.

Nuk mundet askush të fusë përçarje mes nesh dhe në asnjë mënyrë që ta përçajne presidentin, komandantët e luftës dhe familjet e tyre. Jam plotësisht i vetëdijshëm se realizimi i projekteve të mëdha kombëtare e ka çmimin e vet, përpjekjet e pandërprera të qytetarëve të Kosovës për liri dhe çlirim padyshim që kërkuan punë, angazhim, sakrificë dhe mund, por në të njëjtën kohë edhe kurbanet e saj. Të gjithë ata që i vuan shpatullat padrejtësive dhe represionit të vazhdueshëm që po ushtrojnë mbi një popull të pafajshëm ishin të vetëdijshëm se rruga e tyre nuk do të jetë e lehtë dhe, siç thuhet në popull, nuk do të jetë e shtruar me lule.

Ata ishin të vetëdijshëm po ashtu se në këtë rrugë do të ketë plot dhimbje krenare për shokët që do të rralloheshin pas çdo beteje. Në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ishin rreshtuar njerëzit më të devotshëm të këtij vendi, ata do të bëheshin fillimisht një formacion ushtarak më unik që ka njohur historia e konflikteve dhe luftërave në nivel botëror. Ushtria Çlirimtare e Kosovës në fillimet e hershme mbi themelet e rezistencës së saj kishte vendosur parimet më të shëndosha dhe më të pastra konform konventave dhe rregullave ndërkombëtare të luftës.

Caku i vetëm i tyre përgjatë krejt ekzistencës së saj ishte luftimi i aparatit represiv shtetëror, ushtarak e policor që ishte instaluar në Kosovë. Duke iu falënderuar kësaj pastërtie të këtij misioni, të kësaj kauze, Ushtria Çlirimtare e Kosovës arriti që të rritet, të masivizohet dhe të fitojë simpatinë dhe mbështetjen e gjerë në Kosovë.

Falë zhvillimeve në terren dhe falë konstruktivitetit që kishte dëshmuar në vazhdimësi UÇK-ja me njerëzit që po udhëhiqnin arritën që të bëhet partnerë me shtetet më progresive perëndimore që t'ia meritojnë e ta kenë mbështetjen e organizatës më të madhe botërore për siguri, NATO-s. Struktura udhëheqëse e UÇK-së, me njerëzit, të cilët kishin qenë shembull më të mirë të sakrificës dhe vetëflijimit, pas përfundimit të luftës u bënë shembulli më i mirë në shërbim të vazhdimit të proceseve, në rindërtimin e vendit dhe në shtetndërtimin.

Prej vitit 1999 e deri sot ndaj komandantëve dhe ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vazhdimësi u zhvillua një fushatë e përndjekjes, e gjykitimit dhe paragjykitimit të tyre dhe luftës së tyre të drejtë, të cilin e kishin zhvilluar. Ata pandërprerë ishin pjesë e proceseve gjyqësore, të konstruktura keq dhe të ndërtuara mbi dëshmi të dëshmitarëve jokredibilë. Në shërbim të mospërzierjes dhe mosndikimit në drejtësi shpesh u detyruam të bëhemi të verbër e të shtiremi të shurdhër përballë këtyre padrejtësive, të cilat sikur nuk kanë të ndalur.

Padyshim që jemi për hetime dhe ndëshkime të të gjitha shkeljeve dhe krimeve që kanë ndodhur kudo, por në asnjë formë nuk mund të pajtohemi me tendencën për barazim të krimit. Nuk ka peshore që mund të vendosë baraspeshë mes krimeve monstruoze dhe gjenocidiale që janë

ushtruar nga aparati represiv serb në luftën e pastër si loti të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të ushtarëve dhe të komandantëve të saj. Prandaj, njëherë e mirë duhet të ndalen përpjekjet për përbaltje, etiketime dhe përdhosjen e vlerave, të cilat janë ngritur mbi kontributin e pakompromis të njerëzve, të cilët u vetëmohuan për një ideal kundër robërisë e prangave.

Duke u prangosur çlirimtarët nuk do të prangosen asnjëherë lavdia dhe krenaria që kanë qytetarët e Kosovës për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si vlerë shpirtërore dhe monumentale. Nëse shikohet nga perspektiva e sotshme, në debate të ndryshme në diskursin tonë publik, edhe te analistët, opinionistët e po ashtu edhe te politikanët, sidomos në këtë kohën e fundit më ka rënë të dëgjoj më shumë duke përdorur termin “shtet ligjor”, e shumë rrallë, për të mos thënë fare, përdorimin e termit “shtet i së drejtës”. Kjo në shikim të parë mund të duket e parëndësishme, por në fakt, ka një dallim të madh ndërmjet shtetit të së drejtës dhe shtetit ligjor, sepse edhe regjimet totalitare janë shtete ligjore, por janë jo të drejta.

Një shtet i drejtë dhe me një perspektivë për të gjithë ka qenë synim dhe mision i çdo luftëtari të lirisë dhe popullit të Kosovës. E po ashtu ka qenë dhe mbetet dëshira më e madhe e popujve dhe mendjeve të ndritura për një shtet të së drejtës, shtrohet pyetja pse? Sepse: “Drejtësia është lidhur me lirinë dhe një popull që nuk arrin të bashkojë lirinë me drejtësinë, është i humbur në gjithçka”, shkruante Kamy. Ne ndodhemi sot pikërisht në këtë dilemë: a do të arrijmë që ta harmonizojmë lirinë me drejtësinë? Pas luftës së fundit dhe pavarësisë së vendit pritjet e qytetarëve ishin të mëdha, sepse kishim një mbështetje dhe përkrahje të fuqishme ndërkombëtare në të gjitha fushat.

Sot, pas gjithë këtyre viteve të pasluftës dhe pas vendimeve të fundit të Gjykatës së Apelit për grupin “Drenica 2”, me të drejtë qytetari ynë po pyet: Çfarë shteti të së drejtës po ndërtojmë? A është ky shteti i pavarur i ndërtuar pas përpjekjeve shekullore dhe sakrificave të shumta të gjeneratave e gjeneratave dhe të kurorëzuar me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe komandantit të saj legjendar Adem Jashari dhe i përkrahur nga miqtë tanë ndërkombëtarë?

Pse ka aq shumë pyetje, aq shumë dyshime dhe aq shumë dilema? Këto ditë rreth këtyre vendimeve dikush këtu dhe gjithandej mund të thotë se nuk është mirë të komentohen dhe të debatohen për këto vendime sepse mund të konsiderohet si ndërhyrje në sistemin e drejtësisë. Është e kuptueshme se pushtete janë të ndara, por në këtë Kuvend shpesh nga deputetët më ka rënë të dëgjoj se flasin në emër të popullit dhe kur flitet në emër të popullit, natyrisht flitet edhe për sistemin e drejtësisë dhe për të gjitha fushat që janë në interes të popullit.

Merrni materialet në ueb faqen e EULEX-it dhe shikoni aktvendimet që janë marrë në emër të popullit dhe për laikët e drejtësisë, e mos të flasim për ekspertë të fushës së drejtësisë, do të shohim se janë cenuar rëndë elementet bazë të drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës për një gjykim

të drejtë dhe të faktuar. Për mua dhe, besoj, për shumicën e qytetarëve është shqetësuese se si me supozime, pa fakte dhe pa argumente konstruktohen raste të tilla të pabazuara në prova materiale kredibile dhe dëshmi të një personi apo dëshmitari jokredibil.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e zhvilluara, me gjithë procesin e gjykimit të Sylejman Selimit, komandant të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Sami Lushtakut, komandant i Shtabit të Zonës Operative të Drenicës me vendim në shkallën e parë, vëllezërve Demaku e Demaj dhe Hysni Thaçit po shihet se po zbehet dhe po zvogëlohet në masë të madhe besimi në sistemin e drejtësisë, e kjo bazohet edhe deklaratimet e shumta të ekspertëve të fushës së drejtësisë, të cilët thonë se kjo që ka ndodhur në këtë rast nuk ka ndodhur askund në botë. E, unë po besoj se nuk ka ndodhur as në vendin e atyre që e kanë marrë vendime të tilla, sepse nuk ka prova të mjaftueshme që grupi i “Drenicës” të dënohet.

Kjo praktikë e të gjykuarit për të bërë dhe krijuar baraspesha nga ata që kryen krime, si shteti serb që asnjëherë nuk u gjykuan për masakrat e kryera anembanë Kosovës, si dhe tendenca e baltosjes së luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo tendenca për t’i larguar nga skena politike nuk është e pranueshme, është e padrejtë dhe nuk do të duhej të instalohet këtu, sepse në emër të drejtësisë po përfetojmë në padrejtësi të madhe dhe po rrezikojmë vlerat mbi të cilën është ndërtuar shteti ynë.

Unë do ta përfundoj fjalimin tim me një deklaratë të Sami Lushtakut, i cili para trupit gjykues tha: “I nderuar trup gjykues, ne një atdhe kemi, Kosovën, dhe po të jetë nevoja prapë do të luftojmë dhe sakrifikohemi për të. Nuk jam vrasës, por çlirimtar. Mos na gjykoni pse ishim udhëheqës të UÇK-së, më jepni vetëm një fakt dhe emrin se unë paskam vrarë dikë civil, atëherë më dënoni jo 12 vjet burgim, por kërkoj dënim kapital”.

Ne fuqishëm besojmë në pafajësinë e komandantëve dhe luftëtarëve të lirisë, sepse lufta e lavdishme e UÇK-së ishte e drejtë dhe e pastër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bali Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Të nderuar qytetarë,

Ai që e harron luftën, nuk di ta nderojë lirinë dhe ta mbrojë pavarësinë. Mjerë familjet e dëshmorëve, luftëtarë të vërtetë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mjerë historia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në dorë të kujt ka rënë Kosova. Pse nuk është bërë kurrë asnjë veprim nga shteti ynë që do të dëshmonte pastërtinë e luftës tonë, pa pasur nevojë të gjykohen e të dënohen komandantët, luftëtarët e fronteve për lirinë dhe pavarësinë e vendit? Këto dënime që

po ndodhin sot janë si pasojë e gabimeve, lëshimeve, por edhe abuzimeve të këtij pushteti dhe të atij paraardhës.

Krejt këto gabime po i faturohen Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, vlerave të luftës që sublimohen në dëshmorët dhe invalidë të asaj lufte. Kosova nuk duhet të paguajë edhe më tutje çmimin të qenit stabil i Ballkanit. Këto vendime po rrezikojnë diçka tjetër, që Serbia të marrë zemër e prapë nesër të na marrë, të na pushtojë, sepse askush nuk e gjykon për veprimet që i bëri deri në vitin 1999, kur ka bërë hapur në Ballkan, duke e kthyer në një kasaphanë, por edhe pas vitit '99 duke financuar grupet kriminale, për të mos lënë të qetë asnjë shtet, të cilët për 100 vjet i ka sunduar.

Lufta për liri është e shenjtë, do të mbetet e tillë gjithë jetën, e ju sa të doni na dënoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuredin Ibishi, nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar ish-bashkëluftëtarë,

Përfaqësues të mediave dhe qytetarë,

Së pari, s' desha të marr fjalën, mendova pasi që edhe debati devijoi nga vetë kuptimi dhe me qëllim të marrjeve të disa përfundimeve për të krijuar rezolutën, por sido që të jetë, pasi që shumica u përcaktuan për fjalë, edhe unë dua që fillimisht t'i referohem rezolutës për luftën çlirimtare të Kosovës, Kuvendit të Kosovës, domethënë për liri dhe pavarësi miratuar më 15.05.2003, nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, e cila përcakton se lufta e popullit të Kosovës për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës në të gjitha fazat dhe format e zhvillimit të vet nga lufta politike, rezistenca paqësore dhe lufta e armatosur, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ka qenë luftë e drejtë për lirinë e vendit dhe për një shoqëri moderne dhe demokratike.

17 vjet pas çlirimit të Kosovës, 8 vjet nga pavarësia e Kosovës dhe 13 vjet nga miratimi i kësaj rezolute ekzistojë perceptimi se pas gjithë këtyre proceseve ndaj çlirimtarëve si në vend, po ashtu edhe jashtë vendit, sikur po zbehen edhe vlerat e mirëfillta të luftëtarëve të lirisë. Edhe sa procese duhet të ndërmerren ndaj pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës deri te fillimi i punës së Gjykatës Speciale, e krijuar enkas për drejtësi selektive, për t'i përndjekur krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për luftën e drejtë për liri dhe injoruan të gjitha ato krime më makabre serbe ndaj popullatës civile shqiptare në Kosovë.

Pas gjithë këtyre proceseve të përfunduara shtrohet pyetja se a do të ri procesohen rastet e gjykuara deri tash ndaj pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Gjykatën Speciale në Hagë? Autoritetet përgjegjëse pas pavarësisë së Kosovës lëshuan mundësinë e krijimit të Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale për krime të luftës në Kosovë, sikur që u veprua në disa shtete

të dala nga lufta. Deri kur do të funksionalizohen institucionet gjyqësore në Republikën e Kosovës, të cilat duke respektuar sovranitetin e vendit dhe vlerat e përcaktuara kushtetuese e të mos mbetemi në varësi të vazhdueshme të gjyqimit të rasteve nga prokurorët dhe gjykatësit ndërkombëtarë.

Edhe sa kohë do të eksperimentohet me drejtësi në Kosovë nga drejtësia transicionale me qëllim të vendosjes së drejtësisë për paqen deri te drejtësia selektive për të gjykuar rastet e krimeve të pretenduara të pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Gjykatën Speciale në Hagë? Duke pasur parasysh se vendimet e gjykatave për krime lufte lënë pasoja të shumta si në vlera të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po ashtu edhe ndaj vetë individëve të përfshirë në to, e gjithë kjo i obligon ato që seriozisht t'i trajtojnë lëndët, e me këtë edhe provat.

Duke iu referuar rastit konkret, domethënë rastit “Drenica 2”, si në vendim përfundimtar mendoj se duhet shfrytëzuar edhe mundësinë e fundit të mbrojtjes së ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë, i kemi edhe 18 deputetë për të folur në sallë, ndërkohë kemi një draft-rezolutë. Gëzim Kelmendi, a është këtu? Atëherë, janë 17 deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës.

Kisha kërkuar mirëkuptim, në qoftë se pajtohen deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës, të përgatiten për draftin e rezolutës. Fjalimet t'i dorëzoni në sekretari, ose nëse doni të insistoni të flisni secili, mund të flisni. Atëherë, a e mbyllim, apo të flitet ende a?

Kisha kërkuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së të ma jap një përgjigje ta di, një konsultim 1-2 minuta me grupin parlamentar, në qoftë se nevojitet, e ke.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ne edhe më herët kishim një kërkesë që të takohemi dhe të bëjmë një rezolutë, edhe të anashkalojmë debatin që ishte në atë frymë. Ishte kërkesë e opozitës, nëse nuk ka deputetë të opozitës, ne mund të shmangemi pak, të kërkojmë të harmonizojmë një tekst të rezolutës dhe të shkojmë në votim.

KRYETARI: Atëherë, zonja Deliu-Kodra, po e shoh reagimin tuaj, urdhëro!

BLERTA DELIU-KODRA: Kryetar, nuk është kërkesë vetëm imja, po edhe e kolegëve të mi të Grupit Parlamentar, të cilët kanë qenë nismëtarë të këtij debati parlamentar.

Neve na është shfrytëzuar koha prej kolegëve të tjerë, kanë folur më gjatë, por keni mirëkuptim, sepse edhe ne kemi qëndrimin tonë karshi kësaj çështjeje.

KRYETARI: Unë e thashë dhe po e ripërsëris, derisa dëshiron deputeti i fundit, do të flisni, ju vendosni atëherë. Unë e kam listën para, a lëvizim në bazë të ngritjes së dorës të diskutohet, apo të shkojmë në bazë të radhitjes. Zonja Selvije Halimi është në radhë, përgatitet zonja Luljeta Veselaj-Gutaj.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

E di se u bë gjatë duke folur, e di se kishte momente kur mendoja të flisja a të mos flisja për shkak të devijimeve në debat. Mirëpo, devijimet erdhën për shkak të faktit që për një periudhë të gjatë kohore nuk janë zhvilluar debate dhe si duket njerëzit ishin të etur të flasin edhe gjëra të pavërteta në Kuvend për të njollosur.

Të nderuar qytetarë,

UÇK-ja nuk u shpik nga qielli, as nuk piku nga qielli. UÇK-ja buroi nga populli. Edhe shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk piku nga qielli.

KRYETARI: Zonja deputete, kërkoj falje, veç një moment, kërkoj falje në ndërprerje. Po e shoh kryetarët e grupeve parlamentare po kërkojnë të zhvendosen për draft-rezolutën, ndërkohë që vazhdojnë diskutimet, veç të harmonizojnë qëndrimet.

Kisha ftuar kryetarët, përkatësisht përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të shkojnë në harmonizimin e draft-rezolutës. Nga Partia Demokratike e Kosovës kush është? Më fal, zonja deputete, e vazhdon menjëherë. Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Nga Partia Demokratike, zoti Elmi Reçica do të jetë në grupin që do të harmonizojë rezolutën.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës? Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Nga Grupi i Lidhjes Demokratike të Kosovës do të jetë deputeti Agim Kikaj.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lëvizja “Vetëvendosje”?

GLAUK KONJUFCA: Do të jem unë.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Pal Lekaj do të jetë, shef i grupit parlamentar.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Nisma”?

FATMIR LIMAJ: Zafir Berisha do të jetë nga ne.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë kisha ftuar grupin, në qoftë se e konsiderojnë të domosdoshëm për të qëndruar në seancë s'mund t'ua imponoj që të largohen, por në qoftë se dëshirojnë, të largohen dhe ta harmonizojnë draft-rezolutën.

Nga "6+" nuk e pashë asnjë, në qoftë se është dikush nga "6+" do t'i bashkëngjitet, u bëj thirrje publike. Zonja SelvijeHalimi, fjala për ju, kërkoj falje për ndërprerje.

SELVIJE HALIMI: Ju lutem! Pavarësia e këtij vendi u bë, apo pavarësia e Kosovës u shpall në emër të popullit. Po në emër të popullit, në emër të vlerave të demokracisë, në emër të fjalës së lirë, në emër të lëvizjes së lirë, në emër të drejtësisë, a di kush t'i japë përgjigje vetes apo njëritjetrit se çfarë po ndodh në Kosovë?

Qoftë me periudhën e luftës, qoftë me periudhën shekullore të familjeve, të cilat sakrifikuan për pavarësinë e Kosovës, për lirinë e qytetarëve të saj. UÇK-ja, vlerë e më shumë se vlerë, shembull unik i të gjitha sistemeve të organizuara shoqërore ndër popuj në botën kombëtare e ndërkombëtare. Kur e them këtë, kam parasysh faktin se UÇK-ja sublimoi në vete dhe futi nën ombrellën e saj sakrificën shekullore të një populli, që historia u bëri padrejtësi të mëdha. Pa dashur të ndalem në elaborime historike, u drejtohem qytetarëve të tërë botës demokratike, një familje rritet, zhvillohet, arsimohet, edukohet dhe kryen obligimet morale e ligjore në raport me shoqërinë, madje edhe sakrifikohet për popullin e vet, sepse e do shoqërinë, njerëzimin dhe lirinë.

Në Kosovë familja është e tillë dhe do të jetë e tillë, edhe përkundër tendencave që t'i jepet koncept tjetër. Të nderuar, deri në çlirimin e Kosovës familjet tona ishin vetë shteti ynë, e sakrifikuan veten dhe familjet tona për të çliruar dhe për të bërë shtetin. Qendra e vendosjes në BE të mos harrojë për asnjë moment për padrejtësitë që iu bënë në territorin evropian të saj, për padrejtësitë që iu bënë një populli evropian. Andaj, të korrigjojë gabimet e veta në raport me Kosovën dhe popullin e saj, sepse mjaft u sakrifikuam që ju të jeni Evropë në Kosovë, të jeni në vendin tonë dhe së bashku me ne ta bëjmë shtetin e Kosovës.

Faleminderit për përkrahjen, por edhe njëherë tërheq vëmendjen, kujtoni si vendosni, si i ruani familjet dhe njerëzit tuaj, si vendoset drejtësia në vendet tuaja, pastaj ndërmerrni veprime këtu. Faleminderit SHBA për përkrahjen e sinqertë që po bëni!

Të nderuar, qysh në vitin '99 nëpër rrugët e Prishtinës qarkullonin të shkruara fjalët: "5 mijë marka, një informatë në UNMIK", askush nuk dinte se për çfarë informate thuhej. Një informatë të tillë, një shkrim të tillë e kam përcjellë në '99-ën për 11 ditë rresht në lagjen ku unë banoj, në Dardani. Në ditën e 12 kam dalë e kam fshirë vetë, nuk pata vërejtje prej askujt as pse e fshiva,

as nuk mora shpjegim prej askujt se për çfarë deklaratash dhe informatash ishte kjo shkresë. Të nderuar, u bënë deponime e mbi deponime, pa ditur kush për çka dhe për kënd, vetëm që ato në një moment të caktuar historik për vendin të përdoren kundër njëri-tjetrit, por kush i bëri deponimetne ende nuk dimë, ne ende nuk kemi fakte që të flasim, por po e dimë që po dënohen ata që themeluan UÇK-në, ata që luftuan për çlirimin e këtij vendi.

Të nderuar, në emër të lirisë së fjalës nuk ka portal, nuk ka media, nuk ka gazetë, nuk ka revistë që për çdo ditë ka diçka jo të mirë për UÇK-në, për periudhën e lavdishme të popullit tonë. Çfarë lirie e fjalës është kjo? Në emër të lëvizjes së lirë askush nuk di çka po ndodh në Kosovë, sot e 17 vjet. Në emër të paqes me një popull që luftuam, sepse na okupoj, nuk mund të dënohen të gjithë ata që luftuan kundër atij populli. Nuk mund të dënohet një popull i tërë.

Të nderuar, kemi shumë media, kemi edhe një televizion publik, a thua, a mund të ndalemi dhe të bëjmë një analizë se sa flitet për familjet tona atdhetare, për idealin tonë për të çliruar këtë vend dhe këtë popull. Shfrytëzoj rastin që sot në këtë debat t'u bëj ftesë të gjithëve që të kërkojmë nga mediumet publike, sidomos atyre që kanë përgjegjësi publike dhe financohen nga buxheti i Kosovës, në emisionet e tyre të flitet për ndjenjën atdhetare, për sakrificën e popullit, sepse vetëm kështu mund ta forcojmë edhe më tej demokracinë. Nuk e lëndojmë askënd, por duhet në vazhdimësi të tregojmë publikisht kush jemi, çka jemi, çka duam dhe si punojmë.

Sepse, kështu do të vazhdojmë të jemi shembull unik. Ishim shembull se si një popull kaq i lashtë në Evropë gjatë gjithë historisë nuk u çmendëm nga padrejtësitë dhe persekutimet që na u bënë, nuk u asimiluam, nuk u zhdukëm. Dhe sot, nuk guxojmë të lejojmë që në emër të drejtësisë të jemi shembull i padrejtësive. Unë jam juriste me profesion, diskutimi im nuk prek vendimet e gjyqësorit, por e di se vendimet në cilëndo instancë, në cilindo institucion dhe në gjyqësi merren po në emër të popullit, por vërtet për të vënë drejtësi.

Askund nuk jepet dënim në joproporcionalitet me dënim e shkaktuar. Askund nuk jepet dënim pa fakte, pa prova, pa dëshmi të vërtetuara dhe kjo nuk guxon të ndodhë në Kosovë, kjo nuk është ndërhyrje në drejtësi. Kjo është t'i bëjmë me dije të gjithë njerëzit, qofshin ata vendorë apo ndërkombëtarë, që drejtësia duhet të shihet vërtet drejtësi mbi bazën e parimit dhe të transparencës edhe të ligjit, edhe të gjithë të barabartë para ligjit.

Por, jo të vendoset kështu çfarë po ndodh kohët e fundit. Nuk kemi ne vetëm një rast të dënuar për luftën. Në qoftë se kjo UÇK doli nga populli, atëherë me çdo vendim në emër të drejtësisë po dënohet një popull në Kosovë dhe kjo nuk tolerohet. Në qoftë se nesër dikush do të studiojë dhe do të nxjerrë teza se si është vendosur drejtësia në Kosovë, të jeni të bindur që edhe vetë bashkësia ndërkombëtare, po edhe ne vetë do të dalim kokulur, sepse po dalim një shembull jo i mirë për botën demokratike.

Nëse ka demokraci, duhet të ketë vërtetë drejtësi, nëse duam shtet, ai duhet të jetë ligjor, por duhet të shfrytëzohet ligji dhe të vendoset mbi bazën e parimit të fakteve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Luljeta Veselaj-Gutaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është bërë gjatë duke diskutuar, kohë pas kohe filluan kolegët opozitarë të humbin edhe kuptimin e debatit, për çka ne sot ishim thirrur për të diskutuar.

Në të gjitha vendet ku u zhvillua lufta për ideal, për të drejtat e lirisë dhe pavarësisë, vlera më sublime e asaj shoqërie ishte dhe janë çlirimtarët. Rrjedhimisht, në shoqërinë tonë po ndodh e kundërta, pra sot më shumë gjykohe, dënohe, shantazhohen, përgojohen, e nënçmohen çlirimtarët se sa ata të cilët bënë gjenocid. Ata të cilët masakruan popuj me radhë në Ballkan, po ashtu edhe popullin e Kosovës. Pra, ky është një fenomen që mund të quajmë “sui generis” që po ndodh në shoqërinë tonë.

Vendimet e shpallura ndaj grupit “Drenica” jo vetëm që janë shqetësuese dhe të dëmshme për Kosovën, por po e thyjnë motivin më të vogël për një jetë normale në shoqërinë tonë. Këto ngjarje na kanë tronditur, kanë tronditur edhe themelet e atyre të cilët ishin të gatshëm kurdoherë të japin gjithçka, edhe jetën e tyre, vetëm e vetëm për të qenë të lirë. E kam thënë edhe këtu në Parlament, e kam thënë edhe në Bruksel në Parlamentin Evropian, konkretisht kam cekur “Rastin e Drenicës” se çlirimtarët janë duke u nënçmuar, çlirimtarët janë duke u ofenduar. Është duke u përpjekur që të preket dinjiteti dhe kjo nëpërkëmbje e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk po duket që është një zhvillim në mjegull, por këtu është diçka e planifikuar në mënyrën më të keqe të djallëzuar.

Kosovën e shkatërroi dhe e masakroi Serbia, sot ende nuk dimë për fatin e mbi 1600 trupave të pagjetur nga masakrat që ndodhën në luftën e fundit si: masakra e Suharekës, masakra e Krushës së Madhe, Krushës së Vogël, masakra e Tusuzit në Prizren, masakra e Tërrnjes, masakra e Izbicës, masakra e Dubravës, masakra e Prekazit, masakra e Reçakut, masakra e Rezallës, masakra e Rugovës së Hasit, masakra e Luginës së Hasit, e Studimes, masakra e Qyshkut, masakra e Mejës dhe anembanë Kosovës, dhe ne ende nuk na dha dikush përgjegjësi, qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare për atë çfarë ka bërë Serbia në Kosovë.

Gjithçka në korniza njerëzore e ka limitin e vet, edhe atëherë kur prekët shtresa më me vlerë e shoqërisë nuk mund të jem e kënaqur dhe nuk më bën përshtypje a jam e lirë të shkoj qoftë në Bruksel apo në NewYork, e as që me nevojitet. Andaj po kërkoj që drejtësia të jetë e drejtë, e

bazuar në fakte reale dhe jo në fakte imagjinare dhe të inskenuara, siç ka ndodhur në shumë raste dhe tani kemi rastin më të freskët konkret, rastin “Drenica 2”, ku akuzohet një familje e tërë, terrorizohet një familje e tërë, të cilët luftuan, sakrifikuan, e vunë jetën e tyre për Kosovën e lirë dhe sot terrorizohen, inskenohen nga njerëzit, të cilët me imagjinatën e tyre për përfitimet e tyre personale, mashtruese, shkojnë dhe dalin si dëshmitarë mashtrues.

Ne për çdo ditë po përjetojmë ndjenjë jo të mirë, besoni që sot më kryelartë për këtë liri po ecin ata, të cilët jo që nuk kontribuan asgjë për këtë ditë, por që e kanë dëmtuar në atë kohë dhe po e dëmtojnë përditë e më shumë se sa ata të cilët dhanë jetën, ata të cilët dhanë gjymtyrët e trupit dhe ata të cilët e derdhën gjakun për këtë liri. U potencua gjatë diskutimeve që deputetët e Partisë Demokratike kanë votuar Gjykatën Speciale, dhe unë jam një nga ata të cilët e votova Gjykatën Speciale. E kam thënë arsyetimin në foltoren e Kuvendit pse e votoj këtë gjykatë dhe do ta potencoj edhe sot: kam votuar duke besuar në institucionet gjyqësore ndërkombëtare, në një drejtësi që bazohet në fakte dhe dëshmi të vërtetuara, por jo në dëshmi të ndikuara nga dëshmitë armiqësore dhe të fabrikua me motive politike ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Jo me dëshmitarë të fabrikuar, me dëshmitarë, të cilët si pikë të parë kanë interesin personal, interesin përfitues, pa fakte dhe njerëz intrigantë. E kam votuar për t’i treguar botës se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte luftë e drejtë dhe që e ka respektuar çdo normë ndërkombëtare dhe nuk mund të përballojmë përbaltjen dhe nëpërkëmbjen e vlerës sonë të shenjtë dhe historike.

Mos harroni se Ushtria Çlirimtare e Kosovës është historia e kombit tonë me sukseset më të mëdha që kanë ndodhur ndonjëherë për lirinë e popullit. Këta çlirimtarë janë pasuria jonë më e madhe dhe ne sot jemi me fat, që jetojmë në kohën e njëjtë me ta. Ky trend i zhvillimeve më bën të ndjehem shumë e dobët, për çfarë më japin të drejtën e plotë të gjykoj se shteti im Kosova vërtet është shtet “sui generis” për Evropën, se ata e trasuan të identifikohet kështu, por asnjëherë ne nuk do të dorëzohemi pa e bërë Kosovën shtet me dinjitet. Çlirimtarët na e sollën lirinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

E di që është bërë vonë, por ne dëgjuam shumë gjatë kritikën e kolegëve opozitarë, kritika të pabaza për mua. Dëgjuam edhe ata që këtu në Parlament e mbrojtën UÇK-në dhe unë po e them seriozisht që sot ndjehem shumë keq. Ndjehem keq, për faktin se Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk mund të mbrohet nga të tillë, prindërit e të cilëve kanë dënuar me 27 vjet burg Adem Demaçin, simbolin e rezistencës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kur babë e babagjysh i kanë luftuar idealet e tyre, kanë rrahur dhe burgosur bashkëveprimtarët e tij. Qysh mund të flet dikush për bashkim kombëtar, kur babë e babagjysh i ka pasur jugosllavë. Ku e merr guximin Albin

Kurti ta quajë dikë tradhtarë, ta quajë dikë pro-serb, kur vet është falur nga shteti serb, derisa Ukshin Hoti e plotë ushtarë të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk dihet ende për fatin e tyre. Kur zëdhënësi i Milosheviqit i organizonte konferencat për medie në burg në mes të luftës gjenocidiale, ku e merrte guximin Albin Kurti të jetë aty dhe sot të flasë për UÇK-në. Ku e merr Albin Kurti guximin të flasë kundër Bashkësisë Ndërkombëtare, kur është babai i tij ai i cili ka punuar në UNMIK. Ku e marrin guximin anëtarët tjerë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, që sot t’i përmendin shkronjat e arta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe baballarët e tyre të jenë miq dhe kumbarë të kasapit të Milosheviqit.

Nëse vlerat e Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë mbetur të mbrohen nga deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje”, atëherë unë sot nuk kam çfarë të komentoj këtu.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës mbrohet nga ata që e themeluan, mbrohet nga ata që e ngritën me forcën më të suksesshme të shekullit, mbrohet nga vetë qytetarët e Kosovës, që e mbështetën atë. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të mbrohet nga shteti i Kosovës, që u ndërtua me gjakun dhe me sakrificën e atyre që sot nuk janë me ne. Prandaj, ata që sot janë kundër shtetit të Kosovës, ata që sot janë kundër institucioneve të Kosovës, ata që sot gjuajnë me “zallë” institucionet e Republikës së Kosovës, ata që janë kundër Amerikës, që janë kundër Bashkimit Evropian, ata nuk mund ta mbrojnë UÇK-në.

Zoti Selimi, ju edhe mund të qeshni sot dhe unë dua të them, se...

KRYETARI: Zonja deputete... Zoti Selimi, e dëshiron fjalën? Me pas kujdes pak, pasi që është zonjë, e kam për...

BLERTA DELIU-KODRA: ...një pjesë e anëtarëve të Lëvizjes... një pjesë e anëtarëve... ju e dini mirë, zoti Rexhep Selimi, që ju keni qenë bashkë me familjarët...

KRYETARI: Zonja Deputete!

BLERTA DELIU-KODRA: ... e mi në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bashkë me Ilaz Kodrën, dhe unë sot turpërohem se si mund të qëndrosh në afërsi të atyre, të cilët po gjuajnë, po tmerrojnë, po shkatërrojnë institucionet e vendit dhe po atribuojnë akuza në institucionet më të rënda, duke fabrikuar akuza në drejtim të ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ky eksperiment është kundër vetë ligjit të natyrës. Qytetarët e dinë mirë kush ka qenë për bashkim edhe në kohën e Pashiqit, edhe në kohën e Rankoviqit, edhe në kohën e shokut Tito, edhe në kohën e Milosheviqit. Një pjesë e madhe e juaja kurrë, madje kurrë, nuk mund të jetë pasardhës biologjik e as mbrojtës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Po kaloj tek vendimi i fundit, i nderuar kryetar, meqë ne si deputetë të Drenicës kemi marrë nismën që bashkë me kolegët tanë parlamentarë të thërrasim këtë debat, unë konsideroj se vendimi i fundit për rastin “Drenica”, mendoj se është njëri prej vendimeve më të rënda dhe unë sot i kuptoj plotësisht familjet të cilat po ndjehen jashtëzakonisht rëndë. Si deputete, por edhe si familjare, po ndjehem shumë e prekur me standardet e dyfishta që po aplikohen në gjykimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të krerëve të saj.

Dua të them se Drenica ka qenë dhe do të jetë gjithmonë në rrugën e lirisë dhe të ndërtimit të shtetit.

Konsideroj, se sot u thanë shumë gjëra që nuk kanë pasur nevojë të thuheshin dhe për të cilat është dashur që të informohen qytetarët, jo pse këto gjëra nuk janë ditur më herët, por sepse kohën e fundit ka nisur një fushatë e rëndë linçuese ndaj udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me përpjekjen e qartë për ta shtrembëruar realitetin e krijuar së fundmi.

Ka një tendencë të hapur të inkriminimit të luftës së UÇK-së, duke u munduar të tërhiqen paralele ndërmjet luftës mbrojtëse të UÇK-së dhe të agresorit serb. Është absurdi më i madh, që ish-ushtarët e UÇK-së të denoncohen me dëshmitarë që janë inekzistent dhe të persekutohet një familje e tërë për luftën mbrojtëse që e bëri.

Dhe, me plotë të drejtë e tha zoti Limaj këtu, që akuzat janë trefish më të mëdha në raport me serbe, do të thotë shqiptarët për të cilët janë ngritur akuza për krime lufte deri në vitin 2014 kanë trefish akuza më shumë, se sa serbët. Janë 62 shqiptarë dhe vetëm 22 serbë. Janë 1 0495 viktima shqiptare të luftës, në mesin e tyre gra, burra e fëmijë, janë 20 000 gra të dhunuara, mbi 1 600 të pagjetur dhe kriminelët serbë po glorifikohen, po shpërblehen nga vetë shteti serb.

Për mua, për qytetarët e Drenicës, për votuesit e mi, për Kosovën time, Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të mbetet vlera më e madhe, vlera më sublimë që ka krijuar ky popull. Dhe, nuk do të ketë proces gjyqësor, sado i rëndë që të jetë ai, që mund ta zbehë kontributin e madh të atyre djemve dhe vajzave, që dikur dhanë gjithçka për lirinë e Kosovës.

Akuzat e padrejta nuk do ta zbehin gjithë përkushtimin e tyre. Sylja, Samiu, Nexhati, Fadili, të gjithë bashkëluftëtarët tjerë mund edhe të dënohen, por ata do të vazhdojnë të mbeten heronjtë e shtetit të Kosovës. As lufta, as çlirimi i vendit, as pavarësia, as ndërtimi i shtetit ligjor, nuk do të mund të bëhej pa ata.

Këta djem nuk janë fshehur e frikësuar asnjëherë nga e vërteta, por janë ballafaquar gjithmonë me fakte dhe argumente, duke dhënë shembullin më të mirë të respektimit të institucioneve, për të cilat ata punuan shumë. Këta djem të Drenicës, bashkë me shumë shokë të idealit anekënd Kosovës, kishin filluar organizimin shumë herët, atëherë kur kishte filluar dhuna, kur kishte

filluar represioni, mbyllja e shkollave, kur djemtë dhe vajzat më të mira të këtij vendi dhe nënat shqiptare prisnin në arkivol djemtë e tyre të vetëm, të cilët ktheheshin nga ushtria. Edhe atëherë, të nderuar kolegë deputetë, ka pasur shqipfolës, që çonin projektet përpara, projektet e kasapit të Ballkanit, Milosheviq, shqipfolës të cilët u angazhuan shumë për të ndërtuar kisha mu në zemër të Universitetit të Prishtinës, në kampusin e Universitetit të Prishtinës, aty ku ishin mbyllur dyert për djemtë, për vajzat, që donin të mësonin në gjuhën e tyre. Dhe, janë po ata shqipfolës, të cilët sot po thonë se frikësohen se Kosova mund të kthehet në Serbi. Kur shokët e idealit kishin kapur armët për të mbrojtur vendin e tyre, disa politikanë, që janë sot në këto... në këtë sallë të Kuvendit, shtyheshin se kush do të përfitojë i pari bursat e Sorosit, të cilat ndaheshin në Bullgari dhe në shtetet e Rajonit.

Dhe, këtu unë pajtohem përsëri me zotin Limaj, që e tha më herët, se në mesin tonë ka të atillë që duan të mos na shohin më, që duan të përmbysin gjithë atë kthesë të lavdishme që e bëri Ushtria Çlirimtare e Kosovës, gjithë atë kthesë historike që e bënë djemtë, që e bënë vajzat e UÇK-së bashkë me partnerët, bashkë me miqtë ndërkombëtarë. Ka edhe të atillë, të cilët në këto salla, pa fije turpi, drejtuan gishtin e tyre dhe na quajtën kriminelë, na quajtën dhunues dhe, harruan ata deputetë se kriminelë ishin ata që na vranë e masakruan e jo ata të cilët na mbrojtën.

Nuk u ndalën me kaq, por ultë, ultë, të nderuar kolegë deputetë, fabrikuan akuza që ishin pjellë e poshtër e imagjinatës së tyre, vetëm e vetëm për të luftuar rivalët e tyre politikë, me lloj-lloj shpifjesh dhe të pavërtetash. Këta patriotë të pasluftës patriotizmin është dashur që ta shesin atëherë kur ka qenë koha, atëherë kur pjesa dërmuese e qytetarëve të Kosovës, të këtij vendi shqiptar, kanë vuajtur dhe janë bërë pjesë e të gjitha zhvillimeve politike për të çliruar njëherë e përgjithmonë këtë vend, për të fituar lirinë e shtetit të Kosovës. Secili nga ne në këtë sallë i kemi historitë tona të trishta, kush më pak e kush më shumë. Dikush ka humbur familjar, ka të tjerë që kanë ende të pagjetur, ka shumë e shumë e shumë trupa që ende nuk janë kthyer në familjet e tyre dhe familjarët ende janë në pritje, por jam e bindur se me gjithë këto, s'do të ketë forcë që mund ta njollosë luftën e drejtë që e kanë bërë këta djem. Tentativat e ulëta për ta denigruar këtë luftë do të jenë të dështuara, ashtu siç kanë dështuar edhe shumë raste në gjykatën e Hagës.

Nuk mendoj, se përmes linçimit të medieve të cilat i kemi parë së fundi, do të arrijnë të pastrojnë pretendimet e ngritura kundër emrit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kundër luftës së shenjtë, me të cilën Adem Jashari, familja Haradinaj, Samiu, Sylja, vëllezërit Demaku, Ilaz Kodra, Zahir Pajaziti e shumë ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare sakrifkuan jetën e tyre dhe gjithçka, që ne sot të jemi të lirë.

KRYETARI: Faleminderit! Bislim Zogaj, fjala është për ju. Në qoftë se nuk je gati..., atëherë Gëzim Kelmendin e kemi të vetmin pa grup parlamentar, të gjithë jeni pastaj të PDK-së. Atëherë, le të bëhet Safete Hadërgjonaj menjëherë, pastaj Bislimi.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, kryetar!

Përshendetje për të gjithë deputetët dhe ministrat!

Vërtet debati i sotëm me rastin e arrestimit të komandantit dhe gjithë atyre ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është një debat i cili ka prekur ndjenjat e çdo qytetari të Kosovës dhe çdo qytetari që ka punuar për lirinë dhe pavarësinë e këtij vendi. Edhe pse, i titulluar ky debat për vlera të UÇK-së, mendoj se UÇK-ja ka shumë vlera se sa të minimizohen në një debat.

Debate dhe konferenca të shumta nuk mund ta përshkruajnë vlerën e mirëfilltë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ushtria Çlirimtare e Kosovës përveçse ka vlera, ka edhe merita për atë që ne sot jemi këtu, për atë që shteti i Kosovës është i lirë dhe i pavarur, nga se Ushtria Çlirimtare e Kosovës, si prijatë për lirinë e këtij vendi, e ndihmuar nga Aleanca më e fuqishme botërore NATO, ka arritur ta largojë njëherë e përgjithmonë atë regjim gjenocidal, diktatorial dhe terrorist, i cili ka terrorizuar, vrarë e dhunuar qytetarë të pafajshëm.

Vërtet është një situatë jo e mirë, por shumë e rëndë. Kemi të arrestuar komandantin e Shtabit të Përgjithshëm, Sylejman Selimin dhe gjithë ata ushtarë të cilët kanë dhe janë familjarë të dëshmorëve, ndërsa shqetësimi im kryesor, të cilin do ta them në fund të fjalimit tim, pa dashur ta zgjas më shumë, lidhet me atë se çka do të bëjmë ne si Kuvend i Kosovës, ne si deputetë, lidhur me këtë situatë.

Kosova është shtet sovran, Kosova është shtet me identitet dhe dinjitet, por fatkeqësisht, vitet e fundit përballë gjithë këtyre stuhive dhe furtunave, po e luajmë rolin e një shteti pa identitet dhe pa dinjitet.

Si lejojmë që të barazohemi dhe të rritemi në raport me agresorin? Kosova nuk i ka vrarë 20000 civilë, por i ka vrarë regjimi i Serbisë. Kosova nuk i ka dhunuar mbi 12000 gra, por i kanë dhunuar forcat paramilitare serbe. Ne ende... në deponi, varreza masive dhe vende të ndryshme nëpër Serbi i kemi mbi njëmijë të pagjetur, ndërsa ende dikush merr guximin ta dënojë dhe persekutojë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Vërtet një situatë shumë e rëndë, e cila na bën neve të gjithëve që të zgjohemi nga ky gjumë, i cili fatkeqësisht, me apo pa dëshirë, kemi lejuar të ndodhin këto furtuna që duan ta njollosin edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si ushtria vetëmbrojtëse që ka mbrojtur pragun e shtëpisë dhe ka mbrojtur dinjitetin dhe lirinë e qytetarëve të Kosovës.

Të dashur deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Vërtet, përvoja ime negative edhe në këtë mandat edhe në atë mandat më shtynë ta them këtë. Rezolutat të cilat i ka nxjerrë Kuvendi i Republikës së Kosovës, qoftë në këtë mandat, qoftë në atë mandat, as një herë të vetme nuk janë zbatuar nga qeveritë e Republikës së Kosovës, as nga

Qeveria e kaluar dhe as nga kjo Qeveri. Dhe, çfarëdo rezolute që do të dalë sonte, unë mendoj se nuk do të ketë efekt e veçanërisht nëse kësaj ia shtojmë edhe mosharmonizimin në mes grupeve parlamentare, qoftë të atyre në pozitë, qoftë opozitë. Këtë e bën edhe më të rëndë kjo situatë, kur rezolutat nuk janë zbatuar.

Nuk kërkojmë që Kuvendi i Kosovës dhe ne si deputetë të ndërhyjmë në gjyqësor, në asnjë moment. Por, kërkojmë njëherë e përgjithmonë, që të zbardhet e vërteta. Fatkeqësisht, vite me radhë Kuvendi i Republikës së Kosovës ka marrë në mënyrë zyrtare raportin e progresit të Komisionit Evropian, ku shqetësim kryesor, përveç krimit të organizuar dhe korrupsionit, ka edhe ndikimin e politikës në drejtësi.

Dhe, këtu dua të dal për ta përfunduar këtë fjalim timin. Ne si Kuvend i Kosovës, në pamundësi që përmes rekomandimeve dhe rezolutave të realizojmë qëllimet tona, sa i përket rezolutës dhe qëllimeve tona e kemi edhe rastin e fundit negativ, kur Kuvendi arriti të nxjerrë një rezolutë kozmetike, mashtruese dhe jo të sigurtë, rastin e arrestimin e drejtorit rajonal të Policisë, Nehat Thaçit, e cila doli dhe u vlerësua nga shumë qytetarë, shumë analistë, se ishte rezolutë joparimore, shumë mashtruese dhe shumë jo korrekte.

Prandaj, pa dashur të paragjykoj se cila do të jetë rezoluta jonë, ne si Kuvend i Kosovës kemi edhe disa mundësi të tjera. Mos të harrojmë, që roli i Kuvendit të Kosovës është, përveç legjislativ ka edhe rolin përfaqësues por edhe mbikëqyrës. Ne duhet t'i mbikëqyrim dhe të kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, konkretisht nga Ministria e Drejtësisë, që të ushtrojë ndikimin e saj në Këshillin Prokurorial dhe institucionet e gjyqësisë, të kërkojë informata shtesë, të eliminojë të gjithë ata faktorë negativë, që kanë ndikuar në vendimet, e veçanërisht që lidhen me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Dhe, mekanizmi i dytë përveç presionit në Qeveri, është se Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kompetenca edhe në bazë të Rregullores dhe Kushtetutës, të themelojë komisione ad hoc hetimore parlamentare. Përmes këtyre komisioneve hetimore duhet Kuvendi i Kosovës ta zbulojë dhe ta ndriçojë njëherë e përgjithmonë këtë shqetësim që e paraqet edhe Bashkimi Evropian, kur jemi të ndikimi i politikës në drejtësi. Duhet Kuvendi i Kosovës që përmes komisioneve ta zbulojë se kush po e dënon Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, kush po i dënon djemtë dhe bijat më të mira të këtij vendi. A është Serbia përmes dorës së zgjatur të saj në Kosovë dhe instrumenteve të saj apo është politika kosovare, që mbetet shqetësim edhe i ndërkombëtarëve?!

Prandaj, pa dashur ta zgjas më shumë, i nderuar kryetar i Kuvendit, kërkoj nga ju e mund të jetë edhe pjesë e rekomandimeve sonte, që me automatizëm të themelohet një komision hetimor parlamentar, që njëherë e përgjithmonë të hetojë ndikimin e Serbisë në vendimet e gjyqësorit dhe ndikimin e politikës në drejtësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën. Zoti Bislim Zogaj bëhet gati.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar, që më në fund ma dhe fjalën! Kam menduar që do të jem pjesë e diskutimit para dite, pa e bërë pushimin e mesditës, por megjithatë mirë që më erdhi radha tani.

Edhe pse, u hamenda shumë të diskutoj apo të mos diskutoj, mirëpo si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës jam shumë e indinjuar me faktin e dënimit të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka bërë historinë tonë. Veprimtaria, puna, munda e sakrificat e tyre e bënë Kosovën shtet. Pastërtia e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës bëri botën demokratike të radhitet në anën tonë, e solli NATO-n në Kosovë. Luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë heronjtë e gjallë të këtij vendi. Ata hapën horizontet e ardhmërisë për gjeneratat e gjenerata. Ushtria Çlirimtare e Kosovës është krenaria jonë, është vlera jonë.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës për të gjithë qytetarët e shtetit tonë është dhe do të mbetet nismëtarja e lirisë dhe ajo që inspiron gjeneratat. Unë si deputete kam të drejtë të ngre zërin në mbrojtje të luftëtarëve të lirisë, në mbrojtje të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në luftën çlirimtare u dëbuan nga Kosova mbi një milionë qytetarë, u vranë e u plagosën mijëra qytetarë të pafajshëm, humbën pa gjurmë mijëra të tjerë, mbetën pa gjymtyrë të trupit të tyre qindra të tjerë, u plagosën mijëra qytetarë të pafajshëm. Kështu që, dënimi i luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i lëndon miliona qytetarë të Republikës së Kosovës.

Gjenocidi e masakrat që janë bërë në Kosovë ishin të pafalshme. Mosdënimi i atyre që bënë masakër është poshtëruese për të gjithë qytetarët e Kosovës. Duhet të dënohen ata që bënë masakra e gjenocid, duhet të dënohet shteti serb. Ata që bënë masakra në Izbicë, në Rezallë, në Poklek, në Çikatovën e Vjetër, në Mejë, në Korenicë, në Burgun e Dubravës, në Çyshkë e në Lubeniq, në Beleg ku u vranë, masakruan e dhunuan qytetarët në shtëpitë e tyre, ata që masakruan Krushën e Studimen, ata që masakruan Reçakun e shumë vende të tjera nëpër Kosovë.

Duhet të dënohet gjenocidi serb në Kosovë, jo të dënohet sakrifika e lufta e pastër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mjaft të këqija kemi pasur. Në emër të sakrificës së popullit tonë e kemi obligim që të mblidhemi së bashku, të mbrojmë sakrificën e djemve dhe vajzave, që dhanë jetën për Kosovë, të atyre që dhanë gjymtyrët që Kosova të jetë vend i lirë dhe sovran. Nuk ka ardhmëri në një shtet që nuk e mbron historinë e vet të pastër.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot, ashtu siç kemi dëgjuar edhe më parë, u përballëm me rishfaqjen e radhës së hipokrizisë së Lëvizjes “Vetëvendosje”, drejtuesit e së cilës manipulojnë me plagët e luftës dhe ndjenjat patriotike të popullit tonë, për të përmbushur interesat e tyre të ulëta politike.

Tallen me flamurin, sabotojnë festimin e Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës e mandej shtiren sikur janë mbrojtësit më të mëdhenj të Republikës, duke sajuar akuza për imperialistë e kolonizatorë ndaj amerikanëve dhe aleatëve tanë të tjerë. Të flasin për aleanca ballkanike e s’mund të bëjnë aleancë me asnjë parti politike, me askënd, për hir të interesave kombëtare, për hir të shtetit të Kosovës.

U tha nga “Vetëvendosja” : “Kur të vijmë në pushtet nuk do t’ju lëmë të shkoni në Gjykatën Speciale...”, kurse sot edhe një herë e dëshmuar që individët nga radhët e tyre kanë dërguar informata e informata të shërbimet e huaja. E dëshmuar edhe sot! Ju nuk do të vini kurrë në pushtet, sepse për të ardhur në pushtet duhet të merren votat e qytetarëve e qytetari kurrë nuk do ta votojë arrogancën tuaj.

U fye e u sha presidenti i Kosovës, zoti Hashim Thaçi. Normalisht, se forca juaj është shumë e vogël në krahasim me presidentin e Republikës së Kosovës. Fyerja naive e juaja nuk e bën të ndjehet keq presidentin, sepse ai është lider me vlera të larta. Këtë e ka vërtetuar qytetari i Kosovës, duke e votuar më shumë se të gjithë liderët tjerë politikë së bashku.

Të nderuar deputetë, nuk e kanë fare problem që të pranojnë në gjirin e tyre Lëvizja “Vetëvendosje” gjithfarë ish-jugosllavësh, komponentë të familjeve të nomenklaturave të regjimit të kaluar, kolaboracionistë, për sa kohë ata vihen në shërbim të tyre. Aktrojnë sikur janë të revoltuar dhe të indinjuar për dënimin e heronjve tanë të luftës, por në fakt, janë të njëjtit individë që nuk kanë humbur rast që të njollosin luftëtarët tanë, duke shpikur gjithfarë akuzash ndaj tyre. Askush nuk mund t’i dojë, as t’i mbrojë, njerëzit tanë më shumë se sa ne që kemi qenë dhe jemi me ta, ne që e kemi bërë rrugëtimin e përbashkët me ta, që ishim e jemi bashkë në formimin dhe ndërtimin e shtetit tonë.

Shumë deputetë ngrenë zërin sikur janë të shqetësuar për fatin e ish-luftëtarëve tanë në Gjykatën Speciale, por ne e dimë të gjithë që në të vërtetë, brenda jush, jeni të gëzuar për mundësinë e pastrimit të rrugës prej rivalëve, të cilët ju kurrë nuk do të kishit shans t’i mundni në popullaritetin dhe respektin që gëzojnë në publik, sepse, të nderuar, nuk e keni bagazhin atdhetar dhe kombëtar, nuk e keni profesionalizmin dhe guximin politik për të vepruar në raste të caktuara.

Unë e kuptoj luftën për pushtet, por nuk pajtohem kurrë të denigrohen të arriturat tona. Unë ju siguroj, që me kalimin e kohës lojërat dhe hipokrizia që po qartësohet para qytetarëve të

Kosovës, nuk do të keni mundësi ta mashtroni popullin tonë të vuajtur askush, sepse qytetari di të dënojë ata që veprojnë e punojnë për shkatërrimin e shtetit tonë, që e kemi formuar me mund e sakrificë të mëdha. Nuk do të lejojë qytetari ynë të drejtohet shteti me ish-udb-ashë e soje të tyre. Mbeturinat e ish-Jugosllavisë nuk do të diktojnë kurrë rrugën tonë.

Nuk dua të komentoj vendimet e gjykatës, por ne kemi nevojë për reforma të thella në gjyqësor. Duhet t'i jepet fund, njëherë e përgjithmonë, dënimeve politike. UÇK-ja është vlera jonë. Ne jemi me çlirimtarët. Çdo qytetar i Kosovës e di, që e vërteta në fund do të triumfojë. Vlera e lirisë së Kosovës është kontribut dhe vlerë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Bislim Zogaj e ka fjalën. Naim Fetahu po e ngrit dorën. Salie Mustafa... të gjithë do të shkojmë, Shukri Buja, të gjithë do të shkojmë. Të gjithë, sonte do ta përfundojmë debatin.

BISLIM ZOGAJ: Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Unë më shumë do të mundohem t'i drejtohem opinionit.

Fillimisht, dua t'i them vetëm dy gjëra. Kam pasur fatin që të jem anëtar i Shtabit Operativ të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe një fat tjetër e kam pasur, që në masakrën e Dubravës nuk jam plagosur dhe kam pasur mundësi tu ndihmoj të plagosurve.

Sot, dola për të folur për vlerat e UÇK-së, sepse aq shumë u fol për UÇK-në, aq shumë u njollosoi UÇK-ja, sa me të vërtetë është për tu habitur kush po flet dhe për kë po flet!?

Dua të nisem nga një realitet që kisha në burg sa isha. Naim Lushit i ishin vrarë shtatë anëtarë të familjes, ai e kishte vetëm edhe babanë, ishte djalë hasreti dhe pas katër muajsh, kur i erdhi lajmi në burg i thanë se të janë vrarë shtatë anëtarë të familjes dhe Naimi nuk kishte kujt t'i shkruante tjetër, përveç nënës së tij dhe i kishte shkruar një letër: "Nënë, mbahu..."

KRYETARI: Veç pak, Bislim. A ka mundësi, se po flet për rast të rëndë. Ose uluni, ose lëshojeni, më mirë, seancën.

BISLIM ZOGAJ: Vetëm një minutë, se dua të lidhem me një diçka tjetër.

I shkruante Naimi nënës së tij: "Nënë, uroj të jesh e fortë, ashtu sikur ditën kur ma puthe ballin dhe ma urove plagën."

KRYETARI: Veç pak... veç pak... Bislim Zogaj, unë jam kryetar. Nuk do të vazhdoni. Ose uluni, ju lutem, të nderuar kolegë deputetë, ose dilni jashtë. Po ta jap fjalën, qysh jo! Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: S'jam kah të marr vesh. Nuk është brenda rregullores me më dhënë komanda kur me u ulë e kur me u qu. Nëse e kam thyer rregulloren është çështje tjetër. Unë rri në këmbë se më rrihet. Andaj, vazhdoni.

KRYETARI: Ani, ndalet seanca pra. Bislim Zogaj, nuk ka nevojë. Ndalet seanca, pauzë një 15 minuta, për arsye se këtë skenë nuk mund ta lexosh duke ndenjur dikush në këmbë. Çdo herë do ta keni nga 15 minuta. Kështu, kurrkush s'ka me dalë prej seance. Po dalin, se ka nga pak më tepër se sa rregullore në Kuvend. Ndalet 15 minuta. Derisa të ulen kështu e kemi. Jo, se po flet për shtatë anëtarë të vrarë të një familjeje dhe shpinën në tjetrën anë dikush me fol, nuk është bash korrektësi. Hajde. Pauzë ju kisha lutur, një 15 minuta, se edhe kështu jeni lodhur.

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Pasi jemi edhe afër harmonizimit të deklaratës, kolegu deputet Bislim Zogaj, e vazhdon fjalën e vet. Ndërkohë, në qoftë se... mora një njoftim nga kolegë tjerë deputetë. unë i lexoj emrat e tyre që janë lajmëruar për fjalim. Në qoftë se, ata dëshirojnë ta tërheqin fjalën, ne pastaj e mbyllim seancën për... e mbyllim seancën në fakt jo, po e përgatitim harmonizimin e draft-rezolutës, për vetëm të jenë në pjesën e votimit. E shohim, nëse kemi kuorum? Në qoftë se, nuk kemi atëherë e vazhdojmë nesër, në qoftë se kemi mirëkuptimin e përbashkët.

BISLIM ZOGAJ: Faleminderit, kryetar!

Dua ta vazhdoj aty ku mbeta. E kisha fjalën te Naimi dhe shqetësimi i tij më i madh ishte se athua tash populli, qytetarët, çfarë do të thonë. Athua, ne që e nisëm luftën do të na shajnë përse e bëmë luftën dhe atëherë, u mundova ta inkurajoja, por realisht sot po shihet se shumëve kjo UÇK ua ka prishur planet, sepse nuk po i kanë serbët tash, që të bashkëpunojnë me ta dhe domosdoshmërisht se UÇK-ja u ka prishur shumë plane.

Flitet shpeshherë, sidomos nga "Vetëvendosja" për UÇK-në, se UÇK-ja ka qenë e mirë, por këta që e kanë udhëhequr, që e kanë formuar UÇK-në, këta kanë qenë të këqij. Athua, UÇK-ja paska qenë një fantazmë?! Athua, çfarë është kjo UÇK-ja?! A preket? A shihet apo ç'është kjo? Unë mendoj, se UÇK-ja është vetë ushtarët e UÇK-së, vetë ata që e themeluan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe ata që e bënë që sot ne të jemi të lirë.

Fatkeqësisht, shumë nga ata shokë u vranë. E sipas këtyre, vetëm ata që u vranë paskan qenë të mirë, vetëm ata e paskan prurë lirinë. Vallë, Azem Sylja, i cili një jetë të tërë ia kushtoi çështjes kombëtare, Xhavit Haliti, i cili ia kushtoi një jetë të tërë çështjes kombëtare dhe që të dy këta janë, kanë më shumë veprimtari se sa pothuajse të gjithë anëtarët e "Vetëvendosjes".

Pastaj, Hashim Thaçi, Kadri Veseli kriminelë, Sulejman Selimi kriminel, Agim Çeku, Nait Hasani, u akuzuan. E në fund edhe për mua u thanë disa fjalë, po për mua më pak, se nuk ua zija rrugën më herët. U quajtën nga kjo sallë edhe kriminelë dhe pastaj sot çohen dhe flasin “pse e votuat Gjykatën Speciale, pse është EULEX-i këtu...?”

A e dini pse është EULEX-i këtu? A e dini pse u votua Gjykata Speciale? U votua sepse vetë ju e kërkuat këtë, pavarësisht se nuk e votuat ju i kontribuat kësaj gjykate, sepse gjithëherë thoshit: “ja kriminelët...”, “ja vrasësit...”. Dhe, për ta vërtetuar këtë shumë gjykime që u bënë deri tani, si ai “Drenica”, si gjykime të tjera, e keni parë se sa kohë u ka marrë për të vërtetuar fajësinë e tyre, sepse nuk mund të gjenin dëshmitarë. Ishin dëshmitarë të imagjinar dhe në fund ndonjë, sikur rasti në Abri, lirisht mund të themi një psikopat nga i cili janë dorëzuar edhe familja, në bazë të asaj deklarate dënohen e tërë një familje.

Vallë, ai dëshmorë që tani nuk jeton, a paska qenë i mirë, kurse këta të këqijtë?! Unë mendoj se e tërë ajo familje ishte patriotike dhe kombëtare. Mund t’u thotë dikush se “jo ne nuk kemi folur, por vetëm ashtu...”. Por, nga kjo sallë x-herë u quajt kryeparlamentari “kriminel”. Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe e kam shikuar fjalën “kriminel”, dhe shkruan kriminel – vrasës, ose si shpjegim “kriminel lufte”. Athua, kur këta deputetë në këtë sallë po edhe nëpër debate dhe nëpër konferenca shtypi, e quajnë kriminel Kadri Veselin, Hashim Thaçin, Azem Sylen, atëherë Gjykata domosdoshmërisht që do të kërkojë që të gjejë argumente se kë paskan vrarë këta.

Dhe, pa fije turpi, këta i quajnë kriminelë udhëheqësit institucionalë, këta udhëheqës të cilët u zgjodhën me votën e popullit, me votën të cilën e votuam me përgjegjësi. Normalisht, se dikujt nuk i ka konvenuar që të jenë, por megjithatë këta e merituan dhe u zgjodhën.

Fatkeqësia më e madhe është kur në emër të patriotizmit mundohen duke i luftuar vlerat kombëtare mundohen të fitojnë zgjedhjet. Fatkeqësisht, kjo është e paarritshme, fatkeqësisht por edhe të burgosurit e të gjithë këta që i përmendët, në UÇK kanë qenë shumë komandantë dhe do të ketë të mjaftueshëm që çdo herë ta udhëheqin shtetin për të mirën e popullit. Prandaj, edhe një herë u them, ju lutem, kur flisni për UÇK-në keni kujdes. UÇK-ja është vlera jonë sublime, është vlera jonë kombëtare. Por, në UÇK ishin këta që për juve janë kriminelë e për popullin janë çlirimtarë dhe populli e ka besimin tek ta dhe besoj se edhe në të ardhmen do t’i udhëheqin në procese vendimtare dhe në interes të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Unë e mora një sugjerim. E dëshiron prapë fjalën? Ok! Shukri Buja bëhet gati, atëherë Mexhide Mjaku-Topalli pastaj e ka fjalën.

SHUKRI BUJA: I nderuar kryetar,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Shumë të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të ju them të drejtën, jam i habitur për të mirë, sepse po flasin mirë për UÇK-në edhe ata që na akuzuan, na ndoqën dhe na dënuan.

Edhe pse, këta po e bëjnë me qëllim të rehabilitimit, mirë është, le të flasin mirë. Por, mos të harrojnë që po flasin mirë dhe le të vazhdojnë, jo vetëm tash. Po më vjen mirë, që edhe ata që s'bënë kurrigjë, edhe ata që u fshehën ferrave të Kosovës dhe jashtë Kosovës po flasin mirë për UÇK-në. Mirë është që të vazhdojnë të flasin, sepse kështu i ndihmojnë Kosovës, por gjithsesi ne duhet të flasim për atë për të cilën jemi të thirrur, për të mbrojtur vlerat e luftës dhe po ta kemi parasysh se jemi deputetë me vota të qytetarëve dhe nuk e kemi të drejtën madje, as unë nuk e kam të drejtën të flas në emër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por në emër të votës, e cila më ka sjellë në Parlament.

Nuk është e lehtë të flasësh si deputet për një institucion që është i pavarur, për Gjykatën, për vendimet e saj, edhe pse kjo gjykatë mori vendim pa fakte dhe një vendim të paarsyeshëm. Po, si erdhi deri te kjo? Si erdhi që ne të jemi të detyruar të interferojmë në institucione të pavarura? Si dhe pse erdhi deri te kjo?

Pas luftës u instalua administrata e UNMIK-ut në Kosovë dhe filloi të instalojë përmes konkurseve të shpallura edhe gjykatat dhe prokuroritë. Në konkurse të shpallura ishte 12 përvojë pune dhe ato 12 vjet përvojë pune që kërkoheshin nuk kishte kush t'i plotësonte, pos atyre që ishin argatë dhe shërbëtorë të sistemit të Jugosllavisë së Titos, argatë dhe shërbëtorë të sistemit të Jugosllavisë së Milosheviqit. Dhe, edhe pse reaguam, dikush u pajtua dhe erdhën e u instaluan ata njerëz, të cilët na kishin ndjekur dhe ishin të inkriminuar në krimin politik që kishin bërë, sepse na kishin dënuar për veprimtarinë tonë ilegale, për të vetmen kërkesë që kishim bërë për Republikën e Kosovës dhe sot do të punonin në Republikën e Kosovës.

Republika e Kosovës edhe ne brenda saj, sigurisht që me naivitete besonim se arritëm me luftë, por na u desh edhe shumë punë, edhe shumë mund deri në shpalljen e saj.

U instalua pas luftës Kodi Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, me të cilin filluan të ndiqeshin djemtë që kishin vepruar edhe para luftës. Besoj, ju kujtohet ndjekja e zotit Sarramati, i cili ndiqej për një rast të vitit '91. Këto ndjekje nuk u ndalën, vazhduan edhe më tutje, sepse u instalua një sistem prokurorial dhe gjyqësor, i cili ishte tepër i dëmshëm për Kosovën.

Pas konstituimit të Parlamentit të Kosovës, sigurisht se vazhdoi e njëjta këngë që po vazhdon edhe sot, mosinterferim në gjykata, mosinterferim në prokurori, sepse duhej të vazhdonin punën ata të cilët ishin dikur me Milosheviqin dhe me Titon. Emërimet bëheshin nga PSSP-ja dhe kjo e keqja trashej. Përveç kësaj, kishim gjykatës ndërkombëtare të UNMIK-ut, më vonë të EULEX-it,

që ne me të drejtë prisnim ndjekjen e personave përgjegjës për krime në Kosovë, si ajo e masakrës së Krushës së Madhe në Rahovec, Reçak, Abri, Ribar i Vogël, Hallaç, Slllovi të Lipjanit, Kotlinë të Kaçanikut, Burgut të Dubravës, Izbicë, Rezallë, në Rugovë të Hasit, e në Studime të Vushtrrisë, e tjerë. Pritëm e shpresuam, por asgjë. Asnjë aktakuzë, asnjë arrestim, asnjë dënim, madje për çudi fillon ndjekja e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që filloi me zotin Sarramati, por vazhdoi pastaj me ushtarë të Rahovecit, Dukagjinit, Llapit, Nerodimes, Pashtrikut, për të kaluar në rastin e dytë “Drenica”.

Dhe, në të gjitha rastet ose kishte dëshmitarë që edhe u thanë jokredibil, ose dëshmitarë të çrregulluar mentalisht, ose dëshmitarë të rrejshëm, të cilët i përdorte prokuroria. Nuk u potencua këtu rasti i prokurorit të njohur, tashmë për të keq në Kosovë, Salustro, i cili pasi përfundoi punën e tij, shkoi dhe u punësua në Serbi, gjë që na tregon shumë qartë se kush e sugjeroi dhe kush e orientoi me aktakuzat kundër ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ne njerëzit që luftuam për shtet dhe për rregull e ligj ishim të prirë të besojmë në institucionet e drejtësisë, por u dogjëm. Prandaj, dhe reagimi vjen si reagim pas djegies, që duket se është veprim instinkti, veprim i paarsyeshëm si interferencë, por nuk është as njëra e as tjetra. U dogjëm dhe po digjemi nga sistemi dhe shpresa që kemi në drejtësi. Me të gjitha emrat mund të quhen këto vendime dhe veprime, por vetëm drejtësi jo. Qëllimi i fjalës sime është që dua të ju them stop. Stop dënimeve pa fakte dhe me procese politike! Stop dënimeve që do të jenë shembuj të drejtësisë si praktikë e keqe dhe e turpshme! Stop ndjekjeve e persekutimeve të idealistëve çlirimtarë pa fakte, vetëm pse ishin shqiptarë e çlirimtarë.

Por, një stop më të madh një institucioni që është krijuar e është vetëformuar me disa “opinionistë”, me disa “analistë”, që mund të quhen bastexhinj, por as bastit nuk ia kanë qëlluar kurrë. Ata janë një institucione para gjykate, i cili po i akuzon dhe po dënon para gjykatave ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare dhe eprorët.

Prandaj, këtyre duhet tu themi stop. Shihni portalet, shihni gazetatat dhe shihni çfarë propagande e ndyrë bëhet kundër luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. A ka rrenë më të fëlliqur, se të thuhet se shumë shpejt Kosova do të pastrohet prej Gjykatës Speciale nga kriminelë, nga të korruptuar e as nuk e kanë lexuar ligjin, sepse në ligj thuhet se Gjykata Speciale do të merret me rastet e krimeve të pretenduara të luftës, nga ‘98-a deri në dhjetor të 2000-ës dhe s’ka të bëjë as me krimin ekonomik, as me korrupsionin, as me hajninë. Thjesht, s’ka juridiksion pas vitit 2000, kur edhe mund të pretendohen vepra të tilla. Po, turpi nuk e ka mbytur askënd. Prandaj, stop rrenave e shpifjeve.

Syla e Samiu e shumë bashkëluftëtarë tjerë e di shumë mirë se janë krenarë për luftën. Janë krenarë për luftën e tyre dhe dënimi që u është shqiptuar është i pafaktuar dhe i paarsyeshëm, por kjo nuk do t’ua zbehë krenarinë. Ata ishin, janë dhe mbeten çlirimtarë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Mjaku-Topalli, fjala për ju. Ndërkohë, bëhet gati zoti Naim Fetahu.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Arsyeja pse desha ta marr fjalën është për hir të atyre që nuk janë sot në jetë dhe për hir të atyre, ndaj të cilëve nuk është vendosur drejtësia.

Qytetarët e Republikës së Kosovës ka vite që presin një institucion ndërkombëtar të drejtësisë, i cili do të kënaqte shpresat e qytetarëve për vendosjen e drejtësisë në vend pas dështimit të madh që bëri drejtësia e UNMIK-ut. Me këtë bindje dhe me këto shpresa për krijimin e një institucioni vendor-ndërkombëtar të drejtësisë, ne kemi pritur që drejtësia të vendoset në parime të barazisë dhe të trajtimit të barabartë të të pandehurve.

Parimisht, ne nuk e kemi mandatin të komentojmë vendimet gjyqësore, por kur këto vendime marrin përmasa shqetësuese në opinionin e gjerë, atëherë ne duhet të bisedojmë çka po ndodh me këto gjykime dhe na bën që të mendojmë se a po dëmtohet substanca e shtetit dhe a po rrezikohet siguria e vendit.

Të nderuar deputetë,

Gjykimi i fundit i grupit të “Drenicës” ka dëshmuar se drejtësia në këtë proces, thënë më së buti, ka qenë padrejtësi. T’i krahasojmë argumentet dhe faktet, se si e perceptojnë qytetarët këtë drejtësi. Është rregull që aktgjykimet gjithmonë të shpallen në emër të popullit. Me këtë duhet kuptuar, se drejtësia në emër të popullit duhet të kënaq vetë popullin dhe duhet të akceptohet nga populli si diçka e drejtë.

Shtrohet pyetja, a është arritur ky mision i drejtësisë? Jo, në asnjë mënyrë. Populli po shpreh pakënaqësinë e tij nëpërmjet përfaqësuesve të tij. Po lutem, që populli të mos e shprehë pakënaqësinë drejtpërdrejtë me protesta.

Drejtësia në gjithë botën identifikohet me një instrument, që është peshorja. Edhe logoja e Ministrisë së Drejtësisë është me peshore, edhe gjykata si simbolikë e ka peshoren. Kjo domethënë peshim i barabartë i fakteve, i argumenteve të të dyja palëve, por kjo domethënë edhe që drejtësia t’i kënaqë të dyja palët.

Në rastin konkret kemi një dështim të drejtësisë. Të dënosh një grup për keqtrajtim të të dënuarve, në një qendër ndalimi, me dëshmitarë të dyshimtë e mos ta shohësh një masakër institucionale, ku janë vrarë 150 të burgosur në Dubravë, kjo nuk është drejtësi.

Ta dënosh një grup për keqtrajtime dhe mos të shohësh dhjetëra masakra anekënd Kosovës, nuk është drejtësi që populli ynë e pranon.

Ndërkombëtarët po dalin në anën e gjykatës si institucion, por ajo nëse nuk akceptohet si një gjykim i pranuar i një opinioni, ajo ka kundërefekt, ajo nxitë reagime, ajo nxitë trazira, për të cilat më së paku sot ka nevojë Kosova. Këta djem që u dënuan dje me çmimin e jetës së tyre popullit tonë ia kthyen dinjitetin, ia sollën lirinë bashkë me ndërkombëtarët, që në një moment përkrahën konceptin lridashës të popullit tonë, koncept universal i drejtësisë dhe humanizmit.

Në drejtësi ekziston një parim, të cilit i referohen ata që betohen për drejtësinë. Më mirë të jenë të lirë njëmijë kriminelë, se sa të dëmtohet një i pafajshëm. Ky rast i gjyimit të grupit të “Drenicës” drejtësisë ia ka shuar të gjitha koloritet e ngjyrave, përjashtimisht dy ngjyrave – bardhë e zi.

Drejtësia duke shikuar një proces bardhë e zi, mua si qytetare dhe përfaqësuese e këtij populli më ngulfat dhe më bën të padenjë para qytetarëve që më kanë votuar. Drejtësi bardhë e zi është kjo me emër e mbiemër, me vend e orë, bien vrasësit e Rexhep Bislimit, Cen Dugollit, Bilall Shalës. Ata janë vrarë në një institucion zyrtar dhe s’ka drejtësi për ta. Në anën tjetër kemi një dënim për një qytetar të vrarë, që nuk dihet kush është, nga është dhe ku është. Dënohet një komandant për një keqtrajtim fizik të një qytetari!

Kur krahasojmë vetëm këto dy argumente, atëherë drejtësia e shpallur këto ditë na del shumë larg drejtësisë reale. Ajo më nuk është bardhë e zi, ajo është vetëm një ngjyrë zi - zi. Dhe, pikërisht gjykimi i këtij grupit të “Drenicës” tek qytetarët tanë shihet si një gjykim më i errët i dhënë ndonjëherë në historinë e drejtësisë së pasluftës. Historia e përvuajtur shumëshkullore shqiptarëve u ka zhvilluar një shqisë krejtësisht të veçantë, të cilën popujt që janë më herët të lirë ndoshta nuk e kuptojnë në masën sikur e kuptojmë ne. Ne, çlirimtarët i konsiderojmë të shenjtë. Duke qenë se edhe trupat ndërkombëtare kanë qenë çlirimtarë, ne edhe ata i trajtojmë të shenjtë. Mos ta lëmë që kjo shenjtëri të zbehet!

Drejtësia ndërkombëtare dhe ajo vendore duhet të jenë dy anë të së njëjtës medalje e medalja duhet të jetë vetë misioni i drejtësisë. Gjykimi i drejtë që kënaq drejtësinë, gjykimi i drejtë që kënaq popullin. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: Faleminderit! E ftoj deputetin Adem Grabovci ta marrë fjalën. Nuk është këtu. Atëherë, fjalën e ka deputeti Naim Fetahu.

NAIM FETAHU: Faleminderit!

E nderuar nënkryetare,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar të pranishëm,

Për një temë të rëndësishme së veçantë, siç është tema që kemi përpara, edhe unë dua të jap kontributin tim, duke qenë edhe si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe duke dhënë kontributin tepër të drejtë në këtë periudhë të lavdishme.

Masakrat serbe mbi civilët shqiptarë në Kosovë të ndodhura në Malësi të Llapit, si masakra e Dyzit, e Dobratinit, Reçakut, Izbicës, Prekazit, Qyshkut, Lybeniqit e dhjetëra masakra të ndodhura akoma presin drejtësinë, e cila asnjëherë as që mori mundin të merret me to.

Shumë qytetarë tanë akoma nuk kemi asnjë informatë, se ku ndodhen. Familjarët e tyre dhe ne të gjithë presim të dimë për fatin e tyre e askush nuk është thirrur në përgjegjësi për këtë. Masakrat, zhdukjet vrasjet torturat e persekutimet gjenicidiale serbe ndaj shqiptarëve, që në një mënyrë apo tjetrën, preku rreth dy milionë shqiptarë, nuk i bëri përshtypje drejtësisë që t'i trajtojë.

Në anën tjetër, përveç proceseve gjyqësore që jo rrallëherë kanë ngjallë debate, sikur ngjallin dyshime se kemi të bëjmë edhe me tendencë jo qëllimshme në raport me luftën e pastër dhe të drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, sikur kjo nuk kënaqi apetitet e qarqeve të caktuara, vazhdoi gjahu ndaj luftëtarëve dhe komandantëve të shquar të UÇK-së me procese dhe akuza nga më të ndryshmet. Jemi dëshmitarë të proceseve gjyqësore, të cilat filluan me Grupin e Llapit me Rustem Mustafën, Latif Gashin, Nazif Mehmetin, filluan me grupin e Dukagjinit dhe grupet tjera anekënd Kosovës, duke përfunduar me grupin e Drenicës, që është rasti më i freskët të cilin ne po diskutojmë.

Por, për çudi, sa herë që në këtë sallë të Kuvendit të Kosovës është folur për UÇK-në dhe luftëtarët e saj, Lëvizja “Vetëvendosje” dhe deputetët e zyrtarët e saj kanë ndjerë veten keq, janë ndjerë aq të vegjël e të largët prej luftës sonë çlirimtare, saqë çdo sfidë të tyre janë munduar ta përdorin politikisht kundër themeluesve dhe udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Faktikisht, disa zyrtarë të kësaj lëvizjeje që nga lufta e kanë luftuar UÇK-në, e kanë refuzuar atë, kanë dezertuar prej saj dhe nuk janë bashkuar kur janë ftuar për të luftuar. Rasti më i pastër është ai i Albin Kurtit, i cili ka refuzuar tu bashkohet në Zonën e Llapit, kur është ftuar nga komandantët e UÇK-së. Por, si të jenë trima e luftëtarë këta zyrtarë të “Vetëvendosjes”, që janë pinjollë të Jugosllavisë, disa janë familjarë të baballarëve që kanë punuar me Milosheviqin, janë fëmijë të baballarëve që kanë dënuar shqiptarë dhe që kanë bashkëpunuar me Serbinë derisa UÇK-ja në bashkëpunim me NATO-n e ka çliruar vendin.

Duke qenë të vegjël në patriotizëm, të varfër në kontribute dhe shumë larg luftës së UÇK-së, individë kanë zgjedhur luftë ndaj krerëve të UÇK-së duke fabrikuar raporte sipas akuzave të Serbisë dhe duke i dorëzuar ato në adresa të ndryshme ndërkombëtare. Janë pikërisht akuzat e Serbisë ndaj UÇK-së ato të cilat janë recituar që dhjetë vjet nga këta pinjollë të baballarëve të Jugosllavisë, këtu në Kosovë e që kanë qarë deri në formimin e Gjykatës Speciale. Dhe në fund, dalin këta fabrikues dhe duan të paraqiten si mbrojtës të vlerave të UÇK-së.

Unë dua të përfundoj, se lufta e lavdishme e UÇK-së që e bënë djemtë më të mirë të kombit, të cilët sot akuzohen me procese pa ndërprerë, është një luftë me të cilën të gjithë ne duhet të krenohemi dhe përveç dëshmorëve, janë njerëzit më meritore për lirinë që ne gëzojmë dhe për atë që neve na e kanë mundur të jemi të lirë dhe të flasim këtu para jush. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ftoj deputeten Sala Berisha-Shala ta marrë fjalën, ndërkohë përgatitet deputeti Nait Hasani.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Edhe pse, e di që janë lodhur shumica e deputetëve këtu po ndjej si obligim moral edhe unë, ndoshta mund të përsëritem me ndonjërin nga kolegët e mi deputetë. Sidoqoftë, do të përpqem ta shkurtoj fjalën time dhe t'i them edhe unë disa fjalë në lidhje me debatin që e ka titullin "Vlerat e UÇK-së në raport me situatën e krijuar". U shmangën shumica diskutuesve nga kjo temë.

Më lejoni, që në fillim, si deputete e Zonës së Drenicës të shpreh solidaritetin tim dhe të të gjithë qytetarëve të Drenicës me të sapo dënuarit e procesit "Drenica 2" dhe njëherësh të shpreh zhgënjim në organet gjyqësore, të cilat jo njëherë treguan drejtësi selektive, kur bëhet fjalë për dënimin, linçimin dhe etiketimin e padrejtë të ish-luftëtarëve të lirisë së Kosovës.

Sot në të gjitha shkollat dhe në të gjitha nivelet në Drenas ora e parë e mësimit është mbajtur kushtuar Ushtrisë së Lavdishme Çlirimtare të Kosovës. Kjo do të duhej të ishte një nga temat, një nga diskutimet dhe analizat në të gjitha instancat e shtetit tonë, duke filluar nga Akademia deri te institucionet më të ulëta të arsimit.

Para se të gjykohen çlirimtarët drejtësia evropiane le t'i zbardhë krimet e panumërta, siç janë zhdukjet e intelektualëve të famshëm, duke filluar nga Ukshin Hoti, të cilët këta hetues e dinë shumë mirë dhe asnjëherë nuk kanë ndërmarrë diçka, mandej Xhavit Haziri, mandej doktori Hafir Shala nga Drenasi, i cili u kidnapua dhe u zhduk dhe ende nuk dihet asgjë për të.

Le të fillojë drejtësia në Kosovë të hetojë të gjitha krimet, ose disa prej tyre, së paku ndonjë prej tyre e pastaj të merret me krimet, me ndonjë "krim" shuplakë të ndonjë luftëtari të UÇK-së.

Drejtësia evropiane le të zbardhë se si u vra Ymer Elshani me krejt familjen e tij në Paklek, ku u masakruan familja Muçolli, gra fëmijë e pleq.

Sa u përket vëllezërve Demaku unë nuk dua ta përsëris, u tha këtu, vetë fjala e Nexhat Demakut, kur thotë: “Merreni edhe vëllanë tim nga varri dhe gjykojeni për kriminel lufte.”, flet mjaftë. Proceset gjyqësore kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së nëpër tërë vitet e pasluftës, që nga gjyqet e UNMIK-ut e deri te këto të EULEX-it, janë përcjellë me parregullsi, me aktgjykime të njëanshme, me dëshmi dhe dëshmitarë të rrejshëm dhe falsifikime provash.

Këto gjyqe të padrejta në sytë e krejt qytetarëve të Kosovës kanë krijuar një mosbesim në tërë sistemin e drejtësisë dhe si pasojë e kësaj, qytetarët tanë gjithnjë e më shumë po e humbin besimin jo vetëm në institucionet e drejtësisë, por edhe në vlerat e njëmendta të Bashkimit Evropian, për të cilat Bashkimi Evropian këtu ka dërguar njerëzit e vet përmes EULEX-it.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ne si përfaqësues të popullit në këtë Kuvend, por edhe të gjithë qytetarët e Kosovës, sot jemi dëshmitarë se si po shpërfytyrohet drejtësia dhe si po stërkeqet e vërteta. Drejtësia në këtë vend sot ka humbur busullën, ndjek dhe dënon viktimat e vërteta të luftës, ndërkaq shpërblen dhe falë privilegje kriminelëve.

A ka absurd më të madh, se sa të dënohet ky grup i përbërë “Drenica II” për shkak të disa dëshmive të sajara të dëshmitarëve fiktivë. Tragjikomedia me dëshmitarët fiktivë u vërtetua me rastin e dënimit të Sami Lushtakut, ku viktimës nuk i dihet, as emri, as përkatësia etnike, as adresa. Pra, gjykata ka pranuar me aktvendim zyrtar, se viktimat nuk ka ekzistuar në kohën e luftës dhe nuk ekziston as sot.

Të nderuar deputetë, eksperimentet me drejtësinë në Kosovë, gjatë këtyre viteve kanë qenë të tmerrshme dhe kjo është arsyeja pse qytetarët e këtij vendi ndjehen të braktisur nga dora e shtetit. Ne sot nuk kemi në dorë asnjë mundësi, që këtë ndjesi t’ua ndryshojmë atyre, sepse drejtësia në këtë vend po vazhdon të jetë e manipuluar nga instanca, të cilat me çdo çmim po duan ta barazojnë krimin me viktimën, pra duan që luftën e drejtë dhe çlirimtare të popullit të Kosovës ta barazojnë me agresionin serb.

Përgjatë këtyre 17 vjetëve pas ployës serbe mbi shqiptarët, autorët dhe kryerësit e masakrave nuk u bënë kurrë objekt ndjekjeje të këtyre gjykatave. Këta hetues, prokurorë dhe gjykatës, sigurisht që e dinë se shteti serb përmes njësiteve të rregullta policore dhe falangave të ushtrisë shtetërore, vetëm brenda në viti, ‘98 - ‘99, ka vrarë 1386 fëmijë shqiptarë të Kosovës. Nuk po i përmend këtu krimet tjera të serbëve mbi shqiptarë. Kjo drejtësi nuk po i ndjek këta kriminelë, por po i arreston dhe dënon ata që i dolën përpara këtij krimi monstruoz.

Ne si përfaqësues të popullit në këtë Kuvend, por edhe të gjithë qytetarët e Kosovës, sot jemi dëshmitarë se si mediet e caktuara në Kosovë duke bërë argatin e djallit, po realizojnë agjenda antishqiptare, kundër interesit kombëtar e qytetar me shumicë shqiptare dhe atë me lloj-lloj shpifjesh dhe gënjeshtresh. Prandaj, ne si përfaqësues në këtë Kuvend, sot, duhet të kërkojmë llogari nga këto medie për shtrembërim të qëllimshëm të realitetit, për shpifje, gënjeshtra dhe fushatë denigruese ndaj luftës së popullit tonë për liri.

Më lejoni të theksoj se sot patëm rastin të dëgjojmë edhe të akuzohemi për hipokrizi. U vlerësua këtu nga opozita dhe u konsiderua si një e keqe për Kosovën, votimi i Gjykatës Speciale. Ata që e votuan u quajtën hipokritë. Vendimi për këtë të keqe të domosdoshme u mor me këshillim dhe sugjerim të miqve ndërkombëtarë, të cilët na kanë ndihmuar të vijmë deri këtu ku jemi, si shtet i pavarur.

Kështu, mendoj që Kuvendi votoi për “harduerin” e quajtur “Gjykatë Speciale”, ndërkohë që, fatkeqësisht, “softuerin” po e impononi ju me shpifje. Kush është hipokrit këtu?

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Përderisa, Drenica pret drejtësi për viktimat e masakrave të Poklekut, të Abrisë, të Likoshanit, Qirezit e tjera, asaj padrejtësisht po i dënohen bijtë e saj më të devotshëm dhe pa asnjë argument, vetëm e vetëm se luftuan kundër agresorit në vitet 1988/1999.

Prandaj, duke qenë tejet e zhgënjyer me dënimet e fundit, në emër të të gjithë qytetarëve kërkoj nga ajo pak ndërgjegje që i ka mbetur drejtësisë në këtë vend që vendimet ndëshkuese ndaj “Grupit Drenica 2” të rishikohen edhe një herë dhe të ndalet agresioni ndaj çlirimtarëve.

Padrejtësitë e llojit të gjykimeve si ky i “Grupit të Drenicës 2”, duke kundërshtuar në mënyrë të organizuar, të argumentuar e të matur, sepse për të realizuar drejtësi nuk mjafton vetëm e vërteta, por edhe fuqia për ta zbatuar atë. Dhe, kur s’ke fuqi për ta vënë shpejt drejtësinë në vend, je i detyruar të futësh në funksion mendjen, do të thotë të futemi në një proces të gjatë, siç e thashë edhe më herët, duke filluar nga Akademia e Shkencave e tutje.

Ndarja e drejtësisë në emër të paqes u tregua se doli e dështuar. Dhe, në emër të kësaj drejtësie është mbjellë një pasiguri totale te qytetarët e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fund, besoj se të gjithë pajtohemi në këtë se çlirimtarët na e sollën lirinë. Pavarësia e Kosovës është vetë vlera e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ushtria Çlirimtare e Kosovës është vlerë edhe kombëtare, edhe shtetërore, e për ta mbrojtur këtë vlerë duhet të jemi të gjithë bashkë, duhet lënë anash meritat personale dhe luftën për pushtet duke e dëmtuar këtë vlerë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi edhe aq shumë diskutues, për ta harmonizuar më pas. Urdhëroni, fjalën e ka Nait Hasani. Pra, është koha për ta harmonizuar dhe ta përgatisim për votim sonte, ose ta lëmë për ditën e nesërme.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar! Përshëndetje për ministrat!

Besoje se jeni lodhur, por për të ardhur deri te vlerat tona ne kemi ecur këmbë. Për të krijuar vlera kemi bërë mund, sakrificë, kemi derdhur gjak, të plagosur me qindra e mijëra dhe këto kanë krijuar vlera, e ato vlera sot janë të përmbledhura në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Qëndresa e burrit i thyen prangat e robërisë. I thyen edhe burgjet.

Të dashur bashkëluftëtarë, qytetarë dhe ju deputetë,

Liria e popullit tonë i ka rrënjët në gjak, në luftën tonë shekullore për liri, pavarësi, shtet dhe bashkim kombëtar.

Të nderuar,

Ushtria Çlirimtare e Kosovës bashkë me rënien e dëshmorëve në altarin e lirisë e fituan luftën, por lirinë jo, as bashkimin jo. Fitorja jonë ishte madhështore me mbarimin e luftës, e krijuar si vullnet dhe ëndërr shpirtërore që tashmë Kosova të jetë e lirë dhe e çliruar nga Serbia.

Vërtet, Serbinë nuk e kemi në Kosovë, ama të çlirohemi nga ai mentalitet e kemi vështirë, sepse njerëzit e saj janë në Kosovë duke qeverisur. Jo, ajo nuk është si shtet, por si pushtet: Serbia është këmbëkryq në Kosovë, duke qeverisur.

Mjerë Kuvendi i Kosovës që i lut pakicat, pakicën serbe, i lut serbët e Kuvendit të saj për ta bërë ushtrinë e Kosovës, kjo është një mjerim i tmerrshëm. Është një “sui generis”, që jemi mësuar t’i themi vazhdimisht.

Kjo tregon pafuqinë dhe fuqinë tonë. Mjerim!

Çlirimtarët dhe komandantët u dënuan sot, dje, pardje. Nuk janë vetëm rasti “Drenica 1” e “Drenica 2”, janë prej 2001 e 2002 kur kanë filluar dënimet, prej Fatmirit, Ramushit, “Grupit të Dukagjinit”, “Grupit për Drenicë”, grupe e grupe, deri tash këtu. Pra, për 17 vjet duke dënuar vetëm që mos të jenë të lirë, vetëm të mos jenë me familje të tyre, vetëm të mos jenë në shërbim të atdheut, për të cilin luftuan me familjet e tyre dhe ishin në ballë të luftës dhe udhëheqjen e saj.

Sot e dënuan edhe “Grupin e Drenicës”, por lirinë e tyre nuk mund ta dënojë askush. Sot u dënuan, por ata janë të lirë, me ndërgjegjen e tyre shpirtërore. Sot kujtoj edhe kohën kur e kemi kaluar bashkë me Sylën, me Rexhën, me Kadriun, me Hashimin, me Lahiu, me Dautin, me Luanin dhe me Zahirin dhe të tjerë. Të gjithë ata kanë krijuar vlera, secili në vete. Edhe te Muja,

edhe te plaku Xheladin Gashi, edhe te Bislimi, tjetri e tjetri rend me shumë e shumë bashkëluftëtarë, njerëz e dëshmorë.

Ato aktivitete guerile për lirinë e vendit tonë, ato sakrifica, ato mundime në atë kohë të shenjtë të angazhimit tonë për këtë tokë të shenjtë të atdheut tonë. Dhe, atdheu ynë ka nevojë çdo herë dhe sot për kontributin tonë, kontributin e tyre për t'i mbrojtur, sepse populli është me ta, është bërë me ta, me ndërgjegjen kombëtare qëndrojnë ata sot aty, nëpër burgje. Sepse, duke mbrojtur luftën tonë, duke mbrojtur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, ata mbrojnë kombin shqiptar.

Dhe sot, ata janë pjesë e atdheut të lirë, me lirinë kombëtare, që kombi shqiptar të jetë i bashkuar në një shtet. Sot ata i dënuan, po sot ata janë prezent, në çdo familje, sidomos sot. Ata sot i kanë pushtuar të gjitha mediat, të gjitha shtëpitë, të gjitha familjet, gjithë ndërgjegjen kombëtare shqiptare, me qëndresën e tyre, me sakrificën e tyre, me ndërgjegjen, vuajtjet dhe lirinë. Ata sot bashkohen me ndërgjegjen shqiptare në botë.

Sot t'i e fitove lirinë me ndërgjegjen kombëtare, të nderuar komandant të Shtabit të Përgjithshëm, Sulejman Selimi dhe ju të tjerët, të gjithë, të njohur për qëndresën, për forcën që ke në vete, mbaju siç ke ditur të mbahesh çdoherë. Jetojmë me ndjeshmërinë e vuajtjeve të tuaja, sepse “Në kundërshtime nuk vyen ligështuar, mjerë ai që nuk qëndron”, ka thënë Luigj Gurakuqi.

Para se të dalim te të tjerat, kemi rastin e masakrave, të cilat ne i kemi përjetuar vetë drejtpërdrejt nëpër burgje, sidomos në Burgun e Dubravës, ku janë vrarë 120 burgosur, mbi 300 të plagosur, 2 vetëvrasje e të tjerë të lënduar shpirtërisht, me trauma të ndryshme.

Më 19 janar 2007 Shoqata e të Burgosurve Politikë ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Qarkut në Pejë, e cila është bërë me emër e mbiemër për të gjitha vuajtjet dhe vuajtësit që ishim dhe kemi bërë kallëzim për drejtorin e Burgut me emër e mbiemër, ndaj të cilit nuk është marrë asnjë masë. Aleksandar Rakoçeviqi sot bën vaki është edhe pensionist në Beograd, ku në Burgun e Beogradit e kemi pasur prapë drejtor. Pastaj Miodrag Vidiq – Mikit, komandant i burgut, që ka qenë prezent, shihet edhe në fotografi që do t'i ilustroj më vonë.

E kemi Branko Komadinen, po ashtu gardian që ne e kemi përmendur disa herë në rastin e marrjes së Ukshin Hotit, që e ka përcjellë deri te dera dhe askush s'di për fatin e tij, ku është e ku s'është.

Asnjëherë s'është përgjigjur Serbia, po edhe shteti i Kosovës nuk ka bërë një kërkesë zyrtare, asnjë kushtëzim nga askush për të ditur për të.

Milosh Stojanoviqi, Bora Vlahoviq - Munja, Dushan Antiq, e të tjerë.

Këto janë dëshmi, një kallëzim që është bërë prej 2007, bëhen 9 vjet dhe askush s'ka marrë asnjë përgjegjësi, as Prokuroria e Pejës. E kemi mbajtur një seancë në Kuvendin e Kosovës për masakrën e burgut të Dubravës, diku nja 4 vjet i ka dhe kemi nxjerrë një rezolutë dhe ajo rezolutë asnjëherë s'është implementuar. Kjo do të thotë se ne kemi bërë kallëzime penale, por askush nga drejtësia nuk është marrë.

Këtu kemi po ashtu një kallëzim penal pikërisht për rastin e Dubravës të bërë nga Fondi për të Drejtat Humanitare në Beograd kundër 34 përgjegjësve për vrasjen e më shumë se 90 shqiptarëve dhe 150 të burgosur shqiptarë të plagosur më datën 22 dhe 23 maj 1999. Thotë, kallëzim penal bëhet kundër ministrit të Drejtësisë së Qeverisë së Serbisë, Dragolub Janković, zëdhënësit të tij Zoran Stevanović dhe asistentit të Ministrit të Punëve të Brendshme, gjeneralit Obrad Stefanović dhe shumë të tjerëve për masakrën në burgun e Dubravës, prandaj kemi akuza, por s'është marrë askush me këtë çështje.

Dëgjova këtu se u tha nuk duhet ndërhyrë në drejtësi. Po drejtësia është politike sot, nuk ka drejtësi. Në cilin rast kemi drejtësi? Prej vitit 2000 e këndej dhe deri me ditën e sotme asnjë rast nuk kemi drejtësi, por kemi drejtësi politike, drejtësi politike të bashkësisë ndërkombëtare ndaj shqiptarëve dhe asnjëherë s'është marrë një drejtësi kundër Serbisë. Asnjë kriminel serb, të mos i përmend me raste, se i përmendët të gjithë, se masakra është bërë e asnjë s'është dënuar. Hajde t'i krahasojmë cili serb është dënuar në Kosovë për krimet që i ka bërë? I dinë me emra mbiemra.

Prandaj, nuk është përzierje në drejtësi në themi se drejtësia është politike, nëse themi drejtësia është selektive, nëse drejtësia është kundër shqiptarëve dhe i ndan etnikisht shqiptarët dhe kërkojnë të pajtohen shqiptarët me serbët, duke i dënuar shqiptarët. Nuk ka mundësi. Nga familjet tona të vetëm një fshati janë të vrarë dhe dëshmorë 22. Ata 22 dëshmorë kanë familje, kanë vëllezër, kanë motra dhe ata s'mund të pajtohen. Si do të pajtohen që asnjë nga ata vrasës të tyre që shëtitën edhe nëpër Prishtinë nuk është dënuar. Krejt kanë kallëzime penale.

Mendoj se në atë rezolutë është mirë ta fusim një pikë, ku duhet të kërkohet nga ombudspersoni se edhe EULEX-i e ka një ombudsperson në Bruksel dhe atje të kërkohet rishikimi i drejtësisë. Rishikimi i dënimeve që i ka bërë EULEX-i në Kosovë, në përgjithësi. Është një ombudsperson që e kanë ata dhe aty duhet kërkuar nga ai me të gjitha faktet të rishikohen këto.

Po para se të dal, edhe një rast tjetër e kam, për shembull, kur u përmend veriu, Mitrovica, ndarja, e tjera e tjera, por të dimë se rasti i zgjedhjeve në Mal të Zi, 17 policë serbë të Kosovës kanë marrë pjesë me Dinkiçin në sulmin për grusht shtet në Mal të Zi. 17 policë serbë, me uniformë të Policisë së Kosovës.

As Ministria jonë, as Policia jonë nuk ka dalë me deklaratë të thonë kush janë këta, pse kanë marrë pjesë, pse janë përzier në punë të shtetit tjetër, dhe pse nuk e kanë mbrojtur ose janë përgjegjës për këtë.

Mendoj se Ministria e Punëve të Brendshme të ne është duke fjetur, bashkë me organet e tjera dhe kjo tregon se ne kemi defekte në institucione. Këto defekte nuk përmirësohen me këso formash. Nuk përmirësohen me heshtje, nuk përmirësohen me akuza mbi akuza. Sot do t'ju sjell një fotografi që ka ndodhur në Podujevë, ku e kemi ushtarin serb që ia ka prerë kokën shqiptarit dhe ia ka vënë këmbën mbi kokë. A ka më rënd?!

As në kohën e fashizmit, as në kohën e nazizmit, as në kohën e Pinoçetos në Afrikën e Jugut nuk ka pasur këso raste. Qe ku e kemi një rast. Kjo është një masakër, ky është një krim, ky është një gjenocid, askush nuk është dënuar. Dhe ne kërkojmë pajtim, kërkojmë t'u bëjmë asociacione, kërkojmë t'u japim çka lypin të tjerët, edhe kryetari, edhe presidenti, edhe kryeministri kemi qenë në një debat në Asamblenë e NATO-s që ishte në Prishtinë dhe ishte një ngjarje e madhe për ne, dhe që ishin shtetet prezent të NATO-s nga shumë shtete të vogla që janë anëtarësuar në NATO të dala nga ish-Bashkimi Sovjetik, të cilat me popullsitë e tyre që i kanë nëpër shtetet e tyre pakica i quajnë me nga 20 – 30% dhe nuk e kanë asnjë të drejtë.

Por, le të mbetet çështje e një marrëveshje politike që është bërë dhe ne jemi gëzuar kur e kemi shpallur pavarësinë dhe tash pasojat e asaj pavarësie jemi duke i parë. Unë po sjell fotografi të burgut të Dubravës, krimet që janë bërë, të cilat i kanë bërë Aca, Miki, Branko e tjera. Ky është Miki pranë kufomave që ecën.... Ky është Miki me pushkë automatike në spitalin e burgut. Këtu është me makinë në ditën e parë kur është bërë granatimi nga NATO që janë vrarë në burg 3 të burgosur, 5 janë të plagosur, e një ndër ta është edhe Enver Topalli. Është Miki që ka ardhur aty dhe ka hyrë me automatik.

Kjo është masakra brenda që i kemi mbledhur ne të burgosurit kur kemi qenë aty, viktimat që janë vrarë nga policia dhe ushtria dhe civilët serbë që kanë qenë brenda të burgosur, janë veshur e janë armatosur, edhe ata kanë gjuajtur me pushkë automatike, me zolla e me gjitha çka kanë pasur.

Këtu shihen komunitetet rom, ashkali e tjerë që kanë marrë pjesë edhe ata drejtpërdrejt, është pjesë e tyre në bartje, në krime e tjera, e tjera. Këtu shihen civilë të burgosur serbë duke gjuajtur.

Për të folur për këtë kemi sa të duash, kemi këtu përgjegjësin që e ka torturuar Ivan Trifunović, drejtor i Burgut të Mitrovicës së Sremit, torturat që i janë bërë të burgosurve. Kemi kallëzuar, kemi folur, kemi bërë rezoluta, kemi bërë fjalime, kemi bërë deklarata. I kemi të gjitha dhe prapë këta flenë rahat dhe ne prapë flasim, por nuk do të heshtim, asnjëherë s'do të heshtim duke i mbrojtur të drejtat tona, vlerat tona, luftën tonë, vullnetin tonë, dëshirën tonë t'i mbrojmë njerëzit

tanë, dëshmorët tanë, sepse duke mbrojtur luftën, ne mbrojmë kulturën tonë, mbrojmë traditën tonë, mbrojmë atdheun tonë, mbrojmë kombin tonë që me shekuj ka qenë pjesë e vuajtjeve.

Mund të them se këtu kemi për çka të duash të flasim. Ja ku janë çetat e serbëve. Ne nuk jemi kundër serbëve, ne kemi qenë kundër pushtetit serb, kundër ushtrisë serbe, kundër policisë serbe, kundër kolonializmit serb që ka qenë në Kosovë që nga 100 vjet, prandaj edhe një herë mendoj se ky Kuvend, në vend që sot të na bashkojë, të na ofrojë, të na i ofrojë vlerat tona, se vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk janë të një individi, nuk janë të një partie, janë të popullit tonë, ato vlera janë krijuar me mund, sakrificë, gjak, prandaj t'i mbrojmë vlerat tona dhe atë pikë që e kanë futur në rezolutë për ta nxjerrë një ligj dhe të mbrojmë këto vlera, sepse me mbrojtjen e këtyre vlerave, do të mbrojmë dinjitetin e popullit, lirinë e popullit tonë, luftën tonë, të ardhmen tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Nait Hasani, faleminderit! Respekt për të gjitha ato vite vuajtjesh tuaja. Po e përfundojmë me kaq, apo të vazhdojmë. Agim Çeku e ka kërkuar fjalën, por kishim përfunduar, edhe pse ka ende diskutues. Këtë pjesën vetëm te draft-rezoluta kishim dalë për harmonizim, për ta votuar në ditën e nesërme.

AGIM ÇEKU: Faleminderit, kryetar!

Faleminderit edhe juve që treguat durim për të dëgjuar. E di se u bë vonë, por e pashë të arsyeshme që edhe unë t'i them disa fjalë.

Në radhë të parë dua t'u bashkohem të gjithë atyre që këtë vendim të gjykatës së fundit e cilësojnë si të padrejtë dhe e cilësojnë se drejtësi kësaj radhe në emër të drejtësisë bën një padrejtësi.

U tha këtu se dënimet shqiptohen në emër të popullit. Pa marrë parasysh cila gjykatë i ka dënuar këta bashkëluftëtarë tanë, gjykatësi më i mirë dhe arbitri më i drejtë është opinioni publik. Ky vendim s'ka arritur të më bindë as mua, asnjërin prej nesh dhe as opinionin publik që është i drejtë, andaj ne besojmë se këtu ka edhe motive të tjera pse është marrë ky vendim i tillë.

Dola këtu të jap kontributin tim në mbrojtjen e vlerave të luftës. Nuk do të zgjas shumë, besoj, por edhe unë do ta bëj një tregim personal.

Kam pasur një karrierë, shumica prej jush e dini, kam pasur momente edhe të gëzimit, të krenarisë edhe të tjerë, por tri në jetën time i veçoj.

Hera e parë kur drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, presidenti i tanishëm, kryetari i Parlamentit dhe shumë të tjerë kanë filluar zyrtarisht të më angazhojnë, kur kam filluar që

konkretisht të punoj diçka për vendin tim, për popullin tim, për ndërtimin e ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Momenti i dytë është kur kam hyrë në Kosovë, në takimin e parë kur ia kam shtrirë dorën ushtarit të parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Dhe, momenti i tretë, ka qenë takimi i parë, i kujtohet mikut tim, Rexhës, kur jemi takuar natën kur ka kapitulluar Serbia, po atë natë kanë ardhur ushtarët e parë në Shtabin e Përgjithshëm në Divjakë dhe kur ia kemi shtrirë dorën njëri-tjetrit, e kemi parë se përfundoi lufta, filloi një partneritet me bashkësinë ndërkombëtare. Atë natë kemi menduar se sa krenarë jemi, sa faqebardhë e përfunduam luftën, çka në të vërtetë është UÇK-ja. Kam pasur përvoja edhe në luftëra të tjera dhe kam bërë krahasimet.

UÇK-ja i pati vlerat e përmendura, ushtri mbrojtëse, ushtri çlirimtare, po vlera më e madhe e UÇK-së është se ka zhvilluar luftë të pastër, pastërtia e luftës së UÇK-së dhe kjo është vlera më e madhe, e pikërisht në këtë vlerë më të madhe të UÇK-së po atakohet.

E përfunduam luftën dhe atë natë, në të cilën ka qenë edhe Haxhi Shala, kemi biseduar, e përfunduam, siç thashë faqebardhë. Nuk mbetet në historinë tonë se UÇK-ja ka bërë luftë kundër civilëve. Ka bërë luftë të pastër, vetëm kundër ushtrisë, policisë, forcave paramilitare, administratës represive. Nuk mbeten në historinë e luftës sonë masakrat, jo të fshatrave të tëra, por asnjë familje, as një shtëpi, e tjera, e tjera dhe kjo është vlera më e madhe dhe aq më tepër është kjo vlerë më e madhe kur bëhet fjalë për një ushtri, e cila është formuar nga djemtë e vajzat entuziastë, atdhetarë, pa ndonjë edukatë ushtarake, pa ndonjë shkollim se çfarë janë rregullat e luftës dhe konventat e ndryshme, e tjera e tjera, pa ndonjë trajnim shumëvjeçar, pa ndonjë doktrinë të shkruar, të studiuar, e tjera, e tjera, nga shteti, pa ndonjë logjistikë sistemore të shtetit për furnizim, armatim, pajisje, modernizim, e tjera, e tjera. Dhe, një ushtri e tillë është ngritur mbi standardet më të larta të luftës, për luftë të pastër, luftë çlirimtare, luftë mbrojtëse. Dhe, kjo është vlerë.

Dhe, duhet ta them edhe këtë, pse po flas. Mu të nesërmen jemi ballafaquar, ka ndodhur një zhgënjim, jemi ballafaquar me një kërkesë që kjo ushtri e tillë me të cilën ne të gjithë krenohemi e mburremi dhe duhet të krenohemi, duhet të zhbëhet, thanë. Duhet të zhbëhet, e keni kryer misionin dhe duhet të shkoni në shtëpi, këtu tani është prezenca civile-ushtarake në Kosovë dhe se askush tjetër s'bën të jetë.

Dhe, nga ajo ditë për UÇK-në filloi një luftë e re, lufta e ruajtjes së substancës dhe vazhdimësisë së saj. Këta, duke filluar nga presidenti ynë që po atakohet sot në mënyrë shumë të papërgjegjshme dhe shumë të ligë nga disa individë, e fituam këtë betejë. Dikush disa herë e ka përmendur këtu se demilitarizimi ka qenë humbje. Demilitarizimi ka qenë fitore shumë e madhe.

Disa ditë kanë zgjatur bisedimet në malet e Berishës me drejtuesit më të lartë të NATO-s dhe bashkësisë ndërkombëtare. Ata kërkonin shpërbërje, ne kërkonim transformim. Do të thotë, mbijetesë, vazhdimësi, që vlera, substanca e UÇK-së, themeli i lirisë të mbetet dhe mbi të ndërtohet shteti modern i Kosovës.

Ia dolëm. Ia dolëm me TMK-në, ia dolëm me FSK-në dhe shumë shpejt do t'i kemi, besoj, Forcat e Armatosura të Kosovës dhe na dha të drejtë historia. Kështu që, kur nuk mund ta zhbëjnë UÇK-në, filluan t'i godasin shtyllat e UÇK-së, filluan procese gjyqësore. E dinë bashkëpunëtorët e mi, që shumë prej tyre janë këtu, filluan t'i godasin dhe të imponojnë një identitet tjetër të TMK-së, të shkëputet nga UÇK-ja, të mos jetë trashëgimtare e UÇK-së dhe vlerave të UÇK-së. Filluan t'i godasin oficerët e lartë që mendonin se janë pengesë për një gjë të tillë.

Qe, këtu janë Dauti, Rexha, Ramizi, Samiu, Remi. Pra, pa asnjë arsytim, vetëm duhet të largohen nga këtu. Filluan suspendime të oficerëve, qe Nura e di. Filluan të atakonin, e pastaj filluan edhe arrestimet, burgosjet, Haga, e tjera, e tjera. Ishin përpjekje të shumta që të krijohet një frymë anti-UÇK, që t'i imponohet popullit të Kosovës të distancohet nga UÇK-ja për arsye të ndryshme. Po, nuk ia dolën!

Dua ta ngre pak këtë bisedë pse ne duhet ta mbrojmë UÇK-në.

Të nderuar deputetë, të gjithë jemi dëshmitarë se Serbia s'ka hequr dorë prej Kosovës, në forma të ndryshme, në faza të ndryshme dhe e para ka qenë menjëherë pas luftës që të gjitha njësitë që i ka pasur këtu, të tilla, pa ndonjë ndryshim, i ka dislokuar rreth kufijve të Kosovës, duke shpresuar se do të kthehen një ditë. Dështoi ai projekt.

Pasi dështoi, shkuan në rrafshin ligjor. "Do ta fitojmë betejën me Kosovën dhe do të dëshmojmë se është shkelur e drejta ndërkombëtare"! E fituam ne atë betejë në gjykatë.

Tani janë duke ndodhur dy projekte të tjera. Projekte të sajua, projekte të menduara, të gatuara. I pari është që të vazhdojë me vite të tëra dhe Serbia dëshiron ta fitojë amnistinë para historisë, sidomos para opinionit ndërkombëtar, para faktorit ndërkombëtar për krime të bëra në luftërat në këto treva.

Dhe, në këto tri drejtime, në tri shtylla bazohet ky projekt. I pari është të luhet roli i viktimës në mënyrë masive, të paraqiten vetë serbët si viktimë. Për t'u paraqitur viktimë, duhet të ketë procese gjyqësore sa më shumë, sa më shumë të kundërshtarëve të Serbisë.

Dhe merreni, shembull, këto aktakuza, gjykime, arrestimin e fundit, të gjitha janë këto konstruksione.

Pista e dytë është refuzim i të gjitha argumenteve që dëshmojnë gjenocidin. Për shembull, refuzim kategorik i rezolutës për gjenocidin në Srebrenicë, e tjera, e tjera, refuzime të tilla.

Edhe shtylla e tretë është të dëshmohet, të minimizohen krimet sa më shumë që është e mundshme.

Ju jeni dëshmitarë, për shembull, me të zhdukurit tanë, çka ka ndodhur dhe çka po ndodh.

Kur i gjenin në varreza masive me 500 trupa i kthenin një ditë, ne kemi qenë dëshmitarë në TMK, i pranohet në kufi një ditë 20, pas dy muajve 15, kështu edhe pas muajve të tjerë, vetëm të mos shihen përmasat e krimeve të tyre.

S' di a e keni parë? Kur ishte përvjetori i Srebrenicës, çfarë filmi kanë bërë për Srebrenicën. Kur u sheh atë film, dukej se ata kinse paskan qenë viktimë në Srebrenicë.

Do të thotë, edhe në këtë rast, në këtë projekt të tyre ne jemi viktimë, është e goditur edhe Kosova, sidomos UÇK-ja. Këtë duhet ta kemi parasysh.

Projekti i dytë i Serbisë që është duke ndodhur tani, në këtë rrafsh, për Kosovën është që Kosova të bëhet shtet i dështuar, të mos konsolidohet si shtet. Dhe, në këtë drejtim, pengesa është UÇK-ja, njerëzit e UÇK-së.

Është PDK-ja si trashëgimtare e UÇK-së, të krijohet një klimë anti-UÇK, të krijohet një klimë anti-PDK, të zbutet, të dobësohen mbrojtësit, krijuesit e shtetit, formuesit e shtetit të Kosovës.

Për këtë punë bllokohen forcat e armatosura, për këtë punë imponohet Asociacioni, e tjera, e tjera, me kompetenca çfarë i ka.

Pra, ne duhet të ruhem nga këto dy projekte. Dhe krejt këto projekte shkohet të realizohen me kartën e Bashkimit Evropian. Ne themi, do të shkojmë drejt Bashkimit Evropian, kurse bashkësia ndërkombëtare është pak e gatshme të bëjë koncesione në realizimin e këtyre projekteve, e shpeshherë edhe në dëm tonin. Pra, e paguajnë çmimin e këtyre projekteve me kartën e tyre për t'i hapur rrugë Serbisë.

Për këtë arsye, ne kam besuar se do të jemi të gjithë unikë në mbrojtjen e vlerave tona, në mbrojtjen e ADN-së së lirisë dhe pavarësisë sonë që është Ushtria Çlirimtare e Kosovës me vlerat e saj.

Dhe, së fundi, do të ketë edhe Gjykatë Speciale, që disa prej nesh e kemi votuar. E kemi votuar të mos sanksionohet shteti. Asnjëri prej nesh s' e ka bërë me vullnet. E kemi votuar, sepse kemi thënë të gjithë se jemi të gatshëm përballë drejtësisë dhe jemi i vetmi vend, i vetmi popull, e

vetmja ushtri që nuk ka pasur largim nga drejtësia, ikje nga drejtësia apo arratisje, por secili prej nesh kush ka qenë i akuzuar ka shkuar vullnetarisht, e kjo është vlerë dhe do të ndodhë kështu edhe me Gjykatën Speciale.

Kemi gjyqe vendore, kemi gjyqe ndërkombëtare, e kemi Hagën, e kemi Specialen, por një gjë është më e rëndësishmja, ajo është gjyqi i historisë dhe gjyqi i popullit. UÇK-ja në këtë gjyq është ende, por UÇK-ja në këtë gjyq do të dalë fitimtare dhe kjo është më e rëndësishmja. Nuk është i rëndësishëm asnjë individ prej nesh, kjo është e rëndësishmja dhe atë duhet ta ruajmë. Para gjyqit të historisë ne jemi fitues. Para gjyqit të popullit, ne jemi fitues.

Edhe këta djem, bashkëluftëtarët tanë, që janë gjykuar para opinionit janë fitues, janë heronjtë e mi, janë heronjtë e të gjithëve dhe ashtu do të mbesin.

Për fund, ndiej të nevojshme edhe këtë ta them. Çdo luftë, çdo ushtri nxjerr edhe heronj, edhe liderë. Ka edhe liderë heronj. Ne i kemi liderët tanë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që u kanë prirë të gjitha atyre proceseve.

Dikujt ndoshta i duket se kanë bërë ndonjë lëshim. Kam qenë edhe vetë në disa procese i kyçur, kam qenë shumë herë edhe pranë atyre që kanë marrë vendime, dhe e di se kanë marrë vendime të vështira, të dhimbshme, por gjithherë të bindur qind për qind se i kanë marrë në favor të vendit tonë për të ecur procesi, për të ecur vendi, procesi i formimit të shtetit në partneritet me faktorin ndërkombëtar.

Atëherë, të mos japim kualifikime aq të lehta, kualifikime shumë të rënda, sidomos për presidentin e vendit tonë, që u ndie sot këtu dhe jam ndier shumë keq, e s'po mund as të besoj se një njeri i tillë mendon ashtu.

E kemi një behane të madhe ne si popull. Shumë u besojmë të huajve, shumë më shumë se njerëzve tanë. Shumë besojmë se njeriu ynë di më pak, mundet më pak, e ka shtirë dikush, ka një agjendë tjetër. Ai i huaji te ne është blanko.

Nuk është ashtu. Djemtë tanë, njerëzit tanë, liderët tanë e donë këtë vend sa ne, kanë dhënë për këtë vend, janë duke e ndërtuar këtë vend ashtu siç duhet.

Pra, UÇK-ja është një epokë dhe duhet ta ruajmë, sepse epoka, e dimë, nuk nxirret para gjyqit. Nuk ka gjyq që e dënon një epokë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, të shkojmë në harmonizimin e draft-rezolutës. A do ndokush tjetër të marrë fjalën? Nuk ka më të lajmëruar për fjalë.

Sa deputetë i kemi në sallë? Në sallë i kemi 55 deputetë!

Dhe, të presim, sepse edhe 6 deputetë na duhen të jenë të pranishëm dhe do të ishte korrekte të ishin.

Ndërkohë, Nezir Çoçaj e paraqet fjalën e vet.

NEZIR ÇOÇAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra të kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të respektuar,

Ka vite të tëra që eksponentë të caktuar vendorë e ndërkombëtarë në mënyrë sistematike kanë propaganduar, gënjyer dhe shpifur në adresë të luftës çlirimtare, duke mos kursyer edhe vetë popullin shqiptar.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës kurrë dhe në asnjë mënyrë nuk i ka cenuar qytetarët e vet. Këtë punë e konfirmoj edhe unë si pjesëtar i asaj Ushtrie të lavdishme, e cila ishte motor kryesor i lirisë dhe pavarësisht të vendit.

Janë ushtarët dhe udhëheqësit e UÇK-së që nuk u trembën asnjëherë, por, përkundrazi, sakrifikuan gjithçka për ta mbrojtur popullin dhe vendin.

Këto burgosje që po bëhen dhe të tjerat që mund të pasojnë nuk do të krijojnë mur në mes të UÇK-së dhe popullit, por përkundrazi, lidhja do të forcohet më tepër se kurrë, me të vetmin qëllim që të mbrohet vlera sublime e UÇK-së.

Është për keqardhje se si një gjykatë, me gjyqtarë dhe prokurorë ndërkombëtarë, sjell një vendim në kundërshtim me të gjitha normat perëndimore dhe një kundërshtim me të gjitha të drejtat dhe parimet universale për të drejtat e njeriut.

Të nderuar kolegë,

Më lejon të shpreh zhgënjimin tim për një proces të montuar dhe të orkestruar, ku mbetën të dënuar ish-ushtarë dhe udhëheqës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në një gjykim krejtësisht të njëanshëm, jo të barabartë, me dëshmitarë të rrejshëm dhe me fakte të fabrikuara jashtë Kosovës.

Ky dënim konfirmon hipotezën se në Kosovë duhet të dënohet dikush nga pozitat e larta ushtarake të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për ta barazuar gjenocidin serb me luftën çlirimtare të Kosovës.

Është për keqardhje se edhe disa individë shqiptarë së fundmi po mundohen të tërheqin paralele në mes të gjenocidit serb dhe luftës për mbrojtje dhe çlirim nga forcat paramilitare e ushtarake të ish-sistemit gjenocidial të Milosheviqit.

Qytetarë të nderuar,

Serbia është duke investuar jashtëzakonisht në destabilizimin e rajonit, ku për ndihmë ka shumë eksponentë vendorë e të huaj, ndërsa ne si shtet i vogël po bëhemi viktimë e një propagande armiqësore serbe, qëllimet e së cilës dihen botërisht. Serbinë e mundon dhe e shqetëson fakti i një Kosove të zhvilluar dhe i një Kosove me perspektivë evropiane dhe të orientuar drejt Perëndimit.

Unë bëj apel në bashkësinë ndërkombëtare, në shtetet mike të Kosovës, të na respektojnë e besojnë si një aleat i tyre i fuqishëm dhe i qëndrueshëm në Ballkan, e të mos bien pre të propagandave serbe dhe të disa individëve dashakëqij të Republikës së Kosovës.

Unë besoj në vlera properëndimor, ashtu siç jemi të orientuar ne si shtet dhe si popull. Dhe, po ashtu besoj se shkalla tjetër e gjyqësorit, Gjykata Supreme, do ta vërtetojë pafajësinë e çlirimtarëve. Faleminderit!

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

SALIHE MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Si nënë, si motër e si bashkëshorte, s'kam se si të ndihem mirë sot, kur shoh se dikush përkundër që dhanë shumë për këtë vend në luftën çlirimtare, akoma vazhdojnë të përballen me sfida. Aq shumë ndihem keq, që kryerësit e krimeve në masakrat gjithandej Kosovës vazhdojnë të shijojnë lirinë e pamerituar, ndërsa çlirimtarët po burgosen me dëshmi që nuk jep sinjale se janë bindëse.

Duke mos dashur në asnjë mënyrë që të ndërhyjmë në pushtetin e ndarë - drejtësinë, ne duhet thënë këtë shqetësim të qytetarëve të vendit, e që janë njëkohësisht edhe shqetësime tona.

Burgosja e çlirimtarëve është mesazh i keq që po jepet sot në vendin tonë, aq më shumë kur tani, ata që dhanë më së shumti që ne sot ta gëzojmë lirinë, sot u është privuar liria.

Jemi për hetime e gjykime për të gjitha rastet që mund të ketë dyshime të bazuara për kryerje krimesh dhe besoj se në këtë drejtim drejtësia ka shumë punë për të nxjerrë para drejtësisë të gjithë ata kriminelë serbë që vranë e masakruan me dhjetëra mijëra qytetarë të vendit.

Të gjithë që 17 vjet po presim kur do të shohim vrasësit para drejtësisë, ndërsa për çudinë e të gjithëve ata vazhdojnë të jenë të lirë. Burgosen e dënohen pikërisht ata që mbrojtën jetë njerëzish dhe nuk lejuan spastrimin etnik të Kosovës nga okupatori serb.

Të dënohen komandantët dhe ushtarët më të spikatur të UÇK-së, siç janë komandant Sylejman Selimi, pastaj vëllezërit Demaku, Demaj e z. Thaçi, dhe të tjerë, me disa deklarata që nuk janë shumë bindëse nga dëshmitarët, që po ashtu ka dyshime serioze për kredibilitetin e tyre, është sinjal jo më i mirë i mundshëm për vendin tonë.

Sot sidomos në kolegët e grupit parlamentar e kemi të vështirë që sot këtu na mungon kolegu ynë Fadili, i cili gjatë gjithë kohës tregoi gatishmëri për të punuar, por edhe për të sakrifikuar të mirën e vendit dhe të ardhmes sonë.

Është për t'u përshëndetur gatishmëria e të gjithë këtyre, por edhe e dhjetëra luftëtarëve tjerë që ishin dhe janë të gatshëm ta dëshmojnë pafajësinë e luftës sonë duke mos hezitur në asnjë moment që të dalin para gjykatave për ta respektuar ligjin dhe për të dhënë mesazhe të qarta para të gjithëve se drejtësia duhet respektuar dhe vetëm kështu krijohet dhe ndërtohet shteti ligjor. Por, që kjo gatishmëri e tyre, sikur po ngjan që disa po i keqpërdorin për ta njollosur luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Parlamenti i Kosovës dhe të gjitha institucionet e vendit duhet të jenë maksimalisht të angazhuar që këtë vlerë kombëtare ta ruajmë, ta kultivojmë dhe ta mbrojmë edhe me ligj. Pra, jo duke ndërhyrë në drejtësi, por duke kërkuar respektimin e ligjit dhe konventave ndërkombëtare ta mbrojmë të drejtën e luftëtarëve tanë, të luftës sonë dhe të ardhme së vendit tonë.

Sot më shumë se dje dhe më pak se nesër e them me bindje të plotë se jemi me Fadilin, Sylën, Nexhatin dhe të gjithë ata që sot jo me të drejtë të plotë janë dënuar për shkak se luftuan kundër një agresori dhe ndihmuan e shpëtuan qytetarin e vendit të vet të pambrojtur.

Përherë do të jemi krah familjeve Selimi, Demaku, Demaj e Thaçi, sepse ata Kosovës i dhanë shumë, i dhanë dje heroit të luftës dhe sot të njëjtit janë edhe heroit të paqes duke u sakrifikuar, madje disa me familje, siç është rasti i kolegut Fadil Demaku me vëllezër, për të treguar respektin për ligjin dhe drejtësinë në Kosovë.

Por, shtrohet pyetja: Drejtësia, a iu përgjigj me të njëjtën korrektësi dhe respekt këtyre heronjve? A u respektua ligji dhe konventat ndërkombëtare në rastin "Drenica" dhe në të gjitha rastet tjera ku u gjykuan luftëtarët e lirisë?

Në jemi përcaktuar për shtet ligjor dhe kemi synime të qarta të integritetit euroatlantik, andaj në asnjë moment nuk duam dhe nuk kemi synim të ndërhyjmë në drejtësi, por kërkojmë drejtësi për

të gjithë dhe dënim të të gjithë atyre që kanë bërë krime pa asnjë dallim. Masakruesit dhe vrasësit e fëmijëve shqiptarë po presin të shohin kriminelët serbë para drejtësisë.

Drejtësia duhet të triumfojë dhe për këtë ne të gjithë do të jemi në shërbim.

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

AGIM ALIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Sot, në këtë seancë të jashtëzakonshme, para jush dëshiroj të shfaq shqetësimin tim në lidhje me ngjarjet e fundit, të cilat kanë të bëjmë me vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Pa dyshim se Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe lufta e saj është e shenjtë për popullin shqiptar, mirëpo kjo luftë nuk është e shenjtë vetëm për ne shqiptarët, por shenjtëria e saj kalon edhe kufijtë kombëtarë.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka kaluar kufijtë kombëtarë për faktin se sot mund të mburremi dhe të ndihemi krenarë para botës me luftën e pastër që ajo e ka zhvilluar gjatë periudhës së luftës së fundit në këtë vend. Ishte prandaj edhe kjo arsyeja e përkrahjes së kësaj lufte nga partnerët tanë për lirinë tonë.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka dëshmuar edhe para trupave të drejtësisë ndërkombëtare se luftën e saj e ka bërë në përputhje të plotë me normat e luftës të vendosura me konventat ndërkombëtare mbi luftën.

Duke qenë e tillë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, pa asnjë dilemë mund të konsiderohet si model për të gjithë popujt që e kanë pasur fatin e njëjtë me Kosovën.

Deri më sot nuk kemi parë në asnjë vend të botës një model sikurse Ushtria Çlirimtare e Kosovës, që e mbrojti pragu dhe popullin e saj, dhe doli triumfuese e dyfishtë. Një për shkakun se me përkrahjen ushtarake të botës së civilizuar e largoi politikën e regjimit gjenocidal serb nga Kosova, duke mbrojtur civilët nga masakrat, dhunimet dhe vrasjet mizore, që kanë mundur të jenë akoma më shumë në numër sesa që kanë ndodhur.

Gjithashtu, fitorja e dytë ka ndodhur për shkak se UÇK diti t'i respektojë normat e luftës të vendosura me konventa ndërkombëtare dhe ta ruajë pastërtinë e saj.

Të nderuar, as unë dhe askush nga ne, asnjëherë nuk dëshirojmë dhe nuk do t'ia lejojmë vetes që të ndikojmë në drejtësi, sepse duke e bërë një gjë të tillë, biem ndesh me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjakun e derdhur për lirinë e saj.

Kjo luftë dhe ky gjak i derdhur e kanë pasur vetëm një qëllim, lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë dhe që në këtë vend të lirë dhe të pavarur të garantohet rendi dhe ligji, të ketë drejtësi e cila mungoi për shumë shekuj për një popull që vetëm shtypjen dhe padrejtësitë i përjetoi mbi supet e veta, pa kush më mirë se populli ynë di për vlerën e drejtësisë që nuk e kishte kurrë më parë.

Prandaj, asnjëherë nuk do t'ia lejoj vetes dhe askujt mosreagimin atëherë kur duhet të mbrohet drejtësia, sepse kështu mendoj që e respektojmë luftën e shenjtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe vlerat e saj.

Kërkesa për drejtësi nuk është ndërhyrje në drejtësi, por është e drejtë se ne tashmë pushtetet i kemi të ndara, por aktgjykimi i fundit ndaj udhëheqësve dhe luftëtarëve të UÇK-së manifeston luhatje të dukshme të besimit në këtë aktgjykim të nxjerrë nga institucionet e drejtësisë dhe kjo për faktin se po shpreh tendencë të dukshme dhe të vazhduar për denigrimin e vlerave që përfaqëson lufta jonë.

Tashmë nuk kemi më vetëm ekuilibrin në vendimet gjyqësore ndërmjet viktimës dhe agresorit, por kemi anim të dukshëm, sepse tashmë statistikisht gjyqësore flasin se viktimat na u bëjnë agresor, e agresori na u bë viktima. Kjo konsideroj që është për të shprehur shqetësim dhe mosbesim të thellë edhe për faktin se këto aktgjykime po merren mbi bazën e dëshmive të vetme dhe të dëshmitarëve jokredibilë dhe me autoritet të cenueshëm.

Dua të besoj që në Republikën tonë të lirë të ketë drejtësi dhe që të shtohet besimi në institucionet e saj dhe njëkohësisht të ruhet imazhi i tyre dhe që burgjet tona të mos kenë asnjëherë brenda tyre njerëz të pafajshëm. Siç thuhet në thënien e njohur “më mirë njëqind të fajshëm në liri sesa një i pafajshëm në burg”, por duket që po ikim larg kësaj.

Ajo që dëshiroj të them për fund është se ne duhet të ecim para me këmbët tona pavarësisht stuhive që mund të na luhatin gjatë udhëtimit tonë, që nuk do të njohë prapaktim, përveç lavdisë.

Asnjëherë nuk do të dorëzohemi, por do të punojmë së bashku më fort, për një shtet ligjor dhe të drejtë për të gjithë.

Të mos e harrojmë thënien që për mua ka peshë të veçantë në këto momente që po i kalojmë: “Ajo që nuk të vret, të bën më të fortë”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Propozuesi i kërkesës, zoti Reçica e ka fjalën! Nuk e di grupet parlamentare në e kanë harmonizuar draft-rezolutën e propozuar?

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet, zoti zëvendëskryeministër, së bashku me ministra, që keni qëndruar këtu stoikisht deri në fund të këtij debati.

Debati realisht është shtjerrë dhe ne, e të gjitha grupet parlamentare që ishin këtu prezentë, e kemi diskutuar një draft-rezolutë.

Paraprakisht ju them se jemi dakorduar me këtë që do ta lexoj më poshtë:

- Grupi Parlamentar i “Nismës për Kosovën”,
- Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës,
- Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe
- Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

Pra, unë do ta lexoj këtë rezolutë dhe pastaj të shohim nëse sot s’ka kuorum, ta votojmë në seancën e nesërme.

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Duke u nisur nga respektimi i lartë i luftës së UÇK-së për liri dhe pavarësi;

Duke besuar në luftën e drejtë të UÇK-së, të luftëtarëve dhe komandantëve të saj; Të përkushtuar për ndërtimin e shtetit ligjor dhe demokratik;

Të indinjuar nga tendenca për inkriminim dhe padrejtësi ndaj vlerave të luftës dhe luftëtarëve të UÇK-së, pas debatit të zhvilluar në seancën e jashtëzakonshme, më 27 tetor 2016, nxjerr këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Lufta çlirimtare e Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, me qëllim të çlirimit të Kosovës dhe sjelljes së lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës, me karakter mbrojtës dhe çlirimtar, duke respektuar të drejtën dhe standardet më të larta të luftës, e drejtuar ekskluzivisht kundër forcave ushtarake e policore dhe administratës okupuese të Serbisë në Kosovë, është lufta e armatosur e popullit të Kosovës, e cila mbrohet dhe çmohet nga çdo qytetar dhe institucion i Republikës së Kosovës;

2. Pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, në luftën çlirimtare të Kosovës, ishin faktorë vendimtarë në sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës dhe në këtë drejtim gëzojnë dhe duhet të gëzojnë mbështetjen

dhe vlerësimin e tyre të merituar institucional, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

3. Republika e Kosovës është e përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do t'i garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit, dhe në këtë drejtim çdo tendencë e kujt do qoftë që ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të ndërmarrë masa që janë në kundërshtim me parimet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjeve të saj në fuqi dhe për motive jashtë sistemit të drejtësisë, janë të papranueshme;

4. Sikur çdo qytetar i Republikës së Kosovës, edhe pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i kanë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, dhe këto të drejta mund të kufizohen vetëm me ligj dhe vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që në një shoqëri të hapur dhe demokratike të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi;

5. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë, sikur për çdo qytetar të Republikës së Kosovës, ashtu edhe për pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar;

6. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë nuk bën ta mohojë kurrësi esencën e të drejtës së garantuar. Edhe me rastin e dënimeve të Grupit të Drenicës i ftojmë të gjitha institucionet e pushtetit publik dhe sidomos gjykatat që t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe ta shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël;

7. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, në këtë drejtim edhe në mbrojtjen e pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

8. Të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me Kushtetutë dhe me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, duhet të zbatohen edhe për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

9. Pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë të drejtë për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe sikur çdo qytetari tjetër u garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike;

10. Të gjitha institucionet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për t'i mbrojtur

pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që mund t’u nënshtrohen veprimeve diskriminuese, si rrjedhojë e të qenët pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

11. Kuvendi i Republikës së Kosovës u propozon institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë që t’i dekorojë për merita të veçanta komandantët dhe ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në pajtim me Ligjin për dhënien e dekoratave;

12. Kuvendi i Republikës së Kosovës zotohet që brenda 6 (gjashtë) muajve do ta miratojë Ligjin për mbrojtjen e vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të luftës së saj për çlirim.

Pra, kjo është rezoluta, të cilën ne e ofrojmë, kryetar, për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar Reçica! Do të thotë, e kemi një harmonizim nga grupet parlamentare. Urdhëroni, merre fjalën!

ELMI REÇICA: Kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” ka deklaruar se abstenon për këtë rezolutë! Këtë desha ta saktësoj, meqë kemi biseduar gjatë tërë kohës për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Salih Salihu e do fjalën, shumë shkurt, pastaj e merr fjalën Glauk Konjufca, kryetar i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

SALIH SALIHU: Kërkoj falje, Glauk! Meqë e kemi nesër seancën, ne si grup nuk e kemi prezent një numër të madh të deputetëve, do të ishte mirë të mbetet votimi për nesër. E them këtë, nëse ka mundësi!

KRYETARI: Ishte ky deklarimi juaj. Të shohim edhe deklarin e Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe pastaj vendosim si t’ia bëjmë.

GLAUK KONJUFCA: Kërkoj falje, më duhet t’i shfrytëzoj disa minuta për të folur për diskutimin dhe për rezolutën, dhe kjo nuk do të jetë e shkurtër.

Seanca e sotme, nëse për asgjë tjetër dhe diskutimi i sotëm, më kanë bindur vetëm për një gjë, dhe për asgjë tjetër.

Më ka bindur se zgjedhjet janë afër, dhe kjo sidomos për shkak se performansa e PDK-së në këtë seancë ka qenë fatkeqësisht performansë elektorale, jo për temën në fjalë.

Kjo shkon në përputhje me deklaratën e kryetarit të tyre, tash së fundi, për zgjedhje sa më të shpejta në Kosovë, prandaj po e shfrytëzoj rastin t’u kërkoj falje edhe të dënuarve të “Rastit

Drenica” dhe familjeve të këtyre të dënuarve. U kërkoj falje pse në Kuvendin e Kosovës u fol 80% për “Vetëvendosjen” dhe u kërkoj falje që u fol vetëm 20% për “Rastin Drenica”.

Mateni kohën, këqyrni fjalimet e PDK-së. Nëse nuk keni folur 80% për “Vetëvendosjen” dhe vetëm 20% për “Rastin Drenica” unë jap dorëheqje!

Kjo tregon më së miri se ku po i dhemb PDK-së dhe cili është shqetësimi i vërtetë i PDK-së. Këtu po u këqyrën fjalimet dhe koha të cilën e keni shpenzuar dhe fokusimin tuaj, shqetësimi bash më i madhi nuk po më del UÇK-ja, por po më del “Vetëvendosja”.

Te fjalimet e PDK-së i vëreja dy kategori të fjalimeve. Fjalime, si për shembull, i Sala Berishës apo sikur i Mexhide Mjaku-Topallit, që i vlerësoj shumë korrekte, ashtu si duhet të jetë diskutimi, me një sinjeritet për atë çka është duke na ndodhur, për UÇK-në, për problemin në fjalë, për tematikën dhe fjalime, si për shembull, i Hajdar Beqës, i Naim Fetahut, i Bislim Zogajt, i Blerta Deliu, i Bekim Haxhiut e i shumicës së tjerëve që karakterizohen nga shumë mision, nga goxha naivitet, edhe nga pak budallallëk, qe besa.

Për shembull, Blerta Deliu del dhe thotë se Albin Kurti është tradhtar, sepse ka dalë prej burgjeve të Serbisë.

Ukshin Hoti është hero, sepse atë e kanë vrarë, kurse Albin Kurti është tradhtar me logjikën e kësaj, sepse atë e kanë liruar nga burgjet e Serbisë.

Atëherë kjo më detyron t’i kërkoj falje Flora Brovinës këtu. Flora, shumë më fal, që “je tradhtar” se të ka lëshuar Serbia prej burgju. Bislim, më fal “se je tradhtar” se të ka lëshuar Serbia prej burgjeve. Nait Hasani, më fal “se je tradhtar”, se ke arritur të lirohesh nga burgjet e Serbisë.

Krejt këtyre që mendojnë kështu duhet treguar edhe një gjë. Ukshin Hotin e ka liruar dy herë më herët Serbia prej burgjeve, sepse ky tri herë ka qenë në burg. Të tretën herë e kanë vra.

A do të thotë kjo se dy herët e para ka qenë tradhtar, e vetëm herën e tretë, që s’paska arritur të dalë nga burgju, qenka hero?

Kjo do të thotë është absurde se çka qytetarët e Kosovës kanë dëgjuar sot në këtë seancë.

Kurse sa i përket Albin Kurtit, mos u ngut se është ende herët. Ndoshta herën e ardhshme Serbia mund t’ua plotësojë dëshirën, ndoshta edhe e vranë herën e ardhshme.

KRYETARI: Glauk, je duke e analizuar tërë Kuvendin.

GLAUK KONJUFCA: Jo, veç po i analizoj diskutimet.

KRYETARI: Po, por po i përmend të gjithë me emra, e ata pastaj po donë ta marrin fjalën. Dhe, prit pak, se po na krijon... Glauk, për hir të opinionit publik, një sekondë dhe vazhdoje prapë fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Dëgjo, problemi është ky se keni folur 30 herë për “Vetëvendosjen”. Ju kam kursyer nga 30 replika, ashtu që po i përmbledh krejt dhe flas për temën.

KRYETARI: Glauk, nuk e kam ndërmend ta ndërpres fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Pra, kjo është shumë korrekte dhe mendoj se i kam minutat e mi.

KRYETARI: Glauk, një moment, sepse e kanë kërkuar edhe 10 deputetë fjalën, dhe ty s’do ta ndërpres, mos u frikëso.

Çka të duash fol, edhe pse po e tejkalon, por megjithatë, pastaj po e kërkojnë edhe të tjerët fjalën, dhe për po shihet se janë lodhur deputetët. Po bën analizë të gjerë.

GLAUK KONJUFCA: Po, unë i pritja të gjithë, kanë folur dhe tash unë i mbledha, i shënova dhe tash po komentoj lidhur me këtë.

KRYETARI: Ka reagime nga të gjithë, mund të vazhdosh, por po na sjell në pozicion të keq.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, vetëm edhe një moment, e pastaj do të dal menjëherë te rezoluta. Këtu, të gjithë ata që folën, do të thotë në mënyrë propagandistike, jo për “Rastin Drenica”, por për “Vetëvendosjen” e thanë një gjë duke filluar prej Ganimete Musliu e të gjithë të tjerëve.

Thanë, më së shumti “Vetëvendosja” ka kontribuar që UÇK-ja të shkojë në burg. Kështu, pak a shumë, ishte aktakuza për “Vetëvendosjen”.

Dhe tash, bile Bislimi, më duket, se na akuzoi që e kemi akuzuar Kadriun edhe për vrasje. Nuk është e vërtetë!

Shikoni, të gjitha deklaratat e “Vetëvendosjes” për Kadri Veselin, mund ta akuzojmë për korrupsion, mund ta akuzojmë për bëmat e pasluftës. Por, unë për Kadri Veselin në këtë Kuvend i kam dëgjuar vetëm dy deklarata për vrasje.

KRYETARI: Glauk, më fal, e kisha lutur kryeprokurorin e shtetit ta ketë parasysh çdo deklaratë.

GLAUK KONJUFCA: Doruntina Maloku është deputetja e parë që publikisht, këtu në Kuvend të Kosovës e ka akuzuar Kadri Veselin për vrasje. Jeni bashkë në koalicion...

KRYETARI: Jo, jo! Ngadalë, mos fol pa qenë Doruntina!

GLAUK KONJUFCA: Dhe, s'po di, s'po jam i sigurt deri ku ka shkuar Armend Zemaj me aktakuza. Pra, nuk jam i sigurt, nuk po paragjykoj, mirëpo aktakuzat në këtë drejtim më së shumti kanë ardhur prej Doruntina Malokut dhe prej deputetëve të tjerë, por që nuk janë të "Vetëvendosjes".

Sa për hajni, sa keni vjedhur, sa për tenderë, këtu kemi qenë kritikë gjithmonë dhe do të jemi vazhdimisht.

E dyta. Dua t'jua lexoj një deklaratë dhe dua t'i pyes deputetët e PDK-së: Sa prej juve pajtoheni me këtë deklaratë?

Pra, me ngritje dore, ju mund të më tregoni mua se sa prej juve pajtoheni me deklaratë!

(Reagime)

Deklarata është kjo: "Një kontribut shumë i madh kundër neve, ky po thotë kundër UÇK-së se është komandant i UÇK-së. Një kontribut i madh kundër neve është dhënë prej bashkëpartiakëve, prej juve, po thotë, prej bashkëpartiakëve, prej ministrave dhe prej zëvendësministrave, lobimi i tyre intensiv nëpër ambasada dhe te EULEX-i kundër neve për një kohë të gjatë i ka dhënë frytet e tyre të duhura dhe të pritura, dhe kjo është arsyeja pse po dënohem".

Sa prej juve të PDK-së pajtoheni me këtë deklaratë? E qe, unë po ju tregoj kush e ka thënë. E ka thënë ai i cili është dënuar nga "Rasti Drenica", Sami Lushtaku.

(Ndërhyrje e Nuredin Lushtakut: A mund të mos ia përmendësh emrin, kurrë më! Ti je ky që i ke thënë "kriminel" dhe i ke thënë të gjitha!)

Kush i ka thënë, jo s'i kam thënë "kriminel"! Dhe këtu, nuk mund të më tregojë kurrkush se çka të them. Unë e diskutova një deklaratë të tij, dhe ju pyeta juve a po pajtoheni. Kaq është kontributi im si deputet.

(Ndërprerje - reagime të deputetëve)

KRYETARI: Kisha lutur deputetët që të ulen, për hir të korrektësisë. Ju lus, mos bëni reagime fizike. Deputeti Elmi Reçica, ju lutem, uluni në vendin tuaj, sepse nga pak edhe po vuan ky vend për shkak të aktrimit, por mirë, abuzoni me njerëz... Vazhdon Glauk Konjufca fjalimin e vet, janë lajmëruar edhe të tjerë deputetë, u është përmendur emri dhe vazhdojmë tutje. Por, ju lus të jemi të qetë!

GLAUK KONJUFCA: Shiko, kryetar!

Unë vetëm reagoja ndaj asaj që jemi akuzuar se kemi kontribuar që kjo të ndodhë për Kosovën, të shkojnë njerëzit në burg dhe unë vetëm u kundërpërgjigja.

E tash, sa i përket rezolutës, mendoj se kjo...

KRYETARI: Ju kisha lutur të jemi të qetë. Shikoni, vetë po e nxitni situatën e tillë. Këto janë taktika, të cilat çdokush i njeh dhe përdoret pabesisht foltorja e Kuvendit. Mund të vazhdoni, por nuk jeni korrektë! Vazhdo, urdhëro! Të tjerët i lus për qetësi!

GLAUK KONJUFCA: Sa i përket rezolutës, unë mendoj se s'ka pasur rezolutë moti më të dobët në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe kjo është arsyeja pse i kemi pasur vërejtjet tona.

Vetëm paragrafi i parë i rezolutës është ashtu siç duhet, sepse e etablon UÇK-në ashtu sikur që është ajo. Pra, luftë çlirimtare, e drejtë, mbrojtëse, kundër ushtrisë, kundër policisë serbe, kundër administratës serbe në Kosovë, e kështu me radhë.

Mirëpo, kjo rezolutë i ka 12 pika. Pra, edhe 11 të tjerat janë herë të dobëta, herë të panevojshme.

Për shembull, pse këtu flitet në shumë paragrafë për kufizimin e të drejtave të ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

Shikoni! Paragrafi 4, thotë: "Edhe pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë të drejtat dhe liritë e tyre themelore, të garantuara me Kushtetutë, dhe këto të drejta nganjëherë mund të kufizohen me ligj, kur është e domosdoshme për të pasur ne demokraci që të funksionojë ligji", e kështu me radhë.

Paragrafi tjetër thotë: "Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore me Kushtetutë..." Paragrafi 5 e thotë të njëjtën.

Ne kemi shkruar rezolutë të tregojmë se në çfarë raste specifike duhet kufizuar të drejtat e atyre që kanë dalë atje dhe po përballen me gjykatën, apo për çka është kjo rezolutë.

Tjetra! Këtu flitet e thuhet: “Pjesëtarët e UÇK-së që po përballen me gjykata të mbrohen sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

A po më tregoni ju mua qysh mbrohet ushtari i UÇK-së tash, ku e gjeni në Kushtetutë një fjalë që mund të mbështeteni se Kushtetuta e mbron ushtarin e UÇK-së kur është duke u përballur atje me gjyqtarë të EULEX-it.

A po doni t’ju kallëzoj sa e mbron Kushtetuta një ushtar të UÇK-së, kur është duke u përballur me drejtësinë? Asnjë milimetër më shumë se Enver Sekiraçën! Asnjë milimetër nuk e mbron Kushtetuta jonë një ushtar të UÇK-së më shumë se Sekiraçën. Hiç, asnjë milimetër! Dhe, aso Kushtetute kemi ne.

E për ta bërë rezolutën si është dashur, për mendimin tim, pa qenë edhe 4 pika aty, nuk është rezolutë e mirë. Nuk është e mirë!

Qe po ua them shpejt. Në rregull ajo pika 1 duhet të jetë, po pajtohem me pjesën e parë kur thotë: “Lufta e UÇK-së është lufta e drejtë e popullit shqiptar, bile, të Kosovës, kundër okupatorit serb, kundër Serbisë e kështu me radhë”...

Po fjalia e dytë në atë pikën e parë duhet të jetë: “UÇK-ja të futet në preambulë të Kushtetutës dhe të mbrohet si vlerë”.

E dyta. “Kuvendi i Kosovës nuk pajtohet me dënimin e ushtarëve të UÇK-së nga proceset gjyqësore të EULEX-it, kryesisht me prova të fabrikuara nga Serbia”. Kjo duhet të jetë pika e dytë.

Çka kemi bërë ne sot, si e kemi mbrojtur ne sot “Grupin e Drenicës”, nëse ata janë dënuar me vendim të prerë, nëse ne nuk e qesim një pikë në rezolutë ku themi: “Ne nuk e njohim atë dënim”.

Pra, këtu janë dy mundësi, zonja e zotërinj! Ose e njohim atë dënim që na ka ndodhur, ose nuk e njohim.

Nëse e njohim, kot kemi folur. Kot jemi ankuar, s’po na pëlqen!

Jo, jo, a jeni për ta njohur apo për të mos e njohur? Unë jam për ta futur si pikë të dytë të rezolutës: “Kuvendi nuk pajtohet me dënimin e ushtarëve të UÇK-së nga EULEX-i të dënuar me prova të fabrikuara prej Serbisë”. Pikë!

3. “Kuvendi nuk e njeh autoritetin e EULEX-it ta gjykojë UÇK-në”. Nuk ka të drejtë ta gjykojë EULEX-i UÇK-në. Kuvendi nuk ia njeh këtë të drejtë.

Dhe, pse nuk guxojmë ne të themi kështu? Çka na kushton neve të themi kështu.

Dhe 4. “Të shfuqizohen nenet e Gjykatës Speciale”, që kanë ndodhur në Kuvendin e Kosovës.

Nëse i bëjmë këto pika dhe nëse i shkruajmë këto 4 pika mund të themi se Kuvendi ka nxjerrë rezolutë për ta mbrojtur UÇK-në e për të mos na ndodhur edhe 6-7 raste të tjera, si “Rasti Drenica 2”.

E nëse ne nuk veprojmë në këtë drejtim, do të mbajmë edhe këso seanca të tjera, do të flasim deri në orët e vona dhe do të nxjerrim një rezolutë me 12 pika, ku ne themi si mund të kufizohen herë pas here të drejtat dhe liritë e ushtarëve të UÇK-së, por lutemi dhe bëjmë thirrje që ata të trajtohen si qytetarë të barabartë të këtij vendi, dhe kurrë më shumë.

Çfarë thirrje po bëjmë ne sot si Kuvend me këtë rezolutë, që lexoni pikat aty, kur thirrja kryesore e këtij Kuvendi është: Ju lutemi a na i trajtoni edhe ushtarët e UÇK-së si ata kur bëjnë vepra penale të krimit ordiner, që s’bën t’u cenohen, sepse kanë të drejtë edhe ata të shkretë për gjykim të paanshëm, që po quhet, dhe a bën edhe ushtarët e UÇK-së të jenë për gjykim të paanshëm. Pse s’po thoni është gjykim i padrejtë, pse s’po thoni s’pajtohem, pse s’po thoni nuk e njohim. Dhe atëherë, kur të thuhet ajo, atëherë kemi bërë rezolutë për ta mbrojtur UÇK-në.

KRYETARI: Edhe një herë, po mundohem sa më shumë ta evitoj konfliktin, por pothuaj se nëse vazhdoni kështu, me tendenca shumë të qarta, unë si kryetar i Kuvendit nuk mund të marr përgjegjësi për eskalimin tuaj. E ju, çfarëdo fjale që flisni vetëm “taksirat” ndillni ndaj njërit-tjetrit. I paçi në qafë familjet tuaja, për arsye se po tentoni, po nxitni, por unë s’marr përgjegjësi, edhe pse po mundohem t’i evitoj, e t’i largoj, e ju pos fjalëve vrasje, kriminel, e keni vë më, e keni instaluar në këtë Kuvend. Dhe, ruajuni! Ishalla s’e vrani vetën.

Dëgjo, thjesht! Sepse, për besë, e rëndë është kjo! Është mesazh për qytetarët në situata të tilla, sot jemi takuar për disa bashkëluftëtarë, por s’i intereson kujt ajo punë. Ideja është si duhet goditur, dhe të goditet sa më rëndë, sa më ulët. Dhe, sido që të jetë, le ta dinë të gjithë, populli i Kosovës, përfshirë edhe familjet tuaja, “taksirati” është duke u thirrur. Thjesht! Dhe, secili e bart për veti. E unë do të mundohem t’u ruaj, do të mundohem të di kur mund të ndodhë e keqja, edhe ta fus sigurimin, por thjesht, vërtet është shumë e rëndë.

E kanë kërkuar fjalën disa deputetë për reagim. Pal Lekaj, po por kanë kërkuar disa prapë. A bën të mos reagohet fare dhe ta mbyllim këtë pjesë? Atëherë, fjalën e ka Pal Lekaj, e pastaj Bislim Zogaj, Hajdar Beqa dhe Shaip Muja e kanë kërkuar fjalën.

E unë, kisha ftuar që pas Pal Lekajt të përfundohet kjo punë, sepse edhe ashtu është e mjaftueshme.

PAL LEKAJ: Të nderuar kolegë!

Sa i përket rezolutës, ne kemi biseduar dhe është e vërtetë se Glauku nuk është pajtuar, por të eskalojë situata dhe këtu të përmenden shumë gjëra që nuk e kanë vendin, besoj se është për t'u gjykuar nga qytetarët. Dhe, mos mendoni se qytetarët s'po na përcjellin.

Ne sot kemi ardhur këtu të kundërshtojmë një padrejtësi, jo drejtësinë. Sepse drejtësinë kurrkush nuk e kundërshton. Dhe, si Grup Parlamentar jemi munduar të japim më të mirën e mundshme për këtë vend, për ata luftëtarë të lirisë.

Mendoj që shembulli më i mirë se si respektohet drejtësia ka qenë lideri ynë, zoti Ramaush Haradinaj. Prej pozitës së kryeministrit ka shkuar në Hagë, e ka mbrojtur luftën e Ushtrisë Çlirimtare dhe është kthyer bashkë me shokët fitimtarë këtu. Është Fatmiri, është Lahiu e shumë e shumë të tjerë.

Prandaj, ne mendoj se nuk guxojmë si kolegë, si ata që kemi marrë votën, sepse edhe ne kemi familje dhe çdo kush prej nesh nuk guxojmë ta atakojmë njëri-tjetrin. Është prokuroria, për të gjitha ato bëma le të vendosë, por nuk jemi ne që të gjykojmë.

Prandaj, në këtë drejtim, ju lutem të përfundojmë këto debate, sepse nuk i kontribuojnë as vendit, as qytetarëve, as luftëtarëve të lirisë dhe sidomos kur shkelet mbi atë më të shenjtën që kanë dhënë jetën për liri dhe sot prehen qetë në altarin e lirisë.

Pra, ju kisha lutur të kemi vëmendje, të jemi të kulturuar, të civilizuar dhe të mos sillemi kështu. Nuk dua ta atakoj askënd, por po them atë që duhet të veprojmë. Dhe, ajo që është e mirë në këtë rezolutë, u tha. Dhe ne të gjithë biseduam sa i përket pasusit të fundit.

Pra, hajde të nxjerrim ligjin që i mbron këto vlera. Dhe, në kuadër të ligjit, krejt kjo rezolutë dhe çfarëdo që të kishim shkruar, nuk është në kundërshtim me parimet e ushtarëve apo të çlirimit të Kosovës. Por, ajo që është kryesorja, është pasusi i fundit që për 6 muaj të nxjerrim ligjin për vlerat e luftës, për luftëtarët e lirisë, për ushtrinë, për vendin dhe me këtë nuk do ta mbrojmë njëri-tjetrin për të marrë poenë politike.

Prandaj kjo është ajo që ne duhet të veprojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bislim Zogaj e ka fjalën! Të jemi të shkurtër, sepse s'keni nevojë të rëndohet, sepse bolla është rënduar. Urdhëro!

BISLIM ZOGAJ: Vetëm desha të sqaroj dhe të jem shumë i shkurtër!

Është e vërtetë që thashë se kanë ndikuar në themelimin e Gjykatës Speciale dhe të EULEX-it me akuzat që i kanë bërë për çdo ditë nëpër portale dhe tubime, por ajo çfarë është më e keqja, se çka flasin atje është punë e tyre, po në Parlament. Në Parlament po them më së paku dy herë, më së paku dy deputetë i kanë thënë kryetarit të Parlamentit “kriminel”. Në qoftë s’kanë thënë, atëherë le të deklarohet, por i kanë thënë “kriminel”.

E sqarova edhe pak më herët, se “kriminel” do të thotë vrasës, sikur për shembull, që është kriminel lufte. Dhe nuk di si ndryshe është, e sikur të kishin thënë kriminel ekonomik, a kriminel lloj-lloj tjetër, por kanë thënë vetëm “kriminel”. Do të thotë kriminel lufte.

Unë besoj se mjafton kjo dhe nuk e di se qysh mund të thotë “nuk ka thënë kurrkush kriminel”, kur këtu disa herë është thënë. Dhe, përveç kësaj që ka ndikuar në këtë situatë, është edhe fakti që sa kanë dëshirë që komandantët e UÇK-së të jenë në burg, fakti kur është liruar Azem Syla për dy javë apo tri, u mbajt konferencë për shtyp dhe thanë: “Këqyre, EULEX-in e ka kapur PDK-ja dhe e liruan nga burgu”.

Do të thotë, këta kanë qejf në burg t’i shohin të gjithë komandantët, prandaj edhe kjo më shtyri të besoj se këta, përveç këtyre publike që janë, ka edhe të tjera, që sigurisht nuk i dimë.

KRYETARI: Kështu, në qoftë se ishim pajtuar, do ta kishim përfunduar këtë pjesë dhe unë kam një propozim për këtë temë, ta kemi të veçantë. Do ta inicioj si deputet, e pastaj do t’ua sjell të gjithë juve për ta nënshkruar dhe të flasim vetëm në këtë aspekt, një ditë, në një seancë të veçantë.

Sot po e përfundojmë këtë për luftëtarë, nëse bëhet? Pra, po e përfundojmë këtë, se po na shohim familjet e tyre dhe të gjithë bashkëluftëtarët dhe ta përfundojmë këtë, e pastaj do ta kemi një seancë rreth terminologjisë dhe gjërave konkrete, lidhur me çka po ua jep fjalën se iniciativa do të jetë imja. Pra, do të jetë kjo brenda muajit nëntor.

Pra, sa deputetë i kemi në sallë? Janë 57 dhe jemi në pjesën e votimit. Shqip, të lutem, se do të flasim në një seancë, ndoshta në dhjetor, vetëm për këto çështje, për këtë po jua jap fjalën.

Atëherë, në orën 10:00 do ta vazhdojmë këtë seancë dhe pastaj e kemi edhe një seancë të rregullt, të cilën duhet ta vazhdojmë. Mirupafshim nesër, në vazhdimin e punës së seancës!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 27 tetor
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Do të kishte qenë mirë të hyni në Kuvend. Për hir të korrektësisë, seanca është dashur të fillojë në orën 10:00. Ismajl për atë jam dëshiruar të shprehem në qoftë se më lejon.

Do të duhej ta fillonte njëri nga nënkryetarët në orën 10:00, qysh dje është ditur, se ka qenë konferenca e cila është duke u mbajtur në Pallatin e Rinisë për teknologji informative. Sido që të jetë, nuk mund t'ia imponoj askujt, por është ditur që dje se deri në orën 10:30 nuk mund të jem në seancë. Vetëm këtë desha t'jua them deputetëve për hir të korrektësisë. Nëse mund ta arrijmë numrin e 60 deputetëve në sallë, që të procedojmë, se jemi në pjesën e votimit.

Atmosfera në Kuvend ka filluar të bëhet shumë e rëndë, pastaj askush nuk po do të marrë përgjegjësi. Tani në sallë janë 65 deputetë, mund të fillojmë të procedojmë.

Urdhëro, Aida Dërguti e ka fjalën.

AIDA DËRGUTI: Kryetar, pa e deleguar ju detyrën se cili nënkryetar ta udhëheqë seancën, unë nuk mund ta marr përsipër. Unë këtu kam qenë e pranishme prej orës 10:00.

KRYETARI: Edhe kjo është shumë e vërtetë, por dje kam treguar se nuk do të jem unë, është e vërtetë se nuk e kam përcaktuar cili, por duke menduar se do ta marrë ndonjëri prej nënkryetarëve. Kjo është e vërteta.

Mbi 65 deputetë janë në sallë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Debati për vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në raport me situatën e krijuar ka përfunduar, kërkohet deklarimi me votim për miratimin ose jo të projektrezolutës së propozuar nga grupet parlamentare PDK, LDK, AAK dhe "Nisma".

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 72 deputetë, 11 kanë abstenuar, 61 kanë votuar për. Kuvendi e miratoi Rezolutën për vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Me këtë i mbyll punimet e seancës së jashtëzakonshme.

(Reagime nga salla)

Lus njërin nga deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” që ta lexoj Draft-rezolutën tjetër, e votojmë edhe draft-rezolutën tjetër, cila të ketë më shumë vota kalon.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë që të jemi korrektë, vetëm deshëm ta propozojmë një rezolutë alternative.

Në mbështetje të nenit 65, paragrafi 1 i Kushtetutës mbi kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe nenit 6, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, pas diskutimeve në seancën e 27 tetorit 2016, deputetëve të Kuvendit të Kosovës ua propozon këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Ushtria Çlirimtare e Kosovës të futet në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të mbrohet si vlerë.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk pajtohet me dënimin e ushtarëve të UÇK-së nga proceset gjyqësore të EULEX-it, kryesisht me prova të fabrikuara nga Serbia,
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk e njeh autoritetin e EULEX-it për ta gjykuar UÇK-në, si dhe
4. Të shfuqizohen nenet e Gjykatës Speciale, të miratuara më 3 gusht 2015 në këtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Mendojmë që po të votohej kjo rezolutë do të ishte garancia më e mirë qysh mbrohet lufta e UÇK-së dhe UÇK-ja si vlerë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A shkojmë në votim drejt? A e kemi pasur edhe në procedurë, kur ka qenë rasti i komandantit të Policisë, z. Nehat Thaçi, në të njëjtën mënyrë janë votuar dy projekt-rezoluta, njëra ka kaluar. Për atë arsye, kalon ajo e cila merr vota më shumë. Kjo është kështu, të mos e eliminojmë si mundësi. E procedojmë, apo dëshironi të shpërndahet materiali?

Shefat e grupeve parlamentare, urdhëro Zenun Pajaziti, PDK?

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Dje e kemi ftuar këtë debat me një kërkesë të përsëritur këtu që duhet ta gjejmë një gjuhë të përbashkët për të theksuar në përputhje me Kushtetutën edhe ligjet në fuqi, një mbështetje aq sa mund për vlerat e UÇK-së.

Me krejt ato çka është thënë dje këtu është goxha e padrejtë e pamoralshme që të dilet kështu në këtë mënyrë edhe pastaj të luhet, edhe me opinionin, edhe me këto kërkesa.

Nuk mendoj që pas rezolutës që e votuam ne, e që ishte si qëndrim i shumicës së deputetëve, do të ishte mirë të ishin edhe ata që sot dolën me rezolutë të re, ose me tekst të ri, por këtë nuk e bënë sikur gjithherë, asnjëherë nuk janë bashkë në asnjë çështje që është në interes për vendin dhe ne nuk do ta votojmë.

KRYETARI: Ismet Beqiri nga Lidhja Demokratike e Kosovës?

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Ne fjalën tonë e dhamë me votën që e bëmë dhe nuk e kemi ndërmend me dy fytyra për njëjtën çështje. Ne e kemi dhënë votën tonë dhe normalisht që nuk do ta votojmë.

KRYETARI: Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca. Ju e keni procedurën, s’di pse ta...

GLAUK KONJUFCA: Jo, vetëm që desha t’ia shpjegoj zotit Pajaziti që ne nuk mund të pajtohemi me atë që mendojmë që nuk është në rregull. Pra, kemi të drejtë ta rezervojmë mospajtimin tonë dhe kemi të drejtë t’i propozojmë zgjidhjet që mendojmë që janë më të mira se ato që i kemi parë që po propozohen me këtë rezolutë.

Ne i dhamë vërejtjet. Unë nuk po dua t’i përsëris, por mendojmë që po të merreshin këta katër hapa, duken kështu goxha radikalë, mirëpo ne mendojmë që nëse për këto krejt që na ndodhën nuk kthehemi, se nuk pajtohemi, atëherë një rezolutë e tillë që thotë se nuk pajtohemi me këto dënime që i kanë ndodhur grupit “Drenica II”, por edhe grupeve të mëhershme që janë dënuar prej UNMIK-ut apo prej EULEX-it, unë mendoj që nuk kemi ndryshuar diçka substancialisht.

Kështu që kjo rezoluta jonë e mundëson këtë, është zgjedhja e lirë e deputetëve që të vendosin qysh të duan ata.

KRYETARI: Dauti ose Pali, cili të dëshirojë. Daut Haradinaj, në emër të Aleancës.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

E para, domethënë ne e votuam një rezolutë pa e ditur çfarë rezolute e kemi të dytën dhe sipas meje edhe kjo natyrisht që do të ishte kërkuar t’i kishim materialet për ta parë se çfarë rezolute ka ofruar “Vetëvendosja”. Gjithsesi, ne e dhamë votën për, për shkak se dje është diskutuar dhe dje jemi dakorduar, përndryshe nuk është që nuk më pëlqeu rezoluta e Glaukut dhe për këtë arsye unë prapë do t’ia jap votën Rezolutës së Vetëvendosjes”. Personalisht, nuk po flas si grup.

Edhe një gjë tjetër, meqenëse nuk qenka ministri i Drejtësisë, nëse më lejon kryetar edhe një sekondë: Dje u diskutua shumë për akuza e kundërakuzat ndërmjet VV-së dhe PDK-së. Para katër vjetëve e kemi pasur një rast kur Policia e Kosovës e ka arrestuar katër serbë, të cilët ofronin shuma marramendëse për dëshmi false kundër pjesëtarëve të UÇK-së. Të njëjtit janë me video-incizim dhe audio-incizim. Të njëjtit janë në struktura udhëheqëse të UDB-së në Serbi dhe një prej zyrtarëve është edhe në pushtet në një komunë në periferi të Kosovës. Brenda Kosovës, nuk është në veri.

Pyetja është edhe publike edhe morale, edhe për secilin institucion, i cili ka përgjegjësi në Kosovë: A u bë gabim kur i arrestuan, apo u bë gabim kur i liruan? Sepse dje thoshin jo këtu ka deputetë, jo s'ka deputetë. I keni pasur me audio-incizim, me video-incizim, drejtësia në Kosovë i ka liruar ata serbë, të cilët kanë afruar ka 300 mijë euro për një deklaratë false kundër pjesëtarëve të UÇK-së dhe ata të njëjtit janë liruar dhe të njëjtit ushtrojnë funksione në institucionet e Kosovës dhe paguhet nga Buxheti i Kosovës. Për këtë arsye, e përkrah deklaratën ose Rezolutën e VV-së.

KRYETARI: Zoti Enver Hoti, fjala për ju.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

Ne e miratim një rezolutë që e patëm të propozuar nga shumica dhe mendoj e shpresoj që së paku do ta lexojnë ministrat tuaj, se besoj që nuk zbatohet, por së paku le ta lexojnë, sepse nuk e keni as në sallë këtu Qeverinë.

Ndërsa sa i përket propozimit të “Vetëvendosjes”, ajo është dashur të jetë më bashkëpunuese së paku me opozitën dhe sigurisht është një rezolutë që plotësisht i plotëson kërkesat edhe të aktualitetit dhe me të vërtetë e ka jashtëzakonisht rëndësinë e vet. Nëse del në votim, ne do ta mbështetim dhe urojmë edhe shpresojmë që “Vetëvendosja” edhe në një të ardhme tjetër ta bëjë një realitet në bazë të asaj rezolute që e paraqiti.

Por, fillimisht po them dhe edhe një herë po e përsëris që po shpresoj se shumë pak kanë për ta lexuar edhe atë që e miratim ministrat tu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Musliu, dhe më duhet ta lexoj Rregulloren.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolege dhe ju kolegë deputetë,

E dëgjova me vëmendje propozimin e Projekt-rezolutës së Lëvizjes “Vetëvendosje”, ku në pikën e parë thotë që Ushtria Çlirimtare e Kosovës të futet në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të mbrohet si vlerë. Unë mendoj që fillimisht duhet të bëhet inicimi i plotësim-ndryshimit të Kushtetutës dhe pastaj mund të shqyrtohen këto pika.

Nëse mendojnë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ne mund ta iniciojmë plotësim-ndryshimin e Kushtetutës dhe të kemi vota për këtë çështje, unë e mbështes plotësisht këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, po e shoh që në rastin e drejtorit të Policisë, Nehat Thaçi, ka pasur një konsensus për ta vënë rezolutën tjetër në votim, e tash po e shoh që nuk kemi konsensus, zonja Musliu e tha shumë mirë: iniciativën për ta ndërruar Kushtetutën e procedojmë me 2/3 e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Presim prej Lëvizjes “Vetëvendosje”...

Më lejo veç ta lexoj rregulloren, Glauk! Neni 52. Mocioni përmbajtjesor, nëse është rezolutë i dërgohet Zyrës për Propozime dhe Parashtrësja jo më vonë se tetë ditë pune para deputetëve në mbledhje, përveç kur është një çështje urgjente. Urgjente ka qenë dje, e kemi bartur, tash deputetët nuk po e përkrahin.

Nuk e hedh në votim, në qoftë se keni seriozitet të marrim masa për ndërrimin e Kushtetutës me 2/3 e votave, edhe unë jam kurioz ta shoh sa e keni seriozisht vetëm që të mos e bllokoni këtë rezolutën tjetër, se ju po e dini shumë mirë se ajo kalon me 2/3 e votave. Preambula e Kushtetutës duhet me 2/3 e votave. Mirë është shumë, ekstra patriotizëm veç sa për të mos e votuar. Silleni, unë po jua jap fjalën që kam për ta vënë pikë të rendit të ditës. Propozimi juaj, pika e parë është e shkëlqyeshme në qoftë se e doni kaq shumë UÇK-në. Preambulën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, po jua jep fjalën, pa filluar Partia Demokratike e Kosovës, unë do të ju përkrah.

Atëherë, me këtë i mbyll punimet e seancës së jashtëzakonshme. Seanca e rregullt fillon në orën 11:00.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*